



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 103

Tiranë – E mërkurë, 17 korrik 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 39/2019 datë 20.6.2019	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shërbimet ajrore..... 7513
Dekret i Presidentit nr. 11220, datë 11.7.2019	Për shpallje ligji..... 7526
Ligj nr. 40/2019 datë 20.6.2019	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin..... 7526
Dekret i Presidentit nr. 11221, datë 11.7.2019	Për shpallje ligji..... 7539
Ligj nr. 41/2019 datë 20.6.2019	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. dhe KfW-së, Frankfurt am Main, për Programin e Investimeve për Shpërndarjen e Energjisë Elektrike I..... 7539
Dekret i Presidentit nr. 11222, datë 11.7.2019	Për shpallje ligji..... 7557
Dekret i Presidentit nr. 11224, datë 12.7.2019	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 7558
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 15.7.2019	Për emërimin e drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve..... 7558
Udhëzim i ministrit i Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 3, datë 20.6.2019	Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli..... 7558

Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 243, datë 9.7.2019	Për miratimin e rregullores mbi procedurën e klasifikimit të strukturave akomoduese me 4 apo 5 yje, që janë mbajtes të një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht “brand name”	7561
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 53, datë 3.7.2019	Për dhënien e miratimit paraprak për bashkimin me përthithje të Bankës Union sh.a me Bankën Ndërkombëtare Tregtare sh.a.....	7568
Vendim i Entit Rregullator Energjisë nr. 102, datë 26.6.2019	Mbi miratimin e “Propozimit të të gjitha OST-ve të Evropës Kontinentale për karakteristikat shtesë të rezervave të mbajtjes së frekuencës (FCR) në përputhje me nenin 154 (2) të rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 të datës 2 gusht 2017 që përcakton një udhëzues për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”	7568
Vendim i Entit Rregullator Energjisë nr. 104, datë 26.6.2019	Për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017, “Për miratimin e rregullores për kriteret standarte të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, të ndryshuar.....	7580
Vendim i Entit Rregullator Energjisë nr. 105, datë 26.6.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “Terna energy trading” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	7582
Vendim i Entit Rregullator Energjisë nr. 106, datë 26.6.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	7583
Vendim i Entit Rregullator Energjisë nr. 107, datë 26.6.2019	Për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 83, datë 31.5.2019, mbi licencimin e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Thirrë” me kapacitet të instaluar 1.820 mw.....	7584
Vendim i Entit Rregullator Energjisë nr. 108, datë 26.6.2019	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Besta” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Kucova 2”, me kapacitet të instaluar 2 mw.....	7585
Vendim i Entit Rregullator Energjisë nr. 111, datë 10.7.2019	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2019.....	7586
Vendim i Gjykatës Administrative të Apelit nr. 111, datë 6.5.2019	Me objekt shfuqizimin e pjesëshëm të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, dhe konkretisht të pikës 12, të nenit 34, siç është ndryshuar nga neni 23, i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 231 datë 21.3.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, me këtë përmbajtje: “Për objektet në kompetencë të Këshillit Kombëtar të Territorit, sipas nenit 19, të kësaj rregulloreje, distancat midis objekteve mund të përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit me rregullore të posaçme, të miratuara prej tij”	7589
	Ndreqje gabimi material në vendimin nr. 381, datë 12.6.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për përzgjedhjen, kontraktimin e pagesën e avokatëve ose zyrtarëve të avokatisë vendase ose të huaja”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 86, datë 14 qershor 2019.....	7622



LIGJ
Nr. 39/2019

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLITË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
MBRETËRISË SË ARABISË SAUDITE,
PËR SHËRBIMET AJRORE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite për shërbimet ajrore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.6.2019

Shpallur me dekreten nr. 11220, datë 11.7.2019
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta.

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË MBRETËRISË SË ARABISË
SAUDITE MBI SHËRBIMET AJRORE

PREAMBULË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Arabisë Saudite (të referuara më poshtë si “Palët”);

Duke qenë Palë të Konventës së Aviacionit

Civil Ndërkombëtar, të hapur për nënshkrim më 7 dhjetor 1944 në Çikago;

Duke dëshiruar të promovojnë një sistem aviacioni ndërkombëtar bazuar në konkurrencën ndërmjet linjave ajrore në treg dhe rregullimin dhe ndërhyrjen minimale të qeverisë;

Duke dëshiruar të lehtësojnë zgjerimin e mundësive të shërbimeve ajrore ndërkombëtare;

Duke pranuar që shërbimet ajrore ndërkombëtare konkurruese dhe efikase rrisin tregtinë, mirëqenien e konsumatorëve dhe zhvillimin ekonomik;

Duke dëshiruar të mundësojnë që linjat ajrore t’i ofrojnë udhëtimit dhe transportit publik një sere mundësish të shërbimeve me çmimet më të ulëta që nuk janë diskriminuese dhe nuk përfaqësojnë abuzim me detyrën dominuese, dhe duke dëshiruar të inkurajojnë shoqëritë ajrore individuale të zhvillojnë dhe implementojnë çmimet konkurruese dhe novatore; dhe

Me dëshirën për të garantuar shkallën më të lartë të sigurisë dhe të mbrojtjes në shërbimet ajrore ndërkombëtare dhe duke rikonfirmuar shqetësimin e tyre të thellë për aktet ose kërcënimet kundër sigurisë së avionit, të cilët rrezikojnë sigurinë e personave apo pronës, ndikon negativisht në funksionimin e shërbimeve ajrore dhe dëmtojnë besimin e publikut në sigurinë e aviacionit civil.

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

Për qëllimin e kësaj marrëveshje, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe:

1. Termi “Konventë” nënkupton Konventën e Aviacionit Civil Ndërkombëtar, të hapur për nënshkrim në Çikago në datën 7 dhjetor 1944 dhe përfshin çdo shtojcë dhe amendament të miraturar sipas neneve 90 dhe 94 të Konventës, në masën që këto shtojca dhe amendamente kanë hyrë në fuqi ose janë ratifikuar nga të dyja palët.

2. Termi “Autoritetet Aeronautike” nënkupton, në rastin e Qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, Autoritetin e Përgjithshëm të Aviacionit Civil dhe në rastin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, në personin e Autoritetit të Aviacionit Civil, dhe në të dyja



rastet çdo person tjetër ose organ i autorizuar për të kryer funksione të cilat lidhen me këtë Marrëveshje.

3. Termi “linjë ajrore e përcaktuar” nënkupton një linjë ajrore, e cila është përcaktuar dhe autorizuar në përputhje me nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje;

4. Termi “tarifë” nënkupton çdo çmim që duhet të paguhet për transportimin e pasagjerëve, ngarkesave dhe bagazheve dhe kushtet në të cilat aplikohen këto çmime, duke përfshirë çmimet dhe kushtet për agjencinë dhe shërbime të tjera ndihmëse por duke përjashtuar shpërblimin dhe kushtet për transportin e postës;

5. Termi “territor” në lidhje me një shtet ka kuptimin e përcaktuar në nenin 2 të Konventës.

6. Termet “shërbim ajror”, “shërbim ajror ndërkombëtar”, “linjë ajrore” dhe “të ndaluar për qëllime mos-trafiku” kanë kuptimin përkatësish siç përshkruhet në nenin 96 të Konventës.

7. Termi “Marrëveshje” nënkupton këtë Marrëveshje, shtojcat e saj dhe secilin amendament në të.

8. Termi “Grafik” nënkupton Grafikun e linjave për të kryer shërbime të transportit ajror bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje dhe çdo amendamenti të saj, siç është rënë dakord në përputhje me dispozitat e nenit 170 të kësaj Marrëveshjeje.

9. Termi “kapacitet” në lidhje me “një avion” nënkupton pagesën për ngarkesën e atij avioni në dispozicion të një linje ose të një pjese të linjës.

10. Termi “pjesë këmbimi” nënkupton artikujt e një riparimi ose zëvendësimi për inkorporimin në një avion, duke përfshirë motorët.

11. Termi “pajisje e rregullt” nënkupton artikujt, përveç rezervave dhe pjesëve të këmbimit të një natyre të lëvizshme, për përdorim në bordin e një avioni gjatë fluturimit, duke përfshirë edhe ndihmën e parë dhe pajisjet e mbijetesës.

12. Termi “shërbime dhe pagesa aeroportuale” nënkupton pagesat e bëra në linjat ajrore për sigurimin e avionëve, ekuipazhit të tyre, pasagjerët e aeroportit dhe shërbimet e lundrimit ajror, duke përfshirë shërbime dhe pajisje të tilla.

13. Termi “transport ajror” nënkupton transportin publik nga avionët e pasagjerëve,

bagazheve, ngarkesave dhe postës, veçmas apo në kombinim, për dëmshpërblim ose me qira;

14. Termi “transport ajror i brendshëm” është transporti ajror në të cilin pasagjerët, bagazhet, ngarkesat dhe posta të cilat janë marrë në bord në territorin e një Shteti, janë të destinuara për në një pikë tjetër në territorin e të njëjtit Shtet;

15. Termi “transport ajror ndërkombëtar” është transporti ajror në të cilin pasagjerët, bagazhet, ngarkesat dhe posta të cilat janë marrë në bord në territorin e një shteti, janë të destinuara për në një shtet tjetër;

16. Termi “transport intermodal ajror” nënkupton transportin publik me avion dhe me një ose shumë mënyra sipërfaqësore të transportit të pasagjerëve, bagazheve, ngarkesave dhe postës, veçmas apo në kombinim, për dëmshpërblim ose me qira;

17. Termi “ONAC” është Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil;

18. Termi “kod-ndarje” nënkupton një marrëveshje bashkëpunuese marketingu ndërmjet dy apo më shumë linjave ajrore të përcaktuara për kryerjen e veprimeve.

Neni 2

Dhënia e të drejtave

1. Secila Palë i jep Palës tjetër të drejtat e specifikuar në këtë Marrëveshje, me qëllim krijimin dhe kryerjen e shërbimeve ajrore ndërkombëtare të programuara për linjat e specifikuar në Itinerarin e bashkëlidhur në këtë Marrëveshje. Shërbimet dhe linjat e tilla janë quajtur përkatësisht “shërbimet e pranuar” dhe “linjat e specifikuar”.

2. Një linjë ajrore e përcaktuar nga secila Palë, gjatë kryerjes së një shërbimi të miratuar në një linjë të caktuar, do të gëzojë ushtrimin e të drejtave të mëposhtme:

a) të fluturojë, pa ulje, në të gjithë territorin e Palës tjetër;

b) të bëjë ndalesa në territorin në fjalë për qëllime jo trafiku, dhe

c) të bëjë ndalesa në territorin në fjalë në pikat e caktuara për atë linjë në Itinerarin bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje, me qëllim që të ulin dhe marrin përsipër trafikun ndërkombëtar të pasagjerëve, ngarkesave, bagazheve dhe postës.



3. Ushtrimi i të drejtave të trafikut në pikat e ndërmjetme dhe më gjerë të specifikuar në itinerarin e linjave bashkëlidhur kësaj Marrëveshje, i nënshtrohet negocimit dhe marrëveshjes së linjave ajrore të përcaktuara të Palëve dhe miratimit të Autoriteteve të tyre Kompetente.

4. Nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, asgjë nuk do të konsiderohet se i jep linjës/linjave ajrore të një Pale privilegjin për të marrë në bord në territorin e Palës tjetër, pasagjerët, ngarkesat, bagazhet ose postën e kryer për shpërblim ose me qira dhe të destinuar për një pikë tjetër në territorin e Palës tjetër.

Neni 3

Përcaktimi dhe autorizimi

1. Secila palë do të ketë të drejtë t'i përcaktojë me shkrim Palës tjetër një ose më shumë linja ajrore për të kryer shërbimet e miratuara dhe të tërheqë ose ndryshojë një përcaktim të tillë.

2. Me marrjen e një përcaktimi dhe aplikimi të tillë, nga linja ajrore të përcaktuara, në formën dhe mënyrën e përshkruar për autorizim operimi, çdo Palë do të sigurojë autorizimin e duhur operativ me vonesë minimale procedurale, me kusht që:

a) Linja ajrore në thelb është dhe mbetet në pronësi dhe kontrollohet në mënyrë efektive nga shtetasit e Palës caktuese të linjës ajrore;

b) Pala përcaktuese e linjës ajrore është në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenin 13 (Siguria) dhe nenin 14 (Sigurimi i aviacionit); dhe

c) linja ajrore e përcaktuar është e kualifikuar për të plotësuar kushtet e tjera të përcaktuara në bazë të ligjeve dhe rregullave të aplikuara normalisht për funksionimin e shërbimeve të transportit ajror ndërkombëtar nga ana e Palës që merr përcaktimin.

Neni 4

Ndërprerja, tërheqja dhe kufizimi i autorizimit

1. Autoritetet aeronautike të secilës Palë do të kenë të drejtë të mbajnë autorizimet e përmendura në nenin 3 (Përcaktimi dhe autorizimi) të kësaj Marrëveshjeje në lidhje me

një linjë ajrore të përcaktuar nga Pala tjetër dhe të tërheqin, pezullojnë ose vendosin kushte të përkohshme ose të përhershme për autorizime të tilla në rast se:

a) ata nuk janë të kënaqur që linja ajrore në thelb është dhe mbetet në pronësi dhe kontrollohet në mënyrë efektive nga shtetasit e Palës përcaktuese të linjës ajrore;

b) pala që përcakton linjën ajrore nuk arrin të përmbushë dispozitat e përcaktuara në nenin 13 (Siguria) dhe nenin 14 (Sigurimi i aviacionit); dhe

c) linja ajrore e përcaktuar nuk është e kualifikuar për të plotësuar kushtet e tjera të përcaktuara në bazë të ligjeve dhe rregullave të zbatuara normalisht për funksionimin e shërbimeve të transportit ajror ndërkombëtar nga Pala e cila merr përcaktimin.

Neni 5

Facilitetet dhe tarifatat aeroportuale

1. Çdo Palë do të caktojë një aeroport ose aeroportet në territorin e saj për përdorimin nga linja/t ajrore të përcaktuar/a të Palës tjetër për linjat e specifikuar dhe t'i sigurojë linjës ajrore të përcaktuar të Palës tjetër mjete transmetuese, të aviacionit dhe meteorologjike dhe shërbime të tjera të nevojshme për funksionimin të shërbimeve të miratuara.

2. Asnjëra palë nuk do të imponojë ose lejojë që linjave ajrore të përcaktuara të Palëve të tjera, t'u vendosen tarifa shfrytëzimi më të larta se ato të vendosura në linjat e tyre ajrore të caktuara që kryejnë shërbime ajrore ndërkombëtare të ngjashme duke përdorur avionë, objekte dhe shërbime të tilla të ngjashme.

3. Secila Palë mund të kërkojë konsultime për tarifatat e shfrytëzimit dhe ndryshimet e vendosura për tarifa të tilla.

Neni 6

Përfashtimi nga detyrimet doganore dhe detyrime të tjera

1. Çdo Palë në bazë të reciprocitetit do të përfashtojë një linjë ajrore të përcaktuar të Palës tjetër, në masën më të plotë të mundur në bazë të ligjit të tij të brendshëm, nga detyrimet doganore, taksat, tarifatat e inspektimit dhe detyrimeve të tjera kombëtare dhe pagesave të



pabazuara në koston e shërbimeve të ofruara me mbërritjen e avionit, karburantit, vajrave lubrifikantë, pajisjeve teknike të konsumueshme, pjesëve të këmbimit, duke përfshirë motorët, pajisjet e rregullta të avionit, depozitat e avionit dhe dokumenteve zyrtare që mbajnë simbolin e kompanisë ajrore, të tilla si etiketat e valixheve, bileta e fluturimit, faturat e linjës ajrore, biletat e avionit, dhe oraret e importuara në territorin e destinuar për përdorim ose të përdorura vetëm në lidhje me funksionimin ose shërbimin e avionit të linjës ajrore të përcaktuar të Palës tjetër që kryen shërbimet e miratuara.

2. Përfshirjet e dhëna në paragrafin 1 do të aplikohen, gjithashtu, për:

a) depozitat e avionit të marrë në bord në territorin e një Pale brenda kufijve të aeroportit dhe brenda kufijve të përcaktuar nga autoritetet e Palës në fjalë, dhe për përdorim në bord nga avionët që dalin jashtë kufirit, të përfshirë në një shërbim ajror ndërkombëtar për llogari të Palës tjetër;

b) pjesët e këmbimit të hyra në territorin e secilës Palë, brenda kufijve të aeroportit dhe për mirëmbajtjen ose riparimin e avionëve, të përdorur në shërbimet ajrore ndërkombëtare nga linjat ajrore të përcaktuara të Palës tjetër;

c) karburanti dhe lubrifikantët për të furnizuar avionët që dalin jashtë kufirit që operojnë në shërbimet ndërkombëtare nga linjat ajrore të përcaktuara nga Pala tjetër, edhe kur këto furnizime janë për t'u përdorur në pjesën e udhëtimit të kryer mbi territorin e Palës në të cilën ata janë marrë në bord.

3. Pajisjet e rregullta të fluturimit, si dhe materialet dhe furnizimet që mbahen normalisht në bordin e avionit të një linjë ajrore të përcaktuar të secilës Palë, mund të shkarkohen në territorin e Palës tjetër vetëm me aprovimin e autoriteteve doganore të atij territori. Në rast të tillë, ato mund të vendosen nën mbikëqyrjen e autoriteteve në fjalë deri në kohën kur ato rieksporthen ose ndryshe kontrollohen në përputhje me rregullat doganore.

Neni 7

Parimet drejtuese të operimit të shërbimeve të miratuara

1. Linjës/linjave ajrore të përcaktuar/a të të dyja Palëve do t'u sigurohet në mënyrë të drejtë

dhe të barabartë kryerja e shërbimeve të miratuara në linjat e specifikuar.

2. Në kryerjen e shërbimeve të miratuara, linja/linjat ajrore të përcaktuara të secilës Palë do të marrin në konsideratë interesat e linjave ajrore të Palës tjetër që të mos ndikojnë padrejtësisht në shërbimet, të cilat ky i fundit i ofron në të gjithë ose në një pjesë të së njëjtës linjë.

3. Shërbimet e miratuara, të ofruara nga linja/linjat ajrore të përcaktuara të Palëve do të kenë si objektiv të tyre parësor sigurimin, në një faktor të arsyeshëm të kapacitetit të ngarkesës, të përshtatshëm për të kryer kërkesat aktuale dhe të arsyeshme të parashikuara për transportin e pasagjerëve, ngarkesave, bagazheve dhe postës mes territorit të Palës që përcakton linjën ajrore dhe territorit të Palës tjetër. Masa për transportin e udhëtarëve dhe të mallrave, duke përfshirë postën, të dyja të ngarkuara në bord dhe të shkarkuara në pikat e linjave të specifikuar në territoret e shteteve të tjera nga ato që përcaktojnë linjat ajrore, do të miratohet ndërmjet dy palëve meqë kapaciteti është i lidhur me:

a) kërkesat e trafikut për dhe nga territori i Palës, e cila ka përcaktuar linjën ajrore;

b) kërkesat e trafikut të zonës nëpër të cilat kalon shërbimi i miratuar, pas llogaritjes së shërbimeve të tjera të transportit të vendosura nga linjat ajrore të vendeve që përcaktojnë zonën;

c) kërkesat nëpërmjet operimeve të linjave ajrore.

4. Në mënyrë që linja/linjat ajrore të përcaktuara të sigurojnë trajtim të drejtë dhe të barabartë, vazhdimi i shërbimeve dhe kapacitetit të tyre, si dhe oraret e fluturimit do t'i nënshtrohen miratimit nga Autoritetet Aeronautike të të dyja Palëve. Kjo kërkesë duhet të plotësohet në rast të ndonjë ndryshimi, në lidhje me shërbimet e miratuara.

5. Autoritetet Aeronautike të të dyja palëve, nëse është e nevojshme, duhet të përpiqen për të arritur një marrëveshje të pranueshme në lidhje me itineraret e fluturimit, kapacitetet dhe frekuencat.



Neni 8

Miratimi i orareve

Linja ajrore e përcaktuar e secilës Palë duhet t'i paraqesë për miratim Autoriteteve Aeronautike të Palës tjetër oraret e propozuara, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e operimit të çdo shërbimi të miratuar. Oraret e tilla do të përfshijnë llojin e shërbimit dhe avionët që do të përdoren, itinerarin e fluturimit dhe çdo informacion tjetër përkatës. Kjo gjithashtu, do të zbatohet për çdo ndryshim të mëvonshëm. Në raste të veçanta ky afat kohor mund të reduktohet me miratimin e autoriteteve në fjalë.

Neni 9

Sigurimi i statistikave

Autoritetet aeronautike të secilës Palë do t'i sigurojnë autoriteteve Aeronautike të Palës tjetër, me kërkesën e tyre, informacione dhe statistika të tilla që lidhen me trafikun e kryer në shërbimet e miratuara nga linjat e tyre ajrore të përcaktuara për tek dhe nga territori i Palës tjetër ashtu si normalisht mund të përgatitet dhe të dorëzohet nga linja ajrore e përcaktuar për Autoritetet e saj Aeronautike Kombëtare. Këto të dhëna duhet të përfshijnë detajet mbi vëllimin, shpërndarjen, origjinën dhe destinacionin e trafikut. Të dhëna statistikore shtesë të trafikut të cilat Autoritetet Aeronautike të Palës mund të dëshirojnë nga Autoritetet Aeronautike të Palës tjetër, sipas kërkesës, do t'i nënshtrohen diskutimit dhe marrëveshjes të ndërsjellë ndërmjet dy Palëve.

Neni 10

Zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve

1. Ligjet dhe rregulloret e një Pale do të zbatohen për navigim dhe operim të avionit të linjës ajrore të përcaktuar nga Pala tjetër gjatë hyrjes, qëndrimit dhe nisjes nga territori i Palës së parë.

2. Ligjet dhe rregulloret e një Pale që rregullojnë hyrjen, qëndrimin dhe nisjen nga territori i saj të pasagjerëve, bagazheve, ekuipazhit, ngarkesës ose postës si formalitete të tilla në lidhje me hyrjen, daljen, emigrimin, imigrimin, doganat, monedhën, shëndetin dhe

karantinën do të aplikohen për pasagjerët, ekuipazhin, ngarkesat dhe postën e mbajtur nga avionët e linjës ajrore të përcaktuar të Palës tjetër ndërkohë që ndodhen brenda territorit në fjalë.

3. Çdo Palë, sipas kërkesës, do të pajisë Palën tjetër me kopjet e ligjeve dhe rregulloreve përkatëse të përmendura në këtë nen.

4. Asnjëra Palë nuk duhet t'i japë prioritet linjës ajrore të saj kundrejt linjës ajrore të përcaktuar të Palës tjetër, në zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve të parashikuara në këtë nen.

Neni 11

Transferimi i të ardhurave

1. Çdo Palë i jep linjës/linjave ajrore të përcaktuar/a të Palës tjetër të drejtën e transferimit fleksibël, në përputhje me rregullat e kursit të këmbimit të huaj valutor të Palës në territorin e së cilës llogariten të ardhurat, në lidhje me transportin e pasagjerëve, postës dhe ngarkesave. Për transferime të tilla nuk do të zbatohen tarifa të ndryshme nga tarifat bankare normale.

2. Nëse një Palë vendos kufizime në transferimin e të ardhurave të llogaritura nga linja ajrore e përcaktuar e Palës tjetër, ky i fundit ka të drejtë t'i vendosë kufizime reciproke linjës ajrore të përcaktuar të asaj Pale.

Neni 12

Njohja e certifikatave dhe licencave

1. Certifikata mbi vlefshmërinë për fluturim, certifikatat e kompetencës dhe licencat e lëshuara ose të bëra të vlefshme nga njëra Palë dhe që janë ende në fuqi, do të njihen si të vlefshme nga Pala tjetër, me qëllim që të kryejnë shërbimet e miratuara, me kusht që kërkesat në të cilat janë lëshuar ose bërë të vlefshme këto certifikata dhe licenca të jenë të barabarta ose mbi standardet minimale të cilat mund të jenë të vendosura në bazë të Konventës. Megjithatë, çdo Palë rezervon të drejtën të refuzojë për të njohur, me qëllim fluturimin sipër apo uljen brenda territorit të saj, certifikatat e kompetencës dhe licencat e dhëna shtetasve të saj nga Pala tjetër.

2. Nëse privilegjet apo kushtet e licencave apo certifikatave të referuara në paragrafin 1 më sipër, të lëshuara nga Autoritetet Aeronautike të



një Pale për ndonjë person ose linjë ajrore të përcaktuar, ose në lidhje me një avion që përdoret për operimin e shërbimeve të miratuara, lejojnë një ndryshim nga standardet minimale të përcaktuara në bazë të Konventës, ndryshim i cili është vendosur nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil, Pala tjetër mund të kërkojë konsultime ndërmjet autoriteteve aeronautike me qëllim shpjegimin e praktikës në fjalë.

Neni 13 Siguria ajrore

1. Secila palë mund të kërkojë konsultime në çdo kohë në lidhje me standardet e sigurisë të mbajtura nga Pala tjetër në fushat që lidhen me pajisjet aeronautike, ekuipazhin e fluturimit, avionin dhe operimin e avionit. Konsultime të tilla duhet të zhvillohen brenda tridhjetë ditëve nga paraqitja e kësaj kërkesë.

Nëse, pas konsultimeve të tilla, njëra Palë konstaton se Pala tjetër nuk mban dhe administron në mënyrë efektive standardet e sigurisë që përmbushin standardet e vendosura në atë kohë në përputhje me Konventën, Pala tjetër duhet të informohet për konstatimet e tilla dhe për hapat që konsiderohen të nevojshme për të qene në përputhje me standardet e ONAC-it. Më pas pala tjetër do të marrë masat e duhura korrigjuese brenda 13 trembëdhjetë ditëve ose në një periudhë kohe të caktuar.

2. Në mbështetje të nenit 16 të Konventës, çdo avioni që operon ose çdo avion që pronësia e tij nuk i përket linjës ajrore të përcaktuar ose as Palës në përputhje me dispozitat e përcaktuara të kësaj marrëveshje dhe është përdorur për të drejtuar kryerjen e shërbimeve ajrore në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje në dhe nga territori i Palës tjetër nëpërmjet kontratës së huadhënies nga një transportues ajror që i përket shtetit të secilës Palë ose shtetit të Palës së tretë, të jetë subjekt i një kërkimi nga ana e përfaqësuesve të autorizuar të palës tjetër. Pavarësisht detyrimeve të përmendura në nenin 33 të Konventës, qëllimi i këtij kërkimi është të verifikojë vlefshmërinë e dokumentacionit përkatës të avionëve, licencimin e ekuipazhit të saj, dhe nëse pajisjet dhe gjendja e avionit përputhen me standardet e vendosura në atë kohë në pajtim me Konventën, me kusht që të

mos shkaktojë vonesa të paarsyeshme në operimin e avionit.

3. Kur një veprim urgjent është thelbësor për të garantuar sigurinë e operimit të një linje ajrore, secila Palë ka të drejtë të pezullojë menjëherë autorizimin operativ të një linje apo linjave ajrore të Palës tjetër.

4. Çdo veprim i një Palë në përputhje me paragrafin 3 më sipër do të ndërpritet në momentin që arsyeja e marrjes së atij veprimi pushon së ekzistuari.

Neni 14 Sigurimi i aviacionit

1. Palët pohojnë se detyrimi i tyre ndaj njërit-tjetrit për të mbrojtur sigurimin e aviacionit civil ndaj akteve të ndërhyrjeve të paligjshme përbën pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje. Pa kufizuar përgjithësimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre sipas të drejtës ndërkombëtare, Palët në veçanti do të veprojnë në përputhje me dispozitat e Konventës mbi Kundërvajtjet dhe Aktet e tjera të caktuara, të kryera në Bordin e Avionit të nënshkruar në Tokio më 14 shtator 1963, Konventës për Ndalimin e Sekuestrimit të Paligjshëm të Avionëve të nënshkruar në Hagë më 16 dhjetor 1970, Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Aviacionit Civil të nënshkruar në Montreal më 23 shtator 1971 dhe Konventës për Shënjimin e Eksplozivëve Plastike me Qëllim Zbulimin, të nënshkruar në Montreal më 1 mars 1991, si dhe çdo konventë apo protokoll tjetër në lidhje me sigurimin e aviacionit civil në të cilin aderojnë të dyja Palët.

2. Palët do të sigurojnë sipas kërkesës, të gjithë ndihmën e nevojshme për njërit-tjetrit për të parandaluar aktet e sekuestrimit të paligjshëm të avionëve civil dhe akte të tjera të paligjshme ndaj sigurisë së këtyre avionëve, pasagjerëve dhe ekuipazhit të tyre, aeroportëve dhe pajisjeve të navigimit ajror, dhe çdo kërcënim tjetër ndaj sigurimit të aviacionit civil.

3. Në marrëdhëniet e tyre reciproke Palët do të veprojnë në përputhje me dispozitat e sigurimit të aviacionit të vendosura nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil dhe të përcaktuara si shtojcat e Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar në atë masë që



dispozita të tilla të sigurimit të jenë të zbatueshme për Palët, ata do të kërkojnë që operatorët e avionëve të regjistrit të tyre ose operatorët e avionit të cilët kanë qendrën e biznesit ose banim të përhershëm në territorin e tyre dhe operatorët e aeroporteve në territorin e tyre, të veprojnë në përputhje me këto dispozita të sigurimit të aviacionit.

4. Secila palë bie dakord që operatorëve të tillë të avionëve mund t'u kërkojë që të respektojnë dispozitat e sigurimit të aviacionit të përmendura në paragrafin 3 të kërkuar nga Pala tjetër për hyrjen, nisjen ose ndërsa ndodhen brenda territorit të kësaj Pale. Çdo Palë duhet të sigurohet që masat e duhura zbatohen në mënyrë efektive brenda territorit të saj për të mbrojtur avionin dhe për të kontrolluar pasagjerët, ekuipazhin, artikujt që merren me vete në kabinë, bagazhet, ngarkesat dhe depozitat e avionëve para dhe gjatë hipjes apo ngarkimit. Secila palë do të marrë në konsideratë me dashamirësi çdo kërkesë të Palës tjetër për masa të arsyeshme të sigurimit të veçantë për t'u përballur me një kërcënim të caktuar.

5. Kur një incident apo kërcënim për një incident të konfiskimit të paligjshëm të avionit civil apo akteve të tjera të paligjshme kundër sigurisë së avionëve të tillë, ndodh me pasagjerët dhe ekuipazhin e tyre, aeroportet apo objekteve ajrore të navigacionit, Palët duhet të ndihmojnë njëra-tjetrën duke lehtësuar komunikimin dhe masa të tjera të përshtatshme që synojnë të përfundojë shpejt dhe i sigurt një incident ose kërcënim i tillë.

Neni 15

Përfaqësimi i linjave ajrore tregtare

1. Linja/linjat ajrore të përcaktuara të njëres Palë kanë të drejtë, në përputhje me ligjet dhe rregullat që lidhen me hyrjen, qëndrimin dhe punësimin e Palës tjetër, për të sjellë dhe për të mbajtur në territorin e Palës tjetër personelin e vet menaxherial, teknik, operacional dhe specialistë të tjerë që janë të nevojshëm për masat e shërbimeve ajrore aktuale.

2. Këto kërkesa të personelit, në variantin e linjës apo linjave ajrore të përcaktuara të një Pale, mund të plotësohen nga personeli i vet ose duke përdorur shërbimet e ndonjë organizate, shoqërie

apo linje ajrore që operon në territorin e Palës tjetër dhe të autorizuar për të kryer këto shërbime për linjat e tjera ajrore.

3. Përfaqësuesit dhe personeli do t'i nënshtrohen ligjeve dhe rregullave në fuqi të Palës tjetër, dhe në përputhje me ligjet dhe rregullat e tilla:

a) secila Palë në bazë të reciprocitetit dhe me vonesë minimale, do t'u japë përfaqësuesve dhe personelit, autorizimet e nevojshme të punësimit, vizave për vizitorë ose dokumente të tjera të ngjashme të referuara në paragrafin 1 të këtij neni, dhe

b) të dyja Palët do të lehtësojnë dhe përshpejtojnë kërkesat e autorizimeve të punësimit për personelin që kryejnë detyra të caktuara të përkohshme.

Neni 16

Tarifat

1. Tarifat që duhet të vendosen nga linja/linjat ajrore të përcaktuara të Palëve për shërbimet e miratuara, do të vendosen në nivele të arsyeshme, për shkak të kujdesit që u është kushtuar të gjithë faktorëve përkatës, duke përfshirë koston e operimit, fitimin e arsyeshëm, karakteristikat e shërbimit dhe tarifën e linjave të tjera ajrore që kryejnë shërbime të planifikuara mbi të gjithë apo një pjesë të së njëjtës linjë.

2. Tarifat e referuara në paragrafin 1 të këtij neni, nëse është e mundur, do të përcaktohen mbi bazën e vlefshmërisë së kërkesës dhe ofertës në treg.

3. Tarifat e implementimit duhet të depozitohen tek Autoritetet Aeronautike të të dyja Palëve me qëllim mbajtjen e të dhënave dhe reagimin e duhur ndaj çdo sjellje të padrejtë konkurruese në treg.

4. Nëse lind ndonjë mosmarrëveshje midis linjës/linjave ajrore të përcaktuara të të dyja Palëve për shkak të praktikave konkurruese të padrejta në treg në lidhje me implikimet e tarifave, ajo duhet të zgjidhet në përputhje me dispozitat e nenit 33 (Zgjidhja e mosmarrëveshjeve) të kësaj Marrëveshjeje.

5. Palët do të përpiqen për të siguruar që ekzistojnë mekanizma aktive dhe efektive brenda juridiksioneve të tyre për të hetuar shkeljet nga çdo linjë ajrore, pasagjer ose agjent malli,



organizatator udhëtimi, ose dërgues malli, të tarifave të përcaktuara në përputhje me këtë nen. Për më tepër ata do të sigurojnë që shkelja e tarifave të tilla të dënohet nga masat parandaluese mbi baza të qëndrueshme dhe jo diskriminuese.

Neni 17

Konsulenca dhe ndryshimi

1. Në frymën e bashkëpunimit të ngushtë, të dyja Palët ose Autoritetet e tyre Aeronautike do të konsultohen me njëra-tjetrën herë pas here, me qëllim që të sigurohet zbatimi dhe pajtueshmëria e pranueshme me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe shtojcave të saj.

2. Nëse ndonjëra palë konsideron të përshtatshme të ndryshojë ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, ajo mund të kërkojë konsultime me Palën tjetër. Një konsultim i tillë do të fillojë brenda një periudhe prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga data e kërkesës. Çdo amendament i miratuar do të hyjë në fuqi kur ato të jenë konfirmuar nga një shkëmbim i të dhënave diplomatike sipas procedurave të brendshme ligjore.

3. Amendamentet që lidhen vetëm me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, përveç atyre të shtojcave të itinerareve dhe memorandumit të mirëkuptimit, do të miratohen nga çdo Palë në përputhje me procedurat e saj të brendshme ligjore.

4. Amendamentet që lidhen vetëm me dispozitat e shtojcave të itinerareve dhe memorandumit të mirëkuptimit mund të miratohen ndërmjet Autoriteteve Aeronautike të të dyja Palëve. Amendamente të tilla do të hyjnë në fuqi sapo të miratohen nga të dyja Autoritetet Aeronautike.

Neni 18

Sigurimi i dokumenteve të udhëtimit

1. Secila Palë bie dakord për të miratuar masat për sigurimin e pasaportave të tyre dhe dokumenteve të tjera të udhëtimit.

2. Në këtë kuadër, secila Palë bie dakord për të vendosur kontrolle mbi krijimin e ligjshëm, lëshimin, verifikimin dhe përdorimin e pasaportave dhe dokumenteve të tjera të

udhëtimit dhe dokumenteve të identitetit të lëshuara nga ose në emër të asaj Pale.

3. Secila Palë bie dakord gjithashtu për të krijuar ose përmirësuar procedurat, për të siguruar që dokumentet e udhëtimit dhe të identifikimit të lëshuara nga ajo, të jenë të një cilësie të tillë që ato nuk mund të keqpërdoren lehtësisht dhe nuk mund të ndryshohen, kopjohen apo lëshohen lehtësisht në mënyrë të paligjshme.

4. Në bazë të objektivave të mësipërme, çdo Palë do të lëshojë pasaportat e tyre dhe dokumentet e tjera të udhëtimit në përputhje me Dokumentet dhe Rregulloret sipas ONAC-it.

5. Secila palë bie dakord më tej për të shkëmbyer informacion operativ në lidhje me dokumentet e udhëtimit të manipuluar ose të falsifikuara dhe të bashkëpunojnë me Palën tjetër për të forcuar masat e kontrollit për të parandaluar udhëtimin me dokumente të falsifikuara, duke përfshirë falsifikimin ose manipulimin e dokumenteve të udhëtimit, përdorimin e tyre, përdorimin e dokumenteve origjinale të udhëtimit nga mashtruesit, keqpërdorimin e dokumenteve autentike të udhëtimit nga zotëruesit e ligjshëm në mbështetje të kryerjes së një vepre penale, përdorimin e dokumenteve të udhëtimit të skaduar apo të anuluar, dhe përdorimin e dokumenteve të udhëtimit të marra me anë të mashtrimit.

Neni 19

Pasagjerë të papranueshëm dhe pa dokumente dhe të deportuar

1. Secila Palë bie dakord për të vendosur kontrolle efektive të kufirit.

2. Në këtë kuadër, secila Palë bie dakord për të zbatuar Praktikat e Rekomanduara dhe Standarde të shtojcës 9 (Lehtësimi) të Konventës në lidhje me pasagjerët e papranueshëm dhe pa dokumente dhe të deportuarit, me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit për të luftuar migracionin e paligjshëm.

3. Në bazë të objektivave të mësipërme, çdo Palë bie dakord për të nxjerrë ose pranuar, sipas rastit, dokumentin në lidhje me “kopjimin, falsifikimin apo mashtrimin e dokumenteve të udhëtimit apo dokumentet origjinale të paraqitura nga mashtruesit” të përcaktuara në



shtojcën 9 (Lehtësimi) kur marrin masa sipas paragrafëve përkatës të shtojcës në lidhje me konfiskimin e dokumenteve të udhëtimit të falsifikuara, manipuluara apo kopjuara.

Neni 20

Transiti i drejtpërdrejtë

Pasagjerët, bagazhet dhe ngarkesat në transitin e drejtpërdrejtë nëpër territorin e çdo Pale, dhe jo duke e lënë zonën e aeroportit të rezervuar për këtë qëllim, nuk do t'i nënshtrohen ndonjë kontrolli përveç për arsye të sigurisë së aviacionit, kontrollit të lëndëve narkotike, parandalimit të hyrjes së paligjshme ose në rrethana të veçanta. Si rrjedhojë, bagazhet dhe ngarkesat në transit të drejtpërdrejtë do të përjashtohen nga çdo detyrim doganor.

Neni 21

Konkurrenca e ndershme

Secila palë bie dakord:

a) se çdo linjë ajrore e përcaktuar do të ketë një mundësi të drejtë dhe të barabartë për të konkurruar në sigurimin e transportit ajror ndërkombëtar të rregulluar nga marrëveshja; dhe

b) të marrë masa për të eliminuar të gjitha format e diskriminimit ose praktikave të padrejta konkurruese që ndikojnë negativisht në pozitën konkurruese të një linje ajrore të përcaktuar të Palës tjetër.

Neni 22

Masat mbrojtëse

1. Palët bien dakord që praktikave të mëposhtme ajrore mund të konsiderohen si praktika të pandershme konkurruese të mundshme që mund të kërkojnë shqyrtim më të hollësishëm:

a) kostot e faturave dhe çmimet e linjave në nivele, të cilat në total janë të pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e krijimit të shërbimeve që u referohen;

b) shtimi i mundësive apo shpeshtësisë së shërbimit;

c) praktikave në fjalë janë të qëndrueshme dhe jo të përkohshme;

d) praktikave në fjalë kanë ndikim negativ ekonomik ose shkaktojnë dëme të mëdha në një linjë tjetër ajrore;

e) praktikave në fjalë reflektojnë një qëllim të dukshëm ose kanë efektin e mundshëm të dëmtimit, duke përjashtuar ose drejtuar një tjetër linjë ajrore nga tregu.

2. Nëse Autoritetet Aeronautike të një Pale konsiderojnë se një operacion ose operacione të qëllimshme ose të kryera nga linja ajrore e përcaktuar e Palës tjetër mund të përbëjnë sjellje të padrejtë konkurruese në përputhje me treguesit e renditur në paragrafin 1, ata mund të kërkojnë konsultime në pajtim me nenin 17 (Konsultime dhe ndryshime), me qëllim zgjidhjen e problemit. Çdo kërkesë e tillë duhet të shoqërohet me njoftimin e arsyeve për kërkesën dhe konsultimi do të fillojë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas kërkesës.

3. Nëse Palët nuk arrijnë një zgjidhje për problemin nëpërmjet konsultimeve, çdo Palë mund të kërkojë mekanizmin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes sipas nenit 33 (Zgjidhja e mosmarrëveshjeve).

Neni 23

Ligjet e konkurrencës

1. Palët do të informojnë njëra-tjetrën rreth ligjeve, politikave dhe praktikave të tyre të konkurrencës apo për ndryshime në to dhe çdo objektiv të veçantë të tyre, i cili mund të ndikojë në operimin e shërbimeve të transportit ajror sipas kësaj Marrëveshjeje dhe do të identifikojë autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tyre.

2. Palët, në masën e lejuar sipas ligjeve dhe rregullave të tyre, do të ndihmojnë linjat ajrore të njëra-tjetrës, duke u siguruar udhëzime për përputhshmërinë e çdo Praktike të propozuar të linjave ajrore me ligjet, politikave dhe praktikave të tyre të konkurrencës.

3. Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën kurdo që do të gjykojnë që mund të ketë mospërputhje mes zbatimit të ligjeve, politikave dhe praktikave të tyre të konkurrencës dhe çështjeve që lidhen me funksionimin e kësaj Marrëveshjeje; procesi i konsultimit i përfshirë në nenin 17 (Konsultime dhe ndryshime) të kësaj Marrëveshjeje, nëse kërkohet nga secila prej Palëve, do të përdoret për të përcaktuar nëse ekziston një konflikt dhe



të kërkojë mënyra për zgjidhjen ose minimizimin e tij.

4. Në rast se marrëveshja nuk arrihet, në zbatimin e ligjeve, politikave dhe praktikave të tij të konkurrencës, çdo Palë do të japë konsideratën e plotë dhe dashamirëse për pikëpamjet e shprehura nga Pala tjetër dhe duhet të ketë parasysh mirësjelljen, moderimin dhe maturinë ndërkombëtare.

Neni 24

Shitja dhe tregtimi i produkteve të shërbimit ajror

1. Çdo Palë do t'u akordojë linjave ajrore të Palës tjetër të drejtën për të shitur dhe tregtuar shërbimet ajrore ndërkombëtare dhe produkte të përafërta në territorin e tij (drejtpërdrejt ose nëpërmjet agentëve ose ndërmjetësve të tjerë të zgjedhur të linjës ajrore), duke përfshirë të drejtën për të hapur zyrat në linjë dhe jashtë linje.

2. Çdo linjë ajrore do të ketë të drejtën për të shitur mjetet e transportit në monedhën e atij territori ose, sipas zgjedhjes së saj, në monedhën e konvertueshme të shteteve të tjera, dhe çdo person do të jetë i lirë të blejë mjete të tilla transporti në monedhën e pranuar nga linja ajrore.

Neni 25

Ndryshimi i matësit

1. Çdo linjë ajrore e përcaktuar, në ndonjë ose të gjitha fluturimet në shërbimet e miratuara dhe me zgjedhje të saj, mund të ndryshojë avionin në territorin e Palës tjetër ose në çdo pikë përgjatë linjave të specifikuara.

2. Me qëllim ndryshimin e funksioneve të matësit, një linjë ajrore e përcaktuar mund të përdorë pajisjet e veta dhe, sipas rregullave kombëtare, pajisjet e dhëna me qira, dhe mund të veprojë në bazë të marrëveshjeve tregtare me një linjë ajrore tjetër.

3. Një linjë ajrore e përcaktuar mund të përdorë numra të ndryshëm apo të njëjtë të fluturimit për sektorët e ndryshimit të operimit të avionëve të saj

Neni 26

Administrimi i terrenit

Në bazë të dispozitave të sigurisë në fuqi, duke përfshirë Standardet dhe Praktikën Rekomanduar të ONAC-it, të përfshirë në shtojcën 6 (Operimi i Avionëve) të Konventës, linja ajrore të përcaktuara, mund të zgjedhë midis ofruesve konkurrues të shërbimeve të administrimit të terrenit.

Neni 27

Marrëveshjet bashkëpunuese/kodndarëse

1. Kur kryen ose ofron shërbimet e miratuara në linjat e specifikuara, linja ajrore e përcaktuar e një Pale, qoftë si linja ajrore vepruese apo tregtuese, sipas ligjeve ose rregullave të hartuara në bazë të këtyre ligjeve të Palës që i ka përcaktuar ato, mund të hyjë në fushën e marrëveshjes tregtare bashkëpunuese, duke përfshirë por jo kufizuar sipërmarrjen e përbashkët, hapësirën e bllokuar ose kod-ndarëse me:

a) një linjë ose linjat ajrore të së njëjtës Palë, dhe/ose

b) një linjë ose linjat ajrore të Palës tjetër, dhe/ose

c) një linjë ose linjat ajrore të një shteti të tretë.

2. Të drejtat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni mund të ushtrohen vetëm kur:

a) të gjitha linjat e tilla ajrore mbajnë të drejtat e duhura të trafikut dhe/ose autorizimet që të veprojnë në linjat dhe segmente në fjalë; dhe

b) në lidhje me biletat e shitura, linja ajrore ia bën të qartë blerësit në pikën e shitjes që ai është një shërbim kod-ndarës, linja ajrore e cila në fakt do të drejtojë çdo sektor të shërbimit dhe me linjën ajrore ose linjat ajrore me të cilat blerësi hyn në një marrëdhënie kontraktuale.

3. Kapaciteti i ofruar nga një linjë ajrore e përcaktuar si linja ajrore e tregtimit të shërbimeve që kryhen nga linja të tjera ajrore nuk do të llogaritet kundër të drejtave të kapacitetit të Palës që ka përcaktuar linjën ajrore të tregtimit.



Neni 28

Lëshimi me qira i avionit

1. Secila Palë mund të parandalojë përdorimin e avionëve të dhënë me qira për shërbimet sipas kësaj marrëveshjeje, e cila nuk është në përputhje me nenet 13 (Siguria) dhe 14 (Sigurimi i aviacionit).

2. Në bazë të paragrafit 1 më sipër, linjat ajrore të paracaktuara të secilës Palë mund të ofrojnë shërbime në bazë të kësaj marrëveshjeje:

a) duke përdorur avion me qira vetëm si mjet nga ndonjë shoqëri, përfshirë linjat ajrore;

b) duke përdorur avion me qira me të gjitha shërbimet dhe pajisjet nga linjat të tjera ajrore të së njëjtës Palë;

c) duke përdorur avion me qira me të gjitha shërbimet dhe pajisjet nga linjat ajrore të Palës tjetër; dhe

d) duke përdorur avion me qira me të gjitha shërbimet dhe pajisjet nga linjat ajrore të shteteve të treta, me kusht që të gjitha linjat ajrore që marrin pjesë në marrëveshjet e renditura më lart në pikat b), c) dhe d), të mbajnë autorizimin e duhur dhe të përmbushin kërkesat e zbatuara zakonisht për ato marrëveshje.

3. Pavarësisht nga paragrafi 2/d më lart, linjat ajrore të përcaktuara të secilës Palë mund të ofrojnë shërbime në bazë të kësaj marrëveshjeje, duke përdorur avion me qira me të gjitha shërbimet dhe pajisjet për një afat të shkurtër, sipas rastit, nga linjat ajrore të shteteve të treta.

Neni 29

Shërbimet intermodale

Çdo linjë ajrore e përcaktuar mund të përdorë shërbimet e saj ose të tjerëve për transportin sipërfaqësor të pasagjerëve dhe/ose të ngarkesave ajrore.

Neni 30

Sistemet Kompjuterike të Rezervimit (SKR)

Çdo Palë do të zbatojë Kodin e Drejtimit të ONAC-it për Rregullimin dhe Funksionimin e Sistemit Kompjuterik të Rezervimit brenda territorit të saj.

Neni 31

Mbrojtja e mjedisit

Palët mbështesin nevojën për të mbrojtur mjedisin duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm të aviacionit. Palët bien dakord në lidhje me operacionet midis territoreve të tyre përkatëse në përputhje Praktikën dhe Standardet e Rekomanduara të ONAC-it të shtojcës 16 (Mbrojtja e Mjedisit) të Konventës dhe politikave dhe udhëzimeve ekzistuese të ONAC-it për mbrojtjen e mjedisit.

Neni 32

Ndalimi i pirjes së duhanit

1. Secila palë do të ndalojë pirjen e duhanit në të gjitha fluturimet që mbajnë pasagjerë ndërmjet territoreve të Palëve. Ky ndalim do të zbatohet për të gjitha vendet brenda avionit dhe do të jetë në fuqi që nga momenti kur avioni fillon hyrjen e pasagjerëve deri në momentin kur dalja e pasagjerëve ka përfunduar.

2. Çdo Palë do të marrë të gjitha masat që i çmon të arsyeshme për të siguruar pajtueshmërinë, nga linjat ajrore, pasagjerët e tyre dhe anëtarët e ekuipazhit, me dispozitat e këtij Neni, duke përfshirë edhe vendosjen e sanksioneve të duhura për mospërpushmëri.

Neni 33

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Nëse ndërmjet Palëve lind ndonjë mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe të shtojcave të saj, Palët fillimisht do të përpiqen për ta zgjidhur atë me bisedime.

2. Nëse palët nuk arrijnë një zgjidhje me anë të bisedimeve, ata mund të bien dakord për t'ia referuar mosmarrëveshjen ndonjë personi ose organi për një mendim këshillues.

3. Nëse palët nuk arrijnë një marrëveshje në bazë të paragrafëve 1 dhe 2 më sipër, secila Palë mund t'ia referojë mosmarrëveshjen një gjykatë arbitrazhi prej tre arbitrash, dy nga të cilët të propozohen nga Palët dhe një arbitër kryesor. Në rast se mosmarrëveshja i drejtohet arbitrazhit, secila prej palëve do të propozojë një arbitër brenda një periodhe prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve



nga data e marrjes së një njoftimi në lidhje me referimin e mosmarrëveshjes arbitrazhit dhe arbitri kryesor do të emërohet brenda një periudhe të mëvonshme prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga emërimi i fundit i dy të propozuarve. Nëse secila Palë nuk arrin të propozojë arbitrin e vet brenda afatit të caktuar ose arbitrat e propozuar nuk arrijnë të bien dakord për arbitrin kryesor brenda periudhës në fjalë, Kryetari të Këshillit të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil mund t'i kërkojë nga secila Palë për të emëruar arbitrin e palës që nuk ka arritur marrëveshje ose arbitrin kryesor, sipas rastit. Megjithatë, arbitër kryesor do të jetë shtetas i një shteti që ka marrëdhënie diplomatike me të dy Palët në kohën e emërimit.

4. Në rastin e emërimit të arbitrit kryesor nga Presidenti i Këshillit të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, nëse Kryetari i Këshillit të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil është penguar në kryerjen e funksioneve të mësipërme, ose nëse ai është shtetas i njëres prej Palëve, emërimi duhet të bëhet nga Nënkryetari dhe nëse Nënkryetari gjithashtu pengohet në kryerjen e funksioneve të mësipërme, ose nëse ai është shtetas i njëres prej Palëve, emërimi duhet të bëhet nga anëtari i lartë i Këshillit i cili nuk është shtetas i asnjëres prej Palëve.

5. Në bazë të dispozitave të tjera të miratuara nga palët, gjykata e arbitrazhit do të përcaktojë procedurën e saj dhe vendin e arbitrazhit.

6. Vendimet e gjykatës së arbitrazhit do të jenë detyruese për Palët.

7. Tarifatat dhe shpenzimet e arbitrit kryesor do të ndahen në mënyrë të barabartë nga Palët, duke përfshirë çdo shpenzim të kryer nga Këshilli (ONAC). Çdo Palë do të mbajë në mënyrë të pavarur tarifatat dhe shpenzimet e arbitrit që e përfaqëson atë.

Neni 34

Përputhshmëria e konventave dhe marrëveshjeve shumëpalëshe

Kjo Marrëveshje dhe shtojcat e saj do të ndryshohen në mënyrë që të jenë në përputhje me ndonjë nga Konventat ose Marrëveshjet shumëpalëshe, të cilat mund të bëhen të detyrueshme për Palët.

Neni 35

Përfundimi

1. Secila Palë, në çdo kohë, mund të njoftojë me shkrim Palën tjetër për vendimin e saj për të përfunduar këtë Marrëveshje. Një njoftim i tillë, në të njëjtën kohë duhet t'i komunikohet Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil.

2. Në këtë rast Marrëveshja do të përfundojë 12 (dymbëdhjetë) muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga Pala tjetër, përveç rastit kur njoftimi për përfundimin është tërhequr nga marrëveshje reciproke para mbarimit të afatit të kësaj periudhe. Në mungesë të marrjes së konfirmimit nga Pala tjetër, njoftimi do të konsiderohet se është marrë 14 (katërbëdhjetë) ditë pas marrjes së njoftimit nga ana e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil.

Neni 36

Regjistrimi në ONAC

Kjo Marrëveshje dhe çdo amendament i saj duhet të regjistrohen në Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil.

Neni 37

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit të fundit nëpërmjet shënimeve diplomatike nga cilado Palë ndaj Palës tjetër se ka përmbushur masat e nevojshme në përputhje me ligjet dhe rregullat e tij për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Në dëshmi të kësaj, të plotfuqishmit e nënshkruar, të autorizuar posaçërisht nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje. Orari formon pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

Hartuar në Riad më 6.2.2019 (1.6.1440 H) në dy kopje origjinale, në gjuhët shqipe, arabe dhe angleze, ku të gjitha tekstet të jenë njëjloj autentike dhe secila Palë të mbajë një kopje origjinale në çdo gjuhë për zbatim. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.



Për Këshillin e Ministrave të Republikës së
Shqipërisë SH.T.Z Sami Shiba
Ambasador i Republikës së Shqipërisë në
Mbretërinë e Arabisë Saudite

Për Qeverinë e Mbretërisë së Arabisë Saudite
SH.T. DR. NABEEL M AL-AMUDI
Ministër i Transportit i Mbretërisë së Arabisë
Saudite
Kryetar i Bordit të Drejtorve
Autoriteti i Përgjithshëm i Aviacionit Civil

SHTOJCA-A PROGRAMI I ITINERARIT

Seksioni 1

1. Linja ose linjat ajrore të përcaktuara të Republikës së Shqipërisë kanë të drejtë të kryejnë shërbime ajrore ndërkombëtare të planifikuara në të dyja drejtimet në linjat e specifikuar si më poshtë:

Pikat në Republikën e Shqipërisë	Pikat e Ndërmjetme	Pikat në Mbretërinë e Arabisë Saudite	Përtej Pikave
Çdo Pikë ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë	Çdo Pikë	Çdo Pikë ndërkombëtare në Mbretërinë e Arabisë Saudite	Çdo Pikë

Seksioni 2

Linja ose linjat ajrore të përcaktuara të Mbretërisë së Arabisë Saudite kanë të drejtë të kryejnë shërbime ajrore ndërkombëtare të planifikuara në të dyja drejtimet në linjat e specifikuar si më poshtë:

Pikat në Mbretërinë e Arabisë Saudite	Pikat e Ndërmjetme	Pikat në Republikën e Shqipërisë	Përtej Pikave
Çdo Pikë ndërkombëtare në Mbretërinë e Arabisë Saudite	Çdo Pikë	Çdo Pikë ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë	Çdo Pikë

Seksioni 3

Shënime mbi linjat që do të kryhen nga linja ajrore e përcaktuar e të dyja Palëve

1. Pikat e ndërmjetme dhe pikat e përtejme në ndonjë nga linjat e specifikuar të linjës/linjave ajrore të përcaktuara, mund të jenë harruar në ndonjë ose në të gjitha fluturimet, me kusht që çdo shërbim ose fillon ose përfundon në territorin e Palës që përcakton linjën/linjat ajrore.

2. Çdo linjë ajrore e përcaktuar mund të japë pika të ndërmjetme dhe pika të përtejme, të specifikuar në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje, me kusht që pesë të drejtat e trafikut të lirë do të ushtrohen në mes të këtyre pikave dhe territorit të Palës tjetër, në qoftë se është bërë një marrëveshje ndërmjet të dy palëve për këtë qëllim.

**DEKRET**

Nr. 11220, datë 11.7.2019

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 39/2019 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shërbimet ajrore”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 40/2019

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË
ARABISË SAUDITE PËR
SHMANGIEN E TATIMIT TË
DYFISHTË DHE PARANDALIMIN
E EVAZIONIT FISKAL NË LIDHJE ME
TATIMIN MBI
TË ARDHURAT DHE KAPITALIN**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.6.2019.

Shpallur me dekretin nr. 11221, datë 11.7.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJE

**NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË
ARABISË, SAUDITE PËR SHMANGIEN E
TATIMIT TË DYFISHTË DHE
PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL
NË LIDHJE ME TATIMIN MBI TË
ARDHURAT DHE KAPITALIN**

Republika e Shqipërisë dhe Mbretëria e Arabisë Saudite, me dëshirën për të nxitur marrëdhëniet e tyre të përbashkëta ekonomike nëpërmjet lidhjes ndërmjet tyre të një Marrëveshjeje për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin;

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1**Personat e përfshirë**

Kjo Marrëveshje zbatohet për personat që janë rezidentë të një ose dy Shteteve Kontraktuese.

Neni 2**Tatimet e përfshira**

1. Kjo Marrëveshje zbatohet për tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin, të caktuara në emër të Shteteve Kontraktues ose të nënndarjeve të tyre administrative apo autoriteteve lokale pavarësisht nga mënyra sesi vendosen.

2. Konsiderohen tatime mbi të ardhurat të gjitha tatimet e vendosura mbi të ardhurat e plota, mbi kapitalin ose mbi elementë të të ardhurave ose kapitalit, duke përfshirë tatimet



mbi fitimin nga tjetërsim i pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme, tatimet mbi totalin e pagave ose pagesat e bëra nga ndërmarrjet, si dhe tatimet mbi vlerësimin e kapitalit.

3. Tatimet ekzistuese për të cilat zbatohet kjo Marrëveshje janë veçanërisht:

a) në rastin e Republikës së Shqipërisë:

i. tatimet mbi të ardhurat, duke përfshirë tatimin mbi fitimin e shoqërive, tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin e të ardhurave të kapitalit nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme ose të paluajtshme;

ii. tatimi mbi aktivitetet e biznesit të vogël; dhe

iii. tatimi mbi pasurinë: (më poshtë quhet “tatimi shqiptar”).

b) në rastin e Mbretërisë së Arabisë Saudite:

i. Zakati;

ii. tatimi mbi të ardhurat, duke përfshirë tatimin e investimit në gazin natyror (më poshtë quhet saudit).

4. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje zbatohen edhe për çdo tatim të njëjtë ose thelbësisht të ngjashëm që vendoset pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje si shtesë ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të të dy Shteteve Kontraktuese njoftojnë njëri-tjetrin për çdo ndryshim të konsiderueshëm që është bërë në ligjet e tyre tatimore.

Neni 3

Përkufizime të përgjithshme

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, nëse nuk parashikohet shprehimisht ndryshe:

a) termi “Shqipëri” nënkupton Republikën e Shqipërisë dhe, nëse përdoret në kuptimin gjeografik, nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë duke përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi të, si dhe çdo zonë tej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë që, në bazë të ligjeve të saj dhe në pajtim me të drejtën ndërkombëtare është në zonën brenda së cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejtat e saj në lidhje me shtratin detar, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;

b) termi “Mbretëri e Arabisë Saudite” nënkupton territorin e Mbretërisë së Arabisë Saudite që përfshin gjithashtu zonën jashtë ujërave territoriale ku Mbretëria e Arabisë

Saudite ushtron të drejtat e saj sovrane dhe juridiksionale në ujërat e tyre, shtratin detar, nëntokën dhe burimet natyrore në bazë të së drejtës së saj dhe të së drejtës ndërkombëtare;

c) termat “një Shtet Kontraktues” dhe “Shteti tjetër Kontraktues” nënkuptojnë, Republikën e Shqipërisë ose Mbretërinë e Arabisë Saudite, sipas kontekstit:

d) termi “person” përfshin një individ, një shoqëri dhe çdo organizim tjetër personash;

e) termi “shoqëri” nënkupton një person juridik ose subjekt që trajtohet si person juridik, për qëllimet tatimore;

f) termi “ndërmarrje e një Shteti Kontraktues” dhe “ndërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues” nënkuptojnë përkatësisht një ndërmarrje e drejtuar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe një ndërmarrje e drejtuar nga një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues;

g) termi “trafik ndërkombëtar” është çdo transport me anije ose avion i operuar nga një ndërmarrje që ka selinë e menaxhimit efektiv në një Shtet Kontraktues; përveç kur anija ose avioni operojnë vetëm ndërmjet vendeve në Shtetin tjetër Kontraktues;

h) termi “autoritet kompetent” nënkupton;

i. në rastin e Republikës së Shqipërisë, Ministrinë e Financave ose një përfaqësues të autorizuar të Ministrit të Financave;

ii. në rastin e Mbretërisë së Arabisë Saudite, Ministrinë e Financave të përfaqësuar nga Ministri i Financave ose përfaqësuesi i tij i autorizuar;

i) termi “shtetas” nënkupton:

i. çdo individ që ka kombësinë ose shtetësinë e një Shteti Kontraktues; dhe

ii. çdo person juridik, partneritet ose shoqatë që e fiton statusin e saj si e tillë nga ligjet, në fuqi në një Shtet Kontraktues;

2. Në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje në çdo kohë nga një Shtet Kontraktues, çdo term që nuk është përkufizuar në të, përveç kur përcaktohet shprehimisht ndryshe, ka kuptimin që ai ka në atë kohë sipas ligjit të atij Shteti për qëllimet e tatimeve për të cilat zbatohet Marrëveshja, ku çdo kuptim sipas ligjeve të zbatueshme tatimore të atij Shteti mbizotëron mbi kuptimin e dhënë atij termi sipas ligjeve të tjera të atij Shteti.



Neni 4 Rezidenti

1. Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje, termi rezident i një Shteti Kontraktues nënkupton çdo person i cili, sipas ligjeve të atij shteti, i nënshtrohet tatimeve atje për shkak të vendbanimit, vendqëndrimit, vendit regjistrimit, vendit të menaxhimit ose një kriteri tjetër të një natyre të ngjashme dhe përfshin edhe atë shtet ose çdo nënndarje administrativë ose autoritet lokal të tij. Megjithatë, ky term nuk përfshin asnjë person që i nënshtrohet tatimeve në atë Shtet në lidhje me të ardhurat nga burimet në atë Shtet ose kapitalin që ndodhet në të.

2. Kur për shkak të dispozitës së paragrafit 1, të këtij neni, një individ është rezident në të dy Shtetet Kontraktues, statusi i tij përcaktohet si më poshtë:

a) ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i një Shtetit në të cilin ka një banesë të përhershme në dispozicion; nëse ka një banesë të përhershme në dispozicion në të dyja Shtetet, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit me të cilin ka marrëdhënie më të afërta personale dhe ekonomike (qendra e interesave jetike);

b) nëse Shteti në të cilin ai ka qendrën e interesave të tij jetike nuk mund të përcaktohet ose nëse nuk ka banesë të përhershme në dispozicion në asnjë Shtet, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit në të cilin ka vendbanim të zakonshëm;

c) nëse ka vendqëndrim të zakonshëm në të dyja Shtetet Kontraktues ose në asnjërin prej tyre, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit nga i cili është shtetas;

d) nëse ai është shtetas i të dy Shteteve Kontraktues ose i asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese e zgjidhin çështjen me anë të marrëveshjes së ndërsjellë.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, një person i ndryshëm nga një individ është rezident i të dyja Shteteve Kontraktuese, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit në të cilin ka vendin e menaxhimit efektiv.

Neni 5 Selia e përhershme

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termi “seli e përhershme” nënkupton një vend të caktuar biznesi nëpërmjet të cilit zhvillohet biznesi i një ndërmarrjeje në mënyrë të plotë ose të pjesshme.

2. Termi “seli e përhershme” përfshin në veçanti:

- a) një vend menaxhimi;
- b) një degë;
- c) një zyrë;
- d) një fabrikë;
- e) një punishte, dhe
- f) çdo vend nxjerrjeje i burimeve natyrore.

3. Termi “seli e përhershme” përfshin gjithashtu:

a) një kantier ndërtimi, një projekt ndërtimi, montimi ose instalimi ose një aktivitet mbikëqyrës në lidhje me një kantier ose projekt por vetëm nëse ky kantier, projekt apo aktivitet vazhdon më shumë se gjashtë muaj;

b) dhënien e shërbimeve, duke përfshirë shërbimet e konsulencës nga një ndërmarrje nëpërmjet punonjësve ose personelit tjetër të angazhuar nga ndërmarrja për këtë qëllim por vetëm nëse aktivitetet e kësaj natyre vazhdojnë (për të njëjtin projekt ose të lidhur me të) brenda një Shteti Kontraktues për një periudhë ose periudha që në total përbëjnë më shumë se gjashtë muaj brenda çdo periudhe prej dymbëdhjetë muajsh.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, termi “seli e përhershme” çmohet të mos përfshijë:

a) përdorimin e mjediseve vetëm për qëllime magazinimi ose ekspozimi, ose dorëzimin e mallrave që i përkasin ndërmarrjes;

b) mbajtjen e një rezerve mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose dorëzimi;

c) mbajtjen e një rezerve mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllim të përpunimit nga një ndërmarrje tjetër;

d) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për qëllim të blerjes së mallrave ose mbledhjes së informacionit për ndërmarrjen;

e) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për qëllim të kryerjes nga ana e



ndërmarrjes të çdo aktiviteti tjetër të një karakteri përgatitor ose ndihmës;

f) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët “a” deri “e” të këtij paragrafi me kusht që aktiviteti i përgjithshëm i vendit të caktuar të biznesit që rezulton nga ky kombinim, të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, kur një person i ndryshëm nga një agent me status të pavarur për të cilin zbatohet paragrafi 6 i këtij neni, vepron në një Shtet Kontraktues në emër të një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, ajo ndërmarrje konsiderohet të ketë një seli të përhershme në Shtetin e përmendur më parë në lidhje me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për ndërmarrjen, nëse ky person:

a) ka dhe ushtron rregullisht në atë Shtet autoritet për të lidhur kontrata në emër të ndërmarrjes, përveç kur aktivitetet e këtij personi kufizohen tek ato të përmendura në paragrafin 4 të këtij neni që, nëse ushtrohen nëpërmjet një vendi të caktuar biznesi, nuk do ta bënte këtë vend të caktuar një seli të përhershme sipas dispozitave të këtij paragrafi; ose

b) nuk ka autoritet të tillë, por zakonisht mban në Shtetin e përmendur më parë një sasi mallrash gjendje nga të cilat ai dorëzon rregullisht mallra në emër të ndërmarrjes.

6. Një ndërmarrje nuk çmohet të ketë seli të përhershme në një Shtet Kontraktues vetëm ngaqë zhvillon biznesin në atë Shtet nëpërmjet një ndërmjetësi agent me autorizim të përgjithshëm ose çdo agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që këta persona të veprojnë në ushtrim të zakonshëm të biznesit të tyre.

7. Fakti që një shoqëri e cila është rezidente e një Shteti Kontraktues kontrollon ose kontrollon nga një shoqëri rezidente të Shtetit tjetër Kontraktues ose që zhvillon biznes në atë Shtet tjetër (nëpërmjet një selie të përhershme ose ndryshe) nuk përbën në vetvete që njëra prej këtyre shoqërive është seli e përhershme e tjetrës.

Neni 6

Të ardhurat nga pasuria e paluajtshme

1. Të ardhurat që përfitohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga pasuritë e paluajtshme (duke përfshirë të ardhurat nga bujqësia ose pylltaria) që ndodhen në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë Shtet tjetër.

2. Termi “pasuri e paluajtshme” ka kuptimin sipas ligjit të Shtetit Kontraktues në të cilin ndodhet pasuria në fjalë. Në çdo rast, ky term përfshin pasurinë aksesore të pasurisë së paluajtshme, gjënë e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi dhe pylltari, të drejtat për të cilat zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm në lidhje me pasurinë e paluajtshme, uzufruktin e pasurisë së paluajtshme dhe të drejtat për pagesa të ndryshueshme ose fikse si shpërblim për punën ose të drejtën për të punuar, depozitat minerare, burimet dhe pasuritë e tjera natyrore anijet, varkat dhe avionët nuk konsiderohen si pasuri të paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni zbatohen për të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi i drejtpërdrejtë, lënia me qira ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurisë së paluajtshme.

4. Dispozita e paragrafëve 1 dhe 3 të këtij neni zbatohen gjithashtu për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme e një ndërmarrjeje dhe të ardhurat nga pasuria e paluajtshme që përdoren për kryerjen e shërbimeve të pavarura personale.

Neni 7

Fitimet nga biznesi

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues janë të tatueshme vetëm në atë Shtet, përveç kur ndërmarrja zhvillon biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur atje. Nëse ndërmarrja zhvillon biznes si më sipër, fitimet e ndërmarrjes mund të tatohen në Shtetin tjetër por vetëm për ato që i takojnë asaj selie të përhershme.

2. Në bazë të dispozitave të paragrafit 3 të këtij neni, kur një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues zhvillon biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur atje, fitimet të cilat mund të pritej të



nxirrte nëse do të ishte një ndërmarrje e veçantë dhe individuale, e përfshirë në aktivitete të njëjta ose të ngjashme sipas kushteve të njëjta ose të ngjashme dhe që ka marrëdhënie tërësisht të pavarura me ndërmarrjen seli e përhershme e ciles ajo është në secilin shtet Kontraktues do t'i atribuohen atij vendqëndrimi të përhershëm.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme lejohen si zbritje shpenzimet që, janë bërë për qëllime të biznesit të selisë së përhershme, duke përfshirë shpenzimet ekzekutive dhe të përgjithshme administrative, qoftë në Shtetin ku ndodhet selia e përhershme ose gjetkë. Megjithatë, asnjë zbritje nuk lejohet në lidhje me shumatat e paguara sipas rastit, (ndryshe nga rimbursimi i shpenzimeve faktike) nga selia e përhershme për zyrën kryesore të ndërmarrjes ose një prej zyrave të saj, nëpërmjet tarifave të licencave, tarifave ose pagesave të tjera të ngjashme si shpërblim për përdorimin e patentave ose të drejtave të tjera, ose nëpërmjet komisionit, për shërbime specifike të kryera ose për menaxhimin ose, përveç rastit të ndërmarrjes bankare, nëpërmjet të ardhurave nga pretendimet e borxhit në lidhje me fondet e dhëna hua selisë së përhershme. Gjithashtu, nuk merret parasysh në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme, për shumatat e kërkuara (ndryshe nga rimbursimi i shpenzimeve faktike) nga selia e përhershme zyrës kryesore të ndërmarrjes ose një prej zyrave të saj, nëpërmjet tarifave të licencave, tarifave ose pagesave të tjera të ngjashme si shpërblim për përdorimin e patentave ose të drejtave të tjera, ose nëpërmjet komisionit, për shërbime specifike të kryera ose për menaxhimin ose, përveç se në rastin e ndërmarrjes bankare, nëpërmjet interesit për fondet e dhëna hua zyrës kryesore të ndërmarrjes ose një prej zyrave të tjera të saj.

4. Fitimet e biznesit të përftuara nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues nga eksportimi i mallrave në Shtetin tjetër Kontraktues nuk tatohen në atë Shtet tjetër Kontraktues. Nëse kontratat e eksportit përfshijnë aktivitete të tjera që kryhen nëpërmjet një selie të përhershme në Shtetin tjetër Kontraktues, fitimet e nxjerra nga këto aktivitete mund të tatohen në Shtetin tjetër Kontraktues.

5. Termi “fitime të biznesit” përfshin por nuk kufizohet tek të ardhurat e përftuara nga

prodhimi, tregtimi, aktiviteti bankar, sigurimet nga operacionet e transportit të brendshëm dhe dhënia e shërbimeve. Një term i tillë nuk përfshin kryerjen e shërbimeve personale nga një individ si i punësuar ose në një cilësi të pavarur.

6. Asgjë në këtë nen nuk ndikon në zbatimin e ligjeve të një Shteti Kontraktues në lidhje me tatimet e vendosura mbi të ardhurat që përftohen nga aktivitetet e sigurimeve.

7. Kur fitimet përfshijnë zërat e të ardhurave që rregullohen veçmas në nenet e tjera të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e atyre neneve nuk cenohen nga dispozitat e këtij neni.

Neni 8

Transporti me anije dhe avion

1. Fitimet nga operimi i anijeve dhe avionëve në trafikun ndërkombëtar janë të tatueshme vetëm në atë Shtet Kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

2. Termi “fitime të përftuara nga operimi ndërkombëtar i anijeve dhe avionëve përfshin:

a) fitimet e nxjerra nga qiradhënia me bazë të plotë (kohë ose udhëtim) i anijeve ose avionëve të përdorur në transportin ndërkombëtar;

b) fitimet e nxjerra nga qiradhënia pa ekuipazh e anijeve ose avionëve që përdoren në transportin ndërkombëtar;

c) fitimet e nxjerra nga përdorimi ose qiradhënia e kontejnerëve dhe pajisjeve përkatëse të përdorura në transportin ndërkombëtar;

Kjo lidhet në mënyrë të tërthortë me të ardhurat nga operimi ndërkombëtar i anijeve dhe avionëve.

3. Nëse vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes dërguese është një anije, ai konsiderohet të jetë në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet porti i regjistrimit të anijes, ose nëse nuk ka port regjistrimi, në Shtetin Kontraktues rezident i të cilit është operatori i anijes.

4. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni zbatohen dhe për fitimet nga pjesëmarrja në një partneritet, biznes të përbashkët ose agjenci me aktivitet ndërkombëtar.



Neni 9

Ndërmarrjet e asociuara

1. Kur:

a) një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues dhe një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, dhe kur në çdo rast janë caktuar ose vendosur kushte ndërmjet dy ndërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare ose financiare që ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin ndërmjet ndërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim do t'i ishte shtuar një prej ndërmarrjeve por për shkak të atyre kushteve nuk është shtuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj ndërmarrjeje dhe për rrjedhojë të tatohet.

2. Kur një Shtet Kontraktues përfshin në fitimet e një ndërmarrjeje të atij Shteti dhe për rrjedhojë taton fitimet për të cilat një ndërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues është tatuar në atë Shtet tjetër dhe fitimet e përfshira janë fitimet, të cilat do t'i ishin shtuar ndërmarrjes së Shtetit të përmendur më parë, nëse kushtet e vendosura midis dy ndërmarrjeve do të kishin qenë ato që do të ishin vendosur midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë Shteti tjetër do të bëjë një rregullim të përshtatshëm të sasisë së tatimeve të vendosura në të mbi ato fitime. Në përcaktimin e këtij rregullimi duhet t'i kushtohet vëmendje dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese, sipas rastit, konsultohen me njëri-tjetrin.

Neni 10

Dividendët

1. Dividendët e paguar nga një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, mund tatohen në atë Shtet tjetër.

2. Megjithatë, këta dividendë mund të tatohen edhe në Shtetin Kontraktues në të cilin është rezidente shoqëria që paguan dividendët dhe sipas ligjeve të atij Shteti, por nëse pronari

përfitues i dividendëve është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i vendosur nuk duhet të tejkalojë 5 për qind të shumës bruto të dividendëve. Ky paragraf nuk ndikon në tatimin e shoqërisë në lidhje me fitimet nga të cilat paguhet dividendët.

3. Termi “dividendë” siç përdoret në këtë nen nënkupton të ardhurat nga aksionet, aksionet e “gëzimit” ose të drejta të “gëzimit”, aksionet e minierave, aksionet e themeluesve ose të drejta të tjera nuk janë detyrime borxhi, që marrin pjesë në fitime, si dhe çdo e ardhur tjetër që i nënshtrohet të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga aksionet nga ligjet e shtetit në të cilin shoqëria që bën shpërndarjen është rezidente.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen nëse pronari përfitues i dividendëve që është rezident i një Shteti Kontraktues, zhvillon biznesin në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin shoqëria që paguan dividendët është rezidente, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të ose kryen shërbime të pavarura personale në shtetin tjetër nga një bazë fikse që ndodhet atje dhe që pjesëmarrja në lidhje me të cilën paguhet dividendët, është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këto raste, zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje.

5. Kur një shoqëri e cila është rezidente e një Shteti Kontraktues nxjerr fitime ose të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, ai Shtet tjetër nuk mund të vendosë tatime mbi dividendët e paguar nga firma, përveç rasteve kur këta dividendë i paguhet një rezidenti të atij Shteti tjetër ose për sa kohë që pjesëmarrja në lidhje me të cilën paguhet dividendët, është efektivisht e lidhur me selinë e përhershme ose bazën fikse të vendosur në atë Shtet tjetër, dhe as nuk do t'i nënshtrojnë fitimet e pashpërndara të shoqërisë një tatimi mbi fitimet e pashpërndara edhe nëse dividendët e paguar ose fitimet e pashpërndara përbëhen tërësisht ose pjesërisht prej fitimeve ose të ardhurave të nxjerra në atë Shtet tjetër.



Neni 11

Të ardhurat nga pretendimet e borxhit

1. Të ardhurat nga pretendimet e borxhit të nxjerra në një Shtet Kontraktues dhe të paguara një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, mund të tatohen në Shtetin tjetër.

2. Megjithatë këto të ardhura nga pretendimet e borxhit mund të tatohen edhe në shtetin Kontraktues në të cilin zgjidhen edhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i të ardhurave nga pretendimet e borxhit është rezident i shtetit tjetër kontraktues, tatimi i vendosur nuk tejkalon 10 për qind të shumës bruto të të ardhurave nga pretendimet e borxhit.

3. Termi “të ardhura nga pretendimet e borxhit”, siç përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga detyrimet e borxhit të çdo lloji, i garantuar apo jo me hipotekë, pavarësisht nëse mbart të drejtën për të marrë pjesë në fitimet e debitorit dhe në veçanti të ardhurat nga letrat me vlerë qeveritare dhe nga obligacionet ose dëftesat e borxhit, duke përfshirë primet dhe çmimet që u bashkëngjiten këtyre letrave me vlerë, obligacioneve dhe dëftesave të borxhit. Gjohet për vonesat në pagesa nuk llogariten si të ardhura nga pretendimet e borxhit për qëllimet e këtij neni.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen, nëse pronari përfitues i të ardhurave nga pretendimet e borxhit që është rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues në të cilin nxirren të ardhurat nga pretendimet e borxhit, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të, ose kryen shërbime të pavarura personale në shtetin tjetër nga një bazë fikse që ndodhet atje dhe pretendimi i borxhit në lidhje me të cilin paguhet të ardhurat nga pretendimet e borxhit është efektivisht i lidhur me këtë bazë të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje.

5. Të ardhurat nga pretendimet e borxhit çmohen të lindin në një shtet kontraktues kur pagesi është rezident i vetë atij shteti. Megjithatë, nëse personi që paguan të ardhurat nga pretendimet e borxhit, qoftë rezident i shtetit kontraktues apo jo, ka në një shtet kontraktues një seli të përhershme ose bazë fikse në lidhje me

të cilën ka ndodhur mbetja e borxhit mbi të cilën janë paguar të ardhurat nga pretendimet e borxhit dhe këto të ardhura nga pretendimet e borxhit paguhet nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë të ardhurat konsiderohen të lindin në shtetin në të cilin ndodhet selia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet pagesit dhe pronarit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shuma e të ardhurave nga pretendimet e borxhit, duke pasur parasysh pretendimin e borxhit për të cilin paguhet, tejkalon shumën e cila do të ishte rënë dakord nga pagesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, dispozitat e këtij neni zbatohen vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit shtet kontraktues, duke i kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Tarifat e licencave

1. Tarifat e licencave që nxirren në një shtet kontraktues dhe të paguara një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohen në shtetin tjetër.

2. Megjithatë, këto tarifa licencash mund të tatohen edhe në shtetin kontraktues në të cilin nxirren dhe sipas ligjeve të atij shteti kontraktues por nëse pronari përfitues i tarifave të licencave është rezident i shtetit tjetër kontraktues, tatimi i vendosur nuk tejkalon:

a) 5 për qind të shumës bruto të këtyre tarifave të licencave që paguhet për përdorimin ose të drejtën për të përdorur pajisjet industriale, tregtare ose shkencore;

b) 8 për qind të shumave bruto të këtyre tarifave të licencave në të gjithë rastet e tjera.

3. Termi “tarifat e licencave”, siç përdoret në këtë nen, nënkupton pagesat e çdo lloji të marra si shpërblim për përdorimin ose të drejtën e përdorimit të çdo të drejtë autori të veprës letrave, artistike ose shkencore, duke përfshirë filmat kinematografik dhe filmat ose kasetat e përdorura për transmetim në radio ose televizion, çdo patentë, markë tregtare, dizajno ose model, plan, formulë ose proces sekret, për përdorim të/ose të drejtën për të përdorur pajisjet



industriale, tregtare ose shkencore apo për informacion në lidhje me përvojën industriale, tregtare ose shkencore.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen, nëse pronari përfitues i tarifave të licencave që është rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues në të cilin nxirren tarifat e licencave, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të, ose kryen shërbime të pavarura personale në shtetin tjetër nga një bazë fikse që ndodhet atje dhe e drejta ose pasuria në lidhje me të cilën paguhet tarifat e licencave lidhet efektivisht me këtë bazë të përhershme ose bazë fikse. Në këto raste, zbatohen, sipas rastit, dispozitat e nenit 7 ose nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje.

5. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shumica e tarifave të licencave, duke pasur parasysh përdorimin, të drejtën ose informacionin për të cilin paguhet, tejkalon shumën e cila do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, dispozitat e këtij neni zbatohen vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit shtet kontraktues, duke i kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13

Fitimet e kapitalit

1. Fitimet e nxjerra nga një rezident i një shteti kontraktues nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të përmendur në nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje dhe të ndodhura në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohen në shtetin tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme që përbëjnë pjesë të pronës së biznesit të një selie të përhershme që një ndërmarrje e një shteti kontraktues ka në shtetin tjetër kontraktues ose të pasurisë së luajtshme që i përket një baze fikse të disponueshme nga një rezident i një shteti kontraktues në shtetin tjetër kontraktues për qëllimin e kryerjes së shërbimeve personale të pavarura, duke përfshirë fitimet nga tjetërsimi i kësaj selie të përhershme (vetëm ose

me gjithë ndërmarrjen) ose të kësaj baze fikse, mund të tatohen në shtetin tjetër kontraktues.

3. Fitimet nga tjetërsimi i anijeve ose avionëve që operojnë në trafikun ndërkombëtar ose i pasurisë së luajtshme që i përket operimit të këtyre anijeve ose avionëve, janë të tatueshme vetëm në shtetin kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

4. Fitimet nga tjetërsimi i aksioneve që përbëjnë një aksion në një shoqëri që është rezidente e një shteti kontraktues, mund të tatohen në atë shtet.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo sendi pasuror, të ndryshëm nga ai i përmendur në paragrafët e mësipërm të këtij neni, janë të tatueshme vetëm në shtetin kontraktues rezident i të cilit është tjetërsuesi.

Neni 14

Shërbime personale të pavarura

1. Të ardhurat e përftuara nga një rezident i një shteti kontraktues në lidhje me shërbimet profesionale ose aktivitetet e tjera të një natyre të pavarur, janë të tatueshme vetëm në atë shtet, përveç se në rrethanat e mëposhtme kur këto të ardhura mund të tatohen në shtetin tjetër kontraktues:

a) Nëse ai ka një bazë fikse rregullisht të disponueshme prej tij në shtetin tjetër kontraktues për qëllimin e kryerjes së aktiviteteve të tij, në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i përket kësaj baze fikse mund të tatohet në shtetin tjetër kontraktues, ose

b) Nëse qëndrimi i tij në shtetin tjetër kontraktues është për një periudhë ose periudha që janë të barabarta ose kalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore që fillon ose mbaron në të njëjtin vit fiskal përkatës, në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që përfitohet nga aktivitetet e tij të kryera në shtetin tjetër mund të tatohet në shtetin tjetër kontraktues.

2. Termi “shërbime profesionale” përfshin veçanërisht aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore ose mësimdhënëse, si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, juristëve, inxhinierëve, arkitektëve, densitëve dhe kontabilistëve.



Neni 15

Shërbime personale të varura

1. Në bazë të dispozitave të nenit 16, 18, 19, 20 dhe 21 të kësaj Marrëveshjeje, rrogat, pagat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme që përftohen nga një rezident i një shteti kontraktues në lidhje me një punësim, janë të tatueshëm vetëm në atë shtet, nëse punësimi nuk ushtrohet në shtetin tjetër kontraktues. Nëse ushtrohet punësimi, ky shpërblim që përftohet atje mund të tatohet në shtetin tjetër.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, shpërblimi i përftuar nga një rezident i një shteti kontraktues në lidhje me një punësim të ushtruar në shtetin tjetër kontraktues, është i tatueshëm vetëm në shtetin e përmendur më parë, nëse:

a) përfituesi është i pranishëm në shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i tejkalojnë në total 183 (njëqind e tetëdhjetë e tre) ditë në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore e cila fillon ose përfundon në vitin kalendarik përkatës, dhe

b) shpërblimi paguhet nga ose në emër të një punëdhënësi, i cili nuk është rezident i shtetit tjetër, dhe

c) shpërblimi nuk paguhet nga një vendqëndrim i përhershëm ose bazë fikse, të cilën punëdhënësi ka në shtetin tjetër.

3. Pavarësisht dispozitave të mësipërme të këtij neni, shpërblimi i përftuar nga një punësim të ushtruar në bordin e një anijeje ose avioni që operon në trafikun ndërkombëtar mund të tatohet në shtetin kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

Neni 16

Tarifat e drejtorëve

Tarifat e drejtorëve dhe pagesa të tjera të ngjashme që përftohen nga një rezident i një shteti kontraktues në cilësinë e tij si anëtar i bordit të drejtorëve të një shoqërie e cila është rezidente e shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

Neni 17

Artistët dhe sportistët

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 14 dhe 15 të kësaj Marrëveshjeje, të ardhurat që përftohen nga një rezident i një shteti kontraktues si argëtues, si artist teatri, filmi, radioje ose televizioni ose muzikant apo sportist, nga aktivitetet personale të ushtruara si të tilla në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohen në shtetin tjetër.

2. Kur të ardhurat në lidhje me aktivitetet personale të ushtruara nga një argëtues ose sportist në cilësinë e tij si i tillë, nuk përftohen nga subjekti argëtues ose sportisti por nga person tjetër, këto të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 14 dhe 15 të kësaj Marrëveshjeje, mund të tatohen në shtetin kontraktues në të cilin ushtrohen aktivitetet e argëtuesit apo sportistit.

3. Të ardhurat e përftuara nga një rezident i një shteti kontraktues nga aktivitetet e ushtruara në shtetin tjetër kontraktues siç parashikohet në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, përjashtohen nga tatimi në atë shtet tjetër kontraktues nëse vizita në atë shtet tjetër kontraktues mbështetet tërësisht ose kryesisht nga fondet publike të shtetit të parë kontraktues, një nënndarjeje administrative apo autoriteti lokal të tij ose kryhet në bazë të një marrëveshjeje apo mase kulturore ndërmjet shteteve kontraktues.

Neni 18

Pensionet

1. Në pajtim me dispozitat e paragrafit 2 të nenit 19 të kësaj Marrëveshjeje, pensionet dhe shpërblimet e ngjashme të paguara rezidentit të një shteti kontraktues në lidhje me punësimin e kaluar, tatohen vetëm në atë shtet.

2. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, pensionet e paguara dhe pagesat e tjera të bëra sipas një skeme publike që është pjesë e sistemit të sigurimeve shoqërore të një shteti kontraktues ose të një nënndarjeje administrative apo autoriteti lokal të tij, tatohen vetëm në atë shtet.



Neni 19

Shërbimet qeveritare

1. a) Rrogat, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, të paguara nga një shtet kontraktues ose një nënndarje administrative ose autoritet lokal një individ në lidhje me shërbimet e kryera për atë shtet ose nënndarje ose autoritet, janë të tatueshme vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto rroga, paga, ose shpërblime të tjera të ngjashme janë të tatueshme vetëm në shtetin tjetër kontraktues, nëse shërbimet kryhen në atë shtet dhe nëse individ është rezident i atij shteti që:

i. është shtetas i atij shteti, ose

ii. nuk është bërë rezident i atij shteti vetëm për qëllim të kryerjes së shërbimeve.

2. a) Çdo pension i paguar ose prej fondeve të krijuara nga një shtet kontraktues, ose një nënndarje administrative apo autoritet lokal i tij një individ në lidhje me shërbimet e kryera për atë shtet ose nënndarje ose autoritet, janë të tatueshme vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, ky pension është i tatueshëm vetëm në shtetin tjetër kontraktues, nëse individ është rezident dhe shtetas i atij shteti.

3. Dispozitat e neneve 15, 16, 17, dhe 18 të kësaj Marrëveshjeje zbatohen për rrogat, pagat, pensionet dhe shpërblime të tjera të ngjashme, në lidhje me shërbimet e kryera për një biznes të zhvilluar nga një shtet kontraktues ose nënndarje e tij administrative ose autoritet lokal i tij.

Neni 20

Studentët

1. Pagesat që merr një student ose praktikant biznesi ose stazhier, i cili është ose ka qenë menjëherë para vizitës në një shtet kontraktues, rezident i shtetit tjetër kontraktues dhe i pranishëm në shtetin e parë kontraktues vetëm për qëllimin e arsimimit dhe trajnimit të tij, për qëllimin e jetesës, arsimimit ose trajnimit, nuk tatohen në atë shtet me kusht që këto pagesa të lindin nga burime jashtë atij shteti.

2. Pagesat e marra nga studenti, ose praktikanti i biznesit apo stazhieri, i cili është ose ka qenë menjëherë para vizitës në një shtet kontraktues, rezident i shtetit tjetër kontraktues dhe i pranishëm në shtetin e parë kontraktues

vetëm për arsimimin ose trajnimin e tij dhe që përbën një shpërblim në lidhje me shërbimet e bëra në atë shtet kontraktues tjetër, nuk janë të tatueshme në atë shtet tjetër, me kusht që shërbimet të lidhen me arsimin ose trajnimin dhe të jenë të nevojshme për qëllimet e mbështetjes financiare.

Neni 21

Mësuesit dhe kërkuesit

1. Shpërblimet që merr një mësues ose një kërkues i cili është ose ka qenë rezident në një shtet kontraktues para se të ftohej ose të vizitonte shtetin tjetër kontraktues për qëllimin e mësimdhënies ose kryerjes së kërkimeve në lidhje me këto aktivitete, nuk tatohen në shtetin tjetër kontraktues për një periudhë që nuk kalon 2 vjet.

2. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për shpërblimin e përfutur nga kërkimi, nëse ky kërkim nuk ndërmerret në interes publik por është kryesisht ose tërësisht për përfitime private të një personi apo personave specifikë.

Neni 22

Të ardhura të tjera

1. Zërat e të ardhurave të një rezidenti të një shteti kontraktues, kudo që lindin, të patrajuara në nenet e mësipërme të kësaj Marrëveshjeje, janë të tatueshme vetëm në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni nuk zbatohen për të ardhurat e ndryshme nga të ardhurat nga pasuria e paluajtshme, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 6 të kësaj Marrëveshjeje, nëse përfituesi i këtyre të ardhurave që është rezident i një shteti kontraktues zhvillon biznes në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të ose kryen në shtetin tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur në të dhe e drejta ose pasuria në lidhje me të cilat paguhen të ardhurat është efektivisht e lidhur me atë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje, sipas rastit.



Neni 23

Kapitali

1. Kapitali i përfaqësuar nga pasuria e paluajtshme e përmendur në nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje, i zotëruar nga një rezident i një shteti kontraktues dhe që ndodhet në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohet në shtetin tjetër.

2. Kapitali i përfaqësuar nga pasuria e luajtshme që përbën pjesë të pronës së biznesit të një selie të përhershme që një ndërmarrje e një shteti kontraktues ka në shtetin tjetër kontraktues ose nga pasuria e luajtshme që i përket një baze fikse të disponueshme nga një rezident i një shteti kontraktues në shtetin tjetër kontraktues, për qëllimin e kryerjes së shërbimeve personale të pavarura, mund të tatohet në shtetin tjetër.

3. Kapitali i përfaqësuar nga anijet ose avionët që operojnë të trafikun ndërkombëtar ose nga pasuria e luajtshme që i përket operimit të këtyre anijeve ose avionëve, është i tatueshëm vetëm në shtetin kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

4. Të gjithë elementët e tjerë të kapitalit të një rezidenti të një shteti kontraktues janë të tatueshëm vetëm në atë shtet.

Neni 24

Metodat për eliminimin e tatimit të dyfishtë

Tatimi i dyfishtë eliminohet si më poshtë:

1. Nëse një rezident i një shteti kontraktues nxjerr të ardhura ose zotëron kapital, i cili në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, mund të tatohet në shtetin tjetër kontraktues, shteti i përmendur më parë lejon:

a) si zbritje nga tatimi mbi të ardhurat të atij rezidenti, të një shume të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në shtetin tjetër kontraktues;

b) si zbritje nga tatimi mbi kapitalin e atij rezidenti, të një shume të barabartë me tatimin mbi kapitalin të paguar në shtetin tjetër kontraktues.

Kjo zbritje, në asnjë rast nuk kalon pjesën e tatimit mbi të ardhurat ose kapitalin që llogaritet para kryerjes së zbritjes që u takon, sipas rastit të

ardhurave ose kapitalit që mund të tatohen në shtetin tjetër kontraktues.

2. Nëse në pajtim me një dispozitë të kësaj Marrëveshjeje, të ardhurat e nxjerra nga kapitali në pronësi të një rezidenti të një shteti kontraktues, përjashtohen nga tatimi në atë shtet, ky shtet, në llogaritjen e shumës së tatimeve mbi të ardhurat e mbetura ose kapitalit të këtij rezidenti, nuk mund të marrë parasysh të ardhurat e përjashtuara ose kapitalin.

3. Në rastin e Mbretërisë së Arabisë Saudite, metodat për eliminimin e tatimit të dyfishtë nuk cenojnë dispozitat e regjimit të mbledhjes së Zakatit në lidhje me shtetasit Sauditë.

Neni 25

Procedura e Marrëveshjes së ndërsjellë

1. Kur një person çmon se veprimet e një ose dy shteteve kontraktues rezultojnë ose do të rezultojnë për të në tatim, në mospajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nga mjetet e parashikuara nga legjislacioni i brendshëm i atyre shteteve, ai mund t'ia paraqesë çështjen e tij autoritetit kompetent të shtetit kontraktues në të cilin është rezident. Çështja mund të paraqitet brenda 3 vjetësh nga njoftimi i parë i veprimit që rezulton në tatim në mospajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

2. Autoriteti kompetent, nëse kundërshtimi është i bazuar dhe nëse nuk është vetë në gjendje për të arritur një zgjidhje të pranueshme, përpiqet të zgjidhë çështjen me anë të marrëveshjes së ndërsjellë me autoritetin kompetent të shtetit tjetër kontraktues, me qëllim shmangien e tatimit që nuk është në pajtim me Marrëveshjen. Çdo Marrëveshje e arritur zbatohet pavarësisht nga afatet kohore në ligjin e brendshëm të shteteve kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktues përpiqen të zgjidhin me anë të Marrëveshjes së ndërsjellë çdo vështirësi ose dyshim që lind në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ata gjithashtu mund të konsultohen së bashku për shmangien e tatimit të dyfishtë në rastet të cilat nuk janë parashikuar në Marrëveshje.

4. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktues mund të komunikojnë me njëri-



tjetrin për qëllimin e arritjes së një marrëveshjeje në kuptimin e paragrafëve të mësipërm.

5. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktues, me marrëveshje reciproke, mund të zgjedhin mënyrën e përshtatshme të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe veçanërisht, kërkesat të cilat duhet të përmbushin rezidentët e një shteti kontraktues me qëllim që ta marrin në shtetin tjetër përfitimet dhe përjashtimet tatimore të parashkuara në këtë Marrëveshje.

Neni 26

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese shkëmbejnë atë informacion që është i nevojshëm për të zbatuar dispozitat e kësaj Marrëveshjeje ose të ligjeve të brendshme të shteteve kontraktuese në lidhje me tatimet e mbuluara nga kjo Marrëveshje në masën që, tatimi sipas tyre, nuk është në kundërshtim me këtë Marrëveshje. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga neni 1 i kësaj Marrëveshjeje. Çdo informacion i marrë nga një shtet kontraktues trajtohet si konfidencial në të njëjtën mënyrë si informacioni i përfutur sipas ligjeve të brendshme të atij shteti dhe i deklarohet vetëm personave ose autoriteteve (duke përfshirë gjykatat dhe organet administrative) që merren me vlerësimin ose mbledhjen, zbatimin ose procedimin në lidhje me/ose përcaktimin e ankimeve mbi tatimet e mbuluara nga kjo Marrëveshje. Këta persona ose autoritete e përdorin informacionin vetëm për këto qëllime. Ata mund ta deklarojnë informacionin në seanca gjyqësore me dyer të hapura ose në vendime gjyqësore.

2. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni 2 nuk interpretohen sikur vendosin mbi një shtet kontraktues detyrimin:

a) për të realizuar masa administrative në mospajtim me ligjet dhe praktikën administrative të atij ose të shtetit tjetër kontraktues;

b) të japin informacion që nuk është i përfutueshëm sipas ligjeve ose në punën normale të administratës në të ose shtetin tjetër kontraktues;

c) të japin informacion që do të zbulonte çdo sekret tregtar, biznesi, industrial ose profesional, proces tregtar apo informacion, zbulimi i të cilit do të ishte në kundërshtim me politikën publike (rendin publik).

3. Nëse informacioni kërkohet nga një shtet kontraktues në pajtim me këtë nen, shteti tjetër kontraktues zbaton masat e tij për mbledhjen e informacionit për të marrë informacionin e kërkuar, megjithëse shtetit tjetër mund të mos i nevojitet ky informacion për qëllimet e veta tatimore. Detyrimi në përmbajtje të fjalisë së mësipërme i nënshtrohet kufizimeve të paragrafit 2 të këtij neni por në asnjë rast këto kufizime nuk interpretohen sikur lejojnë një shtet kontraktues të refuzojë dhënien e informacionit thjesht pasi nuk ka interes të brendshëm për këtë informacion.

4. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni nuk interpretohen sikur lejojnë një shtet kontraktues të refuzojë dhënien e informacionit vetëm pasi informacioni mbahet nga një bankë, institucion tjetër financiar, person i autorizuar ose person që vepron në cilësinë e agjencisë ose dorëzanësit, ose pasi lidhet me interesa pronësie të një personi.

5. Informacioni i marrë sipas këtij neni përdoret vetëm për qëllime tatimore.

Neni 27

Anëtarët e misioneve diplomatike dhe zyryave konsullore

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk cenon privilegjet fiskale të anëtarëve të misioneve diplomatike ose zyryave konsullore sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ose sipas dispozitave të marrëveshjeve të veçanta.

Neni 28

Dispozita të ndryshme

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk ndikon në zbatimin e dispozitave të brendshme për të parandaluar evazionin fiskal dhe shmangien e tatimeve.

Neni 29

Hyrja në fuqi

1. Çdo shtet kontraktues njofton tjetrin nëpërmjet kanaleve diplomatike në lidhje me përfundimin e procedurave që kërkohen nga ligji i tij për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pas muajit në të cilin është marrë njoftimi i fundit.



2. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje zbatohen:

a) në lidhje me tatimet që mbahen në burim, në lidhje me shumat e paguara në ose pas datës një janar, pas datës në të cilën hyn në fuqi kjo Marrëveshje; dhe

b) në lidhje me tatimet e tjera, për sa u takon viteve tatimore që fillojnë në ose pas datës një janar, pas datës në të cilën hyn në fuqi kjo Marrëveshje.

Neni 30

Përfundimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi për një kohë të pacaktuar por secili nga shtete kontraktues mund ta përfundojë këtë Marrëveshje nëpërmjet kanaleve diplomatike, duke i dhënë shtetit tjetër një njoftim me shkrim për përfundimin jo më vonë se data 30 qershor e çdo viti kalendarik që fillon pesë vjet pas vitit në të cilin ka hyrë në fuqi kjo Marrëveshje.

2. Në këtë rast, kjo Marrëveshje pushon së qeni në fuqi:

a) mbi tatimet e mbajtura në burim, në lidhje me shumat e paguara pas fundit të vitit kalendarik në të cilin bëhet një njoftim i tillë; dhe

b) mbi tatimet e tjera, në lidhje me vitet tatimore që fillojnë pas fundit të vitit kalendarik në të cilin bëhet një njoftim i tillë.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në dy kopje, në RIAD, më 6.2.2019 (01.06.1440H) Në gjuhën shqipe, arabe, angleze, ku të gjithë tekstet janë njëloj autentikë. Në rastin e mospërputhjes në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Anila Denaj

Ministër i Financave dhe Ekonomisë i
Republikës së Shqipërisë

PËR MBRETËRINË E ARABISË SAUDITE

Mohammed A. Al Jadaan

Ministër i Financave i Mbretërisë së Arabisë
Saudite

PROTOKOLL

Me nënshkrimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për Shmangien e Tatimit të Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal në lidhje me Tatimet mbi të Ardhura dhe Kapitalin, Republika e Shqipërisë dhe Mbretëria e Arabisë Saudite kanë rënë dakord që dispozitat e mëposhtme të përbëjnë pjesë integrale të Marrëveshjes:

1. Në lidhje me nënparagrafin “d” të paragrafit 1 të nenit 3 të Marrëveshjes:

Kuptohet që termi “person” përfshin gjithashtu shtetin, nëndarjet e tij administrative ose autoritetet lokale.

2. Në lidhje me paragrafin 1 të neni 4 të kësaj Marrëveshjeje:

Kuptohet që termi “rezident i një shteti kontraktues”, përfshin:

a) një skemë pensioni të krijuar në atë shtet; dhe

b) një organizatë që është ngritur dhe operon vetëm për qëllime fetare, bamirësie, shkencore, kulturore ose arsimore (ose për më shumë se një prej këtyre qëllimeve) dhe që është rezidentë e atij shteti sipas ligjeve të tij, pavarësisht se e gjitha ose një pjesë e të ardhurave ose fitimeve mund të jenë përjashtuar nga tatimet ose nuk i nënshtrohen tatimit në atë shtet.

3. Në rastin e Shqipërisë, termi “evazion tatimor” do të thotë “evazion fiskal” brenda përmbajtjes së Marrëveshjes.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në dy kopje, në RIAD, më 6.2.2019 (01.06.1440H) Në gjuhën shqipe, arabe, angleze, ku të gjithë tekstet janë njëloj autentikë. Në rastin e mospërputhjes në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Anila Denaj

Ministër i Financave dhe Ekonomisë i
Republikës së Shqipërisë



PËR MBRETËRINË E ARABISË
SAUDITE

Mohammed A. Al Jadaan
Ministër i Financave i Mbretërisë së Arabisë
Saudite

DEKRET

Nr. 11221, datë 11.7.2019

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 40/2019 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 41/2019

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCAVE DHE
EKONOMISË, OPERATORIT TË
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE SHA DHE KfW-së,
FRANKFURT AM MAIN, PËR
PROGRAMIN E INVESTIMEVE PËR
SHPËRNDARJEN
E ENERGJISË ELEKTRIKE I**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh. a. dhe KfW, Frankfurt am Main, për programin e investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.6.2019.

Shpallur me dekretin nr. 11222, datë 11.7.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJE HUAJE E DATËS
5.3.2019 NDËRMJET KfW-së, FRANKFURT
AM MAIN (“KfW”) DHE REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË TË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCAVE DHE
EKONOMISË (“HUAMARRËSI”) DHE
OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE SHA (OSHEE
 (“AGJENCIA ZBATUESE E PROJEKTTIT”)
PËR 30,000,000.00 EURO

**Programi i Investimeve për Shpërndarjen
e Energjisë Elektrike I –**

BMZ-ID: 2016 67 518

Nr. i huas 29098

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA
PARATHËNIE

1. Huaja
2. Kanalizimi i Huasë
3. Disbursimi
4. Tarifat



5. Interesi
6. Shlyerja dhe parapagimi
7. Llogaritjet dhe pagesat në përgjithësi
8. Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë
9. Paligjshmëria
10. Kostot dhe Pagesat Publike
11. Detyrime të veçanta
12. Përfundimi i Marrëveshjes
13. Përfaqësimi dhe Deklaratat
14. Publikimi dhe transferimi i informacionit lidhur me projektin
15. Dispozita të përgjithshme
- Shtojca 1 Plani i Disbursimit
- Shtojca 2 Forma e Opinionit Ligjor të Këshilltarit Ligjor të Huamarrësit
- Shtojca 3a Angazhimet e Pajtueshmërisë së Huamarrësit
- Shtojca 3b Angazhimet e Pajtueshmërisë së Agjencisë të Zbatimit të Projektit

PARATHËNIE

Baza për këtë marrëveshje huaje ndërmjet KfW-së, Huamarrësit dhe Agjencisë së Zbatimit të Projektit (**“Marrëveshja” ose “Marrëveshja e Huas”**) është marrëveshja e lidhur më 14.12.2018 midis Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin Financiar 2016 (BF) për projektin - Programi i investimeve për shpërndarjen e Energjisë elektrike I – (**“Marrëveshja Qeveritare”**).

KfW-ja do të rifinancojë Huan e dhënë në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje me subvencione të interesit nga fondet e buxhetit me interes të ulët të siguruara nga Republika Federale e Gjermanisë për projekte që përmbushin kriteret e përshtatshmërisë për zhvillimin e politikave. Termat dhe kushtet e huas janë në përputhje me kërkesat e OBZHE-së që zbatohen në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes për njohjen si Ndihmë Zyrtare për Zhvillim (NZZH).

Mbi këtë bazë dhe me kusht që Republika Federale e Gjermanisë të japë një garanci për Huan, KfW-ja do të japë një hua në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje të Huas.

1. HUAJA

1.1 Shuma. KfW-ja do t'i japë Huamarrësit një Hua që nuk e tejkalon shumën prej 30,000,000.00 EURO (**“Huaja”**), (me fjalë: tridhjetë milionë euro).

1.2 Qëllimi. Huamarrësi do t'ia kanalizojë Huan e plotë Agjencisë së Zbatimit të Projektit në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje. Agjencia e Zbatimit të Projektit do të përdorë Huan ekskluzivisht për investime në sisteme efikase për energji dhe infrastrukturë për shpërndarjen e energjisë (**“Projekti”**). Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet e Projektit dhe pajisjet dhe shërbimet që do të financohen nga Huamarrja me një marrëveshje të veçantë (**“Marrëveshje të veçantë”**), e cila do të bashkëfirmoset nga Huamarrësi, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

1.3 Taksat, tarifat, detyrimet doganore. Tatimet dhe pagesat e tjera publike që i lindin Huamarrësit ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit si dhe detyrimet doganore nuk do të financohen nga Huaja.

2. Kanalizimi i Huas

2.1 Marrëveshja e kanalizimit. Huamarrësi do t'ia kanalizojë Huan Agjencisë së Zbatimit të Projektit sipas një marrëveshjeje të veçantë nënhuazimi me të njëjtat afate dhe kushte financiare të përcaktuara në këtë marrëveshje huaje, në veçanti siç është përcaktuar në nenet 5.1 dhe 6.1 të këtij ligji.

2.2 Përkthimi i certifikuar. Para disbursimit të parë nga Huaja, Huamarrësi do t'i dërgojë KfW-së një përkthim të vërtetuar të marrëveshjes së huadhënies të specifikuar në nenin 2.1.

2.3 Përgjegjësia e Agjencisë së Zbatimit të Projektit. Kanalizimi i Huas nuk do të përbëjë asnjë përgjegjësi të Agjencisë Ekzekutive të Projektit kundrejt KfW-së për detyrimet e pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje.

3. Disbursimi

3.1 Kërkimi i disbursimeve. Sapo të përmbushen të gjitha kushtet paraprake të disbursimit në pajtim me nenin 3.3 (Kushtet paraprake të disbursimit), KfW-ja do të paguajë huan në përputhje me progresin e projektit dhe me kërkesë të Agjencisë së Zbatimit të Projektit. Disbursimet do të bëhen në përputhje me Listën e Disbursimit që gjendet në **aneksin 1** (Plani i



Disbursimit) të kësaj Marrëveshjeje të Huas. KfW-ja do të bëjë disbursime vetëm deri në shumat maksimale të përcaktuara për çdo gjashtë muaj. Në masën që Agjencia e Zbatimit të Projektit kërkon pagesën e shumave më të ulëta brenda gjysmë viti, shumat e padisbursuara mund të kërkojnë në secilën prej periudhave të ardhshme gjashtë mujore. Me përjashtim të disbursimit të fundit, KfW-ja nuk është i detyruar të bëjë disbursime prej më pak se 200,000.00 EURO.

3.2 *Afati për kërkimin e disbursimeve.* KfW-ja ka të drejtë të refuzojë të bëjë disbursime pas datës 30.06.2024.

3.3 *Kushtet paraprake për disbursimin.* KfW-ja është i detyruar të bëjë disbursime sipas kësaj Marrëveshjeje vetëm nëse kushtet paraprake të mëposhtme janë plotësuar në një mënyrë të pranueshme për KfW-në në formë dhe përmbajtje:

a) Huamarrësi do të ketë provuar në nivel të pranueshëm për KfW-në, duke paraqitur një opinion ligjor, përmbajtja e së cilit është kryesisht në përputhje me modelin në aneksin 2 (Forma e Opinioneve Ligjor të Këshilltarit Ligjor të Huamarrësit) dhe duke paraqitur kopje të certifikuar (secila me një përkthim zyrtar në gjuhën e kësaj Marrëveshjeje) të të gjitha dokumenteve të cilave u referohet opinioni i tillë ligjor, se Marrëveshja e Huas është ligjërish efektive dhe e zbatueshme dhe, në veçanti,

i) Huamarrësi ka plotësuar të gjitha kërkesat sipas ligjit të tij kushtetues dhe dispozitave të tjera ligjore në fuqi për marrjen e vlefshme të të gjitha detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje, dhe

ii) KfW-ja është përjashtuar nga të gjitha tatimet mbi të ardhurat nga fitimet e interesit dhe të gjitha taksat, komisionet dhe kostot e ngjashme në Republikën e Shqipërisë gjatë dhënies së Huasë;

b) KfW-ja zotëron një origjinal të kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjes së Veçantë, secila e nënshkruar me forcë ligjore detyruese;

c) nënshkrimet e mostrave të përmendura në nenin 13.1 (Përfaqësimi i Huamarrësit dhe Agjencisë së Zbatimit të Projektit) të këtij ligji janë marrë nga KfW;

d) garancia nga Republika Federale e Gjermanisë e përmendur në nenin 8 (Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë) është në fuqi dhe zbatohet pa ndonjë kufizim;

e) Huamarrësi ka paguar Taksën e Menaxhimit të përcaktuar në nenin 4.2 (Tarifa e Menaxhimit);

f) nuk ka asnjë arsye për ndërprerje, as nuk ka ndodhur ndonjë incident që do të shndërrohet në shkak të ndërprerjes nga njoftimi ose skadimi i afatit ose konstatimi ose plotësimi i një kushti (arsyeja e mundshme për përfundimin); dhe

g) nuk ka pasur rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operacionin ose qëllimin e Projektit ose përmbushjen e detyrimeve të pagesës të marra nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje.

KfW-ja ka të drejtën para çdo disbursimi nga Huaja për të kërkuar dokumente dhe prova të tjera, siç e shihet të nevojshme, sipas gjykimit të saj, për të konstatuar kushtet paraprake për disbursimin e specifikuar në këtë seksion.

3.4 Detajet e procedurës së disbursimit. Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-së do të përcaktojnë detajet e procedurës së disbursimit në Marrëveshjen e Veçantë, e cila do të bashkëfirmoset nga Huamarrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe në veçanti, dëshmitë që duhet të sigurohen nga Agjencia e Zbatimit të Projektit që dokumenton se shumat e kërkuara të Huas janë duke u përdorur për qëllimin e dakordësuar.

3.5 E drejta për anulimin e disbursimeve. Subjekt i përmbushjes së detyrimeve të tij sipas nenit 11 (Detyrimet e veçanta) këtu, Huamarrësi mund të heqë dorë nga lëvrimi i shumave të padisbursuara të Huas me pëlqimin paraprak të KfW-së kundrejt pagesës së një Kompensimi të mospranimit sipas dhe siç përcaktohet në nenin 3.6 (Kompensimi i Mospranimit).

3.6 Kompensimi i Mospranimit. Nëse Huamarrësi anulon pagesën e shumës së huas për të cilën është përcaktuar një normë interesi në përputhje me nenin 3.5 (E drejta për anulimin e disbursimeve), ose nëse shuma e tillë e huas nuk është disbursuar ose nuk është disbursuar deri në afatin e deklaruar në neni 3.2 (Afati i fundit për kërkesën e disbursimeve), Huamarrësi menjëherë do t'i paguajë KfW-së, sipas kërkesës së saj, një shumë të tillë që është e nevojshme për



të kompensuar KfW-në për humbjet, shpenzimet ose shpenzimet e bëra nga KfW-ja si rezultat i mospranimit të shumës së Huas (“Kompensimi i Mospranimit”), përveç nëse një mosdisbursim i tillë përbën një shkelje të kësaj Marrëveshjeje nga KfW-ja. KfW-ja do të llogarisë shumën e Kompensimit të Mospranimit dhe t’ia komunikojë atë Huamarrësit.

4. Tarifat

4.1 Tarifa e Angazhimit. Huamarrësi do të paguajë një tarifë angazhimi të pakthyeshme prej 0.25% në vit (“Tarifa e angazhimit”) për shumat e huas së padisbursuar.

Tarifa e angazhimit është e detyrueshme për pagesë gjashtë mujore me vonesë më 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti, për herë të parë më 15 maj 2020, por jo më herët se në datën përkatëse pas ditës në të cilën kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe efekt në pajtim me nenin 15.10 (Hyrja në fuqi).

Tarifa e angazhimit do të ngarkohet, nëse është e zbatueshme me efekt prapaveprues, për periudhën që fillon dymbëdhjetë muaj pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe që zgjat deri në datën e lënies së huas në tërësi ose, nëse është e zbatueshme, deri në datën e përfundimit të pagesave nga Huaja.

4.2 Tarifa e Menaxhimit. Huamarrësi do t’i paguajë KfW-së një tarifë menaxhimi të njëhershme, të pakthyeshme, të plotë prej 1.00% të shumës së huas të përcaktuar në nenin 1.1 (Shuma) të kësaj marrëveshjeje (“Tarifa e Menaxhimit”).

Tarifa e Menaxhimit është e pagueshme në më të hershmen e dy datave të mëposhtme: i) para disbursimit të parë; ose ii) pas mbarimit të tre muajve që nga nënshkrimi i Marrëveshjes nga KfW-ja ose pas kalimit të një muaji nga hyrja në fuqi dhe efekt të kësaj Marrëveshjeje (cilado nga datat e përcaktuara nën (ii) ndodh më vonë). Tarifa e Menaxhimit është e detyrueshme për pagesë sapo kjo Marrëveshje të jetë nënshkruar pa marrë parasysh nëse Huaja është disbursuar në mënyrë të plotë ose vetëm pjesërisht ose fare.

5. Interesi

5.1 Interesi. Huamarrësi do të paguajë interes kundrejt KfW-së si më poshtë:

Norma fikse e interesit e përcaktuar me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Huaje. Huamarrësi do të paguajë interesin e huas me një normë (“Norma fikse e interesit”) të përcaktuar nga

KfW-ja në ditën e dytë bankare, pas datës së marrjes së njoftimit nga KfW-ja siç përcaktohet në nenin 15.10 (Hyrja e saj në fuqi dhe efekt) derisa kësti i fundit i shlyerjes të jetë marrë në përputhje me planin e shlyerjes të përcaktuar në nenin 6.1 (Plani i shlyerjes). KfW-ja do të njoftojë huamarrësin mbi Normën Fikse të Interesit brenda pesë (5) ditësh bankare pas përcaktimit të saj.

5.2 Llogaritja e interesave. Interesi për shumën e huas do të paguhet nga data (duke e përjashtuar atë) në të cilën shumat përkatëse e huas është disbursuar nga llogaria e huas e mbajtur pranë KfW-së për Huamarrësin deri në datën (përfshirë) në të cilën pagesat përkatëse kreditohen në llogarinë e KfW-së të përcaktuar në nenin 7.3 (Numri i llogarisë, koha e kreditimit). Interesi do të llogaritet në përputhje me nenin 7.1 (Llogaritja).

5.3 Datat e Pagesës. Interesi do të bëhet i pagueshëm në vonesë në datat e specifikuar si më poshtë (secila një “Datë pagese”):

a) para datës së caktuar së kështit të parë të shlyerjes, më 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti, por jo më herët se në datën e pagesës pas ditës në të cilën kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe efekt sipas nenit 15.10 (Hyrja në fuqi dhe efekt);

b) në datën e duhur të kështit të parë të shlyerjes sipas nenit 6.1 (Plani i shlyerjes) së bashku me këstin e tillë;

c) më pas në datat e shlyerjes së kësteve të principalit sipas nenit 6.1 (Plani i shlyerjes) të këtij dokumenti, së bashku me këstin përkatës të principalit.

6. Pagesa dhe parapagimi

6.1 Plani i shlyerjes. Huamarrësi do të shlyejë Huan si më poshtë:

Data e duhur	Kësti i shlyerjes
15.05.2023	1.764.705,88
15.11.2023	1.764.705,88
15.05.2024	1.764.705,88
15.11.2024	1.764.705,88
15.05.2025	1.764.705,88
15.11.2025	1.764.705,88
15.05.2026	1.764.705,88
15.11.2026	1.764.705,88
15.05.2027	1.764.705,88
15.11.2027	1.764.705,88
15.05.2028	1.764.705,88



15.11.2028	1.764.705,88
15.05.2029	1.764.705,88
15.11.2029	1.764.705,88
15.05.2030	1.764.705,88
15.11.2030	1.764.705,88
15.05.2031	1.764.705,92

6.2 Shumat e padisbursuara të Huas. Shumat e padisbursuara të huas do të kompensohen kundrejt kështit përkatës të shlyerjes të fundit në përputhje me planin e shlyerjes të përcaktuar në nenin 6.1 (Plani i shlyerjes), përveç nëse KfW-ja sipas zgjedhjes së vet zgjedh një alternativë tjetër kompensimi në rastet individuale.

6.3 Pagesa në rast të disbursimit jo të plotë. Nëse një kësht shlyerje duhet të paguhet para se Huaja të jetë disbursuar tërësisht, kjo nuk do të ndikojë në planin e shlyerjes sipas nenit 6.1 (Plani i Shlyerjes) për atë kohë sa kështi i shlyerjes së detyrimit sipas skemës së shlyerjes është më i ulët se shuma e huas e disbursuar dhe ende nuk është shlyer (“Shuma e Pashlyer e Huas”). Nëse kështi i shlyerjes në pajtim me nenin 6.1 (Plani i shlyerjes) tejkalon shumën e huas së disbursuar, kështi i shlyerjes do të reduktohet në nivelin e shumës së huas së papaguar dhe diferenca do të ndahet në mënyrë të barabartë në kështet e shlyerjes të mbetura ende të pashlyera. Në llogaritjen e shumës së pashlyer të huas KfW-ja rezervon të drejtën të marrë parasysh disbursimet e huas që bëhen brenda një periudhe prej 45 ose më pak ditë para datës së pagesës për të përcaktuar shumën e pashlyer të huas vetëm për Datën pasuese të Pagesës.

6.4 Parapagimi. Në parapagesat do të aplikohen:

a) E drejta për parapagim. Duke iu nënshtruar paragrafëve të mëposhtëm 6.4 b) (Njoftimi) në 6.4 e) (Kompensimi) të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi ka të drejtë të shlyejë shumat e huas para datës së caktuar të detyrimit nëse ky parapagim është të paktën në shumën e kështit të shlyerjes sipas nenit 6.1 (Plani i shlyerjes).

b) Njoftimi. Parapagimi i shumës së huas në pajtim me nenin 6.4 a) (E drejta për parapagim) është subjekt i njoftimit të parapagimit nga Huamarrësi kundrejt KfW-së jo më vonë se ditën e pesëmbëdhjetë bankare (siç përcaktohet në nenin 15.1 (Dita Bankare) përpara datës së parashikuar të parapagimit. Njoftimi i tillë është i

parevokueshëm; ai duhet të specifikojë datën dhe shumën e parapagimit dhe e detyron Huamarrësin t’i paguajë KfW-së shumën e deklaruar në datën e caktuar.

c) Kompensimi i Parapagimit. Nëse Huamarrësi paguan një shumë të Huas me interes fiks, Huamarrësi do t’i paguajë menjëherë KfW-së me kërkesë një shumë të tillë sa është e nevojshme për të kompensuar humbjet, shpenzimet ose kostot e shkaktuara nga KfW-ja si rezultat i një parapagimi të tillë (“Kompensimi i Parapagimit”). KfW-ja do të përcaktojë shumën e kompensimit të parapagimit dhe do t’ia komunikojë atë Huamarrësit. Me kërkesë të Huamarrësit, KfW-ja do t’i japë Huamarrësit një tregues të shumës së kompensimit të parapagimit para njoftimit të kërkuar të parevokueshëm për shlyerjen sipas nenit 6.4 b) (Njoftimi).

d) Shumat e kërkueshme. Së bashku me parapagimin në pajtim me nenin 6.4 a) (E drejta për parapagim), Huamarrësi do të paguajë shumat e mëposhtme:

i) çdo Kompensim Parapagimi që duhet të paguhet si rezultat i parapagimit sipas nenit 6.4 c) (Kompensimi i Parapagimit); dhe

ii) të gjitha interesat e akumuluar për shumën e Huas së papaguar dhe të gjitha pagesat e tjera të papaguara sipas kësaj Marrëveshjeje që kanë ardhur deri në datën e parapagimit.

e) Kompensimi. Neni 6.2 (Shumat e padisbursuara të Huas) të kësaj Marrëveshjeje do të zbatohet *mutatis mutandis* për kompensimin e parapagimeve.

6.5 Plani i rishikuar i shlyerjes. Në rast se zbatohet neni 6.3 (Shlyerja në rast të disbursimit jo të plotë) ose neni 6.4 (Parapagimi) i kësaj Marrëveshjeje, KfW-ja do t’i dërgojë Huamarrësit një plan të rishikuar të shlyerjes që do të bëhet pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje dhe do të zëvendësojë planin e shlyerjes të vlefshme deri në atë kohë.

7. Llogaritjet dhe pagesat në përgjithësi

7.1 Llogaritja. Interesi, Tarifa e Angazhimit, Interesi i mospagimit sipas nenit 7.5 (Interesi i mospagimit), pagesa e kompensimit të shumave të pashlyera për shumat e vonuara sipas nenit 7.6 (Kompensimi i plotë), Kompensimi i Mospranimi dhe Kompensimi i Parapagimit do të llogariten në bazë të një viti 360 ditësh me muaj tridhjetë ditë.



7.2 Data e përcaktuar. Nëse një pagesë që duhet të bëhet në lidhje me këtë Marrëveshje bie në një datë që nuk është Ditë Bankare, Huamarrësi duhet të bëjë një pagesë të tillë në Ditën Bankare në vijim. Nëse Dita Bankare në vijim bie brenda muajit të ardhshëm kalendarik, pagesa e tillë duhet të bëhet në Ditën e fundit Bankare të muajit aktual kalendarik.

7.3 Numri i llogarisë, koha e kreditimit. Huamarrësi do të lirohet nga detyrimet e tij të pagesës në lidhje me këtë Marrëveshje nëse dhe deri në masën që shumat përkatëse janë kredituar në KfW në dispozicion të lira, pa asnjë zbritje, në euro dhe jo më vonë se ora 10.00 në Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë, në llogarinë e KfW-së në Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë, numri i IBAN DE09 5002 0400 3102 5608 01, duke deklaruar datën e duhur si një referencë shtesë (“Ref YYYYMMDD”).

7.4 Pretendimet e Huamarrësit. Huamarrësi nuk ka të drejtë të kërkojë të drejtat e mbajtjes ose të kompensimit ose të drejtave të krahasueshme kundrejt detyrimeve të pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje përveç nëse këto të drejta njihen me aktgjykim deklarues ose nuk kontestohen nga KfW-ja.

7.5 Interesi mbi mospagimin. Nëse këstet e pagesës ose parapagimet sipas nenit 6.4 (Parapagimi) nuk janë në dispozicion të KfW-së në kohën e duhur, KfW-ja mundet të faturojë pa njoftim paraprak kamatëvonesë në normën prej 200 pikë bazë mbi normën fikse të interesit në vit të përcaktuar në nenin 5.1 (Interesi) për periudhën që fillon në datën e caktuar për pagesë dhe përfundon në datën në të cilën pagesat e tilla janë kredituar në llogarinë e KfW-së të specifikuar në nenin 7.3 (Numri i llogarisë, koha e kreditimit). Interesi i tillë i vonuar duhet të paguhet menjëherë pas kërkesës së parë të KfW-së.

7.6 Kompensimi i shumës së plotë. KfW-ja mundet të kërkojë pa paralajmërim kompensim të plotë për shumat e papaguara (me përjashtim të kësteve të shlyerjes dhe parapagimeve të përmendura në nenin 7.5 (Interesi i vonuar) sipas këtij kuptimi) nga data e duhur deri në datën e pagesës me një normë prej 200 pikësh bazë mbi Normën Fikse të Interesit në vit në përputhje me nenin 5.1 (Interesi). Kompensimi i plotë duhet të

paguhet menjëherë pas kërkesës së parë të KfW-së. Huamarrësi është i lirë të demonstrojë që nuk ka pasur dëmtime ose që dëmet janë më të vogla se kompensimi i plotë.

7.7. Kompensimi. KfW-ja ka të drejtë të kompensojë pagesat e pranuar ndaj pagesave që rrjedhin nga kjo Marrëveshje ose sipas marrëveshjeve të tjera të huas të lidhura ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit. Për të shmangur çdo dyshim, kjo do të aplikohet në mënyrë të veçantë në kushtet kur ndodh një mospagesë apo rast i mundshëm mospagese nga Huamarrësi.

7.8 Llogaritjet e bëra nga KfW-ja. Mungesa e gabimeve të dukshme, vlerat e llogaritura nga KfW-ja dhe llogaritjet e kryera nga KfW-ja për shumat e detyruara në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje përbëjnë dëshmi *prima facie* (Anscheinsbeweis).

8. Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë

KfW-ja do të ketë kërkesa për pagesë sipas kësaj Marrëveshjeje të garantuar nga Republika Federale e Gjermanisë para disbursimit të parë.

9. Paligjshmëria

Nëse, në ndonjë juridiksion të zbatueshëm, bëhet e paligjshme që KfW-ja të kryejë ndonjë nga detyrimet e saj të parashikuara nga kjo Marrëveshje ose të financojë ose mbajë huan, pasi KfW-ja njofton Huamarrësin:

a) angazhimi i KfW-së do të anulohet menjëherë; dhe

b) Huamarrësi do të ripaguajë plotësisht shumën e disbursuar dhe të papaguar të huas në datën e specifikuar nga KfW-ja në njoftimin e dhënë Huamarrësit (duke qenë jo më herët se dita e fundit e çdo periudhe të lejuar me ligj).

10. Kostot dhe pagesat publike

10.1 Asnjë zbritje ose ndalim. Huamarrësi do të bëjë të gjitha pagesat sipas kësaj Marrëveshjeje pa ndonjë zbritje për taksat, ngarkesat e tjera publike ose shpenzimet e tjera. Në rast se Huamarrësi është i detyruar me ligj ose për shkaqe të tjera për të bërë ndonjë zbritje të tillë ose mbajtje nga pagesat, pagesat e bëra nga Huamarrësi do të rriten me shumën e nevojshme që KfW-ja të marrë plotësisht shumat e duhura sipas kësaj Marrëveshjeje pas zbritjes së taksave dhe pagesave.

10.2 Kostot. Huamarrësi do të përballojë të gjitha kostot dhe shpenzimet që rrjedhin në



lidhje me disbursimin dhe shlyerjen e huas, në veçanti dërgesat në para dhe shpenzimet e transferimit (përfshirë tarifat e konvertimit), si dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet që rrjedhin në lidhje me mirëmbajtjen ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe të çdo dokumenti tjetër lidhur me këtë Marrëveshje si dhe të gjitha të drejtat që rrjedhin prej saj.

10.3 Taksat dhe tarifat e tjera. Huamarrësi do të bartë të gjitha taksat dhe tarifat e tjera publike që lindin jashtë Republikës Federale të Gjermanisë në lidhje me përfundimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Nëse KfW-ja parapaguan taksa apo ngarkesa të tilla, Huamarrësi do t'i transferojë ato pa vonesë sipas kërkesës në llogarinë e KfW-së të specifikuar në nenin 7.3 (Numri i llogarisë, koha e kreditimit) ose në llogarinë tjetër siç është përcaktuar nga KfW.

11. Detyrime të veçanta

1.1 Detyrimet e Agjencisë së Zbatimit të Projektit lidhur me Projektin. Agjencia e Zbatimit të Projektit

a) do të përgatisë, zbatojë, operojë dhe mirëmbajë Projektin në përputhje me praktikën e qëndrueshme financiare dhe teknike, në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale dhe kryesisht në përputhje me konceptimin e Projektit të rënë dakord ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së;

b) do të caktojë përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të Projektit inxhinierëve konsultimi apo konsulentëve të pavarur, të kualifikuar, dhe zbatimin e Projektit firmave të kualifikuara;

c) do të japë kontratat për mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga Huaja (neni 11.1 b) të kësaj marrëveshjeje) me ofertë e paraprake ndërkombëtare konkurruese publike;

d) do të mbajë libra dhe regjistra ose do të marrë masa për mbajtjen e librave dhe regjistrave që pa dyshim tregojnë të gjithë kostot e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin dhe identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga kjo Hua;

e) do t'i mundësojë KfW-së dhe agjentëve të saj që në çdo kohë të inspektojnë regjistrime të tilla dhe çdo dokumentacion tjetër të rëndësishëm për zbatimin dhe funksionimin e Projektit dhe për të vizituar Projektin dhe të gjitha instalimet që lidhen me to;

f) do t'i japë KfW-së të gjitha informatat dhe shënimet e tilla për Projektin dhe progresin e mëtejshëm të tij, siç mund të kërkojë KfW-së;

g) menjëherë dhe me nismën e vet,

i) i dërgon KfW-së çfarëdo pyetje të marra nga Huamarrësi nga OECD ja ose anëtarët e saj sipas të ashtuquajturës “Marrëveshje për Transparencë të Përbashkët të Huave ODA” pas dhënies së kontratave për furnizimet dhe shërbimet që do të financohen nga Huaja dhe do të koordinojë përgjigjen për çdo pyetje të tillë me KfW-në, dhe

ii) njoftojë KfW-në për çdo dhe të gjitha rrethanat që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e projektit.

11.2 Detajet e zbatimit të projektit. Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet që kanë të bëjnë me nenin 11.1 të kësaj Marrëveshjeje me anë të një Marrëveshjeje të Veçantë, e cila do të bashkëfirmoset nga Huamarrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

11.3 Detyrimet e Përbashkëta lidhur me Projektin. Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit

a) do të sigurojnë financimin e plotë të Projektit dhe do t'i sigurojnë KfW-së, sipas kërkesës së saj, dëshmi që vërtetojnë se shpenzimet që nuk paguhën nga kjo Hua janë të mbuluara dhe,

b) do të njoftojnë menjëherë KfW-në dhe me nismën e tyre për çdo dhe të gjitha rrethanat që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Projektit.

11.4 Detyrimet e Huamarrësit lidhur me Projektin. Huamarrësi do të asistojë Agjencinë për Zbatimin e Projektit në përputhje me praktikën e shëndosha inxhinierike dhe financiare në zbatimin e Projektit dhe në përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë së Zbatimit të Projektit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe, në veçanti, t'i japë Agjencisë për Zbatimin e Projektit çdo dhe të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e Projektit.

11.5 Angazhime të Pajtushmërisë. Huamarrësi merr përsipër të përmbushë në çdo kohë detyrimet e përcaktuara në aneksin 3a (Angazhime të pajtushmërisë për Huamarrësin). Agjencia e Zbatimit të Projektit merr përsipër të përmbushë në çdo kohë detyrimet e përcaktuara



në Aneksin 3b (Angazhime të Pajtueshmërisë për Agjencinë e Zbatimit të Projektit).

11.6 Transporti i furnizimeve. Dispozitat e përcaktuara në Marrëveshjen Qeveritare, të cilat janë të njohura nga Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit, do të zbatohen për transportin e furnizimeve që do të financohen nga Huaja.

11.7 Klasifikimi *pari passu*. Huamarrësi garanton dhe përfaqëson se detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje do të klasifikohen dhe do të shërbejnë të paktën *pari passu* me të gjitha borxhet e jashtme të pasigurta dhe jo të varura, dhe Huamarrësi do të sigurojë deri në masën e lejuar nga ligji që ky klasifikim të sigurohet edhe për të gjithë borxhin e jashtëm të pasiguar dhe jo i varur, në të ardhmen. Në këtë Marrëveshje, “Borxhi i Jashtëm” sipas përkufizimit të KfW-së, do të thotë një detyrim i Huamarrësit, i cili është:

i. i qeverisur nga një sistem i një ligji tjetër nga ligji i Huamarrësit; ose

ii. i pagueshëm në një monedhë të ndryshme nga monedha e vendit të Huamarrësit; ose

iii. i pagueshëm ndaj një personi të themeluar, banues ose me zyrën e tij qendrore ose vendin kryesor të biznesit jashtë vendit të Huamarrësit.

11.8 Barra. Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk do të krijojnë ose lejojnë të krijohet asnjë Barrë mbi asetet e Projektit pa pëlqimin paraprak të KfW-së. Në këtë Marrëveshje, “Barrë” nënkupton çdo hipotekë, peng, barrë, pagesë, caktim ose transferim me anë të sigurisë, hipotekës ose interesit të sigurisë dhe çdo marrëveshje tjetër ose ujdj, efekti i të cilit është krijimi i një garancie ose të ndonjë të drejte duke i dhënë përparësi pagesës në lidhje me ndonjë detyrim të ndonjë personi.

Ky detyrim nuk zbatohet:

c) për detyrimet ekzistuese ose të rena dakord në kohën kur kjo Marrëveshje u nënshkrua dhe iu njoftua KfW-së para se kjo Marrëveshje të ishte nënshkruar,

i) për detyrimet që krijohen në kryerjen e rregullt të biznesit sipas rregullave ligjore apo rregullave të tjera të zakonshme kontraktuale për të garantuar detyrimet (me përjashtim të detyrimeve të huas) ndaj furnitorëve apo ofruesve të tjerë të shërbimeve (p.sh. ruajtjen e të

drejtave të titullit të zakonshme në industri dhe barrëve/garancive ligjore),

ii) detyrimet ekzistuese në kohën kur një pasuri është blerë, me kusht që këto detyrime të hiqen brenda tre muajve pas blerjes.

Nëse Agjencia e Zbatimit të Projektit i jep një pale të tretë garanci apo të drejta të tjera që i mundëson kësaj pale të tretë të kërkojë përmbushje preferenciale të pretendimeve ndaj ndonjë prej aseteve, pronës apo të ardhurave financiare të Programit, KfW-ja mund të japë pëlqimin e vet, me kushtin që Huamarrësi dhe/ose Agjencia e Zbatimit të Projektit t'i ofrojë KfW-së garanci (shtesë) në të njëjtin nivel që garanton në mënyrë të barabartë dhe proporcionale kërkesat e KfW-së ndaj Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje.

11.9 Shitja e aseteve. Pa pëlqimin paraprak të KfW-së, as Huamarrësi, as Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk do të shesë asnjë aset të Projektit derisa detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje të jenë shlyer plotësisht dhe përfundimisht.

12. Përfundimi i Marrëveshjes

12.1 Arsytet për përfundimin. KfW-ja mund të ushtrojë të drejtat e përcaktuara në nenin 12.2 (Pasojat juridike të ndodhjes së shkakut të ndërprerjes), nëse paraqitet një rrethanë që përbën shkak të mjaftueshëm (Wichtiger Grund). Këto përfshijnë, në veçanti, rrethanat e mëposhtme:

a) Huamarrësi nuk arrin të kryejë detyrimet e pagesës ndaj KfW-së kur duhet;

b) janë shkelur detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas Marrëveshjes së Veçantë, si dhe çdo marrëveshje tjetër shtesë ligjore detyruese ndaj kësaj Marrëveshjeje;

c) kjo Marrëveshje ose ndonjë pjesë e saj nuk ka më ndonjë efekt detyrues mbi Huamarrësin ose Agjencinë e Zbatimit të Projektit ose nuk mund të zbatohet më tej ndaj Huamarrësit ose Agjencisë Zbatuese të Projektit;

d) ndonjë deklaratë, konfirmim, informacion, përfaqësim ose garanci që konsiderohet nga KfW-ja si thelbësor për dhënien dhe mbajtjen e Huas dëshmon të jetë e rreme, çorientuese ose jo e plotë;

e) ndodhin rrethana të tjera të jashtëzakonshme të cilat vonojnë ose pengojnë



përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje

f) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk është në gjendje të dëshmojë se shumat e huas janë përdorur për qëllimin e përcaktuar;

g) Huamarrësi ndërpret pagesat e tij ndaj kreditorëve, është i paaftë të paguajë ose fillon negociatat me një ose më shumë kreditorë të Huamarrësit për një moratorium, heqjen dorë nga borxhet e papaguara, shtyrjen e pagesave ose ndërprerjen e shërbimit të borxhit.

12.2 Pasojat juridike të shfaqjes së një shkakui për ndërprerjen. Nëse ndodh një nga ngjarjet e përmendura në nenin 12.1 (Arsyet për ndërprerjen e kontratës), KfW-ja mund të pezullojë menjëherë pagesat sipas kësaj Marrëveshjeje. Nëse kjo ngjarje nuk zgjidhet brenda një periudhe prej pesë ditësh (në rastin e nenit 12.1 a) ose në të gjitha rastet e tjera të nenit 12.1 (Arsyet për ndërprerjen e kontratës) brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, megjithatë, do të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja mund ta anulojë këtë Marrëveshje krejtësisht ose pjesërisht me pasojat që detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje të ndërpriten dhe KfW-ja mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjithë ose një pjese të shumës së huas së papaguar së bashku me interesin e përlllogaritur dhe shumat e mbetura që detyrohen sipas kësaj Marrëveshjeje. Nenet 7.5 (Interesi i mospagimit) dhe 7.6 (Kompensimi i shumës së plotë) të kësaj Marrëveshjeje zbatohen për shlyerjet e përshpejtuara *mutatis mutandis*.

12.3 Kompensimi për dëmet. Nëse kjo Marrëveshje përfundon plotësisht ose pjesërisht, Huamarrësi do të paguajë Kompensimin e Mospranimit në përputhje me nenin 3.6 (Kompensimi i mospranimit) dhe/ose Kompensimin e parapagimit në pajtim me nenin 6.4 c) (Kompensimi i parapagimit).

13. Përfaqësimi dhe deklaratat

13.1 Përfaqësimi i Huamarrësit. Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe personat e përcaktuar prej tij ose saj në KfW dhe të autorizuar me nënshkrimet e ekzemplarëve të vërtetuara nga ai ose ajo do të përfaqësojnë Huamarrësin në ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. CEO i Agjencisë së Zbatimit-Projektit dhe personat e caktuar nga ai ose ajo në KfW dhe të autorizuar me nënshkrimet e

ekzemplarëve të vërtetuara nga ai ose ajo do të përfaqësojnë Agjencinë e Zbatimit të Projektit në nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje dhe zbatimin e Projektit dhe kësaj marrëveshjeje. Kompetencat e përfaqësimit nuk do të skadojnë deri në momentin e tërheqjes së tyre të shprehur nga përfaqësuesi i Huamarrësit ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit të autorizuar në atë kohë nga KfW-ja.

13.2 Adresat: Deklaratat ose njoftimet në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të jenë me shkrim. Ato duhet të dërgohen si origjinale ose – me përjashtim të kërkesave për pagesë – nëpërmjet faksit. Çdo dhe të gjitha deklaratat ose njoftimet e bëra në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të dërgohen në adresat e mëposhtme:

Për KfW-në:

KfW

Postfach 11 11 41

60046 Frankfurt am Main

Germany (Gjermani)

Faks: +49 69 7431 -2944

Për Huamarrësin:

[Ministria e Financave dhe Ekonomisë](#)

[Blvd. “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3](#)

[Tiranë, Shqipëri](#)

Për Agjencinë e Zbatimit të Projektit

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE)

Blvd. “Gjergj Fishta”, nr. 88, H.1

Njësia Administrative Nr. 7, 1023

Tiranë, Shqipëri

13.3 Amendamentet. Ministri i Ekonomisë dhe Financave është i autorizuar të nënshkruajë çdo amendament/ndryshim që duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet në këtë Marrëveshje që ndikojnë vetëm në periudhën e disponueshmërisë (neni 3.2) nuk do të kërkojnë miratimin paraprak nga Këshilli i Ministrave dhe nuk kërkojnë ratifikimin. Ndryshimet në këtë Marrëveshje që prekin vetëm marrëdhënien juridike ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit nuk do të kërkojnë miratimin e Agjencisë së Zbatimit të Projektit.

14. Publikimi dhe transferimi i informacionit lidhur me projektin



14.1 Publikimi i informacionit lidhur me projektin nga KfW-ja. Për të përmbushur parimet e pranuar ndërkombëtarisht të transparencës dhe efikasitetit maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacione të përzgjedhura (duke përfshirë raportet e vlerësimit) rreth Projektit dhe mënyrën se si financohet gjatë negociatave parakontraktuale, ndërsa marrëveshja/et e projektit është/janë duke u zbatuar dhe në fazën postkontraktuale (në vijim “Periudha e Plotë”).

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të Bankës për Zhvillim të KfW-së <http://transparenz.KfW-entwicklungsbank.de/en>.

Publikimi i informacionit (ose nga KfW-ja ose palët e treta në përputhje me nenin 14.3 (Transferimi i informacioneve të lidhura me projektin te palët e treta dhe publikimi nga këta) më poshtë) në lidhje me Projektin dhe si financohet nuk përfshin ndonjë dokumentacion kontraktual ose ndonjë financiar të ndjeshëm ose informacion të detajuar lidhur me biznesin për palët e përfshira në Projekt ose financimin e tij, si p.sh.

- a) informacion në lidhje me të dhënat e brendshme financiare;
- b) strategjitë e biznesit;
- c) udhëzimet dhe raportet e brendshme të korporatës;
- d) të dhënat personale të personave fizikë;
- e) vlerësimi i brendshëm i KfW-së për pozicionin financiar të palëve.

14.2 Transferimi i informacioneve të lidhura me projektin te palët e treta. Aksionet e KfW-së kanë zgjedhur informacionin rreth Projektit dhe si financohet gjatë Periudhës së Përgjithshme me subjektet e përmendura më poshtë, veçanërisht për të siguruar transparencë dhe efikasitet:

- a) degët e KfW-së;
- b) Republika Federale e Gjermanisë dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë ose entitetet e saj kompetente;
- c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin dypalësh të zhvillimit gjerman, veçanërisht Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH;
- d) organizatat ndërkombëtare të përfshira në grumbullimin e të dhënave statistikore dhe anëtarëve të tyre, veçanërisht Organizatës për

Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZHE) dhe anëtarët e tij.

14.3 Transferimi i informacioneve të lidhura me projektin te palët e treta dhe publikimi nga këto. Për më tepër, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur për Projektin dhe si financohet gjatë gjithë Periudhës së Përgjithshme me subjektet e mëposhtme, të cilat publikojnë pjesët përkatëse për qëllimin:

a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllimet e Iniciativës për Transparencën e Ndhmës Ndërkombëtare

(<http://www.bmz.de/de/ministerium/zahlen-fakten/transparenz-mehr-wirksamkeit/Transparenzstrategie/index.html>).

b) Gjermania Trade & Invest (GTAI) për qëllime të informacionit të tregut (<http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/welcome.html>)

c) OBZHE për qëllimin e raportimit të flukseve financiare në kuadër të bashkëpunimit për zhvillim (<http://www.oecd.org/>)

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (German Institute for Development Evaluation) (DEval), me qëllim të vlerësimit të bashkëpunimit të përgjithshëm gjerman për zhvillim për të siguruar transparencë dhe efikasitet (<https://www.deval.org/en/>).

14.4 Transferimi i informacioneve të lidhura me projektin te palët e treta (duke përfshirë publikimin e tyre). KfW-ja më tej rezervon të drejtën për të transferuar (përfshirë për qëllime të publikimit) informacionin për Projektin dhe mënyrën si financohet gjatë Periudhës Gjithëpërfshirëse për palët e tjera të treta në mënyrë që të mbrojë interesat e ligjshme.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja te palët e tjera të treta nëse interesat e ligjshme të Huamarrësit ose Agjencisë Ekzekutive të Projektit në informacionin që nuk transferohet tejkalojnë interesat e KfW-së për transferimin. Interesat legjitime të Huamarrësit dhe Agjencisë Zbatuese të Projektit përfshijnë veçanërisht konfidencialitetin e informacionit sensitiv të përmendur në nenin 14.1 (Publikimi i informacionit të projektit nga KfW-ja), i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtë të transferojë informacion te palët e treta nëse kjo është e



nevojshme për shkak të kërkesave ligjore ose për të mbrojtur pretendimet ose të drejtat e tjera ligjore në gjykata ose procedurat administrative.

15. Dispozitat e përgjithshme

15.1 Dita Bankare. Nëse i bëhet referencë në këtë Marrëveshjeje në lidhje me “Ditë Bankare”, kjo do të thotë një ditë të ndryshme nga e shtuna ose e diela në të cilën bankat tregtare në Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë janë të hapura për biznes të përgjithshëm.

15.2 Vendi i kryerjes. Vendi i përmbushjes për të gjitha detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje është Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë.

15.3 Pavlefshmëria e pjesshme dhe hendeqet. Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme, ose nëse ekziston një boshllëk në ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, kjo nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje. Palët në këtë Marrëveshje do të zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një tjetër ligjërisht të vlefshme i cili i afrohet sa më pranë frymës dhe qëllimit të dispozitës së pavlefshme. Palët do të mbushin çdo boshllëk në dispozitat me një dispozitë të ligjshme të vlefshme që i afrohet sa më pranë qëllimit të kësaj Marrëveshjeje.

15.4 Forma e shkruar. Çdo shtojcë dhe ndryshim në këtë Marrëveshje duhet të jenë me shkrim. Palët mund të heqin dorë nga kushti i ndryshimit me shkrim, vetëm me shkrim.

15.5 Transferimi. As Huamarrësi, as Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të caktojnë apo transferojnë, të lënë peng apo të lënë si garanci hipotekore ndonjë pretendim që rrjedh nga kjo Marrëveshjeje Kredie.

15.6 Ligji në fuqi. Kjo Marrëveshjeje rregullohet nga ligji gjerman.

15.7 Periudha e kufizimit. Të gjitha pretendimet e KfW-së sipas kësaj Marrëveshjeje përfundojnë pas pesë vitesh nga fundi i vitit në të cilin është ngritur një pretendim i tillë dhe në të cilën KfW-ja është vënë në dijeni për rrethanat që përbëjnë një pretendim të tillë ose mund të ketë qenë në dijeni të tyre pa neglizhencë serioze.

15.8 Heqja dorë nga imuniteti. Nëse dhe në masën që Huamarrësi tani ose në të ardhmen në ndonjë juridiksion do të kërkojë imunitet për

vete ose asetet e tij dhe në masën që një juridiksion i jep imunitet Huamarrësit dhe aseteteve të tij nga padia, përmbarimi, sekuestrimi ose procesi tjetër ligjor Huamarrësi pranon në mënyrë të pakthyeshme heqjen e imunitetit të tillë për kërkesat nga dhe në lidhje me këtë Marrëveshjeje të Huas në masën më të plotë të lejuar nga ligjet e një juridiksioni të tillë.

Huamarrësi nuk heq dorë nga ndonjë imunitet në lidhje me:

i. “ambientet e misionit” aktuale, apo në të ardhmen, siç përcaktohen në Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike, të nënshkruar në vitin 1961, “ambientet konsullore” aktuale apo në të ardhmen, siç përcaktohen në Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore, të nënshkruar në vitin 1963 apo ndryshe të përdorur nga një diplomat apo mision diplomatik i Republikës së Shqipërisë ose çdo agjencie apo instrumenti në këtë Marrëveshjeje.

ii. çdo pronë e paluajtshme, sipas nenit 3, paragrafi 1–3 i ligjit shqiptar nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme shtetërore”,

iii. çdo fond dhe/ose shumë monetare që është bërë tashmë e kërkueshme apo është paguar në moment apo zbatimi për përmbushjen e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë, sipas të drejtës publike, traktateve dhe konventave ndërkombëtare, dhe/ose marrëveshjeve të nënshkruara prej saj.

15.9 Mosmarrëveshjet ligjore.

a) Arbitrazhi. Të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshjeje Huaje do të zgjidhen ekskluzivisht dhe përfundimisht nga një gjykatë arbitrazhi. Në këtë drejtim do të zbatohen si më poshtë:

i) Gjykata e arbitrazhit do të përbëhet nga një ose tre arbitra, të cilët do të emërohen dhe do të veprojnë në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (DHNT) të zbatueshme herë pas here.

ii) Procedimi i arbitrazhit do të zhvillohet në Frankfurt am Main. Gjuha e procedimit do të jetë gjuha angleze.

15.10 Hyrja në fuqi dhe efekt. Kjo Marrëveshjeje nuk do të hyjë në fuqi dhe efekt deri në datën kur KfW-ja të ketë marrë njoftimin me shkrim nga Huamarrësi.



- se Marrëveshja Qeveritare mbi të cilën është bazuar, ka hyrë në fuqi dhe efekt, dhe

- se Marrëveshja e Huas është ratifikuar sipas rregullave.

Nëse Marrëveshja nuk ka hyrë në fuqi pas gjashtë muajsh pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje apo ndonjë afati tjetër që mund të jetë rënë dakord nga KfW-ja, nga ajo datë deri në datën e hyrjes në fuqi, KfW-ja do të ketë të drejtën të tërhiqet në mënyrë të njëanshme nga Marrëveshja dhe kështu të ndërpresë pezullimin e saj duke i dërguar një njoftim me shkrim Huamarrësit.

Bërë në tri kopje origjinale në gjuhën angleze.
Frankfurt am Main, datë 5.3.2019

KfW

Emri:

Titulli:

Emri:

Titulli

Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga
Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Emri:

Titulli:

Operatori i Shpërndarjes Energjisë Elektrike
sh.a. (OSHEE)-së

Emri:

Titulli

SHTOJCA 1 PLANI I DISBURSIMIT

Plani më i shpejtë i mundshëm i disbursimit

Deri në fund të çdo periudhe disbursimi (**“Data efektive e fundit të periudhës”**) në përputhje me listën e mëposhtme) Huamarrësi mund të kërkojë disbursime vetëm deri në një nivel që nuk kalon shumën kumulative të disbursimeve të specifikuara në tabelën në vijim.

Periudha	Data e hyrjes në fuqi e fill. të periudhës (përfshirë)	Data e hyrjes në fuqi e fundit të periudhës (përfshirë)	Shuma maksimale që mund të disbursohet deri në fund të periudhës (kumulative) (të gjitha shifrat në euro)
1	1.7.2019	1.1.2020	3.000.000,00
2	1.1.2020	1.7.2020	6.000.000,00
3	1.7.2020	1.1.2021	11.000.000,00
4	1.1.2021	1.7.2021	16.000.000,00
5	1.7.2021	1.1.2022	20.000.000,00
6	1.1.2022	1.7.2022	22.000.000,00
7	1.7.2022	1.1.2023	24.000.000,00
8	1.1.2023	1.7.2024	30.000.000,00



SHTOJCA 2

FORMA E OPINIONIT LIGJOR TË KËSHILLTARIT LIGJOR TË HUAMARRËSIT

Shënim. Ju lutemi ndryshoni “Republika e SHTETIT”/”SHTETP” në mënyrë të përshtatshme.

Koka e letrës e konsulentit ligjor

KfW

Departamenti []

(data)

Në vëmendje të: []

Palmengartenstrasse 5 - 9

Postfach 11 11 41

60325 Frankfurt am Main/Germany (Gjermani)

Republika Federale e Gjermanisë

Marrëveshja e Huas e datës [] dhe e lidhur ndërmjet KfW-së dhe [] (“Huamarrësi”) për një shumë që nuk kalon shumën totale [] 000.000 EURO.

Të nderuar zotërinj,

Unë jam [Ministri i Drejtësisë i] i [këshilltari ligjor i] [kreu i departamentit juridik] të [] (ju lutem specifikoni ministrinë ose autoritetin tjetër) të Republikës së SHTETIT. Unë kam vepruar në atë cilësi në lidhje me një marrëveshje huaje të datës [] (“Marrëveshja e Huas”) dhe të lidhur ndërmjet Huamarrësit dhe jush në lidhje me një hua që do t’i jepni Huamarrësit në një shumë që nuk tejkalon [] .000.000, EURO .

1. Dokumentet e shqyrtuara

Kam shqyrtuar:

1.1 një kopje autentike e nënshkruar e Marrëveshjes së Huas;

1.2 dokumentet kushtetuese të Huamarrësit, në veçanti:

a) Kushtetuta e Republikës së VENDIT, e datës [], e publikuar në mënyrë të rregullt në [], nr. [] faqe [], e ndryshuar;

b) Ligji/et nr. [] me datë [] publikuar në mënyrë të rregullt në [], nr. [], faqe [], të ndryshuar [ju lutemi shënoni këtu, nëse ekzistojnë, ligjet (p.sh. ligjet e buxhetit) në lidhje me huamarrjen e parave nga Republika e SHTETIT];

c) [] [ju lutem referojuni këtu dokumenteve të tjera, p.sh. dekrete ose vendime nga organet qeveritare ose administrative të SHTETEVE për lidhjen e marrëveshjeve të huas sipas SHTETIT në përgjithësi ose për lidhjen e Marrëveshjes së Huas]; dhe

d) Marrëveshjen e Bashkëpunimit Financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së SHTETIT dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të datës [] (“Marrëveshjes së Bashkëpunimit”)

dhe ligje të tjera, rregullore, certifikata, regjistrime, regjistrime dhe dokumente, siç e kam çmuar të nevojshme apo të dëshirueshme për t’u shqyrtuar. Përveç kësaj, unë kam kryer hetime të tilla që kam çmuar të nevojshme ose të dëshirueshme për qëllim të dhënies së këtij mendimi.

2. Opinion

Për qëllimet e nenit [] të Marrëveshjes së Huas, unë jam i mendimit se sipas ligjeve të Republikës së SHTETIT në datën në vijim:

2.1 Sipas nenit të Kushtetutës []/nenit të ligjit për [] [ju lutem specifikoni si të përshtatshme] Huamarrësi ka të drejtë të hyjë në Marrëveshjen e Huas dhe ka marrë të gjitha



masat e nevojshme për të autorizuar ekzekutimin, dorëzimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Huas, në veçanti në bazë të:

a) Ligji (et) nr.(t) _____ e datës _____ së parlamentit të Republikës së SHTETIT, që ratifikon Marrëveshjen e Huas/miratimin e ekzekutimit, dorëzimit dhe përmbushjes së Marrëveshjes së Huas nga Huamarrësi/ _____ [shënoni sipas rasti];

b) Rezoluta (t) nr.(t) _____ më datë _____ të Kabinetit të Ministrave/Komiteti i Huas Shtetërore/ _____ [Ju lutemi përcaktoni organet qeveritare ose administrative të SHTETIT sipas nevojës];

c) _____ [ju lutem referojuni rezolutave të tjera, vendimeve etj.].

2.2 Znj./Z _____ (dhe Znj./Z) _____ është (janë) të autorizuar rregullisht nga _____ [p.sh. me ligj për shkak të pozitës së tij/saj (si Ministër i _____/ose) _____, me vendim të qeverisë, me autorizim të datës, etj.] për të nënshkruar vetëm/bashkërisht Marrëveshjen e Huas në emër të Huamarrësit. Marrëveshja e Huas e nënshkruar nga (dhe Znj./Z _____) është ekzekutuar në emër të Huamarrësit dhe përbën detyrime ligjore të Huamarrësit të zbatueshme ndaj tij në përputhje me kushtet e saj.

[Alternativa 1 për seksionin 2.3, që do të përdoret nëse përveç dokumenteve të specifikuara në seksionin 2.1 dhe 2.2 autorizimet e caktuara zyrtare, etj., duhet të merren sipas ligjeve të Republikës së SHTETIT:

2.3 Për ekzekutimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Huas nga Huamarrësi (duke përfshirë, pa kufizim, marrjen dhe transferimin në KfW të të gjitha shumave që rrjedhin prej saj në monedhat e specifikuara aty), miratimet, autorizimet, licencat, regjistrimet dhe/ose pëlqimet zyrtare janë marrë dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë:

a) Miratimi i _____ [Bankës Qendrore/Bankës Kombëtare/ _____, të datës _____, nr. _____

b) Pëlqimi i _____ [ministrit/ministrisë së _____], të datës _____, nr. _____; dhe

c) _____ [ju lutem shënoni ndonjë autorizim tjetër zyrtar, licenca dhe /ose pëlqime].

Nuk kërkohet ose këshillohet asnjë autorizim, pëlqim, leje, regjistrim dhe/ose aprovim tjetër zyrtar i ndonjë autoriteti apo agjencie qeveritare (përfshirë Bankën Qendrore/Kombëtare të Republikës së SHTETIT) ose në lidhje me ekzekutimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Huas nga Huamarrësi (duke përfshirë pa kufizim marrjen dhe transferimin në KfW të të gjitha shumave që rrjedhin prej saj në monedhat e specifikuara aty) dhe vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e detyrimeve të Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas.

[Alternativa 2 për seksionin 2.3, që do të përdoret vetëm nëse përveç dokumenteve të përcaktuara në seksionin 2.1 dhe 2.2 nuk duhet të merren autorizimet zyrtare etj. Sipas ligjeve të Republikës së SHTETIT:]

2.3 Asnjë autorizim zyrtar, pëlqim, licencë, regjistrim dhe/ose aprovim i ndonjë autoriteti apo agjencie qeveritare (duke përfshirë Bankën Qendrore/Kombëtare të Republikës së SHTETIT) ose gjykatës nuk kërkohet ose këshillohet në lidhje me ekzekutimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Huas nga Huamarrësi (duke përfshirë pa kufizim marrjen dhe transferimin në KfW të të gjitha shumave që rrjedhin prej saj në monedhat e specifikuara aty) dhe vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e detyrimeve të Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas.

2.4 Asnjë taksë e vulës ose tatim ose detyrim i ngjashëm nuk duhet të paguhet në lidhje me vlefshmërinë ose zbatimin e Marrëveshjes së Huas.

2.5 Zgjedhja e ligjit gjerman për të qeverisur Marrëveshjen e Huas dhe paraqitja në arbitrazh në përputhje me nenin _____ e Marrëveshjes së Huas janë të vlefshme dhe të detyrueshme. Vendimet e arbitrazhit ndaj Huamarrësit do të njihen dhe zbatohen në Republikën e SHTETIT sipas rregullave të mëposhtme: _____ [ju lutem përcaktoni traktatin e zbatueshëm (nëse ka), p.sh.



Konventën e Nju-Jorkut të vitit 1958 dhe/ose parimet themelore në lidhje me njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit në SHTET].

2.6 Gjykatat e Republikës së SHTETIT janë të lirë të japin gjykimin/vendimin e shprehur në monedhën ose monedhat e specifikuara në Marrëveshjen e Huas.

2.7 Huamarrja nga Huamarrësi sipas Marrëveshjes së Huas dhe ekzekutimi dhe përmbushja nga Huamarrësi i Marrëveshjes së Huas përbëjnë akte private dhe komerciale dhe jo akte qeveritare ose publike. As Huamarrësi, as ndonjëra nga pasuritë e saj nuk ka asnjë të drejtë imuniteti nga arbitrazhi, padia, ekzekutimi, sekuestrimi ose procesi tjetër ligjor.

2.8 Marrëveshja e Bashkëpunimit është në fuqi dhe efekt të plotë sipas kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së SHTETIT. [Në pajtim me nenin 3. të Marrëveshjes së Bashkëpunimit] [Nëse Marrëveshja e Bashkëpunimit nuk ka hyrë në fuqi, por ekziston një marrëveshje e tatimit të dyfishtë]. Në përputhje me _____ [Ju lutem specifikoni traktatin ose ligjet dhe rregulloret në fuqi] /Huamarrësi nuk do të kërkojë për të kryer ndonjë zbritje ose mbajtje nga çdo pagesë që Huamarrësi duhet të bëjë në bazë të Marrëveshjes së Huas dhe nëse ndonjë zbritje ose ndalim i tillë do të vendoset më vonë, dispozitat e nenit _____ të Marrëveshjes së Huas duhet të veprojnë në mënyrë që të kërkojnë nga Huamarrësi që të dëmshpërblejë KfW-në në përputhje me rrethanat.

2.9 KfW-ja nuk është dhe nuk do të konsiderohet rezident, me vendbanim, që ushtron biznes ose i nënshtrohet tatimit në Republikën e SHTETIT vetëm për ekzekutimin, përmbushjen ose zbatimin e Marrëveshjes së Huas. Nuk është e nevojshme ose e këshillueshme që KfW-ja të licencohet, kualifikohet ose të ketë të drejtë tjetër për të vazhduar biznesin ose se KfW-ja emëron agjentë ose përfaqësues në Republikën e SHTETIT.

Si pasojë, detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas përbëjnë detyrime të drejtpërdrejta dhe të pakushtëzuara, ligjore, të vlefshme dhe detyruese të Huamarrësit, të cilat janë të zbatueshme ndaj Huamarrësit, në përputhje me kushtet e tyre përkatëse.

Ky opinion ligjor kufizohet në ligjet e Republikës së SHTETIT.

(Vendi)

(Data)

[Nënshkrimi]

Emri: _____

Dokumentet bashkëlidhur:

Shënim. Ju lutem bashkëlidhni fotokopjet e vërtetuara të dokumenteve dhe dispozitave ligjore të lartpërmendura (në lidhje me ligjet e gjata ose me Kushtetutën e Republikës së SHTETIT, një kopje e dispozitave përkatëse do të ishte e mjaftueshme) dhe gjithashtu sigurojini KfW-së një përkthim zyrtar në gjuhën angleze ose gjermane të secilit prej dokumenteve të mësipërme, përveç rasteve kur një dokument i tillë lëshohet në gjuhën angleze ose gjermane si gjuhë zyrtare ose nëse KfW-ja ka përcaktuar se një gjuhë tjetër është e pranueshme.



SHTOJCA 3A
ANGAZHIMET E PAJTUESHMËRISË SË
HUAMARRËSIT

1. PËRKUFIZIME

Praktika Shtrënguese: është dëmi ose dëmtimi, ose kërcënimi për t'i bërë dëm ose dëmtuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çdo personi ose pasurie të personit, me qëllim që të ndikojë në mënyrë të parregullt në veprimet e një personi.

Praktikë e Fshehtë: është një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë personave, e projektuar për të arritur një qëllim të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e gabuar të veprimeve të një personi tjetër.

Praktikë Korruptive: premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, këmbëngulja, marrja, pranimi ose kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo pagese të paligjshme ose avantazhi i papërshtatshëm i çdo natyre, ndonjë personi ose nga ndonjë person, me qëllim ndikimin në veprimet e ndonjë personi ose që shkaktojnë që ndonjë person të përmbahet nga ndonjë veprim i caktuar.

Praktikë Mashtruese: çdo veprim apo mosveprim, duke përfshirë keqinterpretimin që me vetëdije ose nga pakujdesia mashtron ose synon të mashtrojë një person për të marrë përfitim financiar ose për të shmangur një detyrim.

Praktikë Penguese: i) shkatërrimi i qëllimshëm, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e provave materiale për hetimin ose bërja e deklaratave të rreme për hetuesit, në mënyrë që të pengojë materialisht një hetim zyrtar në pretendimet për një Praktikë Korruptive, Praktikë Mashtruese, Praktikë Shtrënguese ose kërcënuese, ngacmuese ose frikësuese e çdo personi për ta penguar atë që të zbulojë njohuritë e tij për çështjet që lidhen me hetimin ose ndjekjen e hetimit; ose ii) veprime që synojnë të pengojnë materialisht ushtrimin e qasjes së KfW-së në informacionet e kërkuara kontraktuale në lidhje me një hetim zyrtar në pretendimet për një praktikë korruptive, praktikë mashtruese, praktikë shtrënguese ose praktikë të fshehtë.

Person: çdo person fizik, person juridik, ortakëri ose shoqatë e painkorporuar.

Praktikë e Sanksionueshme: Çdo Praktikë Shtrënguese, Praktikë e Fshehtë, Praktikë

Korruptive, Praktikë Mashtruese ose Praktikë Penguese (siç janë përcaktuar këtu), e cila: i) është e paligjshme sipas ligjit gjerman ose ndonjë ligji tjetër të zbatueshëm; dhe ii) një efekt material ligjor ose reputacional në këtë Marrëveshje ndërmjet Huamarrësit, Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së ose zbatimin e saj.

Sanksione: ligjet, rregulloret, embargot ose masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, të miratuara ose të zbatuara nga ndonjë organ sanksionues.

Organ Sanksionues: cildo nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

Listë e Sanksioneve: çdo listë e personave, grupeve ose subjekteve të caktuara posaçërisht, të cilat janë objekt i sanksioneve të lëshuara nga ndonjë Organ Sanksionues.

2 NDËRMARRJA E INFORMACIONIT

Huamarrësi

a) do të vendosë menjëherë në dispozicion të KfW-së me kërkesën “njih klientin tënd” përkatës ose informacione të ngjashme në lidhje me Huamarrësin, siç mund të kërkojë KfW-ja;

b) nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit, t'i paraqesë menjëherë KfW-së, me kërkesë, të gjitha informacionet dhe dokumentet e lidhura me Projektin e Huamarrësit dhe kontraktuesve (nënkontraktuesve) të saj dhe palëve të tjera të lidhura që KfW-ja kërkon të përmbushë detyrimet e saj për të parandaluar Praktikën e Sanksionueshme, pastrimin e parave ose/dhe financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me Huamarrësin, të nevojshme për këtë qëllim;

c) nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit, informon menjëherë dhe me pëlqimin e vet, sapo të njihet ose dyshojë për ndonjë praktikë të sanksionueshme, veprim të pastrimit të parave dhe/ose financim të terrorizmit që lidhet me Projektin;

d) nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit, t'i japë KfW-së çdo informacion dhe raporte të tilla mbi Projektin dhe përparimin e mëtejshëm të tij, siç mund të kërkojë KfW-ja për qëllimet e këtij Aneksi; dhe

e) nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit, do t'i mundësojë KfW-së dhe agjentëve



të saj që në çdo kohë të inspektojnë të gjithë dokumentacionin tjetër të Projektit të Huamarrësit dhe të nënkontraktuesve të tij dhe palëve të tjera të lidhura dhe të vizitojnë Projektin dhe të gjitha instalimet që lidhen me to për qëllimet e këtij Aneksi

3. PËRFAQËSIMI DHE GARANCIA

Në lidhje me ligjin gjerman ose ligjin e vendit të Huamarrësit, Huamarrësi deklaron që asnjë nga personat që veprojnë në lidhje me projektin në emër të Huamarrësit nuk ka kryer ose nuk është angazhuar në ndonjë praktikë të sanksionueshme, pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit.

Përfaqësimi dhe garancia e përcaktuar në këtë nen bëhet për herë të parë nëpërmjet ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje. Do të konsiderohet të përsëritet pas çdo tërheqje të Huas dhe në çdo Datë të Pagesës së Interesit, në secilin rast duke iu referuar rrethanave që mbizotërojnë në atë datë.

4. SIPËRMARRJE POZITIVE

Huamarrësi merr përsipër, sa më shpejt që Huamarrësi ose KfW-ja të njoftohen ose dyshojnë për ndonjë praktikë të sanksionueshme, veprim të pastrimit të parave ose financim të terrorizmit, për të bashkëpunuar plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, në përcaktimin nëse ka ndodhur një incident i tillë i pajtueshmërisë. Huamarrësi, në veçanti, do të përgjigjet menjëherë dhe në detaje të arsyeshme për çdo njoftim nga KfW-ja dhe do të ofrojë mbështetje të dokumentuar për përgjigjen e tillë sipas kërkesës së KfW-së.

5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Huamarrësi nuk do të hyjë në ndonjë transaksion ose nuk do të angazhohet në ndonjë aktivitet tjetër në lidhje me Projektin që do të përbënte shkelje të sanksioneve.

SHTOJCA 3B ANGAZHIME TË PAJTUESHMËRISË SË AGJENCISË SË ZBATIMIT TË PROJEKTTIT

1. PËRKUFIZIME

Praktikë Shtrenguese: është dëmi ose dëmtimi ose kërcënim për të dëmtuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çdo person ose pasuri të personit, me

qëllim që të ndikojë në mënyrë të parregullt në veprimet e një personi.

Praktikë e Fshtetë: është një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë personave, e projektuar për të arritur një qëllim të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e gabuar në veprimet e një personi tjetër.

Praktikë Korruptive: premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, këmbëngulja, pranimi, pranimi ose kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo pagese të paligjshme ose avantazhi i papërshtatshëm i çdo natyre, nga ose nga ndonjë person, me qëllim ndikimin në veprimet e çdo personi ose ose që shkaktojnë që ndonjë person të përmbahet nga ndonjë veprim i caktuar.

Kategoritë e Caktuara të Veprave Penale: kategoritë e mëposhtme të veprave penale të përcaktuara me rekomandimet e TFVF-së dhe shënimet interpretuese përkatëse: pjesëmarrja në një grup kriminal të organizuar dhe grumbullimi; terrorizmi, duke përfshirë financimin e terrorizmit; trafikimin e qenieve njerëzore dhe kontrabandimin e emigranteve; shfrytëzimi seksual, duke përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve; trafikimi i paligjshëm i barnave narkotike dhe substancave psikotrope; trafikimi i paligjshëm i armëve; trafikimi i paligjshëm i mallrave të vjedhura dhe të tjera; korrupsioni dhe ryshfeti; mashtrimi; falsifikimi i monedhës; falsifikimi dhe pirateria e produkteve; krimi mjedisor; vrasje, lëndim i rëndë trupor; rrëmbim, mbajtje e paligjshme dhe marrje pengjesh; grabitje ose vjedhje; kontrabandë (duke përfshirë në lidhje me doganat dhe akcizat dhe taksat); krimet tatimore (lidhur me taksat e drejtpërdrejta dhe taksat e tërthorta); zhvatja; falsifikimi; pirateria; tregtia e brendshme dhe manipulimi i tregut.

Rekomandimet e TFVF-së: rekomandime të tilla, siç përcaktohen herë pas here nga Task Forca e Veprimit Financiar (TFVF). TFVF-ja është organi ndërqeveritar, qëllimi i të cilit është zhvillimi dhe promovimi i politikave kombëtare dhe ndërkombëtare për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Praktikë Mashtruese: çdo veprim apo mosveprim, duke përfshirë keqinterpretimin që me vetëdije ose nga pakujdesia mashtron ose synon të mashtrojë një person për të marrë



përfitim financiar ose për të shmangur një detyrim.

Origjina e paligjshme:

është origjina e fondeve të fituara nëpërmjet

a) çdo veprë penale të shënuar në kategoritë e caktuara të veprave penale;

b) çdo praktikë korruptive;

c) çdo praktikë mashtruese; ose

d) pastrimi i parave.

Praktikë Penguese: i) shkatërrimi i qëllimshëm, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e materialeve dëshmi për hetimin ose bërja e deklaratave të rreme për hetuesit, në mënyrë që të pengojë materialisht një hetim zyrtar në pretendimet për një Praktikë Korruptive, Praktikë Mashtruese, Praktikë Shtrënguese apo Praktikë të Fshehtë ose kërcërimi, ngacmimi ose frikësimi i çdo personi për ta penguar atë që të zbulojë njohuritë e tij për çështjet që kanë të bëjnë me hetimin ose ndjekjen e hetimit; ose ii) veprime që synojnë të pengojnë materialisht ushtrimin e qasjes së KfW-së në informacionet e kërkuara kontraktuale në lidhje me një hetim zyrtar në pretendimet për një Praktikë Korruptive, Praktikë Mashtruese, Praktikë Shtrënguese apo Praktikë të Fshehtë

Person: çdo person fizik, person juridik, ortakëri ose shoqatë e painkorporuar.

Praktikë e Sanksionueshme: Çdo Praktikë Shtrënguese, Praktikë e Fshehtë, Praktikë Korruptive, Praktikë Mashtruese ose Praktikë Penguese (siç janë përcaktuar këtu), e cila: i) është e paligjshme sipas ligjit gjerman ose ndonjë ligji tjetër të zbatueshëm dhe ii) një efekt material ligjor ose reputacional në këtë Marrëveshje ndërmjet Huamarrësit, Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së ose zbatimin e saj.

Sanksione: ligjet, rregulloret, embargot ose masat kufizuese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, të miratuara ose të zbatuara nga ndonjë organ sanksionues.

Organ Sanksionues: cilido nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

Listë e Sanksioneve: çdo listë e personave, grupeve ose subjekteve të caktuara posaçërisht, të cilat janë objekt i sanksioneve të lëshuara nga ndonjë Organ Sanksionues.

2. SIPËRMARRJA E INFORMACIONIT

Agjencia për Zbatimin e Projektit do:

a) të vendosë në dispozicion të KfW-së “njih klientin tënd” përkatës ose informacione të ngjashme në lidhje me Agjencinë e Zbatimit të Projektit dhe çdo aksioner, Filial dhe/ose Degë tjetër (nëse ka) (të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë), siç KfW-ja mund të kërkojë;

b) t'i sigurojë menjëherë KfW-së, me kërkesë, të gjitha informacionet dhe dokumentet që lidhen me Agjencitë e Zbatimit të Projektit dhe (nën) kontraktuesit e saj dhe palëve të tjera të lidhura që KfW-ja kërkon të përmbushë detyrimet e saj për të parandaluar çdo Praktikë të Sanksionueshme, të pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me Agjencinë e Zbatimit të Projektit, e cila është e nevojshme për këtë qëllim;

c) ta informojë KfW-në menjëherë dhe me pëlqimin e vet, sapo të njihet ose dyshojë për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, aktin e pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit nga Agjencia e Zbatimit të Projektit, ndonjë anëtar i organeve drejtuese ose organeve të tjera qeverisëse ose ndonjë nga aksionerët e saj;

d) t'i japë KfW-së çdo informacion dhe raporte të tilla mbi Projektin dhe përparimin e mëtejshëm të tij, pasi KfW-ja mund të kërkojë për qëllimet e këtij Aneksi;

e) t'i mundësojë KfW-së dhe agentëve të saj që në çdo kohë të inspektojnë të gjithë dokumentacionin tjetër të Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe kontraktuesve (nënkontraktuesve) të tij dhe palëve të tjera që lidhen me të, dhe të vizitojnë Projektin dhe të gjitha instalimet që lidhen me të për qëllimet e këtij Aneksi;

f) të informojë KfW-në menjëherë dhe me pëlqimin e vet për çdo ngjarje që rezulton që Agjencia e Zbatimit të Projektit, çdo anëtar i organeve të tij drejtuese ose organeve të tjera qeverisëse ose ndonjë prej aksionerëve të saj, të jetë ose bëhet një shtetas i caktuar posaçërisht, person i bllokuar ose ent i përfshirë në ndonjë Listë të Sanksioneve.

3. PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË

Në lidhje me ligjin gjerman ose ligjin e vendit të themelimit të Agjencisë së Zbatimit të



Projektit, Agjencia për Zbatimin e Projektit përfaqëson dhe garanton se të dhënat e mëposhtme janë të vërteta dhe të sakta:

a) Në lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshje Huaje, Agjencia e Zbatimit të Projektit vepron në emër dhe për llogari të vet.

b) Sipas njohurive të saj më të mira dhe vetëm në lidhje me aksionerët e njohur për Agjencinë e Zbatimit të Projektit në pajtim me rregulloret e zbatueshme të tregut të bursës, as kapitali i Agjencisë së Zbatimit të Projektit, as fondet e investuara në Projekt nuk janë me Origjinë të Paligjshme.

c) Asnjë nga Agjencia e Zbatimit të Projektit, filialet e saj ose ndonjë person tjetër që vepron në emër të tyre nuk ka kryer ose nuk është angazhuar në ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit.

d) Agjencia për Zbatimin e Projektit nuk ka: i) lidhur ndonjë marrëdhënie biznesi me shtetas të posaçëm të caktuar, persona të bllokuar ose subjekte/ente të përfshira në Listën e Sanksioneve; ose ii) nuk janë angazhuar në ndonjë aktivitet tjetër që do të përbënte shkelje të Sanksioneve.

Përfaqësimet dhe garancitë e përcaktuara në këtë nen bëhen për herë të parë nga ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje. Ato do të konsiderohen të përsëriten në çdo hartim të Huas dhe në çdo Datë të Pagesës së Interesit, në secilin rast duke iu referuar rrethanave që mbizotërojnë në atë datë.

4. SIPËRMARRJET POZITIVE

Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr

a) të jetë plotësisht në përputhje me standardet e financimit të pastrimit të parave dhe terrorizmit në përputhje me rekomandimet e TFVF-së dhe të zbatojë, ruajë dhe, nëse është e nevojshme, të përmirësojë standardet e saj të brendshme dhe udhëzimet (duke përfshirë pa kufizime në lidhje me verifikimin paraprak të klientit) çdo praktikë sanksionuese, veprim i pastrimit të parave ose financim të terrorizmit; dhe

b) menjëherë sapo Agjencia e Zbatimit të Projektit ose KfW-ja të njoftohen ose dyshojnë për çdo praktikë të sanksionueshme, veprim të pastrimit të parave ose financim të terrorizmit, për të bashkëpunuar plotësisht me KfW-në dhe

agjentët e saj, në përcaktimin nëse ka ndodhur një incident i tillë pajtueshmërie. Agjencia e Zbatimit të Projektit, në veçanti, do të përgjigjet menjëherë dhe në detaje të arsyeshme për çdo njoftim nga KfW-ja dhe do të sigurojë mbështetje të dokumentuar për përgjigjen e tillë sipas kërkesës së KfW-së.

5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr

a) të sigurojë që kapitali i tij dhe fondet e tjera që investon nuk do të jenë me origjinë të paligjshme;

b) të sigurojë që biznesi i tij nuk do të krijojë asnjë praktikë të sanksionueshme, pastrim parash ose financim të terrorizmit; dhe

c) të mos hyjë ose të vazhdojë ndonjë marrëdhënie biznesi me shtetas të posaçëm të caktuar, persona të bllokuar ose ente/subjekte që përfshihen në ndonjë listë të sanksioneve dhe të mos angazhohen në ndonjë aktivitet tjetër që do të përbënte shkelje të sanksioneve.

DEKRET

Nr. 11222, datë 11.7.2019

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 41/2019 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. dhe KfW, Frankfurt am Main për programin e investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

**DEKRET****Nr. 11224, datë 12.7.2019****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Valon Masar Lluka
 2. Liridona Lulzim Lluka (Gojani)
 3. Enis Mehmet Fetahu
 4. Pranvera Musa Dobruna Kryeziu (Dobruna)
 5. Dukagjin Shahin Kryeziu
 6. Adea Dukagjin Kryeziu
 7. Rea Dukagjin Kryeziu
 8. Lea Luan Shllaku
 9. Jeffrey Alfred Bugeja
 10. Bernard Joseph Caruana
 11. Diala Michel El Khoury
 12. Mariam (Mayram) Semen
- Ndroqi (Akopian/Arzumanyan)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Ilir Meta**VENDIM****Nr. 495, datë 15.7.2019****PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË
PËRGJITHSHËM TË TATIMEVE**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Delina Ibrahimaj emërohet në detyrën e drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR**Edi Rama****UDHËZIM****Nr. 3, datë 20.6.2019****PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS SË
LEHTËSUAR TË AUTORIZIMIT PËR
LIDHJEN NË SISTEMIN E
SHPËRNDARJES TË PROJEKTEVE TË
VOGLA TË RINOVUESHME PËR
VETËPRODHUESIT E ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA DIELLI**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të pikës 4, të nenit 15 të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë”,

UDHËZOJ:

1. Një shoqëri e vogël ose e mesme, apo një klient familjar mund të instalojë një kapacitet total deri në 500 kWp për vetëprodhimin e energjisë elektrike nga dielli në përputhje me nenin 15, të ligjit nr. 7/2017.

2. Njësia vetëprodhuese për teknologjinë foto voltaike (PV), e cila e shndërron energjinë diellore në energji elektrike, duhet të vendoset në objektin e konsumatorit në përputhje me nenin 7 “Punime që kryhen me deklaratë paraprake punimesh”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e ndryshuar.

3. Injektimi në rrjet do të lejohet për kategorinë e konsumatorëve të përcaktuar sipas pikës 1 të këtij udhëzimi, të cilët mund të prodhojnë një pjesë ose të gjithë energjinë elektrike që konsumojnë nga impianti PV diellore. Bilanci dhe faturimi neto, të bëhen nga OSHEE-ja në baza mujore për secilën pikë matjeje të autorizuar të klientit. Teprica e energjisë, më e madhe se konsumi mujor, do t'i



shitet Furnizuesit të Shërbimit Universal pas miratimit të Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar për vetëkonsum nga kjo kategori konsumatorësh.

4. Fuqia e instaluar për prodhimin e sasisë vjetore të energjisë elektrike për vetëkonsum, do të përcaktohet mbi bazën e konsumit të tij përgjatë një viti sipas historikut të dy viteve të fundit, ose në rast të mungesës së një historiku, kjo llogaritje në raportin e auditimit të energjisë për këtë qëllim do të bëhet nga një auditues energjetik i certifikuar.

5. Aplikuesi ka të drejtë të aplikojë për rritje të fuqisë së instaluar në rastin e rritjes së konsumit vjetor.

6. Fuqia e instaluar e impiantit PV, për prodhimin e energjisë elektrike nga dielli, për çdo pikë lidhjeje ose/apo konsumator, do të llogaritet mbi bazën e orëve të punës në pik të prodhimit të energjisë elektrike nga ky impiant, por në asnjë rast nuk duhet të kalojë fuqinë e kërkuar. Deri në miratimin e një harte të rrezatimit në varësi të pozicionit gjeografik, kjo fuqi do të llogaritet për rrezatimin e mesatarizuar 1,400 kWh/kWp, pavarësisht faktit se në cilin rajon të Shqipërisë vendoset impianti.

Për qëllim të këtij udhëzimi, fuqia e kërkuar është bazë për përcaktimin e fuqisë së kontraktuar me OSHEE sh.a. Kjo madhësi përcaktohet nga klienti (i cili përfaqësohet nga projektuesi i licencuar për hartimin e projekt-preventivat në përputhje me ligjet e rregulloret në fuqi) dhe OSHEE sh.a. gjatë procesit të lidhje së kontratës së furnizimit me energji dhe vlera e përcaktuar shënohet në kontratë. Me ndryshimin e kushteve të aktivitetit, një përdorues që ka lidhur kontratë furnizimi për energji elektrike me OSHEE-në për një vlerë (fuqi e kërkuar) mund të kërkojë një shtesë fuqie për një fuqi të kërkuar më të madhe.

7. Aplikimi për lidhjen e impiantit PV dhe matësit me dy drejtime në rrjetin e shpërndarjes, do të fillojë të bëhet menjëherë sipas procedurave të ngjashme për lidhjet e reja pranë zyrave të kujdesit të klientit të OSHEE-së. Brenda 6 muajve nga dalja e këtij udhëzimi duhet të ngrihet portali *online* i aplikimeve të impianteve PV për vetëprodhim sipas skemës së matjes neto.

Dokumentacioni për aplikimin pranë OSHEE-së, duhet të shoqërohet me:

a) plotësimin e formularit të aplikimit “Për skemën e matjes neto” dhe lidhjen me matësin me dy drejtime sipas modelit të miratuar, i cili gjendet *online* në adresën www.oshee.al;

b) deklaratën e konsumit mesatar të tij përgjatë një viti sipas historikut të dy viteve të fundit, ose në rast të mungesës të një historiku, raportin e auditit energjetik të lëshuar nga audituesi i certifikuar sipas parashikimeve të pikës 4 të këtij udhëzimi, së bashku me certifikatën përkatëse, dhe propozimin për fuqinë e instaluar sipas parashikimeve të pikës 6 të këtij udhëzimi;

c) projektin e miratuar nga persona fizikë dhe juridikë të licencuar për lidhjen e impiantit PV me rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me Kodin e Shpërndarjes të energjisë elektrike të miratuar nga ERE;

d) propozimin mbi modelin e matësit dhe karakteristikat teknike të tij. Subjekti është i detyruar, sipas nenit 15 “Skemat e matjes neto të energjisë”, të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë”, të instalojë me shpenzimet e veta një matës inteligjent me dy drejtime, sipas kërkesave të përcaktuara nga OSHEE-ja në përputhje me Kodin e Matjes. Matësi, duhet të matë energjinë elektrike që subjekti merr nga rrjeti i OSHEE-së dhe energjinë elektrike që subjekti (impianti PV) fut në rrjetin e OSHEE. Për të njohur konsumin e përgjithshëm të energjisë elektrike të klientit vetëprodhues, vendoset një matës inteligjent me një drejtim të prodhimit pas inventarit kryesor, sipas kërkesave të përcaktuara nga OSHEE-ja në përputhje me Kodin e Matjes.

8. OSHEE-ja duhet që brenda 30 ditëve pune nga data e aplikimit, të kthejë përgjigje për autorizimin për lidhjen. Në rast se OSHEE-ja konstaton mangësi njofton brenda 5 ditëve me shkrim mbi mangësitë e dokumentacionit të aplikimit, i cili duhet të plotësohet brenda 10 ditëve.

9. OSHEE-ja mund të refuzojë aplikimin në rastet kur standardet e planifikuara të sistemit të shpërndarjes në Kodin e Shpërndarjes, nuk u sigurojnë aplikuesve, frekuencën në kufirin normal të operimit, luhatjet e lejuara të tensionit



dhe parametrat teknike të tjerë sipas legjislacionit në fuqi, në pikën ku kërkohet të bëhet injektimi. Në një rast të tillë, OSHEE-ja duhet të njoftojë aplikuesin për luhatjet e tensionit dhe të frekuencës, në një mënyrë transparente dhe të besueshme, të bazuar në matje gjatë periudhës së aplikimit.

10. Çdo subjekt ka të drejtë riaplikimi pas plotësimit të mangësive dokumentare, përmirësimit të cilësisë së rrjetit apo marrjes së masave të optimizimit të rrjetit nga vetë klienti me koston e tij.

11. OSHEE-ja, në përputhje me zhvillimet teknologjike të kohës, të vendosë standarde dhe kushte teknike të aplikueshme për sigurinë në përputhje me gjendjen e rrjetit të shpërndarjes, por në çdo rast, duke mos kufizuar nëpërmjet këtyre kushteve, të drejtën që jep ligji nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë” për aksesin në rrjet dhe të drejtën për të depozituar në rrjetin e shpërndarjes tepricën e energjisë elektrike.

12. OSHEE-ja, pas autorizimit të lidhjes me impiantin PV, me procedurë të përsheptuar të kryejë ndërrimin dhe/ose lidhjen me rrjetin të matësit me dy drejtime dhe në momentin e lidhjes, të bëjë ndryshimet përkatëse në sistemin e llogaritjes së faturës mujore sipas pikës 4 dhe pikës 7/d të këtij udhëzimi. Në çdo rast matësi i propozuar do të jetë në përputhje me kërkesat dhe kushtet e Kodit të Matjes. Këto kërkesa dhe kushte mund të rishikohen në përputhje me kërkesat e pikës 11 të këtij udhëzimi, me qëllim që të merret në konsideratë çdo ndryshim i teknologjisë apo kërkesave teknike që lidhen me zhvillimin industrial, si dhe udhëzimet ndërkombëtare.

13. Vetëprodhuesi duhet që të instalojë sistemin PV brenda 6 muajve nga data e miratimit të aplikimit dhe të bëjë njoftimin pranë OSHEE-së për përfundimin e këtij instalimi. Në rast të tejkalimit të këtij afati aplikimi duhet të përsëritet.

14. Në momentin e vënies në punë të sistemit PV, vetëprodhuesi duhet të njoftojë me shkrim OSHEE-në, duke i venë në dispozicion dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kopje të miratimit të aplikimit dhe procesverbalin e kolaudimit dhe instalimit të sistemit të matjes për të dy matësit inteligjentë;

b) kopje origjinale të aktkolaudimit të sistemit, firmosur nga projektues të licencuar për impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme nga dielli (kat. 10c) dhe zbatues të licencuar për ndërtimin e impianteve të prodhimit të energjisë (kat. NP-10A), së bashku me konfirmimin e vetëprodhuesit të sistemit PV;

c) manualët dhe skedat teknike të produkteve të sistemit PV, siç janë: panelet, inverterat, kabllot etj.;

d) të dhënat e aksesimit *online* në platformën e monitorimit të sistemit.

15. OSHEE-ja mund të shkëpusë impiantin për vetëkonsum, në rast kur vërteton se klientët kanë projektuar një impiant i cili në harkun e një viti tejkalon konsumin e energjisë të klientit ose kur vërtetohet se impianti është instaluar dhe/ose funksionon ndryshe nga projekti i miratuar.

Në të gjitha rastet, OSHEE-ja njofton me shkrim vetëprodhuesin dhe ndërhyr për ndërprerje vetëm pasi vetëprodhuesi nuk ka bërë rregullimin e propozimeve të OSHEE-së.

16. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, OSHEE-ja të propozojë në ERE dhe në MIE, ndryshimet në Kodin e Shpërndarjes dhe në Kodin e Matjes, të cilat mund të ndikohen nga vendosja e PV për vetëkonsum.

17. Deri në miratimin e Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar, teprica e energjisë, që tejkalon konsumin mujor, do t'i kalojë Furnizuesit të Shërbimit Universal pa kundërshtim për vetëprodhuesit.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

**URDHËR**

Nr. 243, datë 9.7.2019

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
MBI PROCEDURËN E KLASIFIKIMIT
TË STRUKTURAVE AKOMODUESE ME
4 APO 5 YJE QË JANË MBAJTËS TË NJË
MARKE TREGTARE TË REGJISTRUAR
DHE TË NJOHUR
NDËRKOMBËTARISHT
“BRAND NAME”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2 të nenit 7/1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 730, datë 20.10.2016, “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores për procedurat e klasifikimit të strukturave akomoduese me 4 apo 5 yje që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht “brand name”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Miratimin e formatit dhe modelit të certifikatës së klasifikimit të strukturave akomoduese, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Komisioni i Standardizimit të Veprimtarive Turistike dhe Inspektorati përgjegjës për turizmin, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Blendi Klosi**

RREGULLORE

**MBI PROCEDURËN E KLASIFIKIMIT TË
STRUKTURAVE AKOMODUESE ME 4
APO 5 YJE QË JANË MBAJTËS TË NJË
MARKE TREGTARE TË REGJISTRUAR
DHE TË NJOHUR NDËRKOMBËTARISHT
“BRAND NAME”**

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurës së klasifikimit të strukturave akomoduese me 4 apo 5 yje që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht “brand name”, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar dhe VKM nr. 730, datë 20.10.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, i ndryshuar.

Neni 2

Kriteret

1. Sipërmarrësi për tu bërë pjesë e procesit të klasifikimit duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të ketë investuar në ndërtimin e një strukture akomoduese sipas kriterëve të strukturave akomoduese me 4 dhe 5 yje të përcaktuara në VKM nr. 730, datë 20.10.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, i ndryshuar;

b) të ketë lidhur kontratë të vlefshme, me një operator të strukturave akomoduese me 4 ose 5 yje, i cili është mbajtës i një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht “brand name”.

Neni 3

Procedura e aplikimit

1. Procedura e klasifikimit të strukturave akomoduese me 4 ose 5 yje i nënshtrohet tre fazave:



a) faza e parë përfshin procesin e vetëdeklarimit të sipërmarrësit turistik, i cili konsiston në plotësimin e formularit të vetëdeklarimit dhe dorëzimit të dokumentacionit përkatës të parashikuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje;

b) faza e dytë përfshin verifikimin në terren të të dhënave të vetëdeklarimit dhe përgatitjen e raportit të verifikimit, nga grupi i punës i ngritur me urdhër ministri;

c) faza e tretë përfshin shqyrtimin e dokumentacionit dhe raportit të verifikimit, nga Komisioni i Standardizimit të Veprimtarive Turistike.

Neni 4

Procesi i vetëdeklarimit për klasifikimin e strukturës akomoduese

1. Sipërmarrësi turistik, që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese 4 ose 5 yje, duhet të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin formularin e vetëdeklarimit sipas modelit, bashkëlidhur kësaj rregulloreje, dhe dokumentacionin përkatës të përcaktuar në nenin 5 më poshtë.

2. Sipërmarrësi turistik mban përgjegjësi për vërtetësinë e të dhënave të deklaruara, të cilat janë objekt i verifikimit sipas rregullave të parashikuar në këtë rregullore.

Neni 5

Dokumentacioni i aplikimit për pajisjen me certifikatë klasifikimi

1. Dokumentacioni që duhet të paraqesë subjekti:

a) kërkesë për t'u pajisur me certifikatë klasifikimi, sipas modelit bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

b) formularin e vetëdeklarimit;

c) akti i pronësisë ose përdorimit të strukturës;

ç) vërtetim për regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit si person fizik/juridik me objekt veprimtarie si strukturë akomoduese;

d) planimetrinë e strukturës akomoduese;

dh) akti i kolaudimit të strukturës akomoduese;

e) vërtetimin që struktura plotëson kushtet për masat e mbrojtjes nga zjarri lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi;

ë) vërtetimin që struktura plotëson kushtet higjeno-sanitare, lëshuar nga Instituti i Shëndetit Publik;

f) foto të brendshme dhe të jashtme të objektit;

g) kontrata e lidhur me operatorin e strukturave akomoduese me 4 ose 5 yje, i cili është mbajtës i një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht “brand name”;

gj) vërtetim i gjendjes gjyqësore të pronarit /administratorit;

h) vërtetimin e pagesës së tarifës së aplikimit dhe verifikimit për pajisjen me certifikatë klasifikimi.

2. Dokumentacioni dhe/ose vërtetimet e kërkuara më sipër paraqiten në format origjinal ose kopje të noterizuara.

3. Dokumentacioni i aplikimit depozitohet pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin në gjuhën shqipe ose/apo në gjuhë të huaj. Dokumentet që disponohen në gjuhë të huaj duhet të paraqiten të shoqëruara me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar.

Neni 6

Procedura e shqyrtimit të dokumentacionit për klasifikimin e strukturave akomoduese

1. Komisioni i Standardizimit brenda 60 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, formularit të vetëdeklarimit, dokumentacionit të parashikuar në nenin 5 të kësaj rregullore dhe pas hartimit të raportit të verifikimit, shqyrton dhe vlerëson dokumentet dhe të dhënat për përmbushjen e kriterëve të kërkuara për klasifikimin e strukturës akomoduese.

2. Pas depozitimit të kërkesës nga ana e subjektit Komisioni i Standardizimit, brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, njofton grupin e punës të ngritur me urdhër ministri, për verifikimin në terren të përmbushjes së kriterëve sipas parashikimeve të VKM-së nr. 730, datë 20.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, i ndryshuar.

3. Procesi i verifikimit në terren të përmbushjes së kriterëve nga sipërmarrësi turistik duhet të përfundojë brenda 20 ditëve nga data e njoftimit të Komisionit të Standardizimit.

4. Në përfundim të procesit të verifikimit, grupi i punës harton një raport përmbledhës për



verifikimet e kryera dhe ia dorëzon Komisionit të Standardizimit brenda 5 ditëve nga data e përfundimit të procesit të verifikimit.

5. Në përfundim të procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit Komisioni, sipas rastit merr vendim dhe ia përcjell Ministrit për miratim për:

a) lëshimin e certifikatës së klasifikimit e cila përcakton nivelin përkatës të strukturës akomoduese nëse është më 4 apo 5 yje;

b) refuzimin e kërkesës për certifikatë klasifikimi.

6. Në çdo rast vendimi i Komisionit të Standardizimit duhet të jetë i arsyetuar dhe të përmbajë kriteret e përmbushura nga struktura akomoduese, si dhe kategorinë e nivelin e përcaktuar për këtë strukturë.

7. Në rast të refuzimit të kërkesës për lëshimin e certifikatës së klasifikimit, kërkuesi ka të drejtë të paraqesë kërkesën e tij për ta nisur procesin përsëri, vetëm pasi të kenë kaluar 90 ditë nga refuzimi, dhe do të trajtohet si kërkesë e paraqitur për herë të parë.

Neni 7

Lëshimi i certifikatës së klasifikimit të strukturës akomoduese dhe regjistrimi i saj

1. Komisioni, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së miratimit nga Ministri për përcaktimin e nivelit të klasifikimit, njofton aplikuesin për miratimin e certifikatës së klasifikimit.

2. Certifikata e klasifikimit nënshkruhet nga ministri dhe përmban:

- a) emrin e subjektit dhe emrin tregtar
- b) emërtesën e strukturës akomoduese;
- c) kategorinë dhe nivelin e klasifikimit;
- ç) datën e lëshimit të certifikatës së klasifikimit;
- d) afatin e vlefshmërisë.

3. Aplikuesi duhet të tërheqë certifikatën e klasifikimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit, në të kundërt, ai do të konsiderohet i paklasifikuar nga autoritetet e kontrollit dhe të inspektimit dhe do të mbajë përgjegjësi administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Certifikata e klasifikimit, sipas formatit dhe modelit të përcaktuar në shtojcën bashkëlidhur këtij urdhri, është tregues i cilësisë së strukturës akomoduese dhe afishohet në recepsionin e strukturës akomoduese.

5. Shenja dalluese e klasifikimit, e prodhuar sipas formatit dhe modelit të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin, vendoset në hyrjen kryesore të strukturës akomoduese.

6. Certifikata e klasifikimit regjistrohet automatikisht, pas përfundimit të procesit të klasifikimit, në Regjistrin Qendror të Turizmit, që administrohet nga struktura përgjegjëse pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin.

Neni 8

Vlefshmëria e certifikatës

1. Afati i vlefshmërisë së certifikatës së klasifikimit është 4 vjet, nga data e lëshimit të saj, me të drejtë rinovimi.

2. Për rinovimin e certifikatës së klasifikimit sipërmarrësi turistik dorëzon kërkesën përkatëse jo më vonë se 30 ditë përpara mbarimit të afatit të vlefshmërisë së saj.

3. Procedura për lëshimin e certifikatës së klasifikimit, e parashikuar në këtë rregullore, do të zbatohet edhe në rastin e rinovimit të certifikatës së klasifikimit.

4. Gjatë procedurës së rinovimit, certifikata e klasifikimit, së cilës i ka kaluar afati i vlefshmërisë, do të konsiderohet e vlefshme deri në përfundim të afateve të parashikuara në këtë rregullore për shqyrtimin e kërkesës për rinovimin e saj.

Neni 9

Riklasifikimi i strukturës akomoduese

1. Me kërkesë të sipërmarrësit turistik, Komisioni mund të nisë procedurat për rivlerësimin dhe riklasifikimin e strukturës akomoduese, me qëllim ngritjen e nivelit të klasifikimit.

2. Kërkesa për riklasifikim nuk mund të paraqitet më parë se 12 muaj nga data e lëshimit të certifikatës së klasifikimit. Procedura për lëshimin e certifikatës së klasifikimit, e parashikuar në këtë rregullore, zbatohet edhe për riklasifikimin e strukturës akomoduese.

Neni 10

Ndryshimi i certifikatës së klasifikimit

Sipërmarrësi turistik, që pajiset me certifikatë klasifikimi, duhet të njoftojë ministrinë për çdo



ndryshim në të dhënat e paraqitura për marrjen e saj ose çdo ndryshim që mund të ndikojë në klasifikimin e strukturës akomoduese brenda 7 ditëve, nga ndodhja e tyre.

Neni 11

Shfuqizimi i certifikatës

1. Komisioni mund të shfuqizojë certifikatën e klasifikimit të strukturës akomoduese në rast se:

a) nga inspektorati konstatohen shkelje të rënda ose ndryshime thelbësore në kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë struktura akomoduese sipas certifikatës së lëshuar të klasifikimit;

b) konstatohen të dhëna të rreme në dokumentet e aplikimit të sipërmarrësit turistik.

2. Vendimi i Komisionit për shfuqizimin e certifikatës së klasifikimit duhet të jetë i arsyetuar.

Neni 12

Tarifat për klasifikimin e strukturave akomoduese

Tarifat për aplikimin dhe procesin e verifikimit për klasifikimin e strukturave akomoduese me 4 apo 5 yje janë në përputhje me nenin 16 të VKM-së nr. 730, datë 20.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, i ndryshuar dhe paguhen sipas modelit të faturës dhe referencës së tarifës, bashkëlidhur këtij urdhri.

KËRKESË PËR CERTIFIKATË KLASIFIKIMI

Lënda: Kërkesë për t'u pajisur me certifikatë klasifikimi strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, brand name.

Aplikim për:

☐ Hotel me 4 yje

☐ Hotel me 5 yje

☐ Resort me 4 yje

☐ Resort me 5 yje

Emri i subjektit aplikues: _____

NIPT: _____

Adresa e subjektit: _____

Personi që përfaqëson subjektin: _____

Nr. tel: _____ **Email:** _____

Operatori Menaxhues (Brand name): _____

Përmbledhje ekzekutive e subjektit aplikuesit

(Përshkrim të veprimtarisë të cilën subjekti ushtron, eksperiencën konkrete sipas periudhave, etj)

Dokumentacioni shoqërues i aplikimit

(Listë e dokumenteve shoqërues të aplikimit)

1.

2.

3.

4.

5.

6.

7.

8.

9.

10.

11.

.....

SUBJEKTI APLIKUES/PERSONI I AUTORIZUAR

(Emër Mbiemër, Firma, Vula)



**FORMULAR VETËDEKLARIMI
PËR KATEGORIZIMIN/KLASIFIKIMIN E STRUKTURAVE AKOMODUESE**

Të përgjithshme	Emri i strukturës akomoduese				
	Kategoria				
	Certifikata e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit Nr. _____ Datë _____				
Kontakte	Emri, Mbiemri i pronarit të strukturës akomoduese				
	Emri, Mbiemri i menaxherit të strukturës akomoduese				
	Emri, Mbiemri i personit të kontaktit të strukturës akomoduese				
Adresa e strukturës akomoduese	Vendndodhja				
	Prefektura				
	Bashkia				
	Qyteti/Fshati				
	Lagja, Rruga, Nr.				
	Telefon				
	E-mail				
	Website				
Ushtrimi i veprimtarisë	Periudha e fillimit të veprimtarisë së strukturës				
	Periudha e ushtrimit të veprimtarisë (Vjetore/sezonale)				
Kapaciteti akomodues i strukturës	Numri i kateve të strukturës akomoduese				
	Numri i dhomave në total				
	Numri i dhomave dyshe				
	Numri i dhomave teke				
	Numri i suitave (nëse ka)				
	Ofrim i akomodimit për një kohë të shkurtër (më pak se një natë fjetje)				
	Dhoma pa tuelet personal				
	Tualetet të përbashkëta				
	Restorant/ Nr i vendeve të uljes në restorant				
	Ofrim mëngjesi				
	Ofrim i vakteve të tjera				
	Bar/Nr i vendeve të uljes në bar				
	Sallë për konferenca, mbledhje, takime				
	Ashensor				
	Sistem MKZ dhe emergjencë				
	Parkim/Parkim i mbuluar				
	Vende parkimi				
	Pronari i strukturës fle në të njëjtën strukturë				
	Ambiente argëtuese	Pishinë			
Mjedise të tjera argëtuese e sportive					
Personeli i strukturës akomoduese					
Struktura	Nr	Arsimi&Kualifikimi	Gjuhë e huaj	Seksi	Mosha
Administrator					
Menaxher					
Shef i pritjes					
Receptionist					
Krye/Kuzhinier					



Kuzhinier					
Shef i sallës					
Kamarierë					
Banakierë					
Pastrues					
Mirëmbajtës					
Mbajtës bagazhesh					
Kopshtar					
Të tjera					

FATURË ARKËTIMI

Nr. Datë: . .2019

Me anë të kësaj fature kërkojmë që Banka Juaj të pranojë nga klientë (persona/persona fizik/persona juridik) arkëtime të të ardhurave, për llogari të institucionit tonë, me emërtimet, kodet dhe shumat si më poshtë :

Emri i Institucionit përfitues	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
Kodi i Institucionit	1026001
Kodi i Degës së Thesarit ku vepron	3535

Nr.	Përshkrimi i të ardhurave		Shuma që Arkëtohet (Lekë)
	Emërtimi	Kodi i Llogarisë Ekonomike	
1	Aplikim për klasifikimin, riklasifikimin, rinovimin e vlerësimit të strukturës akomoduese, për lëshimin e certifikatës së klasifikimit	7113099	100
2	Aplikim për koston e procesit të verifikimit për klasifikimin e strukturës akomoduese*	7113099	
	TOTALI		

INSTITUCIONI

Për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit
Elsa Sadiku

KLIENTI

(Person / Person Fizik / Person Juridik)

Adresa:

Kontakti:

* Kosto e procesit të verifikimit për klasifikimin e strukturës akomoduese, llogaritet sipas tarifave të përcaktuara në tabelën e mëposhtme.

Tarifat për klasifikimin e strukturave akomoduese

Nr.	Kategoria	Kosto për dhomë	Tarifa minimale për strukturë	Tarifa maksimale për strukturë
1	Hotel	1,200	4,500	100,000
2	Resort	1,200	4,500	120,000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

CERTIFIKATË KLASIFIKIMI STRUKTURË AKOMODUESE ME [4, 5] YJE ★★★★★/★

Kjo certifikatë i lëshohet

[Emri subjektit]
[Emri tregtar]

NIPT _____

[Emërtesa e strukturës akomoduese]
Adresa: [Adresa e strukturës akomoduese]

për ushtrimin e veprimtarisë si strukturë akomoduese

Kategoria:[Kategoria e strukturës akomoduese]
Niveli i klasifikimit:[Niveli i klasifikimit të strukturës akomoduese]
Emri i Markës:[Emri i markës/brand name]

Lëshuar më _____._____._____
Nr. Regj._____/2019

E vlefshme deri më _____._____._____

MINISTRI



VENDIM
Nr. 53, datë 3.7.2019

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT
PARAPRAK PËR BASHKIMIN ME
PËRTHITHJE TË BANKËS UNION SHA
ME BANKËN NDËRKOMBËTARE
TREGTARE SHA**

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës “e”, të nenit 43, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të shkronjës “k”, të pikës 1, të nenit 24 dhe të shkronjës “gj”, të pikës 1, të nenit 28, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar; dhe të pikës 7 të Shtojcës nr. 1, të rregullores “Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare”, miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010, të Këshillit Mbikëqyrës, e ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraparak për bashkimin me përthithje të Bankës Union sh.a. (shoqëria përthithëse) me Bankën Ndërkombëtare Tregtare sh.a. (shoqëria e përthithur).

2. Të revokojë licencën e Bankës Ndërkombëtare Tregtare sh.a. (shoqëria e përthithur). Ky revokim hyn në fuqi pas çregjistrimit nga Qendra Kombëtare e Biznesit të Bankës Ndërkombëtare tregtare sh.a. (shoqëria e përthithur), sipas nenit 220 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

3. Banka Union sh.a. (shoqëria përthithëse) duhet të dorëzojë në Bankën e Shqipërisë licencën e revokuar të Bankës Ndërkombëtare Tregtare sh.a. (shoqëria e përthithur), pas hyrjes në fuqi të revokimit.

4. Banka Union sh.a. (shoqëria përthithëse) do të ushtrojë vetëm veprimtaritë bankare dhe financiare për të cilat është licencuar.

5. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes, Departamenti i Sistemit të Pagesave dhe i Kontabilitetit dhe Financës, Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, Departamenti i Stabilitetit Financiar, Departamenti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme; Departamenti i Emisionit dhe Departamenti i Statistikave, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

6. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

7. Ky vendim i njoftohet edhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gent Sejko

VENDIM
Nr. 102, datë 26.6.2019

**MBI MIRATIMIN E “PROPOZIMIT TË
TË GJITHA OST-ve TË EVROPËS
KONTINENTALE PËR
KARAKTERISTIKAT SHITESË TË
REZERVAVE TË MBAJTJES SË
FREKUENCËS (FCR) NË PËRPTHJE
ME NENIN 154 (2) TË RREGULLORES
SË KOMISIONIT (BE) 2017/1485 TË
DATËS 2 GUSHT 2017 QË PËRCAKTON
NJË UDHËZUES PËR OPERIMIN E
SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2 dhe 3; nenit 16; nenit 19, germa “e”, nenit 23, pika 1, germa “a”; nenit 56 dhe nenit 67, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 167 të “Kodit të Transmetimit” të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, si dhe nenit 15 dhe 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të bordit të ERE-s, në mbledhjen e tij



të datës 26.6.2019, mbasi shqyrtoi propozimin e drejtorive teknike mbi miratimin e “Propozimit të të gjitha OST-ve të Evropës Kontinentale për karakteristikat shtesë të Rezervave të Mbajtjes së Frekuencës (FCR) në përputhje me nenin 154 (2) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 të datës 2 gusht 2017 që përcakton një udhëzues për operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike”.

konstatoi se:

- OST sh.a., në shkresën me nr. 2060 prot., datë 15.3.2019, ka paraqitur në ERE për miratim “Propozimin e të gjitha OST-ve të Evropës Kontinentale për karakteristikat shtesë të Rezervave të Mbajtjes së Frekuencës (FCR), në përputhje me nenin 154 (2) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues për Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, së bashku me dokumentin shpjegues për karakteristikat shtesë të rezervave për kontrollin e frekuencës”.

Ky propozim vjen në zbatim të dispozitave të nenit 7 dhe nenit 19, si dhe nenit 67 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendim të bordit të ERE-s nr. 186 datë 10.11.2017, përkatësisht neni 167 “Sigurimi i FCR-së”.

- “Rezervat e mbajtjes së frekuencës” ose “FCR” nënkupton rezervat e fuqisë aktive të disponueshme për të mbajtur frekuencën e sistemit pas shfaqjes së një çekuilibrimi.

Ky dokument vjen si propozim i përbashkët i zhvilluar nga të gjithë Operatorët e Sistemit të Transmetimit të zonës sinkron të Evropës Kontinentale në lidhje me zhvillimin e karakteristikave shtesë të rezervave për mbajtjen e frekuencës, neni 154 (2) i Rregullores së Komisionit BE 2017/1485 të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 73, datë 10.5.2019 vendosi të fillojë procedurën për miratimin e propozimit të të gjithë OST-ve të Evropës kontinentale për karakteristikat shtesë të FCR-së në përputhje me nenin 154 (2) të Rregullores së Komisionit të BE 2017/1485 të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues

për Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike.

- Shoqëria OST sh.a., në shkresën me nr. 2060/1 prot., datë 23.5.2019, regjistruar me nr. 232/2 prot., hyrës, datë 24.5.2019, ka dërguar në ERE një përkthim të përditësuar të Propozimit të të gjitha OST-ve të Evropës Kontinentale për karakteristikat shtesë të FCR-së në përputhje me nenin 154 (2) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 të datës 2 gusht 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë.

- Në shkresën me nr. 232/1 prot., datë 14.5.2019, ERE i ka dërguar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetit të Konkurrencës “Draftpropozimin e të gjitha OST-ve të Evropës Kontinentale për karakteristikat shtesë të FCR-së në përputhje me nenin 154 (2) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 të datës 2 gusht 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë”, për marrje mendimi, brenda 15 ditëve. Në përfundim të këtij afati nuk rezultoi ndonjë koment apo sugjerim nga këto subjekte, lidhur me sa kërkuar nga ERE-ja.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE, me shkresën nr. 32/23, datë 13.5.2019, publikoi në median e shkruar njoftimin lidhur me fillimin e procedurave për shqyrtimin e këtij akti, në mënyrë që palët e interesuara të shprehin komente apo opinione të mundshme lidhur me këtë akt, sipas afateve të përcaktuara në procedurën përkatëse. Në përfundim të këtij afati nuk rezultoi ndonjë koment apo sugjerim, lidhur me sa kërkuar nga ERE-ja.

- Në shkresën me nr. 232/3 prot., datë 31.5.2019, ERE i ka dërguar vendimin e bordit me nr. 73, datë 10.5.2019, shoqërisë OST sh.a.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e Propozimit të të gjitha OST-ve të Evropës Kontinentale për karakteristikat shtesë të Rezervave të Mbajtjes së Frekuencës (FCR), në përputhje me nenin 154 (2) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues për Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike. (Bashkëlidhur)



2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët, të versionit Shqip.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, do të njoftojë OST sh.a., dhe palët e interesuara, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

MATERIAL SHPJEGUES PËR
KARAKTERISTIKAT SHITESË TË
REZERVAVE TË MBAJTJES SË
FREKUENCËS
20.2.2019

SHPJEGIME

Në rast të disbalancave në sistem dhe devijimeve respektive të frekuencës së sistemit, aktivizohet FCR-ja për të stabilizuar sistemin. Për një stabilizim efektiv, FCR-ja duhet të jetë mjaftueshëm e shpejtë për të shmangur devijimet e papranueshme (dinamike) të frekuencës së sistemit. Kështu, aktivizimi duhet të fillojë sa më shpejt të jetë i mundur pas shfaqjes së devijimit. Pavarësisht kësaj, në varësi të teknologjisë së përdorur të njësive që sigurojnë FCR-në, pak vonesë në aktivizimin fizik është e pashmangshme. Për t'u siguruar që kjo vonesë kohe mbetet brenda kufijve të lejuar, nuk duhet të tejkalohet vonesa maksimale. Nga OST-ja mund të jepen "përjashtime" në rast se vonesa është tejkaluar vetëm pak më shumë për shkak të teknologjisë së përdorur. Megjithatë, nëse bazuar në teknologjinë e zbatuar është e mundur përgjigje më e shpejtë, për të kontribuar sa më efektivisht në stabilizimin e sistemin, ajo nuk duhet vonuar artificialisht.

Lidhur me nenin 3.2

Meqenëse FCR-ja është komponentja themelore për stabilizimin e frekuencës së sistemit, është me rëndësi të veçantë që siguresit e FCR-së të sigurojnë mundësinë e lidhjes së njësive dhe grupeve të tyre sigurorese të FCR-së përgjatë gjithë diapazonit të lejuar të frekuencës së sistemit në të cilën sistemi mund të funksionojë. Megjithatë, OST-të mund të kërkojnë shkyçjen e njësive ose grupeve që sigurojnë FCR-në nëse ato janë pjesë e skemës automatike të kontrollit në mbi-frekuencë për zonën përkatëse të LFC-së në përputhje me Rregulloren e Komisionit (BE) 2017/12196, neni 16 (3). Për shkak të teknologjive të ndryshme të njësive që sigurojnë FCR-në dhe niveleve të ndryshme të tensionit të mundshëm të lidhjes së këtyre njësive, është shumë e rëndësishme që, nga njëra anë të kërkohen tarimet e parametrave përkatës të njësive sigurorese të FCR-së dhe nga ana tjetër, të merren parasysh konceptet e mundshme të shkyçjes së ngarkesës së OSSh-ve. Edhe nëse këto koncepte të shkyçjes së ngarkesës nga OSSh-ja zakonisht tentojnë të shkyçin vetëm degë të ngarkesës në rastin e frekuencës së ulët, njësitë sigurorese të FCR-së gjithashtu mund të ndikohen, duke sjellë një humbje të kapacitetit të FCR-së. Kështu, do të nevojitet bashkëpunim i ngushtë me OSSh-të përkatëse.

Lidhur me nenin 3.3

Kategorizimi në LER ose jo- LER:

SO GL paraqet kategorizimin e grupeve ose njësive sigurorese të FCR-s në LER (për Rezervuarin e Kufizuar të Energjisë) dhe jo-LER.

Vetëm për njësitë ose grupet me Rezervuar të Kufizuar të Energjisë (LER), nga SO GL lejohet të ndalojnë sigurimin e FCR-s pas kalimit në gjendje alarmi kur iu shteron rezervuari, por jo para se të kalojë një periudhë e caktuar kohe ndërmjet 15 min. dhe 30 min. Periudha minimale e kohës do të përcaktohet sipas metodologjisë së analizës së kosto-përfitimit në përputhje me nenin 156 (6) të SO GL.


Njësitë ose grupet sigurorese të FCR-s nga jo-LER, përkundrazi duhet të jenë në gjendje të sigurojnë FCR-në në mënyrë të vijueshme (d.m.th për një periudhë kohe të pacaktuar), pavarësisht nga gjendja e sistemit në përputhje me nenin 156 (7) të SO GL-së.

Nga një pikëpamje teknike, madje edhe hidrocentralet e mëdhenj me rezervuar të madh të rezervimit të energjisë, kanë një rezervuar energjie “të kufizuar” edhe pse mund të sigurojnë vazhdimisht për ditë ose muaj FCR-n, ata nuk mund të trajtohen si LER.

Prandaj, OST-të vendosën të bëjnë diferencimin midis LER dhe jo-LER, bazuar në përkufizimin e një periudhe minimale të sigurimit të plotë të FCR-së në mënyrë të vazhdueshme që

do të zbatohet për kategorizimin ndërmjet grupeve ose njësive siguruese të FCR-s nga LER dhe jo-LER. Kjo periudhë minimale quhet “kohë e parakualifikimit si LER”.

Siç tregohet në figurën e mëposhtme, në varësi të përkufizimit të kohës së parakualifikimit si LER, kuptohet mirë që sasia e njësive ose grupeve ofruese të FCR-s të kategorizuara si njësi LER do të ndryshojë.



Sa më e gjatë periudha e parakualifikimit si LER, aq më e madhe pjesëmarrja e grupeve ose njësive LER që OST-të realizojnë vëllimin e dimensionimit të FCR-s.

Meqë detyrimi për grupet ose njësitë LER për të siguruar FCR-n e plotë në gjendjen e alarmit është më e dobët krahasuar me grupet ose njësitë jo-LER, për sistemin ekziston risku i dhënies së përkufizimit si LER që do të nënkuptonte një pjesëmarrje më të lartë të grupeve ose njësive nga LER. Për të mbuluar këtë risk, OST-të marrin parasysh se periudha e parakualifikimit si LER duhet përcaktuar si periudha më e shkurtër e mundshme.

Nga ana tjetër, nga OST-të njihet që, për të garantuar aktivizimin e plotë të FCR-s pavarësisht nga gjendja e sistemit, periudha e parakualifikimit si LER duhet të jetë mjaftueshëm e gjatë sa për të mbuluar kohën e duhur të nevojshme për OSB-n për të kryer menaxhimin e rezervuarit të energjisë sipas termave dhe kushteve të tij lokale. Si terma dhe kushte lokale, OST-të i referohen çdo procesi lokal që mund të luajë rol në strategjinë e menaxhimit të rezervuarit të energjisë së OSB-s, siç janë rregullat lokale të tregut, rregullat lokale të skedulimit, rregullat lokale të transferimit të detyrimit të FCR-s dhe/ose rregullat lokale për kompensimet dhe ato mbështetëse. Në fakt,

periudha e parakualifikimit si LER duhet të jetë mjaftueshëm e gjatë sa të mbulojë periudhën kohore (duke përfshirë çdo kohë paraprake) për të cilën një OSB nuk ka më aftësi për të kryer ndonjë veprim të menaxhimit të rezervuarit të energjisë (p.sh. periudha kohore për të cilën humbja e sigurimit të FCR-s nuk mund të kompensohet nga OSB-ja).

Duke marrë parasysh të gjitha kushtet lokale në Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale, periudha maksimale e kohës për të cilën një OSB nuk mundet të kompensojë shterimin e FCR-s së tij me anë të tregut të energjisë ose zhvendosjes së FCR-s në përputhje me nenin 156 (6) të SO GL-s është 2 orë (p.sh. në rastin e periudhës 1-orëshe të tregut me kohë paraprake 1 orë).

Kjo periudhë 2-orëshe bazohet në të njëjtat gjykime si periudha 2-orëshe në nenin 156 (13) të SO GL-s si periudha maksimale e lejuar (për Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale) për rikuperimin e rezervuarit në rast të shterimit pas një gjendje alarmi për një grup ose njësi siguruese të FCR-s nga LER.

Duke përcaktuar një periudhë parakualifikimi si LER, OST-të marrin parasysh të gjitha OSB-të në Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale, të cilët sipas termave dhe kushteve të tyre lokale, gjithmonë duhet të jenë në gjendje të garantojnë sigurimin e vazhdueshëm të FCR-s për njësitë

ose grupet siguruese të FCR-s nga jo-LER, pavarësisht nga gjendja e sistemit.

Ky përkufizim është tërësisht në përputhje me metodologjinë e analizës së kosto-përfitimit sipas nenit 156 (11) të SO GL-s për të cilin vlerësohet risku i shterimit të FCR-s për Zonën Sinkrone, duke marrë parasysh që grupet dhe njësitë e sigurimit të FCR-s nga jo-LER janë gjithnjë të disponueshme, pavarësisht gjendjes së sistemit.



Për të qenë të qartë, një njësi konvencionale pa asnjë kufizim specifik të rezervuarit, si p.sh. njësi termike nuk do të dështojë asnjëherë në kriterin e parakualifikimit të ofrimit të FCR-s 2-orëshe (për shkak të shterimit të rezervuarit). Prandaj, njësi të tilla konvencionale nuk do të kategorizohen asnjëherë si LER sipas këtij përkufizimi.

Plotësimi i periudhës kohore prej 2-orëve konsiderohet si një kërkesë e zakonshme e parakualifikimit. Nga njësi ose grupi që ofron FCR-n duhet të provohet që kapaciteti i rezervuarit të tij të energjisë të jetë i mjaftueshëm për të lejuar aktivizimin e plotë të FCR-s në drejtimin si pozitiv ashtu edhe negativ. Aftësia arrihet vetëm nëse ka të paktën një nivel të

rezervimit në rezervuarin e energjisë ku një aktivizim i plotë për periudhën e parakualifikimit si LER është i mundur si në drejtim pozitiv edhe në atë negativ. Gjatë klasifikimit të LER ose jo-LER, nuk do të merret parasysh efekti pozitiv i menaxhimit të rezervuarit të energjisë.

Figura në vijim ilustron dy shembuj të kërkesave të zbatueshme në rastin e një njësie ose grupi sigurues të FCR-s të përbërë nga objekte teknike me Rezervuarë të Kufizuar dhe të Pakufizuar të Energjisë, ose që njihen ndryshe si jo-LER dhe LER në përputhje me nenet 156 (7) dhe (8) e SO GL-s. Supozimet e përbashkëta për të dy konfigurimet janë (lart kundrejt fundit të figurës): të njëjtat vëllime të përgjithshme të FCR-s, fuqia/teknologjia e secilit objekt teknik dhe gjendja e nivelit të rezervës së rezervuarit jo-LER të objektit teknik në fillim të periudhës kohore. Ndarja e sigurimit të FCR-s midis objekteve teknike dhe për pasojë, marxhina minimale e FCR-s së rezervuar në rezervuarin e pakufizuar të energjisë së objektit teknik ndryshon klasifikimin e njësisë ose grupit sigurues të FCR-s.

Shembuj të ndarjes së sigurimit të FCR ndërmjet objekteve teknike

Mbështetja dinamike e FCR nga LER për njësi konvencionale	Sigurimi i FCR totale	Shpërndarja e sigurimit të FCR në gjendje të qëndrueshme (p.sh. >30 sekonda)	Detyrat e objektit teknik	Klasifikimi i SO GL	Përshkrime shtesë për LER në tërësi
	≥100%	≥100%	Aktivizimi i plotë në gjendjen e qëndrueshme	Neni 156 (7) "Pa kufizim"	• Pa detyrime në gjendjen normale • Me kohë të papërcaktuar
		0%	Vetëm kompensimi dinamik i jo-LER (pa aktivizim në gjendje të qëndrueshme)		
Sigurimi i plotë i FCR nga LER	Sigurimi i FCR totale	Shpërndarja e sigurimit të FCR në gjendje të qëndrueshme (p.sh. >30 sekonda)	Detyrat e objektit teknik	Klasifikimi i SO GL	Përshkrime shtesë për LER në tërësi
	≥25%	0%	Aktivizim i vazhdueshëm vetëm në gjendje normale	Neni 156 (8) "Me kufizim"	• Zhvendosja e sigurimit në gjendje normale + "1, 25: 1, 00" ose zgjidhje të ngjashme • Me kohë të përcaktuar
		100%	Aktivizimi i plotë i FCR në gjendjen e qëndrueshme		

Shembuj: Supozimi i Shpërndarjes së sigurimit të FCR kundrejt devijimit të frekuencës prej 200 mHz

Në bazë të konfigurimit të treguar në pjesën e sipërme të figurës, objekti teknik me Rezervuar të Kufizuar të Energjisë (Sistemi i Rezervimit të Energjisë me Bateri ose BESS) është përgjegjës për kompensimin, plotësisht ose pjesërisht, të aktivizimit dinamik të FCR-s së gjeneratorit termoelektrik të lidhur me të. Ky aktivizim kryhet përgjithësisht gjatë frekuencave kalimtare dhe zëvendësohet tërësisht nga aktivizimi i plotë i gjeneratorit në atë regjim. Meqë, p.sh. për një devijim të zgjatur të frekuencës i gjithë sigurimi i FCR-s rezervohet në këtë të fundit, njësia ose grupi që ofron FCR-n nuk klasifikohet si LER në përputhje me nenin 156 (7) të SO GL-s. Sistemi BESS do të sigurojë disponueshmërinë e tij vetëm për të mbështetur dinamikën e sigurimit, dhe jo “përmbajtjen e energjisë” së sigurimit të FCR-s.

Në fakt, sipas konfigurimit të treguar në pjesën e poshtme të figurës, objekti teknik me Rezervuar të Kufizuar të Energjisë me Bateri (BESS) jep të gjithë FCR-n e siguruar të njësisë ofruese të FCR-s. Meqenëse grupi konvencional rezervon një marxhinë të FCR-s më të vogël se ofrimi total i FCR-s (<100%), ky konfigurim kufizon aftësinë e njësisë sigurose të FCR-s në rast të një aktivizimi të plotë për afatin e miratuar (nën supozimin e një gjendje të caktuar të rezervës në rezervuar).

Njësia sigurose e FCR-s atëherë klasifikohet si LER në përputhje me nenin 156 (8) të SO GL-s.

Neni 156 (9), (10) dhe (11) i SO GL-s zbatohet për njësitë ose grupet ofruese të FCR-s dhe në përputhje me nenin 156 (8), objekti teknik me Rezervuar të Kufizuar të Energjisë me Bateri (BESS) duhet të aktivizojë FCR-n e tij për sa kohë që vazhdon devijimi i frekuencës, përveç nëse rezervuari i tij i energjisë ka shteruar ose në drejtimin pozitiv ose negativ. Në këtë shembull, një marxhinë e FCR-s, e barabartë ose më e madhe se 25% e sigurimit, duhet të rezervohet në grupin konvencional në mënyrë që të garantojë aktivizim të vazhdueshëm të njësisë sigurose të FCR-s në gjendje normale dhe në pajtim me nenin 156 (8), për aq kohë sa është e mundur.

Kërkesa parakualifikimi të mëtejshme për njësitë LER

Njësitë sigurose të FCR-s me rezervuar të kufizuar të energjisë në përgjithësi kanë riskun e

humbjes së kapacitetit efektiv të FCR-s në rast të devijimeve të frekuencës së sistemit që zgjasin më tepër për shkak të rezervuarëve të zbrazur. Kështu, koncepti i ngarkimit i bazuar në një shkëmbim të përcaktuar energjetik me rrjetin (menaxhimi i rezervuarit të energjisë), për njësi të tilla është thelbësore të garantojë aktivizimin siç duhet, veçanërisht në gjendjet e sistemit në limitet e sigurisë operationale. Në raste të jashtëzakonshme, kur njësia ose grupi ofrues i FCR-s nuk është teknikisht në gjendje të zbatojë menaxhimin e rezervuarit të energjisë (p.sh. hidrocentralet), ose një siguroes i FCR-së zgjedh të mos zbatojë menaxhimin e rezervuarit të energjisë, siguroesi përkatës i FCR-s duhet të jetë në gjendje të kompensojë mungesën e mundshme të energjisë dhe rrjedhimisht mungesën e sigurimit të FCR-s, duke zhvendosur aktivizimin e FCR-s te grupet apo njësitë sigurose të disponueshme.

Gjendja normale me devijim frekuence më të madh se ± 50 mHz nënkupton shterimin e energjisë me ndikim të mundshëm në disponueshmërinë e energjisë për gjendjen e alarmit. Ofruesit e FCR-s duhet të marrin në konsideratë këto devijime frekuence para hyrjes në gjendjen e alarmit që të jenë të pajtueshëm me periudhën minimale të aktivizimit në përputhje me nenin 156 (9).

Duke qenë se gjendja normale përfshin një devijim frekuence konstant me një maksimum prej 49.99 mHz, rezervuari i energjisë mund të shterojë. Menaxhimi i rezervuarit të energjisë për njësitë ose grupet sigurose të FCR-s me rezervuar të kufizuar të energjisë merr në konsideratë këtë skenar në mënyrë që të garantojë aktivizim të vazhdueshëm të FCR-së. Prandaj, kërkohet një dimensionim i fuqisë shtesë prej 25% (50 mHz pjesëtuar me 200 mHz) për të lejuar sigurimin e vazhdueshëm të FCR-s gjatë aplikimit të menaxhimit të rezervuarit të energjisë. Megjithatë, kjo kërkesë përcaktohet vetëm për operimin e pavarur të njërive sigurose të FCR-s me rezervuar të kufizuar të energjisë, që nënkupton se operimi është plotësisht i ndarë nga njësitë e tjera që mund të sigurojnë menaxhimin e rezervuarit të energjisë për këtë njësi. Figura e mëposhtme tregon kërkesën për dimensionimin e energjisë shtesë prej 25%:




Figura tregon marrëdhënien ndërmjet devijimit të frekuencës, sigurimit të fuqisë FCR dhe përdorimit të rezervuarit të energjisë.

Në anën e majtë të figurës, tregohet një rast teorik i shterimit të rezervuarit pa menaxhim të rezervuarit të energjisë aktive gjatë periudhës kohore të kontraktuar nga OST-ja. Pika referuese e operimit të njësive FCR përdoret për të përfaqësuar strategjinë e menaxhimit të rezervuarit të energjisë.


Në anën e djathtë të figurës, tregohet i njëjti rast duke zbatuar një strategji teorike të menaxhimit të rezervuarit të energjisë me kompensim fizik. Aty tregohet që një zhvendosje e pikës referente të operimit mundëson ngarkimin e rezervuarit. Pas zhvendosjes së pikës së operimit, për të vazhduar me sigurimin e FCR-s deri në devijimin e frekuencës prej 200 mHz, mund të kuptohet se mund të arrihet 125% e fuqisë së parakualifikuar e njësive FCR (pra 25% shtesë).

Nëse menaxhimi i rezervuarit të energjisë ka përdorur mbi përmbushjen e aktivizimit (p.sh kur frekuenca e sistemit tejkalon 50Hz, injektimi i energjisë është më i lartë sesa kërkohet), mund të shkaktohen ndikime negative të mundshme në qëndrueshmërinë e sistemit si lëkundjet e fuqisë.

Si rrjedhim, nuk lejohet një menaxhim i tillë i rezervuarit të energjisë.

Një menaxhim i rezervuarit të energjisë nuk mund të parandalojë shterimin e plotë të rezervuarit të energjisë në rast të devijimeve me kohëzgjatje shumë të gjatë, gjatë gjendjes së alarmit. Prandaj, koncepti i ashtuquajtur “Modaliteti Rezervë” duhet të adoptohet plotësisht për të arritur një sjellje përfundimtare dhe të kontrollueshme të grupeve dhe njësive ofruese të FCR dhe për t’i parandaluar ata nga mundësia e një sjellje arbitrare (p.sh, ndalim i plotë i menjëhershëm i aktivizimit) në situata të tilla kritike. Qëllimi i modalitetit rezervë është, në këtë mënyrë, zgjatja maksimale e mundshme e ndikimit stabilizues për sistemin duke marrë në konsideratë kufizimet ekzistuese.

Ideja e Modaliteti Rezervë është për të ndihmuar njësitë siguroese të FCR-s me rezervuarë të kufizuar të energjisë nga “devijimi mesatar” i frekuencës së sistemit. Duke zbatuar këtë metodë, disponueshmëria e njësive siguroese të FCR-s me rezervuar të kufizuar të energjisë mund të zgjatet (shiko gjithashtu grafikun më poshtë) në varësi të vlerës mesatare të frekuencës së sistemit.



Lidhur me nenin 3.4:

Bazuar në rëndësinë e veçantë të FCR-s për sigurinë e sistemit, aktivizimi i përshtatshëm i FCR-s, veçanërisht në situata të jashtëzakonshme (p.sh ndarja e sistemit ose ndërprerja e komponentëve të FCR-s) është me rëndësi të madhe.

Nën dritën e zhvillimit të inkurajimit të tregut të FCR-s, nevojat e pjesëmarrësve përkatës të tregut janë marrë në konsideratë sa aq ka qenë e mundur. Një nga kërkesat e pjesëmarrëse të tregut është kontrolli i centralizuar i FCR-s, si dhe matja e centralizuar e frekuencës, në mënyrë që të rritet efienca e kostos. Megjithatë krahasuar me metodën aktuale të matjes *on-site* të frekuencës dhe aktivizimin plotësisht të pavarur të FCR-s, matja e centralizuar e frekuencës dhe kontrolli i centralizuar mbajnë natyrshëm riskun e keqfunksionimit (në rast të ndarjes së sistemit) ose të humbjes së kapacitetit të FCR-s (ndërprerja e SCADA ose komunikimit). Në përgjithësi, nuk është e pranueshme një përkeqësim i ndjeshëm e sigurisë së sistemit krahasuar me nivelin aktual të sigurisë.

Megjithatë, kërkesat përkatëse në këtë propozim marrin parasysh:

- Mundësinë e zbatimit të matjeve të centralizuara të frekuencës dhe operimin e centralizuar të FCR-s, në rastin kur OSB-ja mund të vërtetojë që një zgjidhje e decentralizuar plotësisht ose një procedurë rezervë e decentralizuar nuk mund të implementohet me përpjekje të mjaftueshme.

- Zbatimin përkatës të nenit 154 (4) të SO GL-s, i cili përfshin kërkesat në lidhje me kufizimet e përqendrimit të FCR-s në lidhje me incidentet e vetme.

Rrjedhimisht, FCR-ja totale e operuar nga një rregullator i vetëm i FCR-s i pavarur është kufizuar në 30 MW, në veçanti në lidhje me incidentet që prekin p.sh. SCADA e OSB-së. OSB lejohet të operojë më shumë se një rregullator të pavarur të FCR-s. Përveç kësaj dhe për të parandaluar ndikimin e keqfunksionimit teknik të sigurimit të FCR-s nga kontrolli i centralizuar, FCR-ja totale e operuar me kontroll të centralizuar dhe matja e centralizuar e frekuencës në një bllok LFC të një OST është e kufizuar deri në 75 MW, në mënyrë që të merren në konsideratë ndërprerjet e një siguresi telekomunikacioni në rajonin e një OST-je, i cili mund të ofrojë shërbimet e tij për disa OSB.

Njësitë dhe grupet siguroese të FCR-s duhet të bazohen në matjen lokale të frekuencës të paktën për çdo pikë lidhje, ku pika e lidhjes është e përcaktuar si pika e lidhjes fizike me rrjetin publik. Në raste të veçanta kur njësitë ose grupet e FCR-s janë lidhur në një rrjet industrial, duhet të përdoret matja lokale e frekuencës së njësisë së FCR-s. Arsyeja për këtë kërkesë është fakti që aktivizimi i FCR-s duhet të bëhet bazuar në matjet e frekuencës lokale për të siguruar aktivizim të përshtatshëm gjithashtu në skenarë të jashtëzakonshëm. Nga ana teknike e njësisë siguroese të FCR-s, matja e frekuencës lokale është një karakteristikë natyrore në shumicën e teknologjive prodhuese, si për njësitë me lidhje sinkrone edhe për ato me lidhje jo-sinkrone (nëpërmjet elektronikës së fuqisë) me sistemin. Kjo kërkesë ka qenë zbatuar gjithashtu edhe më parë.



Derogimi dhe Zhvillimi

Eksperiencat me kontrollin e centralizuar të frekuencës do të shkëmbehen (share) gjatë periudhës prej 4 vitesh, pas hyrjes në fuqi të këtij neni nga OST ku lidhet rezerva dhe pas vlerësimit nga të gjitha OST-të. Nëse rezultati provon se kontrolli i centralizuar i grupeve siguruese të FCR-s mund të jetë po aq i besueshëm dhe i qëndrueshëm sa zgjidhja e decentralizuar, OST-të së bashku mund të rishikojnë zgjidhjen e preferuar (të decentralizuar), ose duke zgjatur periudhën e derogimit ose duke lejuar kontrollin e centralizuar të FCR-s si një zgjidhje alternative sipas kushteve të veçanta. Evoluimi dhe zhvillimi i pajisjeve të kontrolluara nga OSB-të sipas parimit të centralizuar mund të lejojë zgjidhje më të fuqishme gjatë kësaj periudhe derogimi.

Në lidhje me nenin 3.5

Në gjendjen e emergjencës, kur devijimi i frekuencës së sistemit tejkalon 200 mHz, FCR-ja e prokuruar, parimisht ka shteruar. Për të parandaluar rënien e sistemit dhe shkyçjen përkatëse të të gjithë njësive gjeneruese dhe objekteve të kërkesës, njësitë e sigurimit të FCR-s duhet të vazhdojnë aktivizimin e vëllimit të prokuruar. Ky koncept ka qenë zbatuar gjithashtu edhe më parë.

Propozimi i të gjithë OST-ve të Evropës Kontinentale për karakteristikat shtesë të FCR-s në përputhje me nenin 145 (2) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 të datës 2 gusht 2017 për krijimin e një udhëzuesi mbi Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë

28.1.2019

Përmbajtja

Neni 1 Lënda dhe fushëveprimi

Neni 2 Përkufizimet dhe interpretimi

Neni 3 Karakteristikat shtesë të FCR-s

Neni 4 Publikimi dhe zbatimi i propozimit të karakteristikave shtesë të FCR-s

Neni 5 Gjuha

Të gjithë Operatorët e Sistemit të Transmetimit të Zonës Sinkrone të Evropës Kontinentale marrin në konsideratë sa vijon:

Ndërkohë:

1. Ky dokument është një propozim i përbashkët i hartuar nga të gjithë Operatorët e Sistemit të Transmetimit të Zonës Sinkrone të Evropës Kontinentale (në vijim referuar si "OST-të") në lidhje me hartimin e karakteristikave shtesë të Rezervave për Ruajtjen e Frekuencës (në vijim referuar si "karakteristika shtesë të FCR-s" në përputhje me nenin 154 (2) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 të datës 2 gusht 2017, për krijimin e një udhëzuesi për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike (në vijim referuar si: "SO GL").

2. Propozimi i karakteristikave shtesë të FCR-s merr në konsideratë parimet dhe qëllimet e përgjithshme të përcaktuara në Rregulloren e Komisionit (BE) 2017/1485 të datës 2 gusht 2017, për krijimin e një udhëzuesi për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike. Qëllimi i Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 është të garantojë sigurinë operationale të sistemit të transmetimit të interkonektuar. Për këtë qëllim përcakton kërkesa për miratimin e termave dhe kushteve ose metodologjive të OST-ve, veçanërisht në lidhje me karakteristikat shtesë të FCR-së në përputhje me nenin 154 (2).

3. Në lidhje me nenin 154 të SO GL-së, i cili përcakton vetëm kërkesat teknike minimale të FCR-s, të gjithë OST-të e Zonës Sinkrone kanë të drejtë të specifikojnë, në marrëveshjen operationale të zonës sinkrone, karakteristikat e përbashkëta shtesë të FCR-s që kërkojnë për të siguruar sigurinë operative në Zonën Sinkrone, me anë të një sërë parametrash teknikë dhe brenda intervaleve të nenit 15 (2) (d) të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/631 të datës 14 prill 2016 për krijimin e një kodi rrjeti për kërkesat për lidhjen në rrjet të gjeneruesve dhe Nenit 27 dhe 28 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1388 të datës 17 gusht 2016 për krijimin e një Kodi Rrjeti për lidhjen e kërkesës. Për të pasqyruar nevojat individuale të Zonës Sinkrone të Evropës Kontinentale, OST-të e Zonës Sinkrone të Evropës Kontinentale propozojnë karakteristika shtesë përkatëse të përshkruara më poshtë.

4. Propozimi përcakton kushtet për njësitë siguruese të FCR-s dhe/ose grupet siguruese të FCR-s: në lidhje me aktivizimin e FCR-s dhe në



veçanti në lidhje me disponueshmërinë e FCR-së edhe në gjendjen sistemit në limitet e sigurisë me këndvështrim edhe të teknologjitë e reja.

5. Neni 6 (2) (d) (iii) i SO GL-s kërkon që të gjithë OST-të të hartojnë metodologjitë, kushtet dhe vlerat e përfshira në marrëveshjen operacionale të zonës sinkronie në nenin 118 në lidhje me karakteristikat shitesë të FCR-s në përputhje me nenin 154 (2).

6. Sipas nenit 6 të SO GL-s, propozimi i karakteristikave shitesë të FCR-s pritet të zvogëlojë riskun e aktivizimit të papërshtatshëm të FCR dhe të padisponueshmërisë së FCR në gjendjen e sistemit në limitet e sigurisë. Duke pasur parasysh këtë, karakteristikat e propozuara shitesë të paraqitura më poshtë do të kontribuojnë në qëndrueshmërinë e sistemit dhe për më tepër në arritjen e objektivave të nenit 4 të SO GL-s.

7. Specifikimi i aktivizimit të FCR-s ka për qëllim të sigurojë përgjigje të shpejtë dhe për këtë arsye ndihmon në qëndrueshmërinë e sistemit. Specifikimet për njësitë siguruese të FCR-s dhe/ose grupet siguruese të FCR-s me rezervuar të kufizuar të energjisë synojnë të sigurojnë disponueshmëri të mjaftueshme edhe në statusin e sistemit në limitet e sigurisë së operimit. Specifikimet për matjen e frekuencës synojnë të sigurojnë disponueshmërinë e funksionalitetit të pavarur të njërive siguruese të FCR-s dhe/ose grupeve siguruese të FCR-s në veçanti në rast të ndarjes së sistemit ose problemeve në komunikim. Periudha kalimtare përcaktohet për të shmangur gjithashtu ndryshimin e shpejtë të kërkesave për njësitë tashmë ekzistuese të sigurimit të FCR-s dhe/ose grupet siguruese të FCR-s.

8. Në përfundim, propozimi i karakteristikave shitesë të FCR-s kontribuon në objektivat e përgjithshme të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 në të mirë të gjithë pjesëmarrësve të tregut dhe konsumatorëve fundorë të energjisë elektrike.

PARAQET PROPOZIMIN E MËPOSHTËM TË KARAKTERISTIKAVE SHITESË TË FCR-s PËR TË GJITHË AUTORITETET RREGULLATORE:

Neni 1

Lënda dhe fushëveprimi

Karakteristikat shitesë të FCR-s siç përcaktohen në këtë propozim do të konsiderohen si propozim i përbashkët i të gjithë OST-ve të Evropës Kontinentale në përputhje me nenin 154 (2) të SO GL-s dhe do të mbulojnë kërkesat përveç atyre të nenit 154 për njësitë siguruese të FCR dhe/ose grupet siguruese të FCR-s.

Neni 2

Përkufizimet dhe interpretimi

1. Për qëllimet e propozimit të karakteristikave shitesë të FCR-s, termat e përdorur në këtë dokument kanë kuptimin e përkufizimeve të përfshira në nenin 3 të SO GL-s, nenin 2 të Rregullores (EC) 714/2009, nenin 2 të Direktivës 2009/72/EC, nenin 2 të Rregullores së Komisionit (BE) 543/2013 dhe nenin 2 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/631.

2. Në këtë propozim të karakteristikave shitesë të FCR-s, përveç nëse konteksti kërkon ndryshe:

- a) njëjës tregon shumësin dhe anasjelltas;
- b) tabela e përmbajtjes dhe titujt janë vendosur vetëm për lehtësi dhe nuk ndikojnë në interpretimin e këtij propozimi të karakteristikave shitesë të FCR-s; dhe
- c) çdo referencë në legjislacion, rregullore, direktivë, urdhër, instrument, kod ose ndonjë akt tjetër do të përfshijë çdo amendim, shitesë ose rimiratim të tij në fuqi në kohën e miratimit.

Neni 3

Karakteristikat shitesë të FCR-s

1. Secili OST duhet të garantojë që, ose çdo njësi siguruese e FCR-s dhe grupi që siguron FCR-n ose në rast se një OST përdor përgjigje të kombinuara për të përmbushur sigurimin e FCR-së, aktivizimi i të gjitha njërive siguruese të FCR-s dhe grupeve siguruese të FCR-s nuk vonohet artificialisht, fillon sa më shpejt të jetë e mundur,



por jo më vonë se 2 sekonda pas një Devijimi Frekuence, dhe aktivizimi do të rritet të paktën linearisht ose më shpejt. Nëse vonesa në aktivizimin fillestar të përgjigjes së fuqisë aktive ndaj frekuencës është më e madhe se dy sekonda dhe/ose aktivizimi i përgjigjes së fuqisë aktive ndaj frekuencës nuk mund të jetë më lineare ose më e shpejtë, pronari i objektit gjenerues të energjisë duhet të sigurojë dëshmi teknike për OST përkatëse, duke demonstruar pse është e nevojshme një kohë më e gjatë. Këto kërkesa duhet të kontrollohen gjatë parakualifikimit sipas nenit 155 të SO GL-s.

2. Çdo njësi ose grup sigurues i FCR-s duhet të jetë i aftë të qëndrojë i lidhur në rrjet brenda intervalit të frekuencave prej 47,5 deri në 51,5 Hz për periudhat kohore të përcaktuara nga OST duke marrë parasysh teknike kufi të njësive përkatëse të sigurimit FCR-s ose grupeve siguruese të FCR-s në përputhje me nenin 154 (6) të SO GL. Secili OST në dialog me OSSh-të duhet të sigurojë që FCR-n në shpërndarje të mos reduktohet ndjeshëm nga veprimet e shkyçjeve të ngarkesës.

3. Njësitë siguruese të FCR-s ose grupet siguruese të FCR-s konsiderohen të kenë rezervuarë të kufizuar të energjisë (LER) në rast se një aktivizim i plotë i vazhdueshëm për një periudhë prej 2 orësh në drejtim pozitiv ose negativ mundet, pa marrë parasysh efektin e menaxhimit të rezervuarit të energjisë aktive, të çojë në një kufizim të aftësisë së tij për të siguruar aktivizimin e plotë të FCR-s në përputhje me nenin 156 (8) të SO GL-s, për shkak të shterimit të rezervuarit të tij të energjisë duke marrë parasysh rezervuarin(et) efektive të energjisë. Njësitë ose grupet siguruese të FCR-s që nuk konsiderohen si LER që përbëhen nga objekte teknike me rezervuarë të kufizuar të energjisë, duhet të sigurojnë që të jenë në gjendje të aktivizojnë plotësisht sigurimin e FCR-s në përputhje me nenin 156 (7) të SO GL-s. Për shmangien e dyshimit, njësitë ose grupet siguruese të FCR-s që përmbajnë objekte teknike me rezerva të pakufizuara të energjisë dhe objekte teknike me rezerva të kufizuara të energjisë nuk do të konsiderohen LER në rast se rezervari i tyre i energjisë nuk kufizon aftësinë për të siguruar FCR-n sipas nenit 156 (7) e SO GL.

Në rast se njësitë siguruese të FCR-s ose grupet siguruese të FCR-s që përmbajnë objekte teknike me rezervuarë të kufizuar të energjisë duhet të kompensojnë mungesën e mundshme të energjisë dhe kështu mungesën e FCR-s, ata duhet të jenë në gjendje të zhvendosin aktivizimin e FCR-s tek objektet teknike të disponueshme për të garantuar sigurimin e FCR-s. Në çdo rast zhvendosja e aktivizimit të FCR-s do të garantojë vazhdimësinë e sigurimit të FCR-s. Njësitë siguruese të FCR-s ose grupet siguruese të FCR-s që konsiderohen si LER do të respektojnë afatin minimal të aktivizimit të plotë të FCR-s sipas nenit 156 (9), 156 (10) dhe 156 (11) të SO GL-s. Objektet teknike me rezerva të pakufizuara të energjisë të njësive siguruese të FCR-s ose grupeve siguruese të FCR nuk duhet të kufizojnë sigurimin e tyre të FCR-s në rastet kur objektet teknike me rezervuar të kufizuar të energjisë (të atij grupi/njësie që ofron FCR-n) janë tashmë të shteruar në drejtimin pozitiv ose negativ sipas nenit 156 (8) të SO GL-s.

Për parakualifikim, OST-të do të kërkojnë që njësitë siguruese të FCR-s ose grupet siguruese të FCR-s të respektojnë sa më poshtë:

- Njësitë siguruese të FCR-s ose grupet siguruese të FCR-s që përdorin objekte teknike me rezervuar të kufizuar të energjisë, duhet të kenë një menaxhim të rezervuarit të energjisë aktive. Menaxhimi i rezervuarit të energjisë aktive do të sigurojë një aktivizim të vazhdueshëm fizik të FCR-s në gjendje normale sipas nenit 156 (9) të SO GL-s. Në vijim të nenit 156 (9) të SO GL-s, sigurosi i FCR duhet të sigurojë që njësitë siguruese të FCR-s ose grupet siguruese të FCR-s që konsiderohen si LER kanë një dimensionim të rezervuarit të energjisë të mjaftueshëm për të mbuluar Devijimin e Frekuencës prej 200 mHz për të paktën [15-30] minuta në drejtim pozitiv dhe negativ duke marrë parasysh edhe devijimet e mundshme të frekuencës që mund të ndodhin para hyrjes në gjendjen e alarmit. Për të mundësuar menaxhimin e rezervuarit të energjisë aktive, njësitë të tilla siguruese të FCR-s ose grupet siguruese të FCR-s që konsiderohen si LER duhet të kenë një raport të fuqisë nominale me fuqinë e parakualifikuar prej të paktën 1.25: 1 ose një zgjidhje alternative me ndikim ekuivalent. Çdo kohë e nevojshme për procesin e mbushjes së rezervuarit duhet të merret parasysh për

menaxhimin e rezervuarit të energjisë. Vlera në kllapa e dhënë në këtë paragraf varet nga periudha e aktivizimit minimal që duhet të sigurohet nga ofruesit e FCR-s sipas nenit 156 (9), (10) dhe (11) të SO GL-s.

- Menaxhimi i rezervuarit të energjisë të njërive siguruese të FCR dhe grupit sigurues të FCR nuk duhet të mbështetet mbi përmbushjen e aktivizimit.

- Njësitë siguruese të FCR-s ose grupet siguruese të FCR-s me rezervuarë të kufizuar të energjisë që janë të lidhur në rrjet me anë të inverterave duhet të sigurojnë që afër kufirit të

rezervuarit të tij të energjisë, kapaciteti i mbetur është i mjaftueshëm për të ruajtur kundërpërgjigjen e tij ndaj devijimeve të frekuencës në terma afat-shkurtër. Prandaj, njësia do të kalojë nga modaliteti normal në modalitetin rezervë në t_{FAT} (koha e plotë e aktivizimit të aFRR sipas nenit 158 (1) (f) të SO GL-s) përpara shterimit të rezervuarit të energjisë për shkak të sigurimit maksimal të FCR-s në një drejtim. Gjatë modalitetit rezervë njësia duhet të reagojë vetëm ndaj devijimeve të frekuencës në terma afat-shkurtër duke ndjekur frekuencën me shpërndarje standarde normale:

$$\overline{\Delta f_{zero-mean}(t)} = \Delta f(t) - \frac{1}{n(t - t_{FAT})} \sum_{i=0}^{n(t-t_{FAT})} \Delta f(t - t_i) \text{ (modalitetit rezervë)}$$

- Për kalimin nga modaliteti normal në modalitetin rezervë zbatohet një funksion linear kalimtar T brenda periudhës kalimtare të $t_{shterimit} - t_{FAT}$ deri në $t_{shterimit}$:

$$f_{aktivizimit}(t) = \overline{\Delta f_{zero-mean}(t)} \cdot T + (1 - T) \cdot \Delta f(t)$$

Përmbushja e kërkesave të lartpërmendura si dhe atyre në nenin 156 (9), (10) dhe (11) të SO GL-s do t'i nënshtrohen procesit të parakualifikimit të përcaktuar nga OST.

4. Njësitë dhe grupet siguruese të FCR-s duhet të bazohen në matjen lokale të frekuencës së paku për pikë lidhjeje ose kur është e mundur teknikisht më poshtë në anën e njërive gjeneruese, në modulën gjenerues të energjisë ose njësinë e kërkesës.

5. Grupet siguruese të FCR-s duhet të kenë matje të decentralizuara të frekuencës për secilën pikë lidhjeje (bazuar në matjen lokale të frekuencës) që mund të përdoren ose si parazgjedhje ose si një zgjidhje rezervë për të siguruar një funksion të pavarur dhe aktivizimin e duhur në rast të gabimeve të kontrollit qendror p.sh. ndërprerja e SCADA-s, defekte në linjat e komunikimit) ose ndarja e sistemit të rrjetit elektrik. Në rastin e kontrollit qendror, kërkesat shitesë janë si më poshtë:

i) Funksioni i vëzhgimit do të zbulojë çdo lloj gabimi të devijimeve të kontrollit qendror ose të frekuencës midis objekteve teknike. Siguruesi i FCR-së do të iniciojë menjëherë kundër-masat për të siguruar që sigurimi i FCR-së të mos ndikohet dukshëm negativisht.

ii) Saktësia minimale e matjes lokale të frekuencës e përdorur për procedurën rezervë të decentralizuar plotësisht mund të reduktohet nëse pranohet nga OST ku lidhet rezerva.

6. Për një periudhë kohore prej 4 vitesh pas hyrjes në fuqi të këtij propozimi dhe në rast se nuk mund të zbatohet një procedurë rezervë e decentralizuar sipas paragrafit 5, mund të zbatohet brenda një grupi sigurues FCR-s ose në rast se procedura rezervë nuk mund të përmbushë kërkesat e OST-së ku është lidhur rezerva (p.sh. saktësia ose besueshmëria e matjeve lokale të frekuencës) zbatimi i një kontrolli të centralizuar të grupeve siguruese të FCR-s lejohet përkohësisht nën kushtet e mëposhtme:

i) Për të zbutur riskun e keqfunksionimit të objekteve teknike në rast të gabimeve të kontrollit qendror (p.sh. ndërprerja e SCADA-s, problemet në linjat e komunikimit) dhe për të kufizuar ndikimin në frekuencë, një rregulator i vetëm i centralizuar i FCR-s nuk duhet të rregullojë më shumë se 30 MW të FCR-s.

ii) Në përputhje me nenin 156 (6a) të SOGL-s, OST-të ku lidhet rezerva duhet të vëzhgojnë pjesën e FCR-s të siguruar në këtë mënyrë të kontrollit qendror brenda procesit të prokurimit



dhe të zbatojë një kufi të sasisë së përgjithshme të vëllimit të prokuruar për secilin bllok të LFC deri në 75 MW sipas nenit 154 (4) të SOGL-s.

7. Secili OST duhet të kërkojë që njësitë siguruese të FCR-s dhe grupet siguruese të FCR-s të vazhdojnë të sigurojnë FCR-në dhe nuk lejohen të zvogëlojnë aktivizimin në rast të devijimit të frekuencës jashtë intervalit të frekuencës ± 200 mHz deri në intervalet e frekuencës të përcaktuara në nenin 3.2.

Neni 4

Publikimi dhe zbatimi i propozimit të karakteristikave shtesë të FCR-s

OST-të do të publikojnë propozimin e karakteristikave shtesë të FCR-s pa vonesa të panevojshme pasi të gjithë autoritetet rregullatore kombëtare të kenë miratuar propozimin ose është marrë vendim nga Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë në përputhje me nenin 8 (1) dhe nenin 11 të SO GL-s.

OST-të do të fillojnë të zbatojnë karakteristikat shtesë të FCR-s siç specifikohet në këtë propozim menjëherë pasi autoritetet rregullatore kombëtare të kenë miratuar propozimin në përputhje me nenin 6 (3) SO GL-s ose është marrë një vendim nga Agjencia në përputhje me nenin 6 (8) SO GL-s. Periudha kalimtare për zbatimin e karakteristikave shtesë të FCR-s nga siguruesit e FCR-s që preken do të jetë dy vite: një vit për OST-të për të përshtatur Termat dhe Kushtet e tyre dhe një vit shtesë për siguruesit e FCR-s për të zbatuar karakteristikat shtesë në FCR-s.

Neni 5

Gjuha

Gjuha e referencës për këtë propozim të karakteristikave shtesë për FCR-n duhet të jetë anglishtja. Për shmangien e dyshimit, ku OST-të duhet të përkthejnë këtë propozim të karakteristikave shtesë të FCR-s në gjuhën e tyre kombëtare, në rast të mospërputhjeve midis versionit në gjuhën angleze të publikuar nga OST-të në përputhje me nenin 8 të rregullores së SO GL-s dhe çdo versioni në një gjuhë tjetër, OST-të përkatëse, në përputhje me legjislacionin

kombëtar, do t'ju sigurojnë autoriteteve përkatëse kombëtare rregullatore një përkthim të përditësuar të propozimit të karakteristikave shtesë të FCR-s.

VENDIM

Nr. 104, datë 26.6.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 181, DATË 10.11.2017, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET STANDARTE TË CILËSISË SË SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 7, pika 1 dhe nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 104, pika 4, germa “a”; nenit 113, pikat 1 dhe 3, e ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”, si dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 26.6.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017, “Për miratimin e rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017, bordi i ERE-s vendosi miratimin e rregullores për: “Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje me kërkesë të shoqërisë OSHEE sh.a., si rezultat i pamundësisë për të përmbushur kërkesat e kësaj rregulloreje brenda afateve që ajo përcakton, në lidhje me realizimin e investimeve të domosdoshme, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 271, datë 21.12.2018, vendosi shtyrjen e afateve të përcaktuara në rregulloren për “Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

- OSHEE sh.a., me shkresën nr. 13173 prot., datë 14.6.2019, protokolluar në ERE me nr. 400/1, datë 17.6.2019, në përgjigje të shkresës së ERE-s me nr. 400 prot., datë 13.6.2019, me anë



të së cilës iu rikujtua shoqërisë përfundimi i afateve, ka përcjellë tabelën për “Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike të plotësuar nga OSHEE sh.a. dhe analizën e treguesve të performancës së rrjetit shpërndarës për vitin 2018, si dhe krahasimin e realizimit të treguesve në vitet 2017–2018.

- OSHEE sh.a., duke mos qenë e përgatitur për vënien në zbatim të afateve të përcaktuara në këtë rregullore për shkak se gjatë kësaj periudhe ka kryer analiza më të detajuara për përshkallëzimin e realizimit të parametrave të kërkuar nga rregullorja për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, për periudhën 2017–2018, si dhe nisur nga kushtet e vështira financiare të shkaktuara nga situata hidrologjike, OSHEE sh.a. ka rishikuar programin e zhvillimit ekonomik në funksion të ndryshimeve të këtyre efekteve financiare, si të tillë implentimi i projekteve që lidhet me performancën e kompanisë është i kushtëzuar me realizimin në kohë të investimeve.

- Në këto kushte OSHEE sh.a. kërkon aplikimin në mënyrë të përshkallëzuar për të miratuar nivelin e lejuar të kriterëve standarde të performancës në zona të ndryshme, duke e rivlerësuar në funksion të performancës së ushtruar gjatë periudhës tranzitore dhe gjendjes së sektorit të shpërndarjes së energjisë elektrike për sa me poshtë:

- Zona: Tiranë–Durrës, afati i kërkuar - brenda datës 31.12.2021;

- Zona: Vlorë–Elbasan–Fier, afati i kërkuar - brenda datës 31.12.2022;

- Zona: Gjirokastrë–Berat–Korçë, afati i kërkuar - brenda datës 31.12.2023;

- Zona: Shkodër–Burrë–Kukës, afati i kërkuar - brenda datës 31.12.2024.

- Duke e parë në syrin e investimeve të parashikuara nga OSHEE sh.a. vërehet përqendrim i konsiderueshëm i investimeve që ndikojnë në përmirësimin e parametrave të vazhdueshmërisë së furnizimit me energji elektrike. Në analizat e deritanishme që deklarohen nga OSHEE sh.a., merren në konsideratë vlerat e parametrave vetëm në tension të “lartë” dhe të “mesëm” kështu që llogaritja e parametrave të vazhdueshmërisë së furnizimit duhet të shtrihet edhe në tension të

“ulët” e si rrjedhim shtyrja e kërkuar nga OSHEE-ja mund të konsiderohet e domosdoshme.

- Duke shqyrtuar sa më sipër cituar nga shoqëria OSHEE sh.a. dhe duke evidentuar pamundësinë e realizimit të investimeve të domosdoshme, gjykojmë që kërkesa për shtyrjen e afateve është pjesërisht e arsyeshme për realizimin e parametrave të kërkuar nga “Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike” pasi më parë shoqëria duhet të paraqesë në ERE një studim të detajuar mbi përshkallëzimin e realizimit të parametrave të kërkuara sipas zonave të sipërcituara dhe të propozojë nivelet e lejuara të cilësisë së shërbimit siç është përcaktuar në rregullore.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pikat 7.1, 7.2 dhe 10.2, të “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017, të bordit të ERE-s”, të pezullohen deri në miratimin nga ERE-s të niveleve të lejuara të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit, sipas pikës 7.4 të po kësaj rregulloreje.

2. Pika 7.3 e “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, ndryshon dhe bëhet: “OSHEE sh.a. do të propozojë në ERE për miratim, nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit, brenda datës 30 shtator 2019”.

3. Pika 7.4 e “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, ndryshon dhe bëhet: “Brenda 12 muajve nga paraqitja e propozimit të OSHEE sh.a., ERE-ja do të vlerësojë nivelet e pritshme të performancës dhe do të miratojë nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit”.

4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit do të njoftojë OSHEE sh.a. lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 105, datë 26.6.2019

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“TERNA ENERGY TRADING” SHPK,
NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, nenit 15 të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.6.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi kërkesën e shoqërisë “Terna Energy Trading” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 61, datë 10.5.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Terna Energy Trading” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Pas kësaj vendimmarrje, ERE-ja me shkresën nr. 32/22 prot., datë 10.5.2019, ka kryer njoftimin në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje

apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Terna Energy Trading” sh.p.k., për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 302/1 prot., datë 16.5.2019, ERE-ja dërgoi pranë shoqërisë “Terna Energy Trading” sh.p.k., njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës dhe kërkesën për plotësimin e dokumentacionit i cili konsistonte në mungesën e dokumenteve: vërtetim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vërtetim i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për administratorin e kësaj shoqërie.

- Në përgjigje të kërkesës së ERE-s, shoqëria “Terna Energy Trading” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 302/2 prot., datë 13.6.2019.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 302/4 prot., datë 20.6.2019, ka plotësuar tërësisht këtë dokumentacion.

- Aplikimi i shoqërisë “Terna Energy Trading” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, germat: “a”, “b” “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Terna Energy Trading” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).



2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 106, datë 26.6.2019

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“SANG 1” SHPK, NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gema “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e”; nenit 10, pikat 1 dhe nenit 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.6.2019, mbasi shqyrtoi relacionin plotësues të përgatitur me nr. 51/10-1, datë 20.6.2019, në vijim të relacionit të diskutuar më herët në mbledhjen e bordit, nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi licencimin e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, Bordi i ERE-s në vijim të relacionit plotësues me nr. prot 51/10-1 prot, datë 20.6.2019:

konstatoi se:

- Shoqëria “SANG 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr.124 prot., datë 6.2.2019, dhe nr. 124/1 prot., datë 14.2.2019, ka

paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në mbledhjen e bordit të ERE-s të datë 31.5.2019, shoqëria “SANG 1” sh.p.k., e cila kishte aplikuar për licencim në të aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit, me vendimin nr. 83, u licencua dhe në veprimtarinë e prodhimit të energjisë nga HEC “Thirrë”.

- Në mbledhjen e bordit të ERE-s të datës 31.0.2019 u kërkuar që të sqarohet me shoqërinë “SANG 1” sh.p.k., në një seancë dëgjimore, vlera financiare e vënë në dispozicion për secilën veprimtari, pasi ajo e deklaruar nga shoqëria “SANG 1” sh.p.k., nuk rezulton e mjaftueshme për të dy veprimtaritë.

- Në seancën dëgjimore të datës 10.6.2019, përfaqësuesit e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., deklaruan se shuma e deklaruar do të shërbejë për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germa “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë e shoqërinë “SANG 1” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM
Nr. 107, datë 26.6.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-S NR. 83, DATË
31.5.2019, MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË “SANG 1” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“THIRRË” ME KAPACITET TË
INSTALUAR 1.820 mw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, pika 1 dhe 3 e ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative” nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE nr.109, datë 29.6.2016, dhe nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 26.6.2019, mbasi shqyrtoi relacionin plotësues me nr.51/10-1, datë 20.6.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi licencimin e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, konstatoi se:

- Në mbledhjen e Bordit të ERE-s të datës 31.5.2019, shoqëria “SANG 1” sh.p.k. me vendimin nr. 83, u licencua në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Thirrë”.

- Shoqëria “SANG 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 124 prot., datë

6.2.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim edhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në mbledhjen e bordit të ERE-s të datës 31.5.2019 u kërkuar që të sqarohet me shoqërinë “SANG 1” sh.p.k., në një seancë dëgjimore, vlera financiare e vënë në dispozicion për secilën veprimtari, pasi ajo e deklaruar nga shoqëria “SANG 1” sh.p.k., nuk rezultoi e mjaftueshme për të dy veprimtaritë.

- Për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike përfaqësuesit e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., deklaruan në seancë se do të dërgojnë në ERE një kontratë sipërmarrje e cila justifikon çdo investim dhe vlerat monetare të vëna në dispozicion të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

- Kontrata e sipërmarrjes, datë 29.4.2019, “Për punime civile dhe ndërtimin e HEC “Thirrë”, e lidhur midis shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., në cilësinë e investitorit për realizimin e projektit të ndërtimit të HEC “Thirrë” dhe shoqërisë “Xhast” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, për realizimin në sasi dhe cilësi të punimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi (e depozituar në ERE nga shoqëria “SANG 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 124/10, datë 11.6.2019), nuk përbën dokumentacion që vërteton aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin, por përbën një detyrim financiar për t’u përmbushur nga ana e shoqërisë, nëpërmjet mjeteve financiare që ka në dispozicion.

- Shoqëria “SANG 1” sh.p.k., nuk ka depozituar në ERE asnjë dokumentacion, që vërteton mbështetjen financiare të shoqërisë për shlyerjen e kësaj kontrate dhe vijimin e investimit për ndërtimin e veprës prodhuese. Nga shoqëria “SANG 1” sh.p.k. në seancën dëgjimore të datës 05.06.2019, u deklarua se deklaruar shuma e vendosur si mbështetje financiare për të dy aktivitetet, vihet në dispozicion të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr. 83, datë 31.5.2019, ndryshon dhe bëhet:



Shoqëria “SANG 1” sh.p.k., të depozitojë në ERE:

2.1 Lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor nr. 97 prot., datë 8.5.2017, përpara datës 27.4.2022.

2.2 Dokumentacion që vërteton mbështetjen financiare të shoqërisë për ndërtimin e impiantit prodhues, brenda 3 muajve nga marrja e këtij vendimi.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendrike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 108, datë 26.6.2019

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË
SHOQËRISË “BESTA” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK “KUCOVA 2”,
ME KAPACITET TË INSTALUAR
2 mw**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”; nenit 5, pika 1, germa “a”; nenit 10, pikat 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.6.2019 mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të

Tregut, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Besta” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Kucova 2”, me kapacitet të instaluar 2 mw, të kësaj shoqërie.

konstatoi se:

Shoqëria “Besta” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 394 prot., datë 10.6.2019, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Kucova 2”, me kapacitet të instaluar 2 mw.

Shoqëria “Besta” sh.p.k. ka depozituar në ERE shkresat e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 8643 prot., datë 14.6.2018 dhe nr. 8643/2 prot., datë 17.8.2018, nga e cila rezulton se kjo e fundit, ka aplikuar pranë kësaj ministrie për pajisje me “Miratim paraprak”.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresat sipërcituar, i drejtohet shoqërisë “BESTA” sh.p.k duke i komunikuar se pranon aplikimin e saj për pajisjen me miratim paraprak në zbatim të VKM-së nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, e ndryshuar.

Aplikimi i shoqërisë “Besta” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar në mënyrë pjesërisht;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.4.3, germa “c”; pika 4.4.4, germa “d”) është plotësuar në pjesërisht.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 2, germa “f” marrëveshje koncesioni ose autorizimi nga KM-ja në rastet e aplikueshme në përputhje me kuadrin ligjor



përkatës; germa “g” dokumenta që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shit-blerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete për kryerjen e aktivitetit të licencuar).

- Neni 9, pika 4.4.1 Të dhënat teknike për centralet fotovoltaike.

- Neni 9, pika 4.4.2 Të dhënat teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin.

- Neni 9, pika 4.4.3 Dokumentacioni teknik dhe grafik, germa “a” Paraqitje e përgjithshme skematike të centralit A1; germa “b” Një diagram elektrik në format A1 të agregateve dhe bllokut të transformimit ku të evidentohet qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes; germa “d” Një hartë topografike ku të paraqitet qartë gjurma e linjës transmetuese në shkallë 1:25000.

- Neni 9, pika 4.4.4 Dokumentacioni tekniko-ekonomik, germa “a” Studimi i fisibilitetit teknik; germa “b” Grafiku i zbatimit të projektit; germa “c” Oponenca teknike e projektit.

- Neni 9, pika 4.4.5 Leje nga institucione të tjera, germa “a” Miratimin e OST-së ose OSSH-së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes; germa “b” Leje mjedisore nga organet përkatëse;

Do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ta paraqesë atë në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Besta” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike “Kucova 2”, me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 20-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet

ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 111, datë 10.7.2019

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN QERSHOR 2019

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, i ndryshuar; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 10.7.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, për muajin qershor 2019,

konstatoi se:

- OSHEE sh.a., me shkresën nr. 13882 prot., datë 26.6.2019 paraqiti në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF), për muajin qershor 2019.

- Nëpërmjet këtij aplikimi, OSHEE sha, kërkon që çmimi i shitjes së energjisë elektrike tek klientët e FMF-së për muajin qershor 2019 të jetë 13.07 lekë/kWh.

- Llogaritjet e OSHEE sh.a., si dhe propozimi i ERE për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF-ja për muajin qershor 2019 sipas “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, i ndryshuar, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:



Çmimi për FMF për muajin Qershor 2019

Qershor 2019		Aplikimi OSHEE Sh.a	Propozimi i ERE
		Njësia	Çmimi
a	Çmimi maksimal i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me perparësi	Leke/kWh	8.76
b	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.26
c	Çmimi maksimal i blerjes në periudhën relevante	Leke/kWh	9.03
d	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79
e	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75
f	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50
Çmimi i energjisë (c+d+e+f)		Leke/kWh	13.07

- Në aplikimin për çmimin e FMF-së për muajin qershor 2019, OSHEE sh.a. ka zbatuar me korrektësi përcaktimet e nenit 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, i ndryshuar, për sa i përket çmimit maksimal të blerjes.

- Nga informacioni i OSHEE sh.a, në këtë aplikim mbi procedurën e blerjes së energjisë elektrike në tregun e parregulluar, rezultoi se çmimi maksimal i blerjes në fazën përfundimtare të negociimit në datën 21.6.2019 për periudhën 24.6.2019–30.6.2019 dhe fashën orare 6:00–24:00 për sasinë 126 MWh nga shoqëria ofertuese EFT AG (loti 2) është 72.00 EUR /MWh.

- Nga analiza e informacionit të praktikës së dorëzuar nga shoqëria, mbi procedurat e blerjes së energjisë, data e realizimit të procedurës ku u realizua çmimi më i lartë i blerjes, është data 21.6.2019. Për këtë praktikë shoqëria deklaroi se, për konvertimin e çmimit ka përdorur kursin e këmbimit të datës 21.6.2019, që i korrespondon ditës së mbylljes së procedurës së fundit të blerjes nga tregu i parregulluar, ku 1EUR= 121,71 lekë.

- Kostot administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, OSHEE sh.a., janë paraqitur në vlerësimin si vijon:

Tarifa e Shërbimit të Furnizimit Universal, 000/Lekë

Zëri	2019	Kosto Lekë/Kwh
Shpenzime Operative	2,614,889	0.54
Kosto e Energjisë së shitur nga FPSH (+Marzh)	16,841,325	3.51
Kosto e transmetimit	3,311,237	0.69
Marzhi	505,240	0.11
Kompensimi i Borxhit i Keq	3,169,725	0.66
Të ardhura të përealizuara nga tarifë 2017	-	-
Kompensim për humbjet 2012 - 2014 (CEZ)	2,818,842	0.59
Totali i të Ardhurave të Kërkuara	29,261,257	6.09
Energji e shitur në rrjetin e Shpërndarjes (MWh)	4,803,209	
Tarifa mesatare e shitjes Lekë/KWH	6.09	

Elementet e Kostove Administrative në përlogaritjen e tarifës përbëhen nga:

10. Shpenzime Operative	0.54 Lekë/Kwh
11. Kosto e Borxhit të Keq	0.66 Lekë/Kwh
12. Kompensim për humbjet 12 -14	0.59 Lekë/Kwh
Kosto Administrative Gjithsej	1.79 Lekë/Kwh



- Për sa deklaruar nga OSHEE sh.a., dhe konstatuar edhe më herët, shoqëria vazhdon të mos ketë ndarje të llogarive midis aktivitetit të Furnizimit dhe Shpërndarjes dhe nuk ka një strukturë të posaçme për evidentimin e kostove të administrimit dhe kostove të disbalancave për klientët e FMF.

- Gjendur në kushtet e pamundësisë së ndarjes së kostove të FMF-së nga ato të Furnizuesit të Shërbimit Universal, mendojmë se, për përcaktimin e kostove administrative (elementi CA i formulës) është e arsyeshme të pranohet kosto për njësi prej 1.79 lekë/kWh të paraqitur nga OSHEE sh.a.

- Sikurse edhe në periudhat paraardhëse, OSHEE sh.a. vazhdon të mos përcaktojë kostot e disbalancave për klientët e FMF-së dhe nuk deklaron nëse i faturon këta klientë për këto kosto.

- Gjatë kësaj periudhe, si dhe në këtë aplikim për çmimin e FMF-së për muajin qershor 2019, OSHEE sh.a. nuk është shprehur në lidhje me evidentimin e kostove të disbalancave për konsumatorët e FMF-së.

- Nga raportimet periodike të dërguara nga OSHEE sh.a., për muajin prill dhe maj 2019, me shkresën nr. 11890, datë 28.5.2019 dhe me shkresën nr. 13642, datë 21.6.2019 nga analiza e strukturës së shitjes të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për muajin prill dhe maj 2019, evidentohet se OSHEE sh.a., ka vijuar në faturimin në pikë të klientëve FMF.

- ERE edhe më herët me shkresën nr. 109/3, datë 27.03.2019 ndër të tjera i bente me dije shoqërisë se, nisur nga fakti që për llogaritjen e çmimit të furnizimit të energjisë elektrike nga FMF në zbatim të përcaktimeve të formulës sipas nenit 8 të Metodologjisë, komponenti (CBET) konsiderohet “Çmimi maksimal i blerjes së energjisë për periudhën e furnizimit nga tregu i parregulluar...” dhe ndërkohë ky çmim në disa raste realizohet edhe nga prokurimi i energjisë gjatë periudhës së pik-ut (sikurse vërejtur në disa nga aplikimet e OSHEE sh.a.). ERE e gjykoj të paarsyeshme që këta klientë të ngarkoheshin edhe me kosto të tjera.

- ERE i ka kërkuar OSHEE sh.a. të ndërpresë në mënyrë të menjëhershme praktikën e faturimit të konsumit në pik të klientëve në kushtet e FMF-së dhe njëkohësisht të marrë masa për kryerjen e korrigjimeve të faturave të klientëve të cilët janë

faturuar në pik për periudhën e mëparshme duke i kërkuar të bëjë me dije ERE-n në lidhje me përmbushjen e kësaj detyre.

- OSHEE sh.a., vazhdon të faturojë klientët FMF në pik ndryshe nga sa lënë detyrë nga ERE, ndërkohë siç evidentohet dhe në raportimet periodike, shoqëria nuk ka marrë masa për ndërprerjen e kësaj praktike, por gjithashtu nuk ka bërë ende me dije mbi arsyet e mos përmbushjes së detyrës së lënë nga ERE.

- Bazuar në vendimin nr. 266, datë 21.12.2018 të bordit të ERE-s “Mbi përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria OST sh.a., tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit për vitin 2019” është 0.75 lekë/kWh.

- Bazuar në vendimin nr. 268, datë 21.12.2018 të bordit të ERE “Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 190 datë 30.8.2018 në lidhje me tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit dhe çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2019”, tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV është 1.5 lekë/kWh.

- Për sa përcaktuar për çdo element të formulës për llogaritëse rezulton, për muajin qershor 2019, çmimi i shitjes nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit është 13.07 lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimin e furnizimit me energji elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 13.07 lekë/kWh për muajin qershor 2019.

2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 111, datë 6.5.2019

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Nr. 411/178 regj. themeltar

Gjykata Administrative e Apelit me trup gjykues të përbërë nga:

Kryesuese: Alkelina Gazidedja
Anëtar: Amarildo Laçi
Anëtar: Bari Shyti
Anëtar: Artur Malaj
Anëtare: Enkelejda Metaliaj (Softa)

Asistuar nga sekretarja gjyqësore Raimonda Aliaj, sot më dt. 6.5.2019 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen administrative me palë:

PADITËS: Aleksander Meksi, i biri Gabriel dhe Efigjeni, dtl. 8.3.1939 në Tiranë, banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27/1, shk. 1, ap. 2, Tiranë.

Dhurata Meksi, e bija Adem dhe Bukuriye, dtl. 5.10.1953 në Tiranë, banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27/1, shk. 1, ap. 2, Tiranë.

Manushaqe Zhulali, e bija Munir dhe Zire, dtl. 26.3.1957 në Peshkopi, banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27/1, shk. 1, ap. 1, Tiranë.

Elsa Zhulali, e bija Safet dhe Manushaqe, dtl. 9.3.1983 në Tiranë, banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27/1, shk. 1, ap. 1, Tiranë.

Julian Demeti, i biri Fatis dhe Zanzibar, dtl. 27.7.1981 në Tiranë, banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27/1, shk. 1, ap. 2, Tiranë.

Fatmir Karapici, i biri Sulejman dhe Fatime, dtl. 26.6.1946 në Tiranë, banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27, shk. 2, ap. 9/1, Tiranë.

Vjollca Karapici, e bija Halil dhe Floresha, dtl. 5.11.1952 në Tiranë, banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27, shk. 2, ap. 9/1, Tiranë.

Neim Çipi, i biri Gani dhe Haxhire, dtl. 16.6.1933 në Berat, banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27, shk. 3, ap. 14, Tiranë.

Lumturi Çipi, e bija Lilo dhe Salihe, dtl. 24.4.1943, në Velçe Vlorë banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27, shk. 3, ap. 14, Tiranë.

Ana Topalli, e bija Palok dhe Shaqe, dtl. 21.7.1943, në Tiranë, banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27, shk. 4, ap. 26, Tiranë

Joana Topalli, e bija Kolec dhe Ana, dtl. 31.12.1991, në Tiranë, banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27, shk. 4, ap. 26, Tiranë.

Fatbardh Metaj, i biri Sadush dhe Deko, dtl. 15.11.1944 në Zhares Fier, banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27, shk. 2, ap. 11, Tiranë.

Fatmire Metaj, e bija Ramazan dhe Ikbale, dtl. 1.8.1951, në Tiranë, banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27, shk. 2, ap. 11, Tiranë.

Esat Myftari, i biri Shaqir dhe Shykie, dtl. 31.12.1940 në Pejë, banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27, shk. 2, ap. 9, Tiranë.

Shqipe Myftari, e bija Shefqet dhe Sabrie, dtl. 11.3.1956, në Shkup, banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27, shk. 2, ap. 9, Tiranë.

Brikeida Likaj, e bija Ethem dhe Zeqirje, dtl. 10.7.1974, në Tiranë, banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27/1, shk. 1, ap. 3, Tiranë.

Vjollca Konica, e bija Skender dhe Bukuriye, dtl. 10.1.1956, në Tiranë, banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27, shk. 1, ap. 6, Tiranë.

Suzana Arbnori, e bija Loro dhe Roza, dtl. 17.1.1956, në Shkodër, banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27, shk. 1, ap. 3, Tiranë.

Gjystina Arbnori, e bija Pjeter dhe Suzana, dtl. 22.10.1992, në Shkodër, banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27, shk. 1, ap. 3, Tiranë.

Filip Arbnori, i biri Pjeter dhe Suzana, dtl. 7.12.1994, në Tiranë, banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27, shk. 1, ap. 3, Tiranë.

Kozeta Todi, e bija Vangjel dhe Liri, dtl. 6.12.1968, në Tiranë, banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27, shk. 1, ap. 3, Tiranë.

Rexhep Uka, i biri Sali dhe Aishe, dtl. 6.2.1953, në Kamzë Tiranë, banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27, shk. 2, ap.10, Tiranë.

Luljeta Uka, e bija Iliza dhe Dallëndyshe, dtl. 27.11.1955, në Kamzë Tiranë, banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27, shk. 2, ap.10, Tiranë.

Shaqir Vukaj, i biri Bejto dhe Shkurte, dtl. 20.8.1942 në Reç Shkodër, banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27, shk. 4, ap.19, Tiranë.

Sabrije Vukaj, e bija Muhamet dhe Sadije, dtl. 26.7.1948 në Shkodër, banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27, shk. 4, ap.19, Tiranë.

Bardh Spahia, i biri Ali dhe Liri, dtl. 29.1.1976 në Shkodër, banues në rr. "Ibrahim Rugova", pll. 27, shk. 4, ap.18, Tiranë.



Mirela Bardhi, e bija Sotiraq dhe Fllorika, dtl. 19.1.1964, Rr. “Ibrahim Rugova”, pll. 27, shk. 2, ap.13, Tiranë.

Të gjithë paditësit përfaqësuar në gjykim nga **Av. Erind Merkuri me prokurë të posaçme datë 14.12.2018.**

I PADITUR: Këshilli Ministrave, gjykim në mungesë.

Avokatura Shtetit, përfaqësuar në gjykim nga Gramoz Meçani me urdhrin e emërimit nr. 8 datë 16.1.2019.

Palë e tretë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, përfaqësuar në gjykim nga Etleva Malile me autorizim të datës 19.2.2019 me nr. 1834/1 prot.

OBJEKTI: Shfuqizimi i pjesshëm i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, dhe konkretisht të pikës 12 të nenit 34, siç është ndryshuar nga neni 23 i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 231 datë 21.3.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar, me këtë përmbajtje: “Për objektet në kompetencë të Këshillit Kombëtar të Territorit, sipas nenit 19, të kësaj rregulloreje, distancat midis objekteve mund të përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit me rregullore të posaçme, të miratuara prej tij”.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta, nenet 18, 41 dhe 118, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenet 8, 14 dhe neni 1 i Protokollit 1; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar nenet 10, 15, 17, 18 dhe 37; Kodi i Procedurave Administrative, nenet 2, pika 3, 17, 22 dhe 29.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, Gjykata pasi mori në shqyrtim provat shkresore, dëgjoi dhe pretendimet përfundimtare të palëve, të cilat kërkuar:

Paditësi: pranimin e padisë.

Avokatura e Shtetit që kërkoj: rrëzimin e padisë.

Pala e tretë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë që kërkoj: rrëzimin e padisë.

VËREN:

Pranë Gjykatës Administrative të Apelit ka ardhur për gjykim çështja me palë dhe objekt të sipërcituar.

Rrethanat e faktit

Rezulton se paditësit janë banorë të qytetit të Tiranës dhe banojnë në Rrugën “Ibrahim Rugova”, në pallatin nr. 27 dhe 27/1. Gjithashtu paditësit janë edhe bashkëpronarë të pasurisë truall me sipërfaqe 146.28 m² dhe 171 m² me nr. pasurie 4/195; vol.78, faqe 94 dhe nr. pasurie 4/541, vol. 69, f. 155, zona kadastrale 8270 sikundër provohet nga certifikatat e vërtetimit të pronësisë datë 9.6.2015.

Këshilli Kombëtar i Territorit, me vendimin nr. 11, datë 20.6.2018 ka miratuar lejen zhvillimore në favor të subjektit “Invest Society” sh.p.k., për ndërtimin e një godine 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 kate në Rrugën “Ibrahim Rugova”, Tiranë.

Rezulton se Këshilli Kombëtar i Territorit ka miratuar dokumentin: Rregullore e veçantë për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin godinë polifunksionale West Residence 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9-katëshe në Rrugën “Ibrahim Rugova”, Bashkia Tiranë.

Në pikën 4.3 të saj “Përcaktimi i treguesve për zhvillimin të projektit” janë përcaktuar treguesit e zhvillimit të projektit, distancat nga kufiri i pronës, distancat nga aksi i rrugës, distancat nga trupi i rrugës etj.

Me vendim të Kryetarit së Bashkisë së Tiranës nr. E-22296/7, datë 3.10.2018 është miratuar leja e ndërtimit për objektin “Godinë polifunksionale West Residence 2,3,4,5,6,7,8 dhe 9 kate, me 4 kate parkim nën tokë”, në rrugën “Ibrahim Rugova”, Njësia Administrative nr. 5, Tiranë, me zhvillues Shoqëria “INVEST SOCIETY” dhe subjekt ndërtues Shoqëria “TDT & PARTNERS”. Ndërtimi i ri është kufitar me pronën e paditësive, që kanë paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me objekt: *Shfuqizimin e aktit administrativ: vendimi i KKT nr. 11, datë 20.6.2018 “Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin “Godinë polifunksionale West Residence 2,3,4,5,6,7,8 dhe 9 Kate, me vendndodhje në rrugën “Ibrahim Rugova”, Bashkia e*



Tiranës”, me subjekt zhvillues shoqërinë “INVEST SOCIETY”. Shfuqizimin e aktit administrativ të vendimit të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës nr. E-22296/7, datë 3.10.2018 “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin “Godinë polifunksionale West Residence 2,3,4,5,6,7.8 dhe 9 kate, me 4 kate parkim nën tokë”, në rrugën “Ibrahim Rugova”, Njësia Administrative nr. 5, Tiranë, me zhvillues Shoqëria “INVEST SOCIETY” dhe subjekt ndërtues Shoqëria “TDT & PARTNERS”.

Në bazë të nenit 6/2/b të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës mbi propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, i padituri Këshilli i Ministrave ka nxjerrë vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

Në këtë VKM, në nenin 34 janë përcaktuar distancat minimale midis ndërtimeve. Kjo dispozitë ka pasur përmbajtje:

1. Distancat minimale midis dy ndërtimeve sipas këtij neni garantojnë kushtet minimale të standardeve të ndriçimit dhe mbrojtjes nga zjarri dhe përcaktohen si gjatësia e vijës pingule midis planeve më të afërta të faqeve që përballin njëra-tjetrën.

2. Në njësitë ku plani parashikon mbushje urbane dhe nuk parashikon hartimin e PDV-së, distanca minimale e lejuar midis dy ndërtimeve do të matet sipas formulës më poshtë:

$$d = b_{\max} \times k(0.8),$$

nga të cilat, d -distanca minimale; b -lartësia maksimale e ndërtimit më të lartë dhe $k(0.8)$ -koeficienti minimal për ndriçim dhe mbrojtje nga zjarri.

3. Në zonat e reja për zhvillim apo zonat ekzistuese për rrizhvim, distanca midis dy ndërtimeve është e barabartë me lartësinë maksimale mbi tokë të ndërtimit më të lartë.

4. Në rastet e zonave historike dhe të mbrojtura monument kulture sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi respektohen distancat ekzistuese të tipologjisë arkitektonike historike në zonë.

5. Distancat e ndërtimeve të ndryshme nga çerdhet, kopshtet, shkollat dhe objektet shëndetësore duhet të jenë në drejtimin jug, jo më pak se 1,5 herë e lartësisë së përgjithshme të ndërtimit më të lartë të shprehur në metra. Në drejtimit e tjera të horizontit zbatohen pikat 2 dhe 3, e këtij neni.

6. Distancat për ndërtimet industriale përcaktohen në përputhje me sigurinë e ndërtimit dhe nga aktiviteti që kryhet në to, sipas legjislacionit të posaçëm, dhe në çdo

rast nuk dubet të jenë më të vogla se përcaktimet e pikave 2 dhe 3, të këtij neni.

7. Distancat për ndërtimet brenda një zone me përdorim hotelier përcaktohen sipas projektit, në përputhje me këtë rregullore, për aq sa nuk përcaktohet ndryshe në legjislacionin e posaçëm dhe atë mjedisor.

8. Pavarësisht sa përcaktohet në këtë nen, hapësirat që krijohen nga distancat duhet të jenë të tilla që për çdo ndërtim të sigurohet akses i drejtpërdrejtë nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri në të paktën 2 faqe të ndërtimit dhe midis ndërtimeve. Nënkalimet tunel të ndërtesave të gjata janë minimalisht 5 metra të gjera dhe 6 metra të larta, për të lejuar kalimin e lirshëm të ambulancës ose zjarrfikësës.

9. Në rast se faqet që përballin njëra-tjetrën janë kallkan, pra pa dritare dhe pa çarje fasade të çdo lloji tjetër, dy ndërtimet mund të vendosen bashkëngjitur në këto faqe mbi bazën e projektit për ndërtesa të bashkëngjitura dhe marrëveshjes përkatëse mes palëve të interesuara. Në mungesë të marrëveshjes, respektohen distancat sipas pikave në vijim të këtij neni.

Me propozim të ministrit të Zhvillimit Urban, i padituri Këshilli i Ministrave ka nxjerrë vendimin nr. 231 datë 21.3.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, i cili ka ndryshuar nenin 34 me përmbajtjen si më poshtë:

Distancat minimale midis ndërtimeve

1. Distancat minimale midis dy faqeve, ku të paktën njëra ka dritare, sipas këtij neni garantojnë kushtet minimale të standardeve të ndriçimit e mbrojtjes nga zjarri dhe përcaktohen si gjatësia e vijës pingule midis planeve më të afërta të faqeve që përballin njëra-tjetrën.

2. Distanca minimale e lejuar midis dy ndërtimeve do të matet me shumën e numrit të kateve mbi tokë të ndërtimeve që përballen plus 2m, sipas formulës më poshtë:

$$d = nr. k \text{ obj. A} + nr. k \text{ obj. B} + 2m, \text{ ku:}$$

d - distanca minimale midis dy ndërtimeve.

$nr. k$ - numri i kateve.

3. Në rast se ndërtimi përballlet me një objekt ekzistues, të ndërtuar në kundërshtim me kondicionet urbane të legjislacionit përkatës, atëherë ndërtimi i ri përjashtohet nga detyrimi për të respektuar distancat sipas pikës 2, të këtij neni, dhe mbart detyrimin e respektimit të distancës nga kufiri i pronës, sipas nenit 35. Për efekt të zbatimit të kësaj dispozite, nuk do të merren në konsideratë objektet ekzistuese të ndërtuara përpara



viteve 1990, nga të cilat do të respektohen distancat minimale të përcaktuara në pikën 2.

4. Distanca minimale për faqet pa dritare dhe pa çarje fasade të çdo lloji tjetër, të cilat ndodhen përballë njëra-tjetrës dhe për të cilat nuk sigurohet deklarata e të dyja palëve për kallkan, në kushtet e moscenimit të sigurisë së secilit objekt duhet të jetë jo më pak 2 (dy) metra, ku secila ndërtesë mbart detyrimin për respektimin e distancës jo më pak se 1 (një) metër nga kufiri i pronës.

5. Për ndërtimet gjatë rrugëve, çdo dalje konsol do të qubet faqe ndërtimi dhe duhet të respektojë distancat nga trupi i rrugës. Nuk kërkohet të respektojnë distancat e këtij neni elementet arkitektonike të fasadave, të cilat nuk përbëjnë sipërfaqe të shfrytëzueshme dhe nuk dalin nga fasada më shumë se 0.5 metër.

6. Në rastet e zonave historike dhe të mbrojtura, monument kulture, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi, respektohen distancat ekzistuese të tipologjisë arkitektonike historike në zonë.

7. Distancat e ndërtimeve për çerdhet, kopshtet, shkollat dhe objektet shëndetësore duhet të jenë në drejtimin jug, jo më pak se 1,5 herë shumën e numrit të kateve mbi tokë të ndërtimeve që përballen, plus 2m [$d = 1.5 (nr. k. obj. A + nr. k. obj. B + 2m)$] ku: d - distanca minimale midis dy ndërtimeve dhe nr. k - numri i kateve. Në drejtimet e tjera të horizontit zbatohen pikat 2 dhe 3, të këtij neni.

8. Distancat për ndërtimet industriale përcaktohen në përputhje me sigurinë e ndërtimit dhe nga aktiviteti që kryhet në to, sipas legjislacionit të posaçëm, dhe, në çdo rast, nuk duhet të jenë më të vogla se përcaktimet e pikave 2 e 3, të këtij neni.

9. Distancat për ndërtimet brenda një zone me përdorim hotelier përcaktohen sipas projektit, në përputhje me këtë rregullore, për aq sa nuk përcaktohet ndryshe në legjislacionin e posaçëm dhe atë mjedisor.

10. Pavarësisht sa përcaktohet në këtë nen, hapësirat që krijohen nga distancat duhet të jenë të tilla që për çdo ndërtim të sigurohet akses i drejtpërdrejtë nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri në të paktën 2 faqe të ndërtimit dhe midis ndërtimeve. Nënkalimet tunel të ndërtesave të gjata janë minimalisht 5 metra të gjera dhe 5 metra të larta, për të lejuar kalimin e lirshëm të ambulancës ose zjarrfikëses.

11. Në rast se faqet që përballin njëra-tjetrën propozohen kallkan, pa dritare dhe pa çarje fasade të çdo lloji tjetër, dy ndërtimet mund të vendosen bashkëngjitur në këto faqe mbi bazën e projektit për ndërtesa të bashkëngjitura dhe të marrëveshjes përkatëse ndërmjet

palëve kufitare të interesuara. Në mungesë të marrëveshjes, respektohen distancat sipas këtij neni.

12. Për objektet në kompetencë të Këshillit Kombëtar të Territorit, sipas nenit 19, të kësaj rregulloreje, distancat midis objekteve mund të përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit me rregullore të posaçme, të miratuar prej tij.”

Pikërisht pikën 12, të nenit 34, të Rregullores së Zhvillimit Urban, kërkon pala paditëse të shfuqizohet nëpërmjet padisë së paraqitur në Gjykatën Administrative të Apelit.

Në veprimet përgatitore gjykata urdhëroi në bazë të nenit 193 të ndryshuar të Kodit të Procedurës Civile thirrjen si person të tretë Ministrinë e cila ka bërë propozimet përkatëse për vendimin objekt gjykimi. Sikundër del nga përmbajtja e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408 datë 13.5.2015 dhe ai nr. 231 datë 21.3.2017, ministri propozues është ministri i Zhvillimit Urban, në kohën e zhvillimit të këtij procesi kjo ministri nuk ekziston, fusha e zbatimit të saj tanimë përfshihet në fushën e zbatimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për rrjedhojë gjykata thirri me cilësinë e personit të tretë këtë ministri.

Pala e tretë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë depozitoi në sekretarinë e Gjykatës Administrative të Apelit datë 4.3.2019 me nr. 492 prot., një kërkesë për thirrjen me cilësinë e personit të tretë të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit në bazë të nenit 192 të Kodit të Procedurës Civile.

Kjo kërkesë nuk u pranua nga gjykata, pasi kërkesa e bërë nga personi i tretë, është bërë pasi gjykata ka nxjerrë urdhrin e caktimit të seancës gjyqësore, sipas parashikimit të nenit 192 paragrafi i fundit i cili shprehet se thirrja e personit të tretë mund të kryhet derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore sipas nenit 158/c të Kodit të Procedurës Civile. Rezulton se, gjykata e ka marrë vendimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore në datë 27.2.2019, palët janë njoftuar më ditën dhe orën e seancës gjyqësore me fletëthirrjen e datës 27.2.2019, komunikuar në datë 1.3.2019, për pasojë kjo kërkesë rezulton e paraqitur jashtë kushteve dhe kritereve proceduralë. Kolegji i referohet dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, në bazë të nenit 1/2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e



mosmarrëveshjeve administrative “ i cili parashikon se dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe.

Nenit 14, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i cili parashikon:

Të drejtat dhe detyrat e palëve

Palët, përfaqësimi, të drejtat dhe detyrat e palëve dhe të përfaqësuesve, përgjegjësia e palëve për shpenzimet dhe për dëmet gjatë procesit, pjesëmarrësit e tjerë në gjykim rregullohen sipas dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Civile, për aq sa ato nuk bien ndesh me përmbajtjen e këtij ligji.

Si dhe nenit 34, i cili parashikon:

Seanca gjyqësore

1. Seanca gjyqësore zhvillohet sipas neneve të Kodit të Procedurës Civile, për aq sa ato janë të pajtueshme me këtë ligj.

Nga analiza e dispozitave të mësipërme Kolegji i Gjykatës Administrative të Apelit e shqyrton çështjen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” dhe parashikimet e Kodit të Procedurës Civile për sa kohë ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” nuk bën rregullime të posaçme, e që një nga këto raste është edhe procedimi për thirrjen e personit të tretë në gjykim.

Gjithashtu në gjykim u pranua kërkesa e palës paditëse e cila kishte hartuar një akt ekspertimi privat duke e pyetur ekspertin Shaban Alushi, me cilësinë e dëshmitarit në bazë të nenit 2 pika 10 dhe 34 pika 4 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Sipas ekspertit të palës paditëse distancat e miratuara në rregulloren e posaçme janë nën minimumin e distancave të parashikuara në rregulloren e zhvillimit urban.

Pretendimet e palëve

Pala paditëse kërkoj pranimin e padisë, shfuqizimin e pjesshëm të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, dhe konkretisht të pikës 12 të nenit 34, siç është ndryshuar nga

neni 23, i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 231 datë 21.3.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar”, me këtë përmbajtje: “Për objektet në kompetencë të Këshillit Kombëtar të Territorit, sipas nenit 19, të kësaj rregulloreje, distancat midis objekteve mund të përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit me rregullore të posaçme, të miratuara prej tij”, duke pretenduar se:

Paditësit banojnë në rrugën “Ibrahim Rugova”, pallati nr. 27/1 dhe 27. Gjithashtu, ata janë edhe bashkëpronarë të pasurive (truall) me nr. 4/195; (vol. 78, faqe 94) dhe nr. 4/541 (vol. 69, f. 155), zona kadastrale 8270.

Këshilli Kombëtar i Territorit, me vendimin nr. 11, datë 20.6.2018 ka miratuar lejen zhvillimore në favor të subjektit “Invest Society” sh.p.k., për ndërtimin e një godine 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9-katëshe në Rrugën “Ibrahim Rugova”, Tiranë. Bazuar në urdhërimin e pikës 3 dhe Kryetari i Bashkisë Tiranë, më datë 3.10.2018 ka miratuar lejen e ndërtimit nr. E-22296/7, datë 3.10.2018.

Paditësit pretendojnë se, në këtë rast në miratimin e lejes zhvillimore dhe eventualisht asaj të ndërtimit, nuk janë respektuar distancat përkatëse nga kufiri midis objekteve dhe kufiri i pronës, pasi siç rezulton nga planvendosja që shoqëron vendimin e KKT-së, objekt shqyrtimi, rezulton se në krahun jugor të godinës së re, që përballet me godinë 4-katëshe, pronë e paditësve janë parashikuar këto distanca: 10.39 m për volumen 9 kat nga struktura e objektit të paditësve, jo nga ballkoni, që është distanca më e afërt.

Sipas formulës që parashikon neni 34, pika 2, rezulton se duhej të respektohej kjo formulë:

$d = \text{nr. } k \text{ obj. } A + \text{nr. } k \text{ obj. } B + 2 \text{ m}$

Elementët e kësaj formule janë:

d – distanca minimale midis dy ndërtimeve.

nr. k – numri i kateve.

obj. A. – objekti ekzistues

obj. B. – ndërtimi i ri (me pas për çdo kat të ndërtimit të ri shtohen 2 m)

Paditësit pretendojnë se referuar kësaj formule, në rastin e lejes së zhvillimit dhe



ndërtimit nga Bashkia Tiranë kjo distancë duhej të ishte $9+4+2=15\text{m}$ nga struktura në strukturë.

Pala paditëse për të mbështetur pretendimet e saj kërkoi thirrjen me cilësinë e dëshmitarit Shaban Allushi (i cili për llogari të palës paditëse ka hartuar një akt ekspertimi). Ky ekspert në bazë të nenit 34 të ligjit nr. 49/2012 u pyet nga gjykata me cilësinë e dëshmitarit. Ky dëshmitar dëshmoi se këto distanca janë më të vogla se distanca minimale që parashikon pika 2 e nenit 34 të VKM nr. 408/2015.

Gjithashtu në projektin e miratuar distancat nga kufiri i pronës janë: *Jugu: 0.45 m nga kufiri i pronës për volumn 2 kat, 0.41m nga kufiri i pronës për volumn 6 kat, 0.46 m nga kufiri i pronës për volumn 7 kate.*

Referuar këtyre distancave si edhe shpjegimeve të dëshmitarit rezulton se këto distanca duhej të ishin $d=\text{nr. k.obj.A} + \text{nr. k.obj.B} + 2\text{m} = 4+9+2 = 15$ nga ballkoni i godinës 4-katëshe jo i strukturës së saj, që po të shtojmë dhe 1m ballkoni kjo distancë duhej të ishte 16 m. Në volumn 2 kat nga kufiri i pronës do duhej të ishte $d = \text{nr. k.} + 1\text{m} = 3$ m. Në volumn 6 kat nga kufiri i pronës do duhej të ishte $d = \text{nr. k.} + 1\text{m} = 7\text{m}$. Në volumn 7 kat nga kufiri i pronës do duhej të ishte $d = \text{nr. k.} + 1\text{m} = 8\text{m}$.

Këshilli Kombëtar i Territorit, nuk i ka respektuar distancat dhe intensitetin e ndërtimit pasi ai është mbështetur në parashikimin e pikës 12 të nenit 34 i cili është shkaktar i ndryshimit të nenit 34 në tërësinë e tij nga VKM-ja nr. 231/2017, neni 23.

Duke qenë se bazuar në këtë dispozitë Këshilli i Rregullimit të Territorit ka mënjeluar formulat e ndërtimit për llogaritjen e distancave midis dy objekteve (atij ekzistues dhe atij që do të ndërtohet) si edhe midis dhe kufirit të pronë-pronë nëse nuk përballemi me godinë-godinë, paditësit kërkojnë gjyqësish shfuqizimin e tij.

Pala paditëse pretendon se, ky nen është në kundërshtim e parashikimet ligjore të nenit 118 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenin 6/2/b, të ligjit nr. 107/2014, pasi nuk është parashikuar delegimi i të drejtës Këshillit të Ministrave tek Këshilli Kombëtar i Territorit.

Pala paditëse pretendon se në fakt në këtë rast Këshilli i Ministrave i ka lënë dorë të lirë KKT-së që të vendosë vetë, pa asnjë lloj kriteri apo standardi ndërtues që ajo duhet të ketë në

konsideratë. Për më tepër asnjë normë e ligjit nr. 107/2014, nuk i jep të drejtë KKT-së që për çdo ndërtim, të përcaktojë një rregullore të veçantë, të pabazuar në asnjë kriter tjetër ligjor.

Fakti që këto dispozita nuk i japin të drejtë KKT-së që të përcaktojë standarde zhvillimi apo ndërtimi të ndryshme nga ato që parashikon VKM-ja nr. 408/2015, përforcohet edhe nga fakti se asnjë prej këtyre dispozitave nuk është dhe nuk shërben si bazë ligjore për VKM-në nr. 408/2015 dhe VKM nr. 231/2017. Neni 6/2/b autorizon vetëm Këshillin e Ministrave dhe jo KKT-në që të nxjerrë akte nënligjore. Për rrjedhojë parashikimi që ka bërë Këshilli i Ministrave, duke ja deleguar këtë të drejtë KKT-së, bie në kundërshtim me këtë dispozitë.

Pala paditëse pretendoi se, edhe në këndvështrim të parashikimeve të K.Pr.A. në lidhje me delegimin e kompetencave, përsëri Këshilli i Ministrave është në shkelje të këtyre parimeve, referuar nenit 22 pika 3 dhe 29. Në asnjë rast kompetenca planifikuese, në rastin objekt gjykimi për të përcaktuar standardet që duhen ndjekur në ndërtimet civile, si edhe distancat midis objekteve që do të ndërtohen dhe atyre ekzistuese, është parashikuar nga ligji si një kompetencë ekskluzive e Këshillit të Ministrave dhe ky i fundit nuk mundet që t'ia delegojë KKT-së. Për rrjedhojë pika 12 e nenit 34 duhet të shfuqizohet.

Pala paditëse pretendoi se në miratimin e këtij vendimi nga ana e Këshillit të Ministrave nuk janë respektuar procedurat ligjore në lidhje me formën dhe nismën për miratimin e një Vendimi të Këshillit të Ministrave.

Siç rezulton nga materialet e nxjerrjen e këtij akti është ndërmarrë nga ministri i Zhvillimit Urban. Në versionin e parë të këtij propozimi, nuk rezulton asnjë parashikim në lidhje me këtë pikë. Pra, pika 12 e nenit 34, nuk parashikohej fillimisht në propozimin e nisur.

Një parashikim të ngjashëm (por jo të njëjtë) ka propozuar Agjencia e Zhvillimit të Territorit nëpërmjet shkresës nr. 544/1 prot., datë 13.3.2017. Pavarësisht këtij propozimi të ri, nga ana e Ministrisë së Zhvillimit Urban, rezulton se ai nuk është marrë në konsideratë. Kjo del qartë nga këto fakte:

1. Sipas përmbajtjes së projektvendimi në formën e tij përfundimtare (përpara se të



miratohej në Këshillin e Ministrave), kjo pikë nuk ekziston. Neni 34 (siç ndryshohet nga neni 23) përmban vetëm 11 pika. Pra, pika 12 nuk parashikohet (sipas dokumentacionit të përcjellë nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave me shkresën nr. 881/1 prot., datë 14.2.2019).

2. Gjithashtu, edhe në relacionin që shoqëron këtë projektvendim, nuk ka asnjë arsyetim apo gjurmë në lidhje me këtë pikë (sipas dokumentacionit të përcjellë nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave me shkresën nr. 881/1 prot., datë 14.2.2019).

3. Një tjetër moment është edhe fakti se Ministri së Drejtësisë nuk i është çuar dhe për rrjedhojë nuk ka dhënë mendim në lidhje me këtë parashikim.

Kjo mënyrë e të vepruarit bie në kundërshtim me parashikimet e neneve 24 dhe 25, të ligjit nr. 9000/2003 dhe VKM-në nr. 584/2003, e cila në pikat 22, 30 dhe 31.

Rezulton se jemi përpara një detyrimi të qartë, për të kërkuar mendimin e Ministrit të Drejtësisë, mendim i cili në këtë rast nuk është marrë dhe ky i fundit nuk ka pasur mundësinë të shprehet, sidomos në lidhje me ligjshmërinë e tij. Kjo përbën cenim të procedurës ligjore që duhet ndjekur në mënyrë të detyrueshme dhe që passjellë kundërshtinë e pikës 12, të nenit 34 me legjislacionin në fuqi.

Pala paditëse pretendoi se, në lidhje me pikën 12 të nenit 34, rezulton se relacioni nuk ka asnjë shpjegim apo argumentim. Pra, nuk kemi asnjë argument në lidhje me nevojën e këtij parashikimi si edhe nuk kemi asnjë vlerësim paraprak të ligjshmërisë së tij, parashikim ky i detyrueshëm.

Shpjegimet që jep personi i tretë, dhe që janë marrë nga relacioni përkatës, kanë të bëjnë me ndryshimet e tjera të parashikuara të realizoheshin në bazë të projektvendimit fillestar. Por këto argumente nuk vlejnë për parashikimin e pikës 12 të nenit 34, përderisa, kjo normë nuk ka qenë pjesë e draftit fillestar apo final që iu nënshtrua për shqyrtim Këshillit të Ministrave. Për rrjedhojë argumentet e përmendura në relacion dhe në materialin e personit të tretë, nuk kanë lidhje me çështjen objekt gjykimi.

Pala paditëse pretendon se për këtë pikë, mungon çdo lloj argumentimi dhe vlerësimi

rezulton se ky akt administrativ (akt nënligjor normativ), nuk është i arsyetuar, kërkesë kjo e domosdoshme e nenit 99 të Kodit të Procedurave Administrative, për rrjedhojë mungesa e arsytimit të aktit e bën aktin të kundërligjshëm.

Pala paditëse pretendoi se, në miratimin e këtij vendimi nga ana e Këshillit të Ministrave nuk është respektuar parimi i transparencës.

VKM-ja nr. 408/2015, neni 34, pika 12, duke i dhënë të drejtë KKT-së që të vendosë vetë në lidhje me distancat midis objekteve, ka cenuar parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative në lidhje me parimin e transparencës. Kodi i Procedurave Administrative, duke qenë se është miratuar më një shumicë të cilësuar, në bazë të parashikimit të nenit 81, pika 2, germa “d” e Kushtetutës, prevalon ndaj akteve të tjera, përfshirë dhe ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar. Kjo prevalencë del qartë nga vendimi nr. 2, datë 3.2.2010 i Gjykatës Kushtetuese.

Në zbatim të drejtë të konkluzioneve kushtetuese të mësipërme, rezulton se Kodi i Procedurave Administrative, prevalon ndaj ligjit nr. 107/2014 dhe ndaj VKM-së nr. 408/2015, pasi është një akt me fuqi më të lartë juridike. Në këtë kuptim, nuk mund të pretendohet se ligji nr. 107/2014 mund të zbatohet si ligj i posaçëm, pasi ai nuk mund të prevalojë ndaj një ligji me shumicë të cilësuar dhe aq më pak ndaj VKM-së nr. 408/2015 që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tij.

Për sa i përket parimit të transparencës rezulton se neni 5 i Kodit të Procedurave Administrative parashikon se: *Organet publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në të.*

Formulimi i mësipërm dukshëm tregon dy elementë që duhet të ndiqen nga administrata, ku e para është ushtrimi i veprimtarisë në mënyrë transparente dhe e dyta është realizimi i kësaj veprimtarie në bashkëpunim me personat e përfshirë.

Pala paditëse pretendon se, këto dy parashikime nuk plotësohen në rastin e pikës 12, të nenit 34 të VKM-së nr. 408/2015. Pala paditëse pretendon se ajo si palë e prekur nga vendimarrja e KKT-së nuk ka pasur dijeni për



aplikimin e subjekteve investuese dhe ndërtuese. Ata ranë në dijeni vetëm disa muaj mbasi vendimi tashmë ishte marrë. Pra, KKT-ja, bazuar në mënyrën si është formuluar pika 12 e nenit 34 nuk vepron me transparencë dhe nuk e bën të ditur faktin e aplikimit e cila do të kërkojë aplikimin e standardeve të tjera të ndërtimit në raport me ato të miratuara tashmë.

Paditësit pretendojnë se në kundërshtim me parashikimet e neneve 45, 87 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, megjithëse janë palë e interesuar, nuk njoftohen që të japim mendimin e tyre në lidhje me këtë procedurë dhe në lidhje me distancat e reja që kërkohen të aplikohen për shkak të projektit të paraqitur. Pra, në këtë rast, megjithëse ata preken nga vendimmarrja e KKT-së nuk bëhen palë e procedurës. Në këtë rast cenohet edhe elementi i dytë i këtij parimi.

Pala paditëse pretendoi se, në miratimin e këtij vendimi nga ana e Këshillit të Ministrave nuk janë respektuar kërkesat për ushtrimin e ligjshëm të diskrecionit.

VKM-ja nr. 408/2015, neni 34, pika 12, duke i dhënë të drejtë KKT-së që të vendosë vetë në lidhje me distancat midis objekteve, ka cenuar parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative në lidhje me ushtrimin e ligjshëm të diskrecionit.

Nisur nga mënyra se si është formuluar neni 34, pika 12 e VKM-së nr. 408/2015, rezulton qartë se në këtë rast Këshilli i Ministrave i ka dhënë të drejtë KKT-së që të vendosë me diskrecion në lidhje me distancat midis objekteve në rast se leja jepet nga ky institucion. Por dhënia e këtij diskrecioni nuk është bërë në përputhje me parashikimet e neneve 2,3 të Kodit të Procedurave Administrative, pasi në rastin konkret, nga ligji nr. 107/2014 nuk kemi asnjë modalitet për ushtrimin e këtij diskrecioni. Arsyeja e këtij mosparashikimi ligjor është sepse, normalisht në këndvështrimin e ligjvënësit, KKT-ja si çdo organ tjetër në fushën e planifikimit të territorit duhet të ndjekë rregullat që ka parashikuar Këshilli i Ministrave në kuptim të nenit 6, pika 2, germa “b” e ligjit.

Por, Këshilli i Ministrave nëpërmjet VKM-së nr. 408/2015 nuk ka bërë asnjë parashikim, asnjë modalitet, asnjë kufi maksimal, apo minimal për

ushtrimin e diskrecionit nga KKT-ja. Pra, në këtë rast, KKT-ja kur ushtron kompetencat e saj e bën atë në mënyrë të pakontrollueshme. Kjo situatë është e kuptueshme që lë vend për abuzim.

Kështu siç e argumentuam më sipër ligji nr. 107/2014, në asnjë rast nuk i jep Këshillit të Ministrave të drejtën që të përcaktojë organe të tjera për të vendosur standarde në fushën e planifikimit, zhvillimit dhe të ndërtimit. Gjithashtu po ligji nr. 107/2014, në asnjë rast nuk parashikon të drejtën e KKT-së që të vendosë me diskrecion në lidhje me distancat urbane dhe intensitetin e ndërtimit. Pra, në këtë rast jemi në shkelje të nenit 11, germa “a” e Kodit të Procedurave Administrative.

Nga ana tjetër, parashikimi që ka pika 12 e nenit 34 të VKM-së nr. 408/2015 tejkalon kufijtë e ligjit. VKM-ja në këtë rast i ka dhënë KKT-së një pushtet të pakufizuar, e cila pa u kufizuar nga asnjë normë ka të drejtë që të përcaktojë vetë distancat midis objekteve (atij që do të ndërtohet dhe atij ekzistues), pa pasur asnjë standard në lidhje me këtë vendimmarrje. Pra, KKT-ja ka të drejtë që të vendosë vetë që të mos zbatojë rregullat dhe formulat që parashikon neni 34 i VKM-së nr. 408/2015 për distancat urbane dhe se cilat distanca do të përcaktojë, i vendosë po vetë, pa pasur asnjë kriter ligjor se ku do të bazohet. Pra, në këtë rast kjo kompetencë është në tejkalim të kufijve ligjorë, për rrjedhojë cenon nenin 11, germa “b”, të Kodit të Procedurave Administrative.

Pala paditëse pretendon se, në rastin konkret diskrecioni i dhënë sipas pikës 12, të nenit 34, është në kundërshtim me standardet e Këshillit të Evropës, Rekomandimin R (80) 2, më datë 11.3.1980, e titulluar “Lidhur me ushtrimin e kompetencave diskrecionale nga organet e autoritetet administrative, si dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si edhe në jurisprudencën e krahësuar.

Paditësit pretendojnë se, në miratimin e këtij vendimi nga ana e Këshillit të Ministrave është cenuar e drejta e tyre e pronësisë.

KKT-ja ka miratuar një leje zhvillimore e cila, nuk respekton distancat dhe intensitetin e ndërtimit. Kjo ka sjellë si pasojë miratimin e një ndërtimi masiv, e cila nuk respekton distancat, cenon pronën tonë si edhe cenon cilësinë e



jetesës së paditësve, veprime këto përbëjnë shkelje të nenit 41 të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së, neni 1 i Protokollit 1, si edhe të Kodit Civil, nenet 149 dhe 276.

Duke e ballafaquar parashikimin e Kodit Civil me pikën 12 të nenit 34 të VKM nr. 408/2015, rezulton se në këto raste nuk ka asnjë rregull të përcaktuar në lidhje me largësitë, por edhe me elementë të tjera të ndërtimeve.

Pala paditëse pretendon se ligji nr. 107/2014, nuk i jep në asnjë të drejtë KKT-së që të vendosë dhënie lejesh pa respektuar asnjë kriter apo standard në lidhje me distancat urbane apo intensitetin e ndërtimit. Për më tepër rezulton se në këtë rast, për cenimin e të drejtave të paditësve është përzgjedhur një akt, që për nga natyra e tij vlen vetëm për organizimin e brendshëm të institucioneve. Kështu pika 12 e nenit 34, përdor termin “rregullore”. Sipas Kushtetutës, neni 119 rezulton se: *1. Rregulloret e Këshillit të Ministrave, të ministrave e të institucioneve të tjera qendrore, si dhe urdhrat e Kryeministrit, të ministrave e të drejtuesve të institucioneve qendrore kanë karakter të brendshëm dhe janë të detyrueshme vetëm për njësitë administrative që varen prej tyre. 2. Këto akte nxirren në bazë të ligjit dhe nuk mund të shërbejnë si bazë për të marrë vendime në lidhje me individët dhe subjektet e tjera.*

Përkufizimi kushtetues në këtë rast, nuk lë vend për interpretime të tjera. Kjo rregullore e KKT-së mund të vlejë vetëm për KKT-në dhe nuk mund të shërbejë si bazë për të marrë vendime kundrejt paditësve.

Për pasojë mungesa e bazës ligjore që i jep këtë të drejtë KKT-së, për të mosrespektuar asnjë kriter apo standard në lidhje me distancat urbane dhe intensitetin e ndërtimit, përbën cenim të nenit 41 të Kushtetutës (e drejta e pronës), e lidhur kjo me nenin 17 të Kushtetutës.

Paditësit pretendojnë se parashikimi nënligjor, objekt gjykimi cenon dhe parimin e shtetit të së drejtës të përcaktuar në nenin 4, pika 1 e Kushtetutës.

Gjithashtu, edhe sipas GJEDNJ, duhet reflektimi i garancive të shtetit të së drejtës që përmbahet edhe në preambulën e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duhet të ketë një masë mbrojtjeje ligjore kundër ndërhyrjeve arbitrare ndaj të drejtave.

Qartazi në rastin e kësaj çështje mungojnë *kufijtë e veprimtarisë* së KKT-së e cila si organ shtetëror nuk është e lidhur me asnjë kriter apo standard për përcaktimin e distancave dhe të intensitetit të ndërtimit.

Pala paditëse pretendon se mosparashikimi i kufijve të veprimtarisë së KKT-së qartazi krijon mundësi për abuzivizëm. Nga ana tjetër duke mos pasur asnjë kriter apo standard për ta përcaktuar apo krahasuar mënyrën se si ka vepruar KKT-ja atëherë paditësit janë totalisht të pambrojtur nga abuzivizmi. Pala paditëse pretendon se norma nuk është e parashikueshme. Kështu nëse do të respektohej normat mbi distancat që parashikon neni 34, në pikën 2 të tij atëherë paditësit e kanë të qartë se nëse do të lejohet një ndërtim në atë zonë cila do të ishte largësia e saj nga godina ku ata banojnë. Përkundrazi, në rastin e lejes së dhënë nga KKT-ja është e paqartë se cila do të jetë kjo distancë.

Pala paditëse pretendon se në miratimin e këtij vendimi nga ana e Këshillit të Ministrave është cenuar parimi i sigurisë juridike.

Kështu është e paqartë se përse KKT-ja duhet të ketë një trajtim të ndryshëm dhe nuk duhet të jetë e lidhur me kriteret dhe standardet që përcaktojnë nenet 34 dhe 35 të VKM-së nr. 408/2015.

Gjithashtu pika 12 e nenit 34 nuk parashikon asnjë raport të caktuar sjelljeje. Pra nuk përcaktohet në asnjë moment se përse KKT-ja ka të drejtë që të shmangë distancat dhe intensitetin e ndërtimit që janë në fuqi për Bashkitë dhe të aplikojë distanca dhe intensitet ndryshimi tjetër pa asnjë kriter apo standard.

Pika 12 e nenit 34, gjithashtu nuk parashikon asnjë mënyrë veprimi të KKT-së. Pra këtu nuk parashikohet kur ajo mund të përcaktojë distanca të tjera, si edhe si i përcakton këto distanca dhe intensitet ndërtimi.

Pala paditëse pretendon se, në miratimin e këtij vendimi nga ana e Këshillit të Ministrave është cenuar parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit.

Është e paqartë dhe e paargumentuar ligjërisht se përse KKT-ja ka të drejtë që të japë leje zhvillimore me distanca dhe intensitet ndërtimi të ndryshme nga ndërtimet që bëhen me leje të njëjësive vendore. Pra, në këtë rast kemi cenim të parimit të barazisë dhe të mosdiskriminimit.



Kështu në të gjithë Shqipërinë, kur lejet jepen nga Kryetari i Bashkisë, respektohen distancat si edhe intensiteti i ndërtimit, parashikuar nga nenet 34 dhe 35 të VKM-së nr. 408/2015. Në rastin e KKT-së këto distanca dhe intensiteti i ndërtimit nuk merren në konsideratë.

Në materialet në dispozicion nuk rezulton asnjë arsye ligjore se përse lejet zhvillimore, në fushën e ndërtimeve civile, që jep KKT-ja duhet të trajtohen ndryshe nga ndërtimet e tjera, lejet ndërtimore të cilave jepen nga Kryetari i Bashkisë. Domethënë nuk kemi asnjë shkak të përligjur se përse në këtë rast distancat midis pronave dhe objekteve duhet të jene të ndryshme nga formulat e parashikuara nga nenet 34 dhe 35 të VKM-së nr. 408/2015, si edhe intensiteti i ndërtimit duhet të jetë i ndryshëm nga parashikimi i nenit 51 të Rregullores së planit urbanistik vendor të Bashkisë Tiranë (në rastin tonë nga 1.5 është bërë 5.08).

Avokatura e Shtetit kërkoi rrëzimin e padisë si të pambështetur në prova e në ligj duke prapësuar se:

Në aspektin procedural:

Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiale*, nisur nga objekti i kërimit, pretendimi i paditësve është ngritur në nivel kushtetues dhe për këtë arsye pretendimet e tyre bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Paditësit ngrenë pretendime në lidhje me antikushtetueshmërinë e normave objekt gjykimi.

Avokatura e Shtetit prapëson se në bazë të nenit 113, të K.Pr.Administrative edhe po të shfuqizohet pika 12 e nenit 34 e VKM-së nr. 231, kjo do sillte pasoja për të ardhmen dhe në këtë rast paditësi nuk do përfitonte të rivendoste të drejtat e tij me anë të këtij vendimi gjyqësor (të shfuqizonte lejen zhvillimore dhe atë të ndërtimit), çka do të thotë se i mungon interesi i ligjshëm për ngritjen e kësaj kërkesë padie. Leja zhvillimore dhe ajo e ndërtimit në momentin që janë dhënë, kanë qenë të ligjshme dhe të bazuara pikërisht në pikën 12 të nenit 34 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e ndryshuar, të miratuar me VKM. Kjo pikë i ka dhënë pasojat juridike dhe paditësi me anë të kësaj padie nuk mund t'i ndryshojë këto pasoja.

Në aspektin material Avokatura e Shtetit prapësoi se:

VKM-ja është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 107/2014 “Për planifikim e territorit”, si dhe ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”. Përmbajtja e tij është në harmoni me ligjin nr. 107/2014 dhe legjislacionin sektorial që rregullon veprimtarinë e autoriteteve që duhet të shprehen mbi kërkesën për leje ndërtimi. Procesi i shqyrtimit të kërkesave për leje ndërtimi sjell ndërveprimin e legjislacionit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit me legjislacionin në fuqi, si dhe kjo VKM është në harmoni të plotë me të gjithë legjislacionin ndërveprues në fuqi.

Qëllimi i miratimit të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, është përmirësimi i disa aspekteve që lidhen me procesin e shqyrtimit të kërkesave për leje ndërtimi dhe certifikatë përdorimi nga autoritetet e zhvillimit të territorit, si dhe rishikimin e rregullave minimale bazë për distancat ndërmjet ndërtimeve. Ndryshimet në këtë rregullore kanë ardhur si rezultat i praktikave të deritanishme të zbatimit të saj nga ana e përdoruesve, autoriteteve vendore dhe qendrore, si dhe në kërkesat dhe propozimet për ndryshime ligjore të dërguara prej tyre. Miratimi i këtyre ndryshimeve ka synuar të qartësojë disa çështje për të cilat janë hasur vështirësi zbatimi dhe mënyra të ndryshme interpretimi nga bashkitë (kërkesat dhe përmbajtja e lejes së zhvillimit, titulli i pronësisë në rast punimesh me deklaratë paraprake, deklarata e zbatuesit për certifikatë përdorimi etj.), si dhe thjeshton në përgjithësi, procedurat për shqyrtimin e kërkesave për leje në fushën e ndërtimit nga ana e bashkive. Vënia në funksionim i këtij portali është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave dhe i shërben zbatimit të detyrimeve të parashikuara në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

VKM-ja nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, rregullon ndër të tjera procedurat, afatet dhe kërkesat ligjore për pajisjen e aplikuesve me leje në fushën e ndërtimit (leje zhvillimi, leje ndërtimi, certifikatë përdorimi), si dhe përcakton rregullat bazë për distancat që duhen respektuar ndërmjet objekteve dhe objekteve të ndërtimit dhe kufijve të pronës apo



trupit të rrugës. Prej muajit shtator 2016, me qëllim lehtësimin dhe përsheptimin e procedurave të aplikimit dhe shqyrtimit për leje, të gjithë procedurat për shqyrtimin e lejeve në fushën e ndërtimit kanë filluar të kryhen në mënyrë të detyrueshme përmes sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit, të aksesueshëm në portalin *e-Albania*. Sistemi elektronik ka bërë të mundur realizimin konkret të parimit *One-Stop-Shop* për lejet e ndërtimit, duke eliminuar ndalesat e aplikuesve në zyrat e administratës publike dhe duke i mundësuar bashkisë të veprojë si sportel i vetëm shërbimi, si pasojë e bashkërendimit në sistem të saj me institucionet publike që duhet të japin të dhëna apo mendim lidhur me kërkesën për leje ndërtimi.

Nga momenti i hyrjes në fuqi të procedurës elektronike të aplikimit, pranimit dhe shqyrtimit të kërkesave për leje ndërtimi, Ministria e linjës në bashkëpunim me bashkitë, ka evidentuar si të nevojshme disa përmirësime të VKM-së nr. 408/2015, si vijon:

- *Rishikimi i distancave minimale të parashikuara nga VKM-ja nr. 408, nisur nga propozimet e marra nga grupet e interesit, bashkitë, shoqata e ndërtuesve. Distancat aktuale e vështirësojnë zhvillimin në zona urbane, pjesërisht të ndërtuara të qyteteve. Kjo komplikohet edhe nga fakti se zhvillimet e reja i bie jo vetëm barra e mbajtjes së distancave më të mëdha nga kufiri i tyre i pronës, por edhe barra e distancës së ndërtimit fqinj (që në shumë raste, ka ndërtuar pa leje, ose me kushte të ndryshme ligjore nga ato të sotmet). Për këtë arsye, parashikohen rregullime specifike që marrin në konsideratë situatën aktuale urbane në vend dhe synojnë të garantojnë të drejtat për zhvillim të të gjithë pronarëve, përfshirë në rastin e objekteve kufitare që kanë ndërtuar ose kërkojnë të ndërtojnë kallkan.*

Përfundimisht, ndryshimet në VKM nr. 408, ndikojnë në përmirësimin e bashkëveprimin e autoriteteve vendore të zhvillimit të territorit me aplikuesit për leje ndërtimi, si dhe mundëson rregulla të zhvillimit të territorit që harmonizohen me dokumentet e planifikimit në nivel vendor dhe që garantojnë një zhvillim dhe menaxhim të qëndrueshëm të territorit.

VKM-ja nr. 231, datë 21.3.2017 ka dalë sipas procedurës së parashikuar nga ligji nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për funksionimin dhe organizimin e Këshillit të Ministrave”, si dhe vendimit nr. 584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit

të Ministrave”. Sipas nenit 24 të këtij ligji, me anë të shkresës nr. 1386, datë 3.3.2017, MZHU-ja i është drejtuar për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë për Marrëdhëniet me Parlamentin, dhe Ministrisë së Shtetit për çështjet vendore, me anë të së cilës i ka kërkuar mendim për këtë projekt vendim. Ministria e Çështjeve Vendore dhe Ministria për Marrëdhëniet me Parlamentin janë shprehur parimisht dakord dhe pa vërejtje. Ndërsa nga ana e Ministrisë së Drejtësisë kanë ardhur disa komente të cilat janë reflektuar dhe bashkërenduar me ish-Ministrinë e Zhvillimit Urban.

Po kështu me anë të shkresës nr. 1386/1 prot., datë 6.3.2017, MZHU-ja ka kërkuar mendim për këtë projekt vendim Bashkisë Tiranë, Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (Sekretariati i AZHT-së), si institucione të interesuara dhe që preken nga ky projekt vendim. Të dyja këto institucione kanë propozuar komentet dhe sugjerimet përkatëse, të cilat janë marrë në konsideratë nga Ministria e Zhvillimit Urban.

Pikërisht pika 12, e nenit 34, të VKM-së nr. 231 është propozuar nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit. Në rastin konkret sipas VKM-së nr. 725, datë 2.9.2015, “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, Agjencia kryen funksionet e sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit. Ky propozim pasi është shqyrtuar nga MZHU-ja dhe është dhënë dakordësia dhe nga organet e tjera ku është çuar për mendim, i është çuar për propozim Këshillit të Ministrave, i cili me vendimin nr. 231, datë 21.3.2017 ka miratuar këtë projekt vendim.

Pala paditëse nuk e provon se VKM-ja nr. 408/2015, e ndryshuar, ka dalë në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore të dalë në zbatim të tyre.

Në lidhje me themelin e çështjes:

Normat, objekt shqyrtimi, bëjnë pjesë në kategorinë e normave nënligjore, për të cilat parimisht dhe efektivisht duhet t’i referohen Gjykatës Kushtetuese për të vlerësuar papajtueshmërinë e tyre me Kushtetutën, ligjin themeltar të shtetit shqiptar, që kryeson hierarkinë e normave ligjore.



Si VKM-ja bazë, ajo me nr. 408/2015 edhe VKM-ja që ka bërë ndryshime, ajo me nr. 231/2017 përcaktojnë si bazë ligjore të tyre shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 107/2014 datë 31.7.2014 “Për planifikimin e territorit”. Avokatura e Shtetit prapëson se në procedurën e miratimit të kësaj VKM-je, është zbatuar saktësisht ligji pasi a) organi kompetent i caktuar nga ligji është Këshilli i Ministrave dhe b) sikurse e ka përcaktuar ligji, çështjet që ka rregulluar Këshilli i Ministrave me anë të kësaj VKM-je kanë të bëjnë pikërisht me planifikimin, zhvillimin dhe ndërtimin, si dhe të dokumenteve të tjera.

Nuk rezulton në asnjë përcaktim ligjor apo nënligjor delegimi i kompetencave të veta tek një organ tjetër siç është KKT-ja sikurse pretenduan paditësit. KKT-ja nga ana e vet ka sikurse e parashikon ligji nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (ndryshuar me ligjin nr. 73/2015, datë 9.7.2015, nr. 28/2017, datë 23.3.2017), në nenin 7 “Përgjegjësitë e Këshillit Kombëtar të Territorit” (shtuar paragrafi i dytë, me ligjin nr. 73/2015, datë 9.7.2015)

1. Këshilli Kombëtar i Territorit ka këto kompetenca:

a) përcakton rëndësinë kombëtare të një çështjeje, zone ose objekti në planifikimin e territorit, dhe miraton planet e detajuara për zona të rëndësishme kombëtare, kur parashikohen të tilla nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit (PPKT).

Neni 28 - Përgjegjësitë e KKT-së, përcakton se:

1. KKT-ja është autoriteti përgjegjës për vendimmarrjen për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi për llojet e zhvillimit komplekse, të përcaktuara në rregulloren e zhvillimit dhe ato që lidhen me çështje, zona, objekte të rëndësishme kombëtare apo me investime strategjike për interesat e vendit.

Nga përcaktimet e mësipërme, normon edhe te drejtat e përcaktuara në pikën 12, të nenit 34 të VKM-së, e cila parashikon se “Për objektet në kompetencë të KKT-së sipas nenit 19 të kësaj rregulloreje, distancat midis objekteve mund të përcaktohen nga KKT-ja me rregullore të posaçme, të miratuara prej tij”. KKT-ja është organi që sipas ligjit përcakton rëndësinë kombëtare të një çështje, zone ose objekti në planifikimin e territorit, ajo miraton planet e detajuara për zona të rëndësishme kombëtare, kur parashikohen të tilla nga plani i përgjithshëm

kombëtar i territorit. Gjithashtu KKT-ja është autoritet përgjegjës për vendimmarrjen e tij për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi për llojet komplekse, të përcaktuara në rregulloren e zhvillimit dhe ato që lidhen me çështje, zona, objekte të rëndësishme kombëtare apo investime strategjike për interesat e vendit. Pra, nuk kemi asnjë delegim kompetencash, por një te drejte që buron direkt nga ligji i posaçëm. Pika 12 e nenit 23 të VKM-së, është dhe vjen për zbatim në harmoni me të gjitha pikat e tjera të parashikuara në nenin 34 të kësaj VKM-je.

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 180, datë 13.4.2000, dhe urdhri nr. 122, datë 5.3.2007 i Ministrit të Turizmit, Rinisë dhe Sporteve “Për Shpalljen Monument Kulture të Kategorisë së Dytë të Ndërtesave në Aksin Kryesor të Qendrës Historike të Qytetit të Tiranës”.

Sipas kësaj VKM-je dhe sipas hartës bashkëlidhur kësaj VKM-je, rezulton se prona objekt shqyrtimi gjyqësor, ku përfshihet gjurma e projektit, përfshihet në zonën e mbrojtur të qendrës historike të Tiranës dhe në këto kushte zona objekt shqyrtimi gjyqësor për leje zhvillimore, godinë komplekse polifunksionale, është në kompetencë të KKT-së.

Miratimi i kësaj norme nga ana e Këshillit të Ministrave është bërë duke respektuar parimin e proporcionalitetit, midis interesave të publikut dhe respektimit të lirive e të drejtave të individit.

Sa më sipër prapëson avokatura e shtetit, është i pabazuar pretendimi i paditësve se iu është cenuar e drejta e pronësisë. E drejta e pronës private është e garantuar nga Kushtetuta. Ligji mund të parashikojë kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë ose vetëm kundrejt një shpërblimi të drejtë nëse këto kufizime barazohen me shpronësimin (neni 41 i Kushtetutës). Sipas nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Nuk u provua gjatë gjykimit se paditësve iu është cenuar e drejta e gëzimit të pronës së tyre duke cenuar parimet e mësipërme.

Paditësi kërkon shfuqizimin e pikës 12, të nenit 34, pasi ai pretendon se sipas këtij



parashikimi, Këshilli i Ministrave, i ka lënë dorë të lirë KKT-së të vendosë pa asnjë lloj kriteri apo standardi ndërtues në dhënien e lejeve zhvillimore. Ky pretendim nuk është i vërtetë, pasi në asnjë vend të kësaj pike nuk parashikohet që KKT-ja në dhënien e lejeve zhvillimore të shkelë të drejtat e pronarëve dhe rregullat e kushteve urbane në hartimin e rregulloreve të posaçme. Sekretariati i KKT-së, shqyrton kërkesën për leje zhvillimi, duke bashkërenduar punën nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, me të gjitha autoritetet publike të specializuara. Dhe vetëm pas këtij bashkërendimi, Sekretariati (AZHT), ia përcjell gjithë dokumentacionin përkatës KKT-së.

Avokatura e shtetit prapëson se përfundimet në të cilat arriti eksperti, i pyetur me cilësinë e dëshmitarit, se në rastin e dhënies së lejes së zhvillimit, dhënë nga KKT dhe të lejes së ndërtimit dhënë nga Bashkia Tiranë, janë shkelur distancat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 34, dhe nenit 35 të VKM-së nr. 408/2015, nga 15 m që parashikon kjo VKM në rreth 11 m, që rezulton në dhënien e lejes zhvillimore, nuk duhet të merren në konsideratë nga Gjykata Administrative e Apelit, pasi nuk kanë lidhje me aktin administrativ (pika 12 e nenit 34 të VKM-së nr. 231/2017), objekt shqyrtimi gjyqësor. Objekt shqyrtimi gjyqësor nuk janë as pika 2 e nenit 34 dhe as neni 35 që citon eksperti. Objekt shqyrtimi gjyqësor është pika 12 e nenit 34, e cila parashikon se në raste përjashtimore, për objekte në kompetencë të KKT-së, distancat e objekteve mund të përcaktohen nga KKT-ja me rregullore të posaçme. Pra, kur lejet zhvillimore jepen nga KKT-ja, nuk zbatohen rregullat e përgjithshme, që parashikohen në pikën 2 të nenit 34. Dëshmitari i sqaroi gjykatës se në rastin konkret pika më e afërt e godinës së re me objektin pronë e paditësve do ishte rreth 11m. Kjo largësi kurrësi nuk cenon të drejtën e pronësisë dhe as të privatësisë së paditësve.

Në pjesën e tjetër të kërtimeve, pretendohet nga paditësit se VKM-ja nr. 408/2015, e ndryshuar, cenojnë ndër të tjera sigurinë juridike dhe proporcionalitetin.

Avokatura e shtetit prapësoi se paditësit nuk paraqitën asnjë argument kushtetues apo fakt se ku është cenuar parimi i sigurisë juridike dhe i proporcionalitetit, me ndryshimet e vendimit të

Këshillit të Ministrave. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar se parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, është një nga parimet themelore në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Aspekte të këtij parimi janë edhe siguria juridike, mbrojtja e të drejtave të fituara, si dhe pritshmëritë e ligjshme. Siguria juridike presupozon, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme (*shih vendimin nr. 31, datë 18.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës. Parimi i shtetit të së drejtës ku mbështetet një shtet demokratik nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike. Parimi i sigurisë juridike përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik (*shih vendimet nr. 15, datë 10.3.2016 dhe nr. 25, datë 28.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

Për të zbatuar drejt këtë parim kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të, dhe, nga ana tjetër, të mos qëndrojnë statik nëse duhet t'i japë formë një koncepti, siç është ai i drejtësisë në një shoqëri që ndryshon me shpejtësi (*shih vendimin nr. 36, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në një nga gjykimet e Dhomës së Madhe, ka nënvizuar se: “Kërkesat për siguri juridike dhe mbrojtje të besimit legjitim të qytetarëve nuk sanksionojnë një të drejtë të fituar njëherë e përgjithmonë me një jurisprudencë të qëndrueshme (Unédic kundër Francës, nr. 20153/04, § 74, 18 dhjetor 2008). Në fakt, zhvillimi i jurisprudencës nuk është në vetvete kundër një administrimi të mirë të drejtësisë për sa kohë mungesa e një qasjeje dinamike dhe



evolutive do të pengonte çdo ndryshim ose përmirësim (Atanasovski kundër ish-Republikës jugosllave të Maqedonisë”, nr. 36815/03, § 38, 14 janar 2010)

Personi i tretë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë kërkoi rrëzimin e padisë si të pambështetur në prova e në ligj duke prapësuar se:

Projektvendimi i propozuar është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 107/2014, si dhe ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”. Përmbajtja e tij është në harmoni me ligjin nr. 107/2014 dhe legjislacionin sektorial që rregullon veprimtarinë e autoriteteve që duhet të shprehen mbi kërkesën për një leje ndërtimi. Procesi i shqyrtimit të kërkesave për leje ndërtimi sjell ndërveprimin e legjislacionit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu ky projektvendim është në harmoni të plotë me të gjithë legjislacionin ndërveprues në fuqi.

Pala e tretë prapëson në lidhje me legjitimitimin e paditësit në këtë gjykim, se paditësi vërtet pretendon se legjitimohet si subjekt që cenohet në mënyrë indirekte nga parashikimet e pikës 12, të nenit 34, të VKM-së objekt shqyrtimi gjyqësor, por me këtë padi ai nuk mund të realizojë qëllimin për të cilin i është drejtuar kësaj gjykate (shfuqizimin e lejes zhvillimore dhe të lejes së ndërtimit).

Paditësi kërkon shfuqizimin e pikës 12 të nenit 34 të VKM nr. 231, datë 21.3.2017. Por, nga sa rezultoi e provuar gjatë këtij gjykimi, në zbatim të këtij parashikimi, nga ana e KKT është nxjerrë Leja Zhvillimore miratuar me vendimin nr. 11, datë 20.6.2018 “Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin “Godinë polifunksionale West Residencë 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 kate, me vendndodhje në rrugën Ibrahim Rugova, Bashkia Tiranë”. Pas kësaj Bashkia Tiranë me anë të vendimit nr. E-22296/7, ka miratuar lejen e ndërtimit për këtë objekt.

Janë pikërisht këto dy akte që paditësi pretendon se e kanë cënuar atë në gëzimin e pronës së tij, për shkak të mosrespektimit të distancave ndërtimore të parashikuara nga VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e ndryshuar, neni 34 dhe 35 i tij. Të dyja këto akte administrative paditësi i ka

bërë objekt shqyrtimi gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe ky gjykim vijon ende.

Sipas nenit 113 të K.Pr.Administrative del plotësisht e qartë se edhe po të shfuqizohet pika 12 e nenit 34 të VKM-së nr. 231, kjo do sillte pasoja për të ardhmen dhe në këtë rast paditësi nuk do përfitonte të rivendoste të drejtat e tij me anë të këtij vendimi gjyqësor (të shfuqizonte lejen zhvillimore dhe atë të ndërtimit), çka do të thotë se i mungon interesi i ligjshëm për ngritjen e kësaj kërkesë padie. Leja zhvillimore dhe ajo e ndërtimit në momentin që janë dhënë, kanë qenë të ligjshme dhe të bazuara pikërisht në pikën 12 të nenit 34 të VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e ndryshuar, të miratuar me VKM.Kjo pikë i ka dhënë pasojat juridike dhe paditësi me anë të kësaj padie nuk mund ti ndryshojë këto pasoja.

Në rast se do pranohej ky shfuqizim dhe në rast se shfuqizimi i kësaj pike do i shtrinte efektet në lejen zhvillimore dhe lejen e ndërtimit, që prekin interesat e paditëseve, atëherë kjo do bënte precedent dhe të njëjtin fat do ndiqnin të gjitha lejet zhvillimore që KKT-ja ka dhënë në zbatim të këtij parashikimi, duke cenuar interesat e shumë shoqërive që tashmë mund të kenë filluar punimet dhe të kenë hedhur shumën e mëdha investimesh në këto objekte. Një gjë e tillë do i legjitimonte ata në kërkimin e dëmshpërblimit ndaj shtetit duke sjellë një faturë të lartë në buxhetin e shtetit.

Pala e tretë prapësoi se nisur nga objekti i padisë dhe përmbajtja e saj, pretendimet e paditëseve janë ngritur në nivel kushtetues dhe për këtë arsye pretendimet e tyre bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Paditësit ngrenë pretendime në lidhje me antikushtetueshmërinë e normave objekt gjykimi.

Në nenin 124/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, parashikohet se: “Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës”.

Në nenin 131/1/c të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, parashikohet se: “Gjykata Kushtetuese vendos për: (c) pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare”.



Paditësit pretendojnë se nëpërmjet akteve normative, objekt gjykimi, iu është cenuar e drejta e pronës, e cila gëzon mbrojtje kushtetuese, por edhe në KEDNJ-së dhe të Protokollit nr. 1 të saj, marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara me ligj dhe që janë pjesë e sistemit të brendshëm juridik të Republikës së Shqipërisë dhe pothuajse i gjithë arsyetimi i kërkesë padisë, pavarësisht dhe bazës ligjore të saj është i mbështetur dhe argumentuar referuar dhe cituar Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kufizimi i të drejtës së pronës, të sanksionuar me Kushtetutë mund të vendoset vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

Duke e vlerësuar padinë në tërësinë e saj, si dhe referuar praktikës gjyqësore të unifikuar me vendimin nr. 3, dt. 29.3.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vlerësojmë se kjo mosmarrëveshje duhet të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila vendos për pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore me Kushtetutën. Është pikërisht kjo gjykatë e cila shqyrton përputhshmërinë e normave ligjore me përmbajtjen dhe qëllimin e ligjit themelor të shtetit, si gjykata e cila bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.

Pala e tretë prapësoi se paditësi kërkon shfuqizimin e pikës 12, të nenit 34, pasi ai pretendon se sipas këtij parashikimi, Këshilli i Ministrave, i ka lënë dorë të lirë KKT-së të vendosë pa asnjë lloj kriteri apo standardi ndërtues në dhënien e lejeve zhvillimore. Ky pretendim nuk është i vërtetë, pasi në asnjë vend të kësaj pike nuk parashikohet që KKT-ja në dhënien e lejeve zhvillimore të shkelë të drejtat e pronarëve dhe rregullat e kushteve urbane në hartimin e rregulloreve të posaçme.

Përfundimet në të cilat arriti eksperti, i pyetur me cilësinë e dëshmitarit, se në rastin e dhënies së lejes së zhvillimit, dhënë nga KKT-ja dhe të lejes së ndërtimit dhënë nga Bashkia Tiranë, janë shkelur distancat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 34, dhe nenit 35 të VKM-së nr. 408/2015, **nga 15 m që parashikon kjo VKM në rreth 11 m**, që rezulton në dhënien e lejes zhvillimore, nuk duhet të merren në konsideratë nga Gjykata Administrative e Apelit, pasi nuk kanë lidhje me

aktin administrativ (pika 12 e nenit 34 të VKM nr. 231/2017), objekt shqyrtimi gjyqësor. Objekt shqyrtimi gjyqësor nuk janë as pika 2 e nenit 34 dhe as neni 35 që citon eksperti. Objekt shqyrtimi gjyqësor është pika 12, e nenit 34, e cila parashikon se në raste përjashtimore, për objekte në kompetencë të KKT-së, distancat e objekteve mund të përcaktohen nga KKT me rregullore të posaçme. Pra kur lejet zhvillimore jepen nga KKT-ja, nuk zbatohen rregullat e përgjithshme, që parashikohen në pikën 2, të nenit 34.

Gjithashtu paditësi pretendoi gjatë shqyrtimit të çështjes se kjo pikë e VKM-së cenon të drejtën e pronësisë dhe të privatësisë së paditësve. As kjo nuk u vërtetua gjatë shqyrtimit të çështjes, pasi siç e sqaroi edhe eksperti në rastin konkret pika më e afërt e godinës së re me objektin pronë e paditëseve do ishte rreth 11m. Kjo largësi kurrsesi nuk cenon të drejtën e pronësisë dhe as të privatësisë së paditësve.

Pala e tretë prapësoi se nuk qëndron pretendimi i paditësve se Këshilli i Ministrave nuk mund t'ia delegojë kompetencat e tij një organi tjetër, referuar ligjit nr. 107/2014, neni 7, neni 28, neni 10, 10.1, 19 i VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”.

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 180, datë 13.4.2000, dhe urdhri nr. 122, datë 5.3.2007 i ministrit të Turizmit, Rinisë dhe Sporteve “Për shpalljen monument kulture të kategorisë së dytë të ndërtesave në aksin kryesor të Qendrës Historike të Qytetit të Tiranës”.

Sipas kësaj VKM-je dhe sipas hartës bashkëlidhur kësaj VKM-je, rezulton se prona objekt shqyrtimi gjyqësor, ku përfshihet gjurma e projektit, përfshihet në zonën e mbrojtur të qendrës historike të Tiranës dhe në këto kushte zona objekt shqyrtimi gjyqësor për leje zhvillimore, godinë komplekse polifunksionale, është në kompetencë të KKT-së.

Sipas VKM-së nr. 519, datë 20.9.2017 “*Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit*”, KKT-ja është konceptuar si Autoritet Kombëtar i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, dhe kryesohet nga Kryeministri. Po kështu, në përbërje të tij ka ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, ministrin e Financave dhe Ekonomisë, ministrin e Drejtësisë, ministrin e Kulturës, ministrin e



Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ministrin e Turizmit dhe Mjedisit, ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, si dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit.

Pra, Këshilli i Ministrave këtë të drejtë ia ka deleguar një Këshilli Kolegjal (KKT), për raste përjashtimore, kur ky organ miraton leje zhvillimore apo dhe leje ndërtimi për ato objekte që lidhen me çështje, zona, objekte të rëndësishme kombëtare apo me investime strategjike për interesat e vendit, sipas rasteve të parashikuara nga neni 28, i ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, i cili në përbërje të tij ka pothuaj të njëjtët anëtarë të KM (shumica e ministrave të kabinetit qeveritar).

Pretendimi i paditësit se miratimi i kësaj rregulloreje është në diskrecion vetëm të Këshillit të Ministrave, nuk qëndron për shkak se siç e sqaruam edhe më lart, rastet kur lejet zhvillimore jepen nga KKT-ja, janë për raste përjashtimore për ndërtesat të cilat janë Shpallur Monument Kulture të Kategorisë së Dytë në Aksin Kryesor të Qendrës Historike të Qytetit të Tiranës (nr. 180, datë 13.4.2000). Pra, këto objekte janë objekte të rëndësishme së veçantë dhe kërkesa për leje zhvillimore shoqërohet bashkëlidhur edhe me rregulloren e veçantë, e cila është shqyrtuar dhe bashkërenduar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, me të gjitha autoritetet publike të specializuara, nga Sekretariati i KKT-së (Agjencia e Zhvillimit të Territorit).

Pala e tretë prapësoi se, VKM-ja nr. 231, datë 21.3.2017 ka dalë sipas procedurës së parashikuar nga ligji nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për funksionimin dhe organizimin e Këshillit të Ministrave”, si dhe vendimit nr. 584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”. Sipas nenit 24 të këtij ligji, me anë të shkresës nr. 1386, datë 3.3.2017, MZHU-ja i është drejtuar për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë për Marrëdhëniet me Parlamentin, dhe Ministrisë së Shtetit për çështjet vendore, me anë të së cilës i ka kërkuar mendim për këtë projekt vendim. Ministria e Çështjeve Vendore dhe Ministria për Marrëdhëniet me Parlamentin janë shprehur parimisht dakord dhe pa vërejtje. Ndërsa nga ana e Ministrisë së Drejtësisë kanë ardhur disa komente të cilat janë reflektuar dhe

bashkërenduar me ish-Ministrinë e Zhvillimit Urban.

Po kështu me anë të shkresës nr. 1386/1 prot., datë 6.3.2017, MZHU-ja ka kërkuar mendim për këtë projekt vendim Bashkisë Tiranë, Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (Sekretariati i AZHT-së), si institucione të interesuara dhe që preken nga ky projekt vendim. Të dyja këto institucione kanë propozuar komentet dhe sugjerimet përkatëse, të cilat janë marrë në konsideratë nga Ministria e Zhvillimit Urban.

Pikërisht pika 12 e nenit 34 të VKM-së nr. 231 është propozuar nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit. Në rastin konkret sipas VKM-së nr. 725, datë 2.9.2015, “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, Agjencia kryen funksionet e sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit. Ky propozim pasi është shqyrtuar nga MZHU-ja dhe është dhënë dakordësia dhe nga organet e tjera ku është çuar për mendim, i është çuar për propozim Këshillit të Ministrave, i cili me vendimin nr. 231, datë 21.3.2017 ka miratuar këtë projektvendim.

Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

Kolegji Administrativ pasi shqyrtoi çështjen, dëgjoi palët, analizoi rrethanat, faktet dhe ligjin çmon se padia duhet të pranohet me arsyetimin si më poshtë vijon:

Së pari, në lidhje me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykimit të mosmarrëveshjes administrative të çështjes objekt gjykimi.

Neni 10/2/b i ligjit nr. 49/2012 Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” parashikon:

2. Gjykata Administrative e Apelit shqyrton:

a) ankimet kundër vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë;

b) në shkallë të parë, mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative, si dhe raste të tjera të parashikuara me ligj.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 408 datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 231 datë 21.3.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.



408 datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit” sipas përkufizimit të nenit 2, pika 3, e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, përbën akt nënligjor normativ pasi në rastin konkret, organi publik ka shprehur vullnetin në ushtrim të funksionit të tij publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje dhe që nuk shteron në zbatimin e tij.

Ky vendim ka dalë në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 6 të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, ku sipas këtij vendimi është vendosur:

1. Miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. **Ngarkohen autoritetet e planifikimit, të përcaktuara në ligjin nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 80, datë 21.5.2015, së bashku me tekstin e rregullores e cila është pjesë përbërëse e vendimit.

Në këtë VKM, në nenin 34 ishin përcaktuar distancat minimale midis ndërtimeve. Kjo dispozitë ka pasur këtë përmbajtje:

1. Distancat minimale midis dy ndërtimeve sipas këtij neni garantojnë kushtet minimale të standardeve të ndriçimit dhe mbrojtjes nga zjarri dhe përcaktohen si gjatësia e vijës pingule midis planeve më të afërta të faqeve që përballin njëra-tjetrën.

2. Në njësitë ku plani parashikon mbushje urbane dhe nuk parashikon hartimin e PDV-së, distanca minimale e lejuar midis dy ndërtimeve do të matet sipas formulës më poshtë:

$$d = b_{\max} \times k(0.8),$$

nga të cilat, d-distanca minimale; b-lartësia maksimale e ndërtimit më të lartë dhe k(0.8)-koeficienti minimal për ndriçim dhe mbrojtje nga zjarri.

3. Në zonat e reja për zhvillim apo zonat ekzistuese për rishvillim, distanca midis dy ndërtimeve është e

barabartë me lartësinë maksimale mbi tokë të ndërtimit më të lartë.

4. Në rastet e zonave historike dhe të mbrojtura monument kulture sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi respektohen distancat ekzistuese të tipologjisë arkitektonike historike në zonë.

5. Distancat e ndërtimeve të ndryshme nga çerdhet, kopshtet, shkollat dhe objektet shëndetësore duhet të jenë në drejtimin jug, jo më pak se 1,5 herë e lartësisë së përgjithshme të ndërtimit më të lartë të shprehur në metra. Në drejtimet e tjera të horizontit zbatohen pikat 2 dhe 3, e këtij neni.

6. Distancat për ndërtimet industriale përcaktohen në përputhje me sigurinë e ndërtimit dhe nga aktiviteti që kryhet në to, sipas legjislacionit të posaçëm, dhe në çdo rast nuk duhet të jenë më të vogla se përcaktimet e pikave 2 dhe 3, të këtij neni.

7. Distancat për ndërtimet brenda një zone me përdorim hotelier përcaktohen sipas projektit, në përputhje me këtë rregullore, për aq sa nuk përcaktohet ndryshe në legjislacionin e posaçëm dhe atë mjedisor.

8. Pavarësisht sa përcaktohet në këtë nen, hapësirat që krijohen nga distancat duhet të jenë të tilla që për çdo ndërtim të sigurohet akses i drejtpërdrejtë nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri në të paktën 2 faqe të ndërtimit dhe midis ndërtimeve. Nënkalimet tunel të ndërtesave të gjata janë minimalisht 5 metra të gjera dhe 6 metra të larta, për të lejuar kalimin e lirshëm të ambulancës ose zjarrfikësës.

9. Në rast se faqet që përballin njëra-tjetrën janë kallkan, pra pa dritare dhe pa çarje fasade të çdo lloji tjetër, dy ndërtimet mund të vendosen bashkëngjitur në këto faqe mbi bazën e projektit për ndërtesa të bashkëngjitura dhe marrëveshjes përkatëse mes palëve të interesuara. Në mungesë të marrëveshjes, respektohen distancat sipas pikave në vijim të këtij neni.

Me propozim të ministrit të Zhvillimit Urban, i padituri Këshilli i Ministrave ka nxjerrë vendimin nr. 231 datë 21.3.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit””, të ndryshuar, i cili ka ndryshuar nenin 34 me përmbajtjen si më poshtë:

Distancat minimale midis ndërtimeve

1. Distancat minimale midis dy faqeve, ku të paktën njëra ka dritare, sipas këtij neni garantojnë kushtet minimale të standardeve të ndriçimit e mbrojtjes nga zjarri dhe përcaktohen si gjatësia e vijës pingule midis planeve më të afërta të faqeve që përballin njëra-tjetrën.



2. Distanca minimale e lejuar midis dy ndërtimeve do të matet me shumën e numrit të kateve mbi tokë të ndërtimeve që përballen plus 2m, sipas formulës më poshtë:

$$d = \text{nr. } k \text{ obj. } A + \text{nr. } k \text{ obj. } B + 2m, \text{ ku:}$$

d - distanca minimale midis dy ndërtimeve.

$\text{nr. } k$ - numri i kateve.

3. Në rast se ndërtimi përballlet me një objekt ekzistues, të ndërtuar në kundërshtim me kondicionet urbane të legjislacionit përkatës, atëherë ndërtimi i ri përjashtohet nga detyrimi për të respektuar distancat sipas pikës 2, të këtij neni, dhe mbart detyrimin e respektimit të distancës nga kufiri i pronës, sipas nenit 35. Për efekt të zbatimit të kësaj dispozite, nuk do të merren në konsideratë objektet ekzistuese të ndërtuara përpara viteve 1990, nga të cilat do të respektohen distancat minimale të përcaktuara në pikën 2.

4. Distanca minimale për faqet pa dritare dhe pa çarje fasade të çdo lloji tjetër, të cilat ndodhen përballë njëra-tjetrës dhe për të cilat nuk sigurohet deklarate e të dyja palëve për kallkan, në kushtet e moscenimit të sigurisë së secilit objekt duhet të jetë jo më pak 2 (dy) metra, ku secila ndërtesë mbart

detyrimin për respektimin e distancës jo më pak se 1 (një) metër nga kufiri i pronës.

5. Për ndërtimet gjatë rrugëve, çdo dalje konsol do të qubet faqe ndërtimi dhe duhet të respektojë distancat nga trupi i rrugës. Nuk kërkohet të respektojnë distancat e këtij neni elementet arkitektonike të fasadave, të cilat nuk përbëjnë sipërfaqe të shfrytëzueshme dhe nuk dalin nga fasada më shumë se 0.5 metër.

6. Në rastet e zonave historike dhe të mbrojtura, monument kulture, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi, respektohen distancat ekzistuese të tipologjisë arkitektonike historike në zonë.

7. Distancat e ndërtimeve për çerdhet, kopshtet, shkollat dhe objektet shëndetësore duhet të jenë në drejtimin jug, jo më pak se 1,5 herë shumën e numrit të kateve mbi tokë të ndërtimeve që përballen, plus 2m, [$d = 1.5 (\text{nr. } k \text{ obj. } A + \text{nr. } k \text{ obj. } B + 2m)$] ku: d - distanca minimale midis dy ndërtimeve dhe $\text{nr. } k$ - numri i kateve. Në drejtimet e tjera të horizontit zbatohen pikat 2 dhe 3, të këtij neni.

8. Distancat për ndërtimet industriale përcaktohen në përputhje me sigurinë e ndërtimit dhe nga aktiviteti që kryhet në to, sipas legjislacionit të posaçëm, dhe, në çdo rast, nuk duhet të jenë më të vogla se përcaktimet e pikave 2 e 3, të këtij neni.

9. Distancat për ndërtimet brenda një zone me përdorim hotelier përcaktohen sipas projektit, në përputhje

me këtë rregullore, për aq sa nuk përcaktohet ndryshe në legjislacionin e posaçëm dhe atë mjedisor.

10. Pavarësisht sa përcaktohet në këtë nen, hapësirat që krijohen nga distancat duhet të jenë të tilla që për çdo ndërtim të sigurohet akses i drejtpërdrejtë nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri në të paktën 2 faqe të ndërtimit dhe midis ndërtimeve. Nënkalimet tunel të ndërtesave të gjata janë minimalisht 5 metra të gjera dhe 5 metra të larta, për të lejuar kalimin e lirshëm të ambulancës ose zjarrfikëses.

11. Në rast se faqet që përballin njëra-tjetrën propozohen kallkan, pa dritare dhe pa çarje fasade të çdo lloji tjetër, dy ndërtimet mund të vendosen bashkëngjitur në këto faqe mbi bazën e projektit për ndërtesa të bashkëngjitura dhe të marrëveshjes përkatëse ndërmjet palëve kufitare të interesuara. Në mungesë të marrëveshjes, respektohen distancat sipas këtij neni.

12. Për objektet në kompetencë të Këshillit Kombëtar të Territorit, sipas nenit 19, të kësaj rregulloreje, distancat midis objekteve mund të përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit me rregullore të posaçme, të miratuara prej tij.

Ky vendim është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 63, të datës 29.3.2017, si i tillë është një akt me fuqi të plotë.

Pra, VKM-ja objekt gjykimi ka normuar rregulla të përgjithshme sjelljeje që nuk shtron në zbatimin e tij, duke përcaktuar rregullat e zhvillimit të territorit.

Nga analiza e dispozitave të mësipërme, kolegji vlerëson se kjo çështje është në kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit, juridiksion fillestar, si gjykatë e shkallës së parë.

Së dyti: Në lidhje me afatin e ngritjes së padisë kolegji vlerëson se pala paditëse kërkon shfuqizimin e pikës 12 të nenit 34 të ndryshuar me VKM-në nr. 231 datë 21.3.2017, padia është paraqitur në sekretarinë e Gjykatës Administrative të Apelit në datë 20.12.2018 pra brenda afatit 3 vjeçar të parashikuar nga neni 18 pika 3 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i cili sanksionin se Padia kundër aktit nënligjor normativ duhet të paraqitet në gjykatë brenda 3 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të aktit. Sikundër u citua më sipër, kjo VKM është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 63, të datës 29.3.2017,



për sa më sipër konkludohet se padia është paraqitur brenda afatit 3 vjeçar.

Së treti: Në lidhje me pretendimet e ngritura nga Avokatura e Shtetit dhe personi i tretë se pretendimet e palës paditëse janë ngritur në nivel kushtetues, për rrjedhojë çështja bën pjesë në juridiksionin kushtetues, kolegji vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Kolegji vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit ka juridiksion dhe kompetencë lëndore dhe funksionale për gjykimin e kësaj çështje pasi objekt shqyrtimi është një akt nënligjor normativ konform nenit 10/2/b të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen e shtruar përpara saj brenda kufijve të përcaktuar në nenin 37 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” sipas të cilit parashikohet se

Kufijtë e shqyrtimit të çështjes

1. Gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ.

2. Në rastet kur paditësi ose kur ligji material kërkon nxjerrjen e një akti administrativ, gjykata e bazon vendimin e saj në situatën faktike dhe ligjore në kohën e marrjes së vendimit.

3. Në rastin kur ligji i jep organit publik të drejtën për zgjedhje alternative, në nxjerrjen e një akti administrativ apo në kryerjen e veprimit tjetër administrativ, gjykata shqyrton edhe nëse:

a) zgjedhja nga organi publik është bërë në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit;

b) zgjedhja nga organi publik është bërë vetëm për të arritur qëllimin e ligjit;

c) zgjedhja nga organi publik është në raport të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.

4. Në rastin e aktit nënligjor normativ, gjykata shqyrton ligjshmërinë e aktit që kundërshtohet, duke vlerësuar të tre kriteret e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

Në këto kushte Gjykata Administrative e Apelit e merr në shqyrtim çështjen objekt gjykimi, mbi ligjshmërinë ose jo të aktit nënligjor

normativ, konkretisht pika 12 e nenit 34 të ndryshuar me VKM-në nr. 231 datë 21.3.2017, brenda kufijve të shqyrtimit të përcaktuar në nenin 37 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Kolegji në zgjidhjen e shqyrtimit të kësaj çështje, sa i përket elementëve që kanë të bëjnë me gjykatën kompetente, legjitimin e palëve, ka në konsideratë edhe praktikën e krijuar tashmë nga Gjykata e Lartë Kolegji Administrativ pikërisht për të bërë dallimin midis kufijve të shqyrtimit të akteve nënligjore nga kjo gjykatë, dhe shqyrtimit të tyre nga Gjykata Kushtetuese.

Kështu Gjykata e Lartë Kolegji Administrativ do të arsyetonte në një vendim të tijin se:

10. Ky kolegji vlerëson të evidentojë faktin se kjo çështje është duke u gjykuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë për faktin se natyra juridike e këtij gjykimi është administrative. Konflikti ka lindur si pasojë e nxjerrjes nga ana e paditur Këshilli i Ministrave të vendimit nr. 953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

11. Akti administrativ objekt gjykimi është akt nënligjor/akte administrative të cilat në bazë të nenit 10/2/b të ligjit 49/2012 gjykohen nga Gjykata Administrative e Apelit. Në këtë dispozite parashikohet shprehimisht se gjykata administrative e apelit shqyrton në shkallë të parë mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative si dhe rastet e tjera të parashikuara nga ligji.

12. Do të jete objekt i gjykimit nga kjo gjykate pikërisht rastet kur këto akte goditen për ligjshmërinë e tyre (nëse ato kanë dalë në bazë dhe zbatim të ligjit) fushe kjo zbatimi e cila është përcaktuar qartë në nenin 37/4 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, në të cilin thuhet se: “Në rastin e aktit nënligjor normativ, gjykata shqyrton ligjshmërinë e aktit që kundërshtohet, duke vlerësuar të tre kriteret e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni”.

13. Në analizë të kësaj dispozite si dhe të shkakut ligjor të kërtimeve (nga ku rezulton se kërkohet pavlefshmëria absolute e aktit administrativ) arrihet në konkluzionin se është pikërisht Gjykata Administrative e Apelit gjykata kompetente që duhet të shqyrtojë ligjshmërinë e këtyre akteve dhe jo një gjykatë tjetër. Është kjo gjykate që në rastin kur këto akte kundërshtohen me shkakun ligjor që ato mund të mos



kenë dalë në përputhje me ligjin dhe mund të paraqesin kundërligjshmëri, të shqyrtoje ligjshmërinë e tyre në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe situatës ligjore e faktike që ekzistonte në kohën e daljes së akteve.

14. Ky parashikim vjen në përputhje dhe me nenin 118/2 të Kushtetutës (kushtetuta që ka qenë në fuqi në momentin e daljes së akteve objekt shqyrtimi) në të cilën thuhet se: “1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë. 2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të cilave nxirren këto akte. 3. Organi i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni, nuk mund t’ia delegojë kompetencën e tij një organi tjetër”.

15. Janë pikërisht këto parime baze dhe këto kritere të përcaktuara në kushtetutë cilat jo vetëm ligji specifik por edhe organi kompetent shtetëror që nxjerr akte administrative duhet ti zbatojë dhe nuk duhet ti kapërcejë apo ti shkelë. Sa më sipër përbën atë që quhet respektimi i “parimit të ligjshmërisë “i cili qëndron në themel të veprimtarisë së organeve administrative dhe që siç do të analizojmë më poshtë në këtë vendim nuk është respektuar nga ana e paditur. **Duke pasur parasysh hierarkinë e normave ky kolegji evidenton faktin që çdo organ në veprimtarinë e tij duhet të ketë parasysh normat kushtetuese dhe duhet ti respektojë dhe ti zbatojë ato duke qenë se këto të fundit përbejnë aktin më të lartë të shtetit. Rendi juridik është një sistem hierarkik ku secila nga aktet që nga piramida dhe deri në bazë kanë vlera të ndryshme. Nga vlefshmëria e këtyre akteve përcaktohet dhe fuqia e zbatimit të tyre. (për më tepër shih vendimin Dhoma Kombëtare e Avokatisë kundër KM-së, vendimi datë 19.7.2017)**

Së katërti: Avokatura e Shtetit dhe personi i tretë prapësuan në gjykim se pala paditëse nuk legjitimohet në ngritjen e kësaj padie sepse nëpërmjet këtij gjykimi ata nuk mund të realizojnë interesin e tyre që është gjykimi tjetër që ato kanë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me objekt: *Shfuqizimin e aktit administrativ: vendim i KKT-së nr. 11, datë 20.6.2018 “Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin “Godinë polifunksionale West Residence 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 Kate, me vendndodhje në rrugën “Ibrahim Rugova”, Bashkia e Tiranës”, me subjekt*

zhvillues shoqërinë “INVEST SOCIETY”. Shfuqizimin e aktit administrativ të vendimit të Kryetarit së Bashkisë së Tiranës nr. E-22296/7, datë 3.10.2018 “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin “Godinë polifunksionale West Residence 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 kate, me 4 kate parkim nën tokë”, në rrugën “Ibrahim Rugova”, Njësia Administrative nr. 5, Tiranë, me zhvillues Shoqëria “INVEST SOCIETY” dhe subjekt ndërtues Shoqëria “TDT & PARTNERS”. Këto palë prapësuan se në bazë të nenit 113 të K.P. Administrative edhe po të shfuqizohet pika 12 e nenit 34 të VKM-së nr. 231, kjo do sillte pasoja për të ardhmen dhe në këtë rast paditësi nuk do përfitonte të rivendoste të drejtat e tij me anë të këtij vendimi gjyqësor (të shfuqizonte lejen zhvillimore dhe atë të ndërtimit), çka do të thotë se i mungon interesi i ligjshëm për ngritjen e kësaj kërkesë padie. Leja zhvillimore dhe ajo e ndërtimit në momentin që janë dhënë, kanë qenë të ligjshme dhe të bazuara pikërisht në pikën 12 të nenit 34 të VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e ndryshuar, të miratuar me VKM. Kjo pikë i ka dhënë pasojat juridike dhe paditësi me anë të kësaj padie nuk mund ti ndryshojë këto pasoja.

Në lidhje me këtë prapësim pala paditëse pretendoi se ky pretendim është haptazi i pabazuar pasi, dispozita që referon personi i tretë, bën pjesë në Kodin e Procedurave Administrative. Ky ligj, siç rezulton nga mënyra se si është formuluar neni 2 i tij, i shtrin efektet ndaj organeve publike si edhe ndaj subjekteve private por që ushtrojnë aktivitet publik. Pra, qartazi rezulton se ky Kod nuk gjen zbatim dhe nuk rregullon juridiksionin e gjykatave administrative, përfshirë edhe juridiksionin e Gjykatës Administrative të Apelit, në shqyrtimin e këtyre çështjeve. Në këtë kontekst, anulimi dhe shfuqizimi i aktit është kompetencë e organeve publike që ushtrojnë veprimtari administrative por jo e gjykatave administrative. Theksojmë se ligj nr. 49/2012, nuk bën një dallim të tillë dhe nuk parashikon padi që kanë për objekt anulimin e aktit, apo shfuqizimin e aktit. Neni 15 i këtij ligji është i qartë ku nuk bën një dallim të tillë dhe nuk parashikon padi që kanë për objekt anulimin e aktit, apo shfuqizimin e aktit. Dispozita në këtë rast është e qartë ku në çdo rast kërkohet vetëm shfuqizimi i aktit, përfshirë edhe aktin normativ nënligjor. Sipas ligjit nr.



49/2012, neni 15, që një subjekt të ngrejë një padi, duhet që të ketë interes të ligjshëm. Për këtë arsye në nuk mundet që në asnjë rrethanë të ngrinin padi për shfuqizimin e pjesshëm të VKM-së nr. 408/2015, nëse nuk do të kishte pasur më parë një zbatim i saj kundrejt nesh.

Kolegji vlerëson se ky prapësim i ngritur nga Avokatura e Shtetit dhe personi i tretë në gjykim, nuk është objekt shqyrtimi nga ky kolegji. Se si do të gjej zbatim vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit nuk përbën shkak shqyrtimi nga ky kolegji. Kolegji Administrativ i Apelit në analizë të faktit, mosmarrëveshjes së shtruar përpara saj për diskutim, arrin në përfundimin se pala paditëse gëzon legjitim aktiv në ngritjen e kësaj padie. Paditësit janë banorë të pallatit nr. 27/1 dhe nr. 27 të ndodhur në rrugën “Ibrahim Rugova” Tiranë, e njëherësh edhe bashkëpronar të truallin nën të. Rregullorja e zhvillimit urban përcakton rregulla për përcaktimin e kushteve dhe procedurave të detajuar për zbatimin e instrumenteve të drejtimit të zhvillimit si dhe përmbajtjen, strukturën e procedurën e miratimit të dokumenteve të kontrollit të zhvillimit, ndërsa qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të autoriteteve të zhvillimit për ushtrimin e funksionit të kontrollit të zhvillimit të territorit, në përputhje me ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Më tej një nga elementet që parashikon kjo rregullore janë edhe distancat minimale midis ndërtimeve. Pikërisht në këtë kuadër pala paditëse legjitimohet në ngritjen e kësaj padie pasi vlerëson se pika 12 e nenit 34 i ndryshuar është nxjerrë në kundërshtim me parashikimet ligjore.(pretendimet e palës paditëse më hollësisht janë cituar më sipër në këtë vendim). Paditësit janë gjendur para faktit që prona kufi me ta po zhvillohet mbi bazën e një leje zhvillimore e cila shoqërohet nga një rregullore e posaçme e miratuar në KKT-ja e që ka përcaktuar distancat e objektit të ri që do të zhvillohet. Fakt i cili u provua nga lejet përkatëse, rregullorja e posaçme dhe dëshmia e ekspertit të palës paditëse, z. Shaban Alushi. Për sa më sipër pala paditëse legjitimohet në ngritjen e padisë pasi pikërisht pika 12 e nenit 34 ka gjetur zbatim në zhvillimin e pronës kufitare me pronën e tyre.

Së pesti, në lidhje me procedurën e nxjerrjes së aktit, VKM-së nr. 231 datë 21.3.2017, pika 12 e nenit 34.

Sikundër rezulton nga praktika e administruar në dosjen gjyqësore me shkresën kthim përgjigje datë 14.2.2019 me nr. 881/1 prot., të depozituar nga Kryeministria në datë 18.2.2019 me nr. 375 prot., në sekretarinë e Gjykatës Administrative të Apelit, mbi kërkesën e bërë nga gjykata, si dhe praktikën e depozituar nga personi i tretë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, VKM-ja nr. 231, datë 21.3.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 të KM “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, është iniciuar nga ministri i Zhvillimit Urban dhe sipas relacionit të shoqëron projekvendimin ai është propozuar me qëllim përmirësimin e disa aspekteve që lidhen me procesin e shqyrtimit të kërkesave për leje ndërtimi dhe certifikatë përdorimi nga autoritetet e zhvillimit të territorit, si dhe rishikimin e rregullave minimale bazë për distancat ndërmjet ndërtimeve.

Sipas relacionit, nevoja e propozimit të këtyre ndryshimeve është diktuar nga praktika e deri atëherëshme e zbatimit të kësaj rregulloreje, nga ana e përdoruesve, autoriteteve vendore dhe qendrore, si dhe nga kërkesat dhe propozimet për ndryshime ligjore të dërguara prej tyre. Ndryshimet e propozuara synonin të qartësonin disa çështje për të cilat janë hasur vështirësi zbatimi dhe mënyra të ndryshme interpretimi nga bashkitë (kërkesat dhe përmbajtja e lejes së zhvillimit, titulli i pronësisë në rast punimesh me deklaratë paraprake, deklaratë e zbatuesit për certifikatë përdorimi etj.), si dhe të thjeshtojë në përgjithësi procedurat për shqyrtimin e kërkesave për leje në fushën e ndërtimit nga ana e bashkive. VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, rregullon ndër të tjera procedurat, afatet dhe kërkesat ligjore për paisjen e aplikuesve me leje në fushën e ndërtimit (leje zhvillimi, leje ndërtimi, certifikatë përdorimi), si dhe përcakton rregullat bazë për distancat që duhen respektuar ndërmjet objekteve dhe ndërmjet objekteve të ndërtimit dhe kufijve të pronës apo trupit të rrugës. Prej muajit shtator 2016, me qëllim lehtësimin dhe përsheptimin e procedurave të aplikimit dhe shqyrtimit për leje, të gjitha procedurat për shqyrtimin e lejeve në fushën e



ndërtimit kanë filluar të kryhen në mënyrë të detyrueshme përmes sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit, të aksesueshëm në portalin e-Albania. Sistemi elektronik ka bërë të mundur realizimin konkret të parimit One-Stop-Shop për lejet e ndërtimit, duke eliminuar ndalesat e aplikuesve në zyrat e administratës publike dhe duke i mundur bashkisë të veprojnë si sporteli i vetëm i shërbimit, si pasojë e bashkërendimit në sistem të saj me institucionet publike që duhet të japin të dhëna apo mendim lidhur me kërkesën për leje ndërtimi. Nga momenti i hyrjes në fuqi të procedurës elektronike të aplikimit, pranimit dhe shqyrtimit të kërkesave për leje ndërtimi, Ministria e Zhvillimit Urban ka bashkërenduar hap pas hapi me bashkitë vijimësinë e këtij procesi. Si rezultat i praktikës së deritanishme 6-mujore të punës përmes sistemit, janë evidentuar si të nevojshme disa përmirësime të VKM nr. 408, që janë pasqyruar në projektvendim, si vijon:

- Rishikimi i distancave minimale të parashikuara në VKM-n nr. 408, nisur nga propozimet e marra nga grupet e interesit, bashkitë si dhe Shoqata e Ndërtuesve. Distancat aktuale e vështirësojnë zhvillimin në zona urbane, pjesërisht të ndërtuara të qyteteve. Kjo komplikohet edhe nga fakti se zhvillimeve të reja i bie jo vetëm barra e mbajtjes së distancave më të mëdha nga kufiri i tyre i pronës, por edhe barra e distancës së ndërtimit fqinj (që, në shumë raste, ka ndërtuar pa leje, ose me kushte të ndryshme ligjore nga ato të sotmet). Për këtë arsye, parashikohen rregullime specifike që marrin në konsideratë situatën aktuale urbane në vend dhe synojnë të garantojnë të drejtat për zhvillim të të gjithë pronarëve, përfshirë në rastin e objekteve kufitare që kanë ndërtuar ose kërkojnë të ndërtojnë kallkan.

Në relacion thuhet, se ky projekt-akt ka pritshmëri të ndikojë në përmirësimin e bashkëveprimit të autoriteteve vendore të zhvillimit të territorit me aplikuesit për leje ndërtimi, si dhe të mundësojë rregulla të zhvillimit të territorit që harmonizohen me dokumentet e planifikimit në nivel vendor dhe që garantojnë një zhvillim dhe menaxhim të qëndrueshëm të territorit.

Në projekt vendimin e propozuar neni 34 është i parashikuar me 11 pika, (pra pa pikën e 12). Pas diskutimeve të këtij projekt-vendimi Agjencia e Zhvillimit të Territorit me shkresën e datës 13.3.2017 me nr. 544/ prot., ka propozuar një variant të ripunuar të nenit 34 duke propozuar një nen me 14 pika, ku pika e 14 ka këtë përmbajtje: në rastet e zonave specifike si në përcaktim grafik dhe procedural të përcaktuara në instrumentet lokale të zhvillimit të territorit, distancat midis objekteve do të përcaktohen në rregullore të veçanta të hartuara për këto zona. Këto rregullore do të miratohen nga KKT-ja.

Pas përfundimit të procedurave projektvendimi përfundimtar ka dalë në përmbajtjen që ka sot VKM-ja nr. 231 datë 21.3.2017 pika 12, neni 34, i ndryshuar.

Pala paditëse pretendoi se nga pala e paditur ka shkelje të procedurës në nxjerrjen e aktit objekt gjykimi si i tillë ai është i pavlefshëm.

Kolegji Administrativ i Apelit vlerëson se akti objekt gjykimi, për pikën 12 të nenit 34 nuk përbën një akt absolutisht të pavlefshëm në referim të nenit 108 të Kodit të Procedurave Administrative i cili parashikon:

Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme:

a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me:

- i. kompetencën e organit publik;
- ii. procedurën e nxjerrjes së tij; ose
- iii. formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit;

b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale;

c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal;

ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.

Nga analiza që më sipër ju bë procedurës së nxjerrjes së aktit, pra, VKM-së nr. 231/2017, kolegji vlerëson se në rastin konkret as nuk plotësohet por as nuk përmbushen një nga rastet e kërkuara nga neni 108, që të passjellin konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit për rrjedhojë pretendimi i paditësit nuk pranohet.



Së gjashti: në lidhje me shqyrtimin e themeltesisë dhe ligjshmërisë e aktit Kolegji Administrativ i referohet akteve objekt shqyrtimi, provave të nënshtruara debatit gjyqësor, kuadrit ligjor të aplikueshëm në rastin konkret.

Rezultoni se paditësit janë banorë të qytetit të Tiranë dhe banojnë në rrugën “Ibrahim Rugova”, në pallatin nr. 27 dhe 27/1. Gjithashtu, paditësit janë edhe bashkëpronarë të pasurisë trull me sipërfaqe 146.28 m² dhe 171 m² me nr. pasurie 4/195; vol.78, faqe 94 dhe nr. pasurie 4/541, vol. 69, f. 155, zona kadastrale 8270 sikundër provohet nga certifikatat e vërtetimit të pronësisë datë 9.6.2015.

Këshilli Kombëtar i Territorit, me vendimin nr. 11, datë 20.6.2018 ka miratuar lejen zhvillimore në favor të subjektit “Invest Society” sh.p.k., për ndërtimin e një godine 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9-katëshe në Rrugën “Ibrahim Rugova”, Tiranë.

Rezultoni se Këshilli Kombëtar i Territorit ka miratuar dokumentin rregullorë e veçantë për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin godinë polifunksionale West Residence 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 kate në rrugën “Ibrahim Rugova” Bashkia Tiranë.

Në pikën 4.3 të saj, “Përcaktimi i treguesve për zhvillimin të projektit” janë përcaktuar treguesit e zhvillimit të projektit, distancat nga kufiri i pronës, distancat nga aksi i rrugës, distancat nga trupi i rrugës etj.

Me vendim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës nr. E-22296/7, datë 3.10.2018 është miratuar leja e ndërtimit për objektin “Godinë polifunksionale West Residence 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 kate, me 4 kate parkim nën tokë”, në rrugën “Ibrahim Rugova”, Njësia Administrative nr. 5, Tiranë, me zhvillues Shoqëria “INVEST SOCIETY” dhe subjekt ndërtues Shoqëria “TDT & PARTNERS”. Ndërtimi i ri është kufitar me pronën e paditësve, të cilët kanë paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me objekt *Shfuqizimin e aktit administrativ: Vendim i KKT nr. 11, datë 20.6.2018 “Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin “Godinë polifunksionale West Residence 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 kate, me vendndodhje në rrugën “Ibrahim Rugova”, Bashkia e Tiranës”, me subjekt zhvillues shoqërinë “INVEST SOCIETY”. Shfuqizimin e aktit administrativ të Vendimit të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës nr. E-22296/7, datë*

3.10.2018 “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin “Godinë polifunksionale West Residence 2,3,4,5,6,7,8 dhe 9 kate, me 4 kate parkim nën tokë”, në rrugën “Ibrahim Rugova”, Njësia Administrative nr. 5, Tiranë, me zhvillues Shoqëria “INVEST SOCIETY” dhe subjekt ndërtues Shoqëria “TDT & PARTNERS”.

Në bazë të nenit 6/2/b të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës mbi propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, i padituri Këshilli i Ministrave ka nxjerrë Vendimi nr. 408 datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

Neni 6 i ligjit nr. 107/2014, parashikon:

Përgjegjësitë e Këshillit të Ministrave

2. Këshilli i Ministrave është përgjegjës për:

a) miratimin e Planit të Përgjithshëm të Territorit;

b) miratimin e rregullores së planifikimit, zhvillimit, ndërtimit, rregullores së Regjistratit të Integruar të Territorit si dhe të dokumenteve tjera sipas përcaktimeve të këtij ligji;

Në këtë VKM, në nenin 34, janë përcaktuar distancat minimale midis ndërtimeve. Kjo dispozitë ka këtë përmbajtje:

1. *Distancat minimale midis dy ndërtimeve sipas këtij neni garantojnë kushtet minimale të standardeve të ndriçimit dhe mbrojtjes nga zjarri dhe përcaktohen si gjatësia e vijës pingule midis planeve më të afërta të faqeve që përballin njëra-tjetrën.*

2. *Në njësitë ku plani parashikon mbushje urbane dhe nuk parashikon hartimin e PDV-së, distanca minimale e lejuar midis dy ndërtimeve do të matet sipas formulës më poshtë:*

$$d = b_{\max} \times k(0.8),$$

nga të cilat, d-distanca minimale; b-lartësia maksimale e ndërtimit më të lartë dhe k(0.8)-koeficienti minimal për ndriçim dhe mbrojtje nga zjarri.

3. *Në zonat e reja për zhvillim apo zonat ekzistuese për rishvillim, distanca midis dy ndërtimeve është e barabartë me lartësinë maksimale mbi tokë të ndërtimit më të lartë.*

4. *Në rastet e zonave historike dhe të mbrojtura monument kulture sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi respektohen distancat ekzistuese të tipologjisë arkitektonike historike në zonë.*



5. Distancat e ndërtimeve të ndryshme nga çerdhet, kopshtet, shkollat dhe objektet shëndetësore duhet të jenë në drejtimin jug, jo më pak se 1,5 herë e lartësisë së përgjithshme të ndërtimit më të lartë të shprehur në metra. Në drejtimet e tjera të horizontit zbatohen pikat 2 dhe 3, e këtij neni.

6. Distancat për ndërtimet industriale përcaktohen në përputhje me sigurinë e ndërtimit dhe nga aktiviteti që kryhet në to, sipas legjislacionit të posaçëm, dhe në çdo rast nuk duhet të jenë më të vogla se përcaktimet e pikave 2 dhe 3, të këtij neni.

7. Distancat për ndërtimet brenda një zone me përdorim hotelier përcaktohen sipas projektit, në përputhje me këtë rregullore, për atë sa nuk përcaktohet ndryshe në legjislacionin e posaçëm dhe atë mjedisor.

8. Pavarësisht sa përcaktohet në këtë nen, hapësirat që krijohen nga distancat duhet të jenë të tilla që për çdo ndërtim të sigurohet akses i drejtpërdrejtë nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri në të paktën 2 faqe të ndërtimit dhe midis ndërtimeve. Nënkalimet tunel të ndërtesave të gjata janë minimalisht 5 metra të gjera dhe 6 metra të larta, për të lejuar kalimin e lirshëm të ambulancës ose zjarrfikësës.

9. Në rast se faqet që përballin njëra-tjetrën janë kallkan, pra pa dritare dhe pa çarje fasade të çdo lloji tjetër, dy ndërtimet mund të vendosen bashkëngjitur në këto faqe mbi bazën e projektit për ndërtesa të bashkëngjitura dhe marrëveshjes përkatëse mes palëve të interesuara. Në mungesë të marrëveshjes, respektohen distancat sipas pikave në vijim të këtij neni.

Me propozim të ministrit të Zhvillimit Urban, i padituri Këshilli i Ministrave ka nxjerrë vendimin nr. 231, datë 21.3.2017 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, i cili ka ndryshuar nenin 34 me përmbajtjen si më poshtë:

Distancat minimale midis ndërtimeve

12. Për objektet në kompetencë të Këshillit Kombëtar të Territorit, sipas nenit 19, të kësaj rregulloreje, distancat midis objekteve mund të përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit me rregullore të posaçme, të miratuara prej tij.”

Pikërisht pikën 12, të nenit 34, të rregullores së zhvillimit urban, kërkon pala paditëse të shfuqizohet nëpërmjet padisë së paraqitur në Gjykatën Administrative të Apelit.

Nga analiza e dispozitave të sipër cituara rezulton se Këshillimi i Ministrave **është përgjegjës për miratimin e rregullores së planifikimit, zhvillimit, ndërtimit, rregullores së Regjistrimit të Integruar të Territorit, si dhe të dokumenteve tjera sipas përcaktimeve të nenit 6/2/b të këtij ligji.**

Pikërisht në zbatim të kësaj dispozite 6/2/b, ka dalë edhe VKM-ja nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”. Ligji i posaçëm nr. 107/2014 nuk i ka parashikuar të drejtën Këshillit të Ministrave për të deleguar kompetencën e miratimit të rregullores së zhvillimit të territorit organeve të tjera sikundër është proceduar në rastin konkret ku i është dhënë e drejta Këshillit Kombëtar të Territorit, që distancat midis objekteve të mund të përcaktohen nga KKT-ja nëpërmjet hartimit të një rregulloreje të veçantë.

Neni 118 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se:

1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë.

2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.

3. Organi i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni, nuk mund t’ia delegojë kompetencën e tij një organi tjetër.

Kodi i Procedurave Administrative në lidhje me delegimin e kompetencave, në nenin 22, pika 3 të tij parashikon se:

3. Delegimi ose zëvendësimi i kompetencave mund të bëhet vetëm nëse:

a) parashikohet shprehimisht në ligj;

b) ligji parashikon organin ose nëpunësin zëvendësues ku bëhet delegimi ose zëvendësimi.

Neni 6 i ligjit nr. 107/2014 parashikon:

2. Këshilli i Ministrave është përgjegjës për:

a) miratimin e Planit të Përgjithshëm të Territorit;

b) miratimin e rregullores së planifikimit, zhvillimit, ndërtimit, rregullores së Regjistrimit të Integruar të Territorit si dhe të dokumenteve tjera sipas përcaktimeve të këtij ligji;

Sipas nenit 109 të K.Pr. Administrative një akt administrativ është i paligjshëm nëse:



a) organi publik që e ka nxjerrë ka vepruar në mungesë të kompetencës;

b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;

c) është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ;

ç) është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij Kodi;

d) është në kundërshtim me ligjin material;

dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme; apo

e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Ndërsa neni 37, i ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” parashikon:

Kufijtë e shqyrtimit të çështjes

1. *Gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ.*

2. *Në rastet kur paditësi ose kur ligji material kërkojnë nxjerrjen e një akti administrativ, gjykata e bazon vendimin e saj në situatën faktike dhe ligjore në kohën e marrjes së vendimit.*

3. Në rastin kur ligji i jep organit publik të drejtën për zgjedhje alternative, në nxjerrjen e një akti administrativ apo në kryerjen e veprimit tjetër administrativ, gjykata shqyrton edhe nëse:

a) zgjedhja nga organi publik është bërë në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit;

b) zgjedhja nga organi publik është bërë vetëm për të arritur qëllimin e ligjit;

c) zgjedhja nga organi publik është në raport të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.

4. Në rastin e aktit nënligjor normativ, gjykata shqyrton ligjshmërinë e aktit që kundërshtohet, duke vlerësuar të tre kriteret e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

Sipas VKM –së nr. 408/2015 është vendosur:

1. Miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. 2. Ngarkohen autoritetet e planifikimit, të përcaktuara në ligjin nr. 107/2014, datë

31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Sipas ligjit nr. 107/2014 “Autoritetet e planifikimit” janë organet dhe institucionet publike, që kanë përgjegjësi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, në përputhje me nenin 5 të këtij ligji.

Sipas nenit 5, Autoritetet përgjegjëse për planifikimin e territorit janë:

1.1. Në nivel qendror:

a) Këshilli i Ministrave;

b) Këshilli Kombëtar i Territorit;

c) ministria përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

1.2. Në nivel qarku:

a) këshilli i qarkut.

1.3. Në nivel bashkie:

a) këshilli bashkiak;

b) kryetari i bashkisë.

Pra, KKT-ja është një autoritet përgjegjës i ngarkuar nga VKM-ja nr. 408/2015 për zbatimin e saj. Ndërsa autoriteti i vetëm që miraton rregulloren është Këshilli i Ministrave.

Kolegji vlerëson se ligji nr. 107/2014 nuk e autorizon për asnjë moment KKT-në që të nxjerrë rregullore të posaçme për përcaktimin e distancave, në këtë kuptim ky kolegji gjen të pabazuar prapësimet e Avokaturës së Shtetit dhe personit të tretë se KKT-ja është në kompetencën e saj në rastin konkret.

Përkundrazi neni 7 i ligjit nr. 107/2014 që përmend kompetencat e KKT-së parashikon se:

Këshilli Kombëtar i Territorit ka këto kompetenca:

a) *vendos miratimin, miratimin me ndryshime ose shtyrjen për shqyrtim të mëvonshëm të dokumenteve të planifikimit, kërkuar për miratim nga autoritetet e planifikimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji;*

b) *vendos për miratimin e dokumenteve të planifikimit sektorial, të përcaktuara me legjislacion të posaçëm, dhe që kanë efekte në territor;*

c) *përcakton rëndësinë kombëtare të një çështjeje, zone ose objekti në planifikimin e territorit, dhe miraton planet e detajuara për zona të rëndësishme kombëtare, kur parashikohen të tilla nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit.*

Siç rezulton asnjë nga kompetencat e mësipërme ligji, nuk i jep të drejtë KKT-së që të vendosë për çështje që kanë të bëjnë me rregullat e planifikimit, zhvillimit dhe ndërtimit, sikundër



është në rastin konkret përcaktimi i distancave midis objekteve.

Për sa i përket më pas kompetencave të KKT-së në dhënien e lejeve zhvillimore dhe/apo ndërtimore, ato rregullohen nga ligji nr. 107/2014, nenet 18 dhe 28 dhe neni 19 i VKM-së nr. 408/2015 i ndryshuar.

Bazuar në këto dispozita rezulton se për zhvillime komplekse dhe ato që lidhen me zona të caktuara apo objekte të rëndësishme kombëtare është KKT-ja që jep lejen e zhvillimit dhe të ndërtimit.

Marrë në analizë sa më sipër dalin qartë faktet që Këshilli i Ministrave përcakton rregulloren e zhvillimit të territorit dhe nuk mund të delegoj te KKT-ja që kjo e fundit të miratojë rast pas rasti rregullore te posaçme për të përcaktuar distancat midis objekteve për lejet që ky i fundit ka në kompetencë të jap.

Ligjvënësi kur ka bërë këtë parashikim, pra dhënien e kompetencës për përcaktimin e rregullore së zhvillimit të territorit Këshillit të Ministrave ka pasur parasysh si respektimin e parimit të “sigurisë juridike” i cili është shumë i rëndësishëm në një shtet demokratik ashtu dhe faktin që të mos dëmtojë subjektet e tjera. Doktrina juridike e se drejtës kushtetuese ka pranuar se siguria juridike është një ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës. Në vendimet e saj ajo shprehet se “*siguria juridike parakupton besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluar. Besueshmëria ka të bëjë me faktin që qytetari nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve normative që cenojnë dhe përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Parimi kushtetues i shtetit të së drejtës do të konsiderohet i dhunuar nëse mohohen ose shkelen siguria juridike, stabiliteti ligjor dhe mbrojtja e pritshmëri të ligjshme. Ligjvënësi nuk mund të përkeqësojë në mënyrë të paarsyeshme gjendjen ligjore të personave, të mohojë të drejtat e fituara ose të shpërfill interesat legjitime të tyre. Për këtë qëllim ligji duhet të ofrojë siguri qartësi, vazhdimësi në mënyrë që individët të drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të (vendime të Gjykatës Kushtetuese nr. 20, datë 29.9.2008, nr. 9, datë 26.2.2007 nr. 8, datë 2.5.2006 dhe nr. 36/2007)*

Në vazhdim të kësaj analize, si dhe të analizës së bërë me lart, ky kolegji thekson dhe njëherë se

nuk mundet në asnjë rast që organi administrativ të ndryshojë me anë të akteve administrative /nënligjore atë çka ligji ka përcaktuar qartë.

Parashikimet e bëra në ligj janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga ana e organit administrativ, Këshilli i Ministrave në rastin konkret.

Në rast se ligjvënësi do t’i jepte të drejtë organit administrativ në rastin konkret Këshillit të Ministrave të delegonte të drejtën e hartimit të rregullores së përcaktimit të distancave midis objekteve tek organet e ngarkuara me ligj për lëshimin e lejes së ndërtimit, ai patjetër për shkak të rëndësisë së madhe që ka ky fakt dhe pasojat që sjellin akte të tilla, do ta kishte bërë një parashikim të tillë në ligj të shprehur në mënyrë të qartë dhe të saktë dhe nuk do ta linte këtë në dëshirën e organit administrativ.

Ligjvënësi e ka parashikuar dhe është shprehur qartë në ligj duke i përcaktuar në mënyrë shteruese kompetencat e organit administrativ, Këshillit të Ministrave. Ai duhet të ushtrojë vullnetin e tij brenda kornizës ligjore dhe në interes të publikut.

Kështu në analize të nenit 6/2/b të ligjit nr. 107/2014, i cili përcakton kompetencën që i është dhënë Këshillit të Ministrave, vetëm ky organ ka të drejtën të miratojë rregulloren e zhvillimit të territorit dhe jo të delegojë kompetencën tek KKT pra që edhe kjo e fundit, të përcaktojë vetë distanca midis objekteve me rregullore te posaçme të miratuar prej tij për objektet që ai ka në kompetencë për nxjerrjen e lejes së ndërtimit sipas nenit 19 të VKM-së nr. 408/2015 i ndryshuar.

Përfundimisht Kolegji Administrativ i Gjykatës Administrative të Apelit në interpretim të dispozitave të ligjit konkludon që Këshilli i Ministrave është organi i vetëm që përcakton dhe miraton rregulloren e zhvillimit urban dhe nuk mund ta delegojë atë tek një organ tjetër, pasi në asnjë rast ligji nuk e përcakton shprehimisht që Këshilli i Ministrave mund të bëjë këtë delegim.

Nxjerrja e dispozitës, pika 12 e nenit 34 nga Këshilli i Ministrave, sipas të cilës parashikohet se: **Për objektet në kompetencë të Këshillit Kombëtar të Territorit, sipas nenit 19, të kësaj rregulloreje, distancat midis objekteve mund të përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit me rregullore të posaçme, të**



miratuara prej tij”, pa qenë në asnjë nga kushtet e parashikuara nga neni 6/2/b i ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” passjell faktin që pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin organik dhe për rrjedhojë ky përcaktim i parashikuar në nenin 34/12 të VKM-së nr. 231 datë 21.3.2017 është i paligjshëm si i tillë duhet të shfuqizohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 40/1, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar

VENDOSI:

- Pranimin e padisë.
- Shfuqizimin e pikës 12, të nenit 34, të VKM-së nr. 408 datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 231, datë 21.3.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-n nr. 408, datë 13.5.2015.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.
- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë, brenda 30 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmeja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall më datë 6.5.2019 në Tiranë.

Kryesuese: Alkelina Gazidedja

Anëtarë: Amarildo Laçi, Artur Malaj,

Anëtarë kundër: Bari Shyti, Enkelejda Metaliaj (Softa)

MENDIM PAKICE

Ne gjyqtarët, Enkelejda Metaliaj (Softa) dhe Bari Shyti parashtrojmë mendimin kundër në lidhje me çështjen që ju përket palëve:

PADITËS: Aleksander Meksi, Dhurata Meksi, Manushaqe Zhulali, Elsa Zhulali, Julian Demeti, Fatmir Karapici, Vjollca Karapici, Neim Çipi, Lumturi Çipi, Ana Topalli, etj.

IPADITUR: Këshilli Ministrave, gjykim në mungesë.

Pale e tretë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i pjesshëm i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit, i ndryshuar, dhe konkretisht të pikës 12 të nenit 34, siç është ndryshuar nga neni 23, i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 231, datë 21.3.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, me këtë përmbajtje: “Për objektet në kompetencë të Këshillit Kombëtar të Territorit, sipas nenit 19, të kësaj rregulloreje, distancat midis objekteve mund të përcaktohen nga Këshilli Kombëtar Territorit me rregullore të posaçme, të miratuara prej tij”.

Ka rezultuar e provuar nga aktet e dosjes sikundër e pranon edhe shumica se:

Rezulton se paditësit janë banorë të qytetit të Tiranë dhe banojnë në rrugën Ibrahim Rugova, në pallatin nr. 27 dhe 27/1. Gjithashtu paditësit janë edhe bashkëpronarë të pasurisë truall me sipërfaqe 146.28 m² dhe 171 m² me nr. pasurie 4/195; vol. 78, faqe 94 dhe nr. pasurie 4/541, Vol. 69, f. 155, zona kadastrale 8270 sikundër provohet nga certifikatat e vërtetimit të pronësisë datë 9.6.2015.

Këshilli Kombëtar i Territorit, me vendimin nr. 11, datë 20.6.2018 ka miratuar lejen zhvillimore në favor të subjektit “Invest Society” sh.p.k., për ndërtimin e një godine 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9-katëshe në Rrugën “Ibrahim Rugova”, Tiranë.

Rezulton se Këshilli Kombëtar i Territorit ka miratuar dokumentin rregullorë e veçantë për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin godinë polifunksionale Residence 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 kat në Rrugën “Ibrahim Rugova”, Bashkia Tiranë.

Në pikën 4.3 të saj “Përcaktimi i treguesve për zhvillimin të projektit” janë përcaktuar treguesit e zhvillimit të projektit, distancat nga kufiri i pronës, distancat nga aksi i rrugës, distancat nga trupi i rrugës etj.

Me vendim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës nr. E-22296/7, datë 3.10.2018 është miratuar leja



e ndërtimit për objektin “Godinë polifunksionale West Residence 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 kate, me 4 kate parkim nën tokë”, në Rrugën “Ibrahim Rugova”, Njësia Administrative nr. 5, Tiranë, me zhvillues Shoqëria “INVEST SOCIETY” dhe subjekt ndërtues Shoqëria “TDT & PARTNERS. Ndërtimi i ri është kufitar me pronën e paditësive, të kanë paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me objekt *Shfuqizimin e aktit administrativ: vendim i KKT nr. 11, datë 20.6.2018 “Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin “Godinë polifunksionale West Residence 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 kate, me vendndodhje në Rrugën “Ibrahim Rugova”, Bashkia e Tiranës”, me subjekt zhvillues shoqërinë “INVEST SOCIETY”. Shfuqizimin e aktit administrativ të vendimit të Kryetarit së Bashkisë së Tiranës nr. E-22296/7, datë 3.10.2018 “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin “Godinë polifunksionale East Residence 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 kate, me 4 kate parkim nën tokë”, në rrugën “Ibrahim Rugova”, Njësia Administrative nr. 5, Tiranë, me zhvillues Shoqëria “INVEST SOCIETY” dhe subjekt ndërtues Shoqëria “TDT & PARTNERS”.*

Në bazë të nenit 6/2/b, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, mbi propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, i padituri Këshilli i Ministrave ka nxjerrë vendimi nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

Në këtë VKM, në nenin 34, janë përcaktuar distancat minimale midis ndërtimeve.

Me propozim të ministrit të Zhvillimit Urban, i padituri Këshilli i Ministrave ka nxjerrë vendimin nr. 231, datë 21.3.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, i cili ka ndryshuar nenin 34 me përmbajtjen si më poshtë:

Distancat minimale midis ndërtimeve

1. *Distancat minimale midis dy fageve, ku të paktën njëra ka dritare, sipas këtij neni garantojnë kushtet minimale të standardeve të ndriçimit e mbrojtjes nga zjarri dhe përcaktohen si gjatësia e vijës pingule midis planeve më të afërta të fageve që përballin njëra-tjetrën.*

2. *Distanca minimale e lejuar midis dy ndërtimeve do të matet me shumën e numrit të kateve mbi tokë të ndërtimeve që përballen plus 2m, sipas formulës më poshtë:*

$d = nr. k \text{ obj. } A + nr. k \text{ obj. } B + 2m, ku:$

d - distanca minimale midis dy ndërtimeve.

$nr. k$ - numri i kateve.

3. 6. Në rastet e zonave historike dhe të mbrojtura, monument kulture, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi, respektohen distancat ekzistuese të tipologjisë arkitektonike historike në zonë.

7. 10. Pavarësisht sa përcaktohet në këtë nen, hapësirat që krijohen nga distancat dubet të jenë të tilla që për çdo ndërtim të sigurohet akses i drejtpërdrejtë nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri në të paktën 2 fage të ndërtimit dhe midis ndërtimeve. Nënkalimet tunnel të ndërtesave të gjata janë minimalisht 5 metra të gjera dhe 5 metra të larta, për të lejuar kalimin e lirshëm të ambulancës ose zjarrfikëses.

11. 12. **Për objektet në kompetencë të Këshillit Kombëtar të Territorit, sipas nenit 19, të kësaj rregulloreje, distancat midis objekteve mund të përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit me rregullore të posaçme, të miratuara prej tij”.**

Pikërisht pikën 12 të nenit 34 të rregullores së zhvillimit urban, kërkon pala paditëse të shfuqizohet nëpërmjet padisë së paraqitur në Gjykatën Administrative të Apelit.

Shumica e këtij kolegji, duke pranuar pretendimet e palës paditëse, çmoi se dispozita e pikës 12 të nenit 34 të VKM-së nr. 408 datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, ndryshuar me VKM nr. 231 datë 21. 3.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, për shkak se vlerëson se ky rregull i përgjithshëm vjen në kundërshtim me autorizimin ligjit. Sipas shumicës, pala e paditur, KM-ja, nuk kishte autorizim nga ligji nr. 107/2014 për të deleguar rregullat e zhvillimit të territorit tek organet e tjera publike, pasi ligji ia ka ngarkuar KM përcaktimin e rregullave në ndërtim dhe asnjë organi tjetër.

Pakica ndahet në qëndrim me shumicën lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjes si dhe argumentet që ajo parashtrohet për pranimin e padisë në themelin e saj (ligjshmërinë e aktit nënligjor normativ), ndërsa sa i përket anës formale të saj paraqitjes së padisë, legjitimitetit të palës paditëse, afatit të paraqitjes së padisë dhe kompetencës lëndore e funksionale për



gjykimin e kësaj çështje që është Gjykata Administrative e Apelit, pakica ndan të njëjtin qëndrim me shumicën.

Ndryshe sa ka konkluduar shumica, pakica vlerëson se dispozita e aktit normativ objekt kundërshtimi me padi, nuk kishte shkaqe ligjore për ta shfuqizuar.

Për të vlerësuar ligjshmërinë e një akti administrativ (Individual apo normativ nënligjor), pakica çmon ti referohet nenit 37/3 të ligjit nr. 49/2012, dispozitë kjo e cila vendos kriteret mbi të cilat vlerësohet përputhshmëria e aktit administrativ me qëllimin dhe qëllimin dhe përmbajtjen e ligjit.

Kështu pika 3 e nenit 37 të ligjit nr. 49/2012 ka përcaktuar;

3. Në rastin kur ligji i jep organit publik të drejtën për zgjedhje alternative, në nxjerrjen e një akti administrativ apo në kryerjen e veprimit tjetër administrativ, gjykata shqyrton edhe nëse:

a) *zgjedhja nga organi publik është bërë në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit;*

b) *zgjedhja nga organi publik është bërë vetëm për të arritur qëllimin e ligjit;*

c) *zgjedhja nga organi publik është në raport të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë;*

Pakica çmon se rregulli i vendosur nga organi administrativ në pikën 12, të nenit 34, të VKM-së nr. 231 datë 21.3.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, është në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit, dhe se zgjedhja e këtij rregulli është bërë vetëm për të arritur qëllimin e ligjit, çështje këto të shtruar për diskutim në rastin konkret.

Për të kuptuar nëse zgjedhja nga organi publik është bërë në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit dhe vetëm për të arritur qëllimin e ligjit, duhen parë në tërësi dhe në harmoni me njëra tjetrën dispozitat e ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin e territorit si dhe çfarë rezervash ligjore ka parashikuar Ligji në dispozita të veçanta të tij.

Duke qenë se në rastin konkret, nga pala paditëse kundërshtohet rregulli i vendosur në VKM nr. 231, datë 21.3.2017, ku në pikën 12 të nenit 34 me titull “*Distanca minimale midis ndërtimeve*”, është përcaktuar se; **Për objektet në kompetencë të Këshillit Kombëtar të Territorit, sipas nenit 19, të kësaj rregulloreje,**

distanca midis objekteve mund të përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit me rregullore të posaçme, të miratuara prej tij”, lypset para se gjithash të përcaktohet se çfarë kompetence i ka deleguar ligji nr. 107/2014 KM, në raport me kompetencat që vetë ligji i ka caktuar KKT.

Në pamje të parë, duket sikur Këshilli i Ministrave i ka deleguar KKT-së kompetencën për të nxjerrë rregulla mbi planifikimin dhe ndërtimin, kompetencë të cilën sipas germës “b”, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 107/2014 i takon KM-së.

Në nenin 6, me titull “Përgjegjësitë e Këshillit të Ministrave”, germa “b” të pika 2, të ligjit nr. 107/2014 është parashikuar:

2. Këshilli i Ministrave është përgjegjës për:

a) *miratimin e Planit të Përgjithshëm të Territorit;*

b) *miratimin e rregulloreve të planifikimit, zhvillimit, ndërtimit, rregulloreve të Regjistrimit të Integruar të Territorit si dhe të dokumenteve tjera sipas përcaktimeve të këtij ligji;*

Në nenin 2 të tij, ligji nr. 107/2014 ka dhënë përkufizimin e termave të përdorur.

Kështu në pikat 35, 36 e 37 jepet përkufizimi për rregulloren e planifikimit, të zhvillimit dhe të ndërtimit si vijon;

35. **“Rregullore e planifikimit”** është rregullore e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, që përcakton rregulla të unifikuara për përmbajtjen dhe strukturën e dokumenteve të planifikimit, sipas kreut II të këtij ligji.

36. **“Rregullore e zhvillimit”** është rregullore e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave që përcakton kushtet dhe procedurat e detajuara për zbatimin e instrumenteve të drejtimit të zhvillimit dhe për përmbajtjen, strukturën dhe procedurën e miratimit të dokumenteve të kontrollit të zhvillimit, sipas kreut III të këtij ligji.

37. **“Rregullore ndërtimi”** është rregullorja e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, që përcakton normat dhe kushtet teknike bazë të detyrueshme për garantimin e qëndrueshmërisë së strukturave, hapësirave të emergjencës, ndriçimit adekuat dhe ventilimit, ruajtjen e energjisë dhe sigurinë e jetës, në lidhje me objektet e reja dhe ato ekzistuese, për të mbrojtur shëndetin publik, sigurinë dhe mirëqenien e përgjithshme të banorëve, si dhe për përshatjen e hapësirave për përdorimin nga persona me aftësi të



kufizuar. Rregullorja bazohet në standardet ndërkombëtare dhe përfshin norma teknike të përshtatura për Shqipërinë.

Në kuadër të miratimit të rregullave të zhvillimit, Këshilli i Ministrave në nenin 34 të tij ka përcaktuar, ***Distancat minimale midis ndërtimeve***, duke parashikuar distanca të ndryshme për lloje të ndryshme objektsh, ndërsa për objektet për të cilat është kompetente për lëshimin e lejes së zhvillimit dhe lejes së ndërtimit KKT, përcaktimin e distancave ia ka ngarkuar vetë këtij organi.

Me përcaktimin e këtij rregulli, Këshilli i Ministrave ka ushtruar plotësisht përgjegjësinë që i ka përcaktuar neni 6, pika 2 e ligjit nr. 107/2014, duke vendosur rregulla të posaçme për distancat që duhet kihen parasysh nga organet administrative në lëshimin e lejeve të zhvillimit dhe lejeve të ndërtimit.

Lidhur me Autoritetet përgjegjëse për zhvillimin e territorit, në nenin 28 të ligjit nr. 107/2014 janë përcaktuar Përgjegjësitë e KKT-së;

1. KKT-ja është autoriteti përgjegjës për vendimmarrjen për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi për llojet e zhvillimit komplekse, të përcaktuara në rregulloren e zhvillimit, dhe ato që lidhen me çështje, zona, objekte të rëndësishme kombëtare apo me investime strategjike për interesat e vendit, mbi propozimin e ministrisë që mbulon sektorin apo zhvillimin përkatës.

Pra është e qartë se KKT-ja është autoriteti përgjegjës për dhënien e lejeve të zhvillimit dhe lejeve të ndërtimit për llojet e objekteve të cilat sipas rregullores së zhvillimit janë në kompetencë të saj. Lidhur me këtë parashikim të ligjit, në rregulloren e zhvillimit, në nenin 19 të saj janë përcaktuar objektet për të cilat është kompetentë të lëshojë leje zhvillimi dhe leje ndërtimi KKT-ja.

Kështu në nenin 19, të VKM-së nr. 408 është përcaktuar:

1. Llojet e zhvillimit komplekse për vendimmarrjen e të cilave është përgjegjës Këshilli Kombëtar i Territorit, në bazë të nenit 28, të ligjit, janë:

a) centralët prodhues të energjisë, pjesë e sistemit elektro-energetik të vendit, në përputhje me legjislacionin e posaçëm në fuqi;

b) impiantet e prodhimit dhe të përpunimit të gazit, naftës e bitumeve, naftës-jellësit dhe gazsjellësit, depot e naftës, gazit dhe derivateve të naftës me kapacitet mbi 500 tonë;

c) impiantet e trajtimit dhe strukturat e depozitimit të mbetjeve, të ngurta dhe të lëngshme, të çdo lloji, si dhe impiantet e trajtimit të ujërave të përdorura sipas klasifikimeve të legjislacionit të posaçëm në fuqi;

ç) aeroportet, portet e pasagjerëve, portet dhe terminalët, të çdolloj natyre dhe madhësie sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi;

d) korpuset universitare, qendrat universitare dhe të kërkimit shkencor, përfshirë kampuset;

dh) spitalet, qendrat dhe komplekset spitalore;

e) strukturat e institucioneve ndëshkuese dhe edukuese;

ë) resorte dhe fshatra turistike tradicionale, komplekse parqesh ujore, argëtimi apo zhvatitjeje, që përmbajnë ujë në basen, mbi 5 000 m³, impiante skish, teleferikë dhe infrastruktura ndihmëse.

f) muze të dhe teatrot kombëtare, veprat monumentale me rëndësi kombëtare, objektet në zonat e mbrojtura në përputhje me ligjin sektorial;

g) pikat doganore dhe kufitare;

gj) minierat, kriporet, karrierat, pika nxjerrjeje dhe shfrytëzim inertesh;

h) strukturat dhe infrastrukturat ushtarake sipas legjislacionit të posaçëm;

i) stacionet dhe objektet e Policisë së Shtetit apo shërbimeve inteligjente;

j) stacionet e shërbimit zjarrfikës;

k) Banka e Shqipërisë;

l) Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut;

ll) strukturat dhe qendrat e prodhimit e të përpunimit të industrisë metalurgjike, farmaceutike, kimike, armëve, lëndëve plasëse apo teknologjisë së lartë;

m) qendrat apo institucionet në të cilat kryhen veprimtari, përfshirë kërkimore dhe eksperimentale në fusha të industrisë kimike, fizikës bërthamore dhe të tjera, që klasifikohen nga legjislacioni i posaçëm në fuqi si me rrezikshmëri të lartë;

n) pjesët përbërëse të rrjeteve apo sistemeve të infrastrukturave kombëtare (bekurudha, metro, tramvaj, rrugë, autostrada, rrjete kabllorë nënujore, nëntokësore dhe ajrore, objekte dhe rrjete të furnizimit me ujë, objektet, rrjetet e komunikimit elektronik me shtrirje apo ndikim kombëtar ose rajonal);

nj) strukturat dhe rrjetet e furnizimit me ujë, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të përdorura etj., të cilat janë nën përgjegjësinë e ministrive në fushat e transportit, energjisë, administrimit të ujit, komunikimit elektronik, mbrojtjes së tokës dhe mbrojtjes së sigurisë publike e kombëtare;



o) basent ujore artificiale me kapacitete mbi 10,000 m³;

p) stadiumet me kapacitet 10,000 e më shumë vende për spektatorë;

q) urta dhe tunelet me gjatësi mbi 50 m;

r) vendparkimet publike me kapacitet mbi 5,000 mjete 4+1 ose ekuivalente;

rr) pikat e furnizimit me karburant;

s) investimet strategjike, sipas ligjit përkatës.

sh) shfuqizuar

2. Elementet përbërëse të zhvillimeve si në pikën 1, të këtij neni, përcaktohen në legjislacionin e posaçëm në fuqi.

3. Këshilli Kombëtar i Territorit është autoriteti përgjegjës për miratimin e lejeve të ndërtimit për:

a) çështje, zona apo objekte të përcaktuara si të rëndësishme kombëtare;

b) zhvillime komplekse apo rikonstruksione të tyre, sipas kategorive të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni;

c) objektet shtetërore apo rikonstruksione të tyre, kur ato ngrihen në pronat shtetërore të patransferuara te njësitë e qeverisjes vendore.

4. Për punimet që kryhen me deklaratë paraprake punimesh, sipas nenit 7, të kësaj rregulloreje, autoriteti përgjegjës është njësia përkatëse e qeverisjes vendore.

Pra është e qartë se, KKT-ja është parashikuar në ligjin për planifikimin e territorit, si një ndër institucionet përgjegjëse për miratimin e lejeve të zhvillimit dhe të ndërtimit për objekte veçanërisht të rëndësishme, të cilët për nga natyra dhe specifika që kanë, rregullat dhe standardet e ndërtimit nuk mund të parashikohen në mënyrë të plotë dhe ezauresuese në një rregullore, siç është ajo për zhvillimin e territorit. Kështu në ndërtime të tilla si, stadione, vendparkime qendra kërkimi shkencor, muze, aeroporte, kampuse universitare, pa përmendur lloje të tjera objektesh si impiantet e trajtimit dhe strukturat e depozitimit të mbetjeve, të përpunimit të gazit dhe naftës, rrjete rrugore hekurudhore apo rrjete ujësjellësish dhe kanalizimesh, është objektivisht e pamundur por edhe paarsyeshme që të parashikohen rregulla dhe standarde ndërtimi në rregulloren për zhvillimin e territorit që miraton KM në zbatim të pikës 2/b të nenit 6 të Ligjit nr. 107/2014.

Gjithsesi, lidhur me ndërtimet të natyrës objekte banimi dhe shërbimi, ku ka premisa të cenohen të drejtat e gëzimit të lirë të

pronës nga të tretët, në rregulloren e miratuar nga KM janë përcaktuar rregulla dhe standarde të cilat janë të detyrueshme për tu zbatuar nga çdo institucion përgjegjës për miratimin e lejeve të zhvillimit apo të lejeve të ndërtimit.

Kështu në TITULLIN IV të VKM-së nr. 408 të ndryshuar, janë përcaktuar orientimet kryesore dhe standardet e zhvillimit dhe të distancave ndërmjet ndërtimeve. Një nga standardet e ndërtimit që duhet të respektohet nga institucionet përgjegjëse për planifikimin e territorit janë treguesit e distancave të ndërtimit. Në mënyrë të përgjithshme, rregullorja e zhvillimit ka parashikuar që, *distancat duhet të jenë të tilla që të mos cenojnë lirinë e përdorimit të pronës, të krijojnë hapësira publike dhe/ose funksionale të nevojshme për shërbimet ndaj komunitetit dhe të garantojnë siguri individuale dhe shëndetësore* (pika 2 e nenit 33 të VKM-së nr. 408). Treguesit bazë të përcaktuar nga rregullorja e zhvillimit të territorit miratuar me VKM-në nr. 408 e ndryshuar, janë të detyrueshëm për t'u zbatuar nga autoritetet e zhvillimit gjatë hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit (pika 1 e nenit 33 të VKM-së nr. 408).

Me tej, në nenin 34 të saj, rregullorja e zhvillimit të territorit ka përcaktuar distancat minimale midis ndërtimeve për disa lloje ndërtimesh dhe sipas konstruksionit të ndërtimit si dhe distancat nga akset e rrugëve sipas një formule të mirëpërcaktuar.

Në pikën 10 të kësaj dispozite është parashikuar standardi minimal për distancat midis ndërtimeve, ku rregullorja e zhvillimit ka parashikuar si rregull përjashtimor që, distancat duhet të jenë të tilla që për çdo ndërtim të sigurohet akses i drejtpërdrejtë kundrejt shërbimit të mbrojtjes nga zjarri në të paktën 2 faqe të ndërtimit dhe midis ndërtimeve.

Për rastin e ndërtimeve ku leja e zhvillimit dhe e ndërtimit është në kompetencë të KKT-së, për shkak të natyrës së veçantë dhe rëndësisë së llojit të ndërtimeve, Rregullorja e zhvillimit e miratuar me VKM-n nr. 408 e ndryshuar, i ka lejuar KKT-së që të përcaktojë rregulla të posaçme lidhur me distancat **midis objekteve**.

Ky rregull, në vlerësim të pakicës nuk do të thotë aspak që standardi i ndërtimeve për ndërtime të tilla si objekte banimi, të miratuar



nga KM-ja në rregulloren e zhvillimit të territorit mund të cenohet, apo që KM-ja i delegon këtij organi përgjegjësi që ligji ia ka ngarkuar posaçërisht KM-ja. Ky rregull i detyrueshëm për zbatim nga çdo institucion përgjegjës për planifikimin, është sanksionuar në mënyrë imperative në pikën 1, të nenit 33, të rregullores ku është parashikuar shprehimisht; **“Treguesit bazë të përcaktuar nga kjo rregullore janë të detyrueshëm për t’u zbatuar nga autoritetet e zhvillimit gjatë hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit”**.

Për sa më sipër, në analizë të fakteve të çështjes dhe dispozitave të lart cituara, pakica vlerëson se nëpërmjet rregullit të parashikuar në pikën 12 të VKM-së nr. 231/2017, KM-ja nuk ka deleguar ndonjë kompetencë që ligji ia ka ngarkuar atij, por në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit, për të arritur qëllimin e ligjit, duke vepruar në këtë rast në raport të drejtë me nevojën që i ka diktuar vendosjen e këtij rregulli, për shkak të natyrës së veçantë të vendimeve që janë në përgjegjësi dhe kompetencë të KKT-së, ka urdhëruar që kjo e fundit kur merr vendime për leje zhvillimore apo leje ndërtimi duhet të përcaktojë edhe rregulla të posaçme lidhur me distancat, që sikurse theksuam më lart është objektivisht e pamundur të përcaktohen në rregulloren e zhvillimit, për të gjitha kategoritë e objekteve të përcaktuara në nenin 19 të rregullores.

Pretendimet e saj për cenim të të drejtës së pronës, për shkak të vendimeve të dhëna nga autoritetet përgjegjëse për planifikimin e territorit të përcaktuara në ligjin nr. 107/2014, pala paditëse mund ti parashtrojë në përputhje me kuadrin ligjor që rregullon të marrëdhëniet juridike në fushën e të drejtës së pronësisë si dhe të përcaktimeve dhe standardeve të shprehura qartësisht në disa dispozita të kësaj rregullore, kur bëhet fjalë për ndërtime në zona banimi.

Për sa më sipër, pakica vlerëson se padia nuk gjen mbështetje në ligj e prova dhe si e tillë duhej të rrëzohej.

GJYQTARE

Enkelejda Metaliaj (Softa)

GJYQTAR

Bari Shyti

VENDIM

Nr. 164, datë 27.6.2019

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Nr. Regj. Themeltar 116

Datë 10.6.2019

Gjykata Administrative e Apelit e përbërë nga:

Kryesuese: Alkelina Gazidedja

Anëtar: Amarildo Laçi

Anëtar: Bari Shyti

Anëtar: Artur Malaj

Anëtare: Enkelejda Metaliaj (Softa)

Asistuar nga sekretare gjyqësore Raimonda Aliaj, në dhomë këshillimi të datës 27.6.2019, mori në shqyrtim çështjen që u përket palëve:

KËRKUES: Aleksandër Meksi, Dhurata Meksi, Manushaqe Zhulali, Elsa Zhulali, Julian Demeti, Fatmir Karapici, Vjollca Karapici, Neim Çipi, Lumturi Çipi, Ana Topalli, Joana Topalli, Fatbardh Metaj, Fatmire Metaj, Esat Myftari, Shqipe Myftari, Brikena Likaj, Vjollca Konica, Suzana Arbnori, Gjystina Arbnori, Filip Arbnori, Kozeta Todi.

Pala e paditur në vendimin që kërkohet të plotësohet: Këshilli Ministrave

Palë e tretë në vendimin që kërkohet të plotësohet: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

OBJEKTI: Plotësimin e vendimit nr. 111, datë 6.5.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Neni 1/2 i ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, si dhe neni 313 i K.Pr. Civile.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Pasi shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi:

VËREN:

Rezulton se, kërkuesit janë paditës në vendimin që kërkohet plotësim vendimi.

Rezulton se Gjykata Administrative e Apelit ka marrë në shqyrtim çështjen me palë dhe objekt:



PADITËS: Aleksandër Meksi, Dhurata Meksi, Manushaqe Zhulali, Elsa Zhulali, Julian Demeti, Fatmir Karapici, Vjollca Karapici, Neim Çipi, Lumturi Çipi, Ana Topalli, Joana Topalli, Fatbardh Metaj, Fatmire Metaj, Esat Myftari, Shqipe Myftari, Brikena Likaj, Vjollca Konica, Suzana Arbnori, Gjystina Arbnori, Filip Arbnori, Kozeta Todi, Rexhep Uka, Luljeta Uka, Shaqir Vukaj, Sabrije Vukaj, Bardh Spahia, Mirela Bardhi.

Të gjithë paditësit përfaqësuar në gjykim nga Av. Erind Merkuri me prokurë të posaçme datë 14.12.2018

I PADITUR: Këshilli Ministrave, gjykim në mungese.

Avokatura Shtetit, përfaqësuar në gjykim nga Gramoz Meçani me urdhrin e emërimit nr. 8 datë 16.1.2019.

Pale e tretë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, përfaqësuar në gjykim nga Etleva Malile me autorizim të datës 19.2.2019 me nr. 1834/1 prot.

OBJEKTI: Shfuqizimi i pjesshëm i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit, i ndryshuar, dhe konkretisht të pikës 12 të nenit 34, siç është ndryshuar nga neni 23, i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 231 datë 21.3.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar, me këtë përmbajtje: “Për objektet në kompetencë të Këshillit Kombëtar të Territorit, sipas nenit 19, të kësaj rregulloreje, distancat midis objekteve mund të përcaktohen nga Këshilli Kombëtar Territorit me rregullore të posaçme, të miratuara prej tij”.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta, nenet 18, 41 dhe 118 Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenet 8, 14 dhe neni 1 i Protokolli 1. Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, nenet 10, 15, 17, 18 dhe 37. Kodi i Procedurave Administrative, nenet 2, pika 3, 17, 22 dhe 29.

Konstatohet se ky kolegji me vendimin nr. 111, të datës 6.5.2019 ka vendosur:

- *Pranimin e padisë.*

- *Shfuqizimin e pikës 12, të nenit 3,4 të VKM-së nr. 408 dt. 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit” i ndryshuar, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 231, datë 21.3.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 408, datë 13.5.2015.*

- *Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.*

- *Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë, brenda 30 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmyja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.*

Kërkuesit (paditës në vendimin që kërkohet të plotësohet) kërkojnë nëpërmjet kësaj kërkesë plotësimin sa i përket vendimit të dhënë nga ky trup gjykues në lidhje me urdhërimin për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare në bazë të nenit 43, pika 2, e ligjit nr. 49/2012.

Kolegji Administrativ i Apelit vlerëson të theksojë se ligji nr. 49/2012 në nenin 1/2 të tij ka parashikuar se dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe.

Në ligjin nr. 49/2012 nuk ka parashikim të posaçëm në lidhje me kërkesën për plotësim vendimi, për rrjedhojë referimi do të bëhet në Kodin e Procedurës Civile neni 313 i cili parashikon se:

Plotësim vendimi

Secila nga palët, brenda tridhjetë ditëve nga shpallja e vendimit, mund të kërkojë plotësimin e vendimit, në rast se gjykata nuk është shprehur mbi të gjitha kërkesat për të cilat pala ka paraqitur prova.

Gjykata e shqyrton kërkesën me të njëjtin trup gjykues, pasi thërret palët dhe jep këtë vendim plotësues.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, sipas rregullave të përgjithshme.

Kolegji administrativ vlerëson se ky kërkim duhet të pranohet pasi Gjykata Administrative e Apelit ka marrë në shqyrtim në juridiksion fillestar padinë me objekt kundërshtimin e aktit nënligjor VKM-në nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit, i ndryshuar, dhe konkretisht të pikës 12, të nenit 34, siç është ndryshuar nga neni 23 i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 231 datë 21.3.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar. Ky akt nënligjor është



publikuar në Fletoren Zyrtare sipas parashikimeve kushtetuese.

Konstatohet se ky kolegji me vendimin nr. 111, të datës 6.5.2019, ka vendosur:

- *Pranimin e padisë.*

- *Shfuqizimin e pikës 12 të nenit 34 të VKM –së nr. 408 dt. 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit” i ndryshuar, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 231 dt. 21.3.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-n nr. 408 dt. 13.5.2015.*

- *Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.*

- *Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë, brenda 30 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmyja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.*

Pra dukshëm konstatohet fakti se gjykata nuk është shprehur për urdhërimin e publikimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare në kushtet kur është disponuar me vendim për pranimin e padisë dhe shfuqizimin pjesërisht të aktit nënligjor, vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 43 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” parashikon:

Detyrimi i publikimit

1. *Të gjitha vendimet e gjykatës publikohen në mënyrën dhe me mjetet e përshtatshme.*

2. *Vendimi për shfuqizimin e aktit nënligjor normativ, me kërkesë të gjykatës që ka dhënë vendimin, publikohet i plotë, në të njëjtën mënyrë me atë të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për botimin e aktit.*

Kolegji konstaton se në kushtet kur ka disponuar për pranimin e padisë dhe shfuqizimin e pikës 12 të nenit 34 të VKM-së nr. 408 dt. 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit” i ndryshuar, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 231 dt. 21.3.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 408 dt. 13.5.2015 i cili është akt nënligjor normative, duhej të ishte shprehur në bazë të nenit 43 pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” për publikimin e plotë të këtij vendimi me të njëjtën mënyrë me atë të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për botimin e aktit, i cili në rastin konkret është në formën e botimit në Fletoren Zyrtare. Në këto kushte kolegji konkludon se ka vend për plotësimin e

vendimit gjyqësor nr. 111, datë 6.5.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit duke urdhëruar publikimin e tij në Fletoren Zyrtare. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit nr. 111, datë 6.5.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit në mbështetje të nenit 313 të K. Pr. Civile dhe nenit 1/2 dhe 43, të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar .

VENDOSI:

Pranimin e kërkesës.

Plotësimin e vendimit gjyqësor nr. 111, datë 6.5.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Urdhërimin e publikimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit nr. 111, datë 6.5.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Kundër vendimit lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

U shpall sot më datë 27.6.2019 në Tiranë

Kryesuese: Alkelina Gazidedja

Anëtarë: Amarildo Laçi, Bari Shyti, Artur Malaj, Enkelejda Metaliaj (Softa)

NDREQJE GABIMI MATERIAL

Në vendimin nr. 381, datë 12.6.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për përzgjedhjen, kontraktimin e pagesën e avokatëve ose zyrate të avokatisë vendase ose të huaja”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 86, datë 14 qershor 2019, në faqen 6285 bëhet korrigjimi i gabimit material si më poshtë:

Në shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 21, të vendimit, fjalët “...= 20X numrin më të madh të rasteve/numrin e propozimit të radhës”, të zëvendësohet me “... = 20X numrin e propozimit të radhës/numrin më të madh të rasteve.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 812 lekë